

REFLEKSIONE MBI LUFTËN ÇLIRIMTARE NË KOSOVË

Dr. Sulejman Abazi (NESHAJ)

1. Refleksione mbi ngjarjet në Kosovë

Ti ke brengë

Unë zjarr

Vuajmë që të dy një hall...!

Në kontekstin e përgjithshëm të analizës së ngjarjeve të fundshekullit që lam pas, refleksionet mbi veprimtaritë e përmasave të karakterit kombëtar, parë në kontekstin e zgjidhjes së problemeve të shqiptarëve në Ballkan dhe të dominimit në rajon të psikologjisë së luftës kundër luftës, drejt paqes dhe lirisë, kërkojnë vëmendje të vecantë, duke mo i parë thjesht vetëm me praninë e tyre.

Në vitet që kanë kaluar nga përfundimi luftimeve në hapësirat etnike shqiptare, koha ka qenë e mjaftueshme për angazhimin serioz të personaliteteve të politikës botërore, forcave moderne të kohës dhe të faktorit shqiptar për të reflektuar mbi lëvizjen mbatëkombëtare, në kërkim të drejtësisë. Përvoja e zhvillimeve të pasluftës tregoi se prania e sfidave dhe vënies në provë të arsyes dhe vullnetit njerëzore, të politikës, diplomacisë dhe të faktorit ushtarak në Ballkanin e trazuar, bën ende që të trokasë “në cdo derën tonë” përgjegjësia e lartë kombëtare për të arritur paqen dhe integrimin në rajon.

Referencat ndaj hulumtimeve dhe vlerësimeve të kësaj periudhe nga personalitete politike, diplomatike, shkencore, të kulturës dhe të inteligjencies ushtarake botërore, gjatë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, Kosovën Lindore dhe në IRMJ, kanë dhënë kohën e nevojshme për të ofruar zgjidhjet më të drejta, dhe kjo nuk është pak për të mos u vlerësuar.

Periudha e luftës kundër kolonizatorëve serbë, shënoi një faqe të ndritur në historinë e popullit shqiptar, duke i dhuruar asaj simbolet e krenarisë e të pavdekësisë në kursorin e panteonit të Lirisë. Një luftë e ashpër e përmasave tragjike. Të vrarë, të zhdukur e të martirizuar, rreth 24 mijë vetë, një e treta e të cilëve femra. Midis tyre shkëlqen heroizmi dhe martirizimi në simbol i 2017 dëshmorëve të luftës së UCK-së, 22 prej të cilëve nga Republika e Shqipërisë dhe 28 femrave të dhunuara e të zhdukura.

Nëpërmjet materialit jetësor, protagonistët dhe pjesmarrësit në ngjarje, flasin me gjuhën e fakteve. Ata përpiqen të vlerësojnë këtë kontribut, të vlerësojnë bashkëpunimin me të gjithë elementët veprues të Aleancës Euroatlantike dhe nëpërmjet trajtimit të panoramës së gjenocidit dhe të pasojave të luftës, të arrihet të reflektohet ndaj mesazheve të fuqishme në shërbim të jetës, lirisë, paqes dhe të demokracisë.

Përballë realitetit qëndron Kosova, që sot më shumë se kurrë ndodhet në prag të evendimitit më të rëndësishëm historik, shpalljes së pavarësisë. Cdo të behet me të? Cila do të jetë e ardhmja e saj? Një shqetësim i ligjshëm, që lidhet me dilemën dhe dëshirën e zjarrtë të popullit shqiptar në Kosovën e martirizuar në me shumë se një shekull nga kolonizatorët serbë, dhe që beson se sot e ka prekur me dorë lirinë.

Pse Kosova është kaq “e dashur” për Serbinë

Trojet shqiptare në përgjithësi dhe Kosova në veçanti, fituan gjatë shekujve rëndësi të jashtëzakonëshme për mbretërit e sulltanët, për perandoritë dhe shtetet e fuqishme të Evropës, të

cilët nëpërmjet zaptimit të këtyre trojeve dëshironin të dominonin dhe të ruanin influencën e tyre në gadishullin Ballkanik dhe më gjërë. Ata e kuptonin dhe vlerësonin se kushdo që zotëronte Kosovën, kishte kontrollin mbi të gjithë rrugëkalimet që të lidhnin me Evropën Lindore.

Duke hedhur vështrimin prapa në histori, dëbimet me dhunë të shqiptarëve nga trojet e tyre, gjenocidet, masakrat dhe spastrimet etnike, historikisht janë bërë në mënyrë të organizuar mbështetur në filozofinë e mbrapshtë antishqiptare të ideologëve serbë. Albanologjia trajton fakte historike tronditëse dhe duhet të flasë më shumë për këtë në të ardhmen.

Si ai bari i keq, që befás mbin dhe fillon të rritet, ashtu filluan të lulëzojnë teoritë e persekutimit dhe kolonizimit të shqiptarëve në kancelerinë serbe. Po kush e mbjell barin e keq?! Ai nuk mbin vetë, por dhe nëse mbin, kush e lë të rritet? Si një bar i keq u lind filozofia serbe e çkombëtarizimit të shqiptarëve në trojet e tyre etnike. Këtë e vërtetojnë të gjitha memorandumet dhe elaboratet e tyre. Më në zë do të përmëdim "Nacertania" të Grashaninit (1844), duke vazhduar me teorinë e Çubriloviçit (1937-1944), të Ivo Andriçit (1939), e deri në memorandumun e Akademisë së Shkencave të Serbisë, në vitin 1986.

Në referatet e tij të viteve 30-40, Çubriloviç theksonte: "...Shqiptarët është i pamundur t'i asgjësojmë vetëm me kolonizim, ani pse ua morëm tokat më pjellore... Lypset shpërngulja e tyre në masë...Kolonistëve serbë do t'u japim armë...Turqia është e gatëshme të pranojë mbi 300 mijë shqiptarë...", dhe më tej ai shton se: "...pushteti shtetëror kur të dojë të ndërhyjë në favor të elementit të vet në luftën rreth tokës, mund të arrijë suksese vetëm atëhere, nëse vepron brutalisht".

Këto publikime në thelb ultranacionaliste, mbështetur në filozofinë serbe të dhunës dhe terrorit, nuk duan komente. Në këtë periudhë të ekzistencës dhe të veprimit të këtyre teorive famëkeqe, sipas burimeve historike, nga trojet shqiptare janë shpërngulur më se 3 milion shqiptarë, të degdisur në shumë vende të botës.

Flaka përvëluese e ngjarjeve të 81-it, preludi i shpërbërjes së Jugosllavisë

Në vitin 1974, kushtetuta e Jugosllavisë e ktheu Kosovën në një "krahinë autonome", por kjo formalisht, sepse ajo mbeti pjesë territoriale e Serbisë dhe vetëm si e tillë nuk kishte të drejtë kushtetuese për shkëputje nga federata. Në marsin e vitit 1981, studentët shqiptarë filluan demonstrata të fuqishme me kërkesa për statusin e "Kosovës Republikë". Demonstratat u shtypën me dhunë ushtarake dhe politike. Që nga ajo kohë, protagonistët e ngjarjeve tronditëse që zgjuan ndërgegjen kombëtare dhe vunë në lëvizje mekanizmin popullor, nuk i rreshtën përpjekjet e tyre për t'i kthyer këto shkëndija të luftës për liri, në një flakë përvëluese, që do të digjte përfundimisht teoritë famëkeqe të kolonializmit serb dhe pjellat e tyre, dhe do të niste rrugën e paracaktuar të shpërbërjes së shtetit federativ.

Uragani kishte kohë që kishte filluar të akumulonte forcën dhe energjitë e tij, por nga ana tjetër, kolonizatori ushtronte dhunë politike, psikologjike e ushtarake për të parapërgatitur masakrat më të rënda në historinë e kohëve moderne. Marsi i viti 1989 pason me ngjarje të tjera edhe më të rënda për çështjen shqiptare. Në kushtet e krizës së brendëshme politike të "federatës së mbetur", përballë situatës së rënduar politike, sociale dhe ekonomike, Milosheviçi ja hoqi përfundimisht autonominë Kosovës, duke rritur praninë ushtarake. Përsëri populli shqiptar në Kosovë protestoi dhe këto protesta u mbytën me gjak.

Në korrik 1989, Milosheviç zgjidhet president i Serbisë dhe në shkurt 1990, pas protestave të fuqishme të shqiptarëve, ai e shpërndan "qeverinë" e Kosovës dhe instalon atje pushtetin policor dhe ushtrinë. Ndërkaq, shqiptarët nuk i ndaluan veprimet e tyre politike. Më 2 korrik 1990, deputetët shqiptar të parlamentit krahinor shpallën "Deklaratën Kushtetuese", ku deklarohet Kosova si "njësi e pavarur" brenda Federatës Jugosllave. Më 7 shtator 1990, po ky parlament fshehurazi, në qytetin e Kaçanikut, e shpall Kosovën "Republikë". Aksioni politik i faktorit shqiptar tashmë nuk mund të ndalej më.

Rritja e pranisë ushtarake dhe dhunës serbe në Kosovë

Pas vitit 1992, në rrjedhën e ngjarjeve, duke mos qënë në gjëndje të ndalonte funksionimin e strukturave paralele shqiptare, Beogradi rriti së tepërmi praninë ushtarake dhe policore në Kosovë, shtoi dhunën dhe represionin mbi popullsinë shqiptare, filloi spastrimet nga administrata, mbyti dhunshëm lirinë e mendimit e të shtypit, mbylli shkollat fillore e të mesme, Universitetin dhe bibliotekën e tij, mbylli radion dhe televizionin në gjuhën shqipe, Akademinë e Shkencave, Institutin Albanologjik, Arkivin dhe Entin e Botimeve, duke flakur në rrugë mbi 100 mijë shqiptarë. Është koha kur kolonët serbë fillojnë të vendosen në masë në Kosovë.

Politika e një rezistence aktive paqësore e ndjekur deri në këtë periudhë, dhe në krahun tjetër, rritja e dhunës dhe represionit, afruan kushtet që situata të acarohet më tej, duke krijuar premisat e një shpërthimi të dhunshëm. Ky faktor eksploziv perceptoi në vite, në masa e qëndrime ekstreme të të dy palëve.

Reagimet e para të armatosura të shqiptarëve dhe përshkallëzimi i luftës

Në vitin 1996, kemi reagimet e para të armatosura me atentate të grupeve të armatosura shqiptare dhe në vitin 1997, për herë të parë, shfaqen publikisht tre antarët e njësitit të parë luftarak të UÇK-së, e cila më parë kishte marrë përsipër atentatet kundër postave të policisë serbe.

Në mars 1998, kemi një përshkallëzim të ngjarjeve dhe të veprimtarisë ushtarake, e fiksuar kjo në konfliktin e armatosur të Prekazit, në zonën e Drenicës. Është masakra e parë, që denoncohet në opinionin ndërkombëtar me tërë përmasat tronditëse të tij. Kam qënë disa herë në Prekaz të Skënderajt, në Drenicë, dhe kam përjetuar përmasat e kësaj masakre, gjurmët e të cilës janë të gjalla dhe sot, si simboli i terrorizmit serb, por dhe i bashkimit dhe qëndresës shqiptare në luftën për liri. Prekazi e më pas Recaku, janë aktakuza më e rëndë për bishën terroriste serbe.

Pas kësaj periudhe, konflikti i armatosur midis UÇK-së dhe makinerisë ushtarake serbe, përhapet në të gjithë Kosovën dhe pranvera e këtij viti e gjen UÇK-në me rreth 40 % të territoreve të Kosovës nën kontrollin e saj. Kjo situatë u shndërrua në një faktor dominues e të përgjithshëm politik - ushtarak, e cila u vlerësua seriozisht nga udhëheqja politike dhe shtatmadhuria jugosllave, e cila në po këta muaj, filloi një kundërofensivë me të gjitha strukturat e saj ushtarake, duke zbatuar masat e planit të parapërgatitur "Operacioni Patkoi".

Ishte koha, kur në rrethin e Tropojës kalojnë për herë të parë kufirin 20 mijë shqiptarë të Kosovës, të përzënë nga trojet e tyre. Ishte koha, kur këtë tragjedi që sapo kishte filluar të shfaqet hapur me pasoja të drejtëpërdrejta, shqiptarët po e përjetonin me dhimbje e tronditje. Ishte koha, kur po vlerësohej me shqetësim gjëndja dhe po konsolidohej mendimi, se masat e reagimit politik - ushtarak të shtetit shqiptar ishin evidente, të mundëshme, e pse jo dhe të paevitueshme. Gjëndja në Kosovë kërkonte ndërkombëtarizimin e saj

Bota ndjek me ankth tragjedinë njerëzore në Kosovë

Ditët në vazhdim, janë për protagonistët e ngjarjeve, një tablo e trishtueshme dhe e dhimbëshme e asaj që po ndodhte në Kosovë dhe në anën jugore të kufirit; momente këto, që tronditën botën moderne dhe do ta detyronin atë të mbante qëndrim të prerë ndaj regjimit fashist të Beogradit. Bota do të ndiqte me tmerr e ankth krimet, dhunën, terrorin dhe shpërnguljet masive, tërë sfondin e tragjedisë dhe të gjenocidit mbi shqiptarët e Kosovës.

Ishte koha, kur bota do të përballlej me një qëndrim tjetër krejt të kundërt. Veprimet ushtarake serbe në Kosovë kishin natyrë krimi në nivelin më të lartë të diskriminimit që ata dëshironin t'u bënin shqiptarëve, një diskriminim ekstrem me pasoja të rënda. Ndonëse shqiptarët përbënin mbi 97% të popullsisë në Kosovë, ky lloj diskriminimi po i shndërronte ata hapur në qytetarë të dorës së dytë.

Duke mbyllur sytë përpara të vërtetës, e keqja e një pjese të opinionit dhe politikanëve “të moderuar” ndërkombëtarë, qëndronte pikërisht në faktin, se veprimet serbe shikoheshin si një qëndrim dhe veprim i justifikuar, duke fshehur pikpamjet e tyre të vërteta dhe tepër negative për kohën. Ata, të verbuar prej interesave të tjera, nuk e kuptonin se agresori serb nuk e njihte dhe nuk e konceptonte dot "autostradën e paqes botërore". Ai nuk dëshironte dhe nuk kishte vullnet të futej në këtë rrugë. Koha e vërtetoi këtë.

Një luftë që tronditi shekullin

Shteti shqiptar u angazhua tërësisht në publikimin e fakteve dhe ngjarjeve rrënjëqethëse, në pritjen dhe akomodimin e qindra mijra të shpërngulurve, duke kontribuar nëpërmjet komunikatave zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Rendit Publik, për atë që po ndodhte përditë në terren. Publikimi i të dhënave krijonte ndjesinë e përhapjes së veprimeve ushtarake në drejtim të Shqipërisë, fakt ky që tërhoqte fort vëmendjen e autoriteteve zyrtare shqiptare dhe të faktorit diplomatik ndërkombëtar, për t'i dalë përpara me masa parandaluese një fatkeqësie me përmasa rajonale e më gjerë.

Makineria ushtarake serbe ishte hedhur në veprim dhe kërkonte të shtynte qëllimisht konfliktin në jug, pa e vrarë mendjen se ç'mund të ndodhte përreth. Shtatmadhuria shqiptare ndiqte me vëmendje zhvillimet e situatës dhe në këtë kuadër realizoi një sërë masash të karakterit ushtarak, të cilat kënaqë të mirëpritura në opinionin e brendshëm e të jashtëm. Një agresion i pritshëm serb në drejtim të kufijve veriorë shtetëror të Shqipërisë, ishte i mundshëm dhe kjo e komplikonte më shumë situatën.

Detyrimi dhe kostua historike

Ndoshta është e arësyeshme që të rikthehemi për një moment në vite e dekada më parë, për të dhënë një panoramë historike, e cila na bën të arësyeshëm të kuptojmë, se shteti shqiptar në vorbullën e ndikimeve dhe luhatjeve politike, ka ndjerë detyrimin dhe ka pranuar koston që i la historia në çështjen kombëtare, në veçanti për të ardhmen e Kosovës. Është kjo një çështje, e cila në vite ka qënë e mbyllur, në kuadrin e veprimeve të cikluara si “emërtesë” e udhëheqjes së lartë të shtetit shqiptar.

Qëndrimi dhe veprimtaritë e karakterit politiko - ushtarak të asaj periudhe, duke qënë në axhendën e lidërshiptit të lartë, u shoqëruan me veprime pa shumë bujë e publicitet. Është ky një aspekt i rëndësishëm, që tregon seriozitetin e qëndrimit zyrtar për të parashikuar e përballuar veprimtari, deri ekstreme të karakterit politik e ushtarak. Gjithësesi, pas kësaj "heshtje" të shtetit zyrtar shqiptar, filozofia e sigurisë kombëtare ka ekzistuar dhe ka funksionuar në ato linja dhe detyrime, që shtronte platforma e çështjes kombëtare shqiptare. Kjo filozofi nuk mund të ngatërrohet me ideologjinë që dominonte atëherë në Republikën e Shqipërisë. Ajo buronte natyrshëm dhe e kishte bazën e vet, në të drejtën e kombeve për vetvendosje, sipas parimeve të legjislacionit ndërkombëtar dhe Kartës së OKB-së. Historia vërtetoi se shqiptarët, në të gjitha trevat, ku bukës i thonë bukë dhe ujit i thonë ujë, kanë pasur dhe kanë të drejtë të projektojnë dhe realizojnë të ardhmen e tyre.

Analiza historike e situatës.

Në kushtet e izolimit politiko - ushtarak, Republika e Shqipërisë është gjendur e rrethuar nga presionet e vazhdueshme midis Lindjes dhe Perëndimit, e në veçanti nga represioni i përhershëm i shtetit federativ jugosllav. Qeveria e Beogradit, duke e parë dhe vlerësuar problemin shqiptar të njëanshëm dhe duke e paragjykuar rëndë atë, e ka konsideruar rrezik të përhershëm praninë dhe fuqizimin e Forcave të Armatosura Shqiptare. Ajo ka ndjekur në vite të gjitha ndryshimet strukturore dhe përgatitjen e komandave, shtabeve dhe trupave shqiptare, duke u

përpjekur në çdo kohë, jo vetëm të vendoste dhe të mbante ekuilibrin, por dhe supermacinë në favor të saj, në forca e mjete, veçanërisht në territoret e Kosovës.

Në thelb, populli i Kosovës kërkonte të drejtat e veta, në të njëjtën kohë, kur të dy regjimet, në Republikën e Shqipërisë dhe në Jugosllavi, ishin përfaqësues të ideologjisë komuniste. Jugosllavia titiste e mbarsur me ekstremizmin politik, ekonomik e ushtarak, të mbështetur veçanërisht me nacionalizmin ekstrem, nëpërmjet etiketimit ideologjik mudohej të përliqte brutalitetin dhe represionin ndaj shqiptarëve. Midis dy shteteve ishte Kosova, e cila për dekada përjetonte kolonizimin serb dhe aspironte për liri dhe pavarësi.

Në këtë kontekst, dallojmë një veçori të kohës: Rinia kosovare dhe inteligjenca ngrihen në lëvizje të fuqishme për të sfiduar regjimin komunistonacionalist të Beogradit. Këto shtresa, nuk menduan ndonjëherë se në Republikën e Shqipërisë ishte i instaluar pikërisht një regjim i tillë. Ata shikonin tek Shqipëria, shtetin amë, i cili nuk mund të pajtohej me kolonializimin e Kosovës. Ai nuk mund të qëndronte indiferent, kur vëllezërit e një gjaku masakroheshin, vetëm e vetëm sepse kërkonin të drejtat dhe lirinë e tyre. Në këto kushte, Kosova shikonte me shpresë e dhimbje nga shteti shqiptar dhe akumulonte përballë represionit serb vetëm urrejtje e qëndresë. Situata, nga të dy palët, impononte qëndrime ekstreme, deri në mundësinë e një konfrontim të mundshëm ushtarak.

Ideja mbi një konfrontim të mundshëm ushtarak

Ideja e këtij konfrontimi ka ekzistuar përherë midis dy shteteve dhe shtatmadhorive të tyre, duke u imponuar atyre në çdo kohë masa të veçanta të karakterit politik e veçanërisht ushtarak. Fuqizimi i Forcave të Armatosura Shqiptare në vitet 1978-të, kohë kjo kur ato njihnin kulmin e modernizimit dhe të fuqisë së tyre ushtarake, e bënte shtetin fqinj të reflektonte në masa të tjera për rritjen e kapaciteteve ushtarake, veçanërisht të prezencës në rajonin e Kosovës. Fakti, që pas viteve 1978-të e në vazhdim, Armata Jugosllave dispononte Brigada të llojeve të këmbësorisë, të këmbësorisë së mekanizuar, tankiste, artilerie, xhenjere, trupa aerodesante parashutiste, batalione kufitare, forca speciale etj. konfirmonte parapërgatitjen e tyre jo vetëm për superioritet në Ballkan, por për të përballuar lëvizjen e mundëshme për liri e pavarësi në Kosovë, duke mbajtur gjallë intensivisht presionin ndaj shtetit shqiptar.

Një presion ushtarak i rrezikshëm.

Lidershipi ushtarak shqiptar ndiqte me vëmendje organizimin dhe dislokimin e forcave jugosllave, veçanërisht në drejtimin me Kosovën. Nga vitet 1978 deri në vitin 1981, Armata Jugosllave përbëhej nga forcat tokësore, forcat ajrore dhe forcat detare, me një efektiv rreth 260 mijë vetash. Ajo përfshinte në strukturë e saj gjithashtu forcat partizane, ndihmëse të ushtrisë, në të gjithë territorin në forcat e mbrojtjes popullore dhe rininë shkollore të armatosur, në një efektiv të përgjithshëm prej 4.5 milion njerëz.

Forcat Operative përbëheshin nga 193 mijë veta të forcave tokësore, 40 mijë veta të forcave ajrore, 27 mijë veta të forcave detare dhe 16 mijë veta të forcave të mbrojtjes së kufirit. Forcat tokësore të kohës së paqes, të organizuara në 7 Zona Ushtarake (ZU) dhe një rreth autonom, përbëheshin nga 9 DK, 20 BrK, 2 BrK Mek, 11 BrT dhe 9 Br Kufitare.

Interes për Shtatmadhorinë Shqiptare në këtë kohë përbënte Zona e Dytë Ushatarke (Z2U), me qendër dhe shtabin e saj në Nish. Ky drejtim, ishte drejtimi kryesor Kosovë - Shqipëri. Forcat kryesore përbëheshin nga D2K në Nish, Br5K në Prishtinë, Br23K në Zajeçar, Br135K në Vranjë, Br211T në Nish, BrK Malore në Pejë dhe Br229 Kufitare në Knjezhevaç. Të gjitha këto forca, ishin të kompletuara në masën 70%. Një fluks të madh përbënte sasia e njëjësive rezervë të Armatës Jugosllave në drejtimin Kosovë - Shqipëri. Forcat rezerviste llogariteshin në 600 mijë veta. Në Tetovë dhe Gostivar, në pjesën shqiptare në Maqedoni, ekzistonin shtabet e 2 BrK me kompletim rezervist. Forcat e gatëshme të ushtrisë jugosllave, në vitet 1980-1981, zinin

1.2 % të popullsisë së përgjithëshme (atëhere Jugosllavia numëronte 22.5 milion banorë). Forcat e kohës së luftës, përbënin 15% të numrit të popullsisë, deri në 3.65 milion vetë.

Prani e fuqishme ushtarake në kufi me Shqipërinë

Në zonën kufitare me Shqipërinë, në një gjerësi 187 km dhe deri në një thellësi 150 km (aq sa është shtrirja e Kosovës në veri), ushtria jugosllave dispononte 14 njësi luftarake. Deri në distancën 25-70 km, 7 njësi luftarake nga të cilat 1BrKMek dhe 1BrK në Kosovë. Jugosllavia përgatitej për luftë. Ndërkaq, qeveria e Beogradit dhe institucionet e saj ushtarake, kanë ndjekur përherë me vëmendje zhvillimet politike dhe ushtarake në Shqipëri.

Kjo është një nga arsyet, që përreth kufijve të Shqipërisë, kanë qënë të dislokuara një sasi kaq e madhe forcash ushtarake në nivelin operativ dhe strategjik. Ky dispozitiv ushtarak është vlerësuar si një grupim i fuqishëm mësymës për disa drejtime kryesore, që synonin Tiranën. Planifikimi dhe përgatitja e shtabeve të Armatës Jugosllave, nuk mund të mbetej jashtë vëmendjes e të mos vlerësohej nga Shtatmadhuria Shqiptare, sepse në çdo rast në këtë "konfrontim në dukje hartash e mendimesh" qëndronte çështja e Kosovës dhe një armiqësi e vjetër, me bazë në të shkuarën historike.

Në mars - prill 1981, në shumë qytete të Kosovës, si në Prishtinë, Ferizaj, Podujevë, Mitrovicë etj, si rezultat i shkëndijës studentore, shpërthyen demonstrata të fuqishme popullore. Njohja e "statusit" të Republikës ishte një nga kërkesat kryesore, që e bëri të tronditej nga themelet shtetin jugosllav. Demonstruesit u shtypën egërsisht nga dhjetra mijra ushtarë, malicë dhe njësi të posaçme të ushtrisë jugosllave, të cilët përdorën tanket e deri aeroplanë luftarakë. Faktori ushtarak jugosllav, në atë periudhë, po i përgjigjej dy sfidave: shtypjes së lëvizjes paqësore të rinisë kosovare dhe rritjes së domosdoshme të kapaciteteve ushtarake në kufijtë me Shqipërinë. Pikërisht në kuadrin e këtyre masave represive, ashpërsohet së tepërmi qëndrimi i shtetit jugosllav ndaj Shqipërisë.

Përreth kufijve shtetëror, nga të dy krahët, fillon të forcohet qëndrimi politik dhe ushtarak. Shtatmadhuria Jugosllave në mënyrë të rrufeshme filloi ridislokimin e forcave të reja në Kosovë dhe afrimin e reparteve të nivelit taktik më pranë kufirit shqiptar. Një manovër ushtarake kjo që zbatohet në cdo rast të acarimit të gjendjes. Kjo situatë luftarake ndiqej me angazhime maksimale nga organet dhe strukturat përkatëse të Tiranës. Trupat shqiptare e kishin të qartë misionin e tyre. Ato kishin një motivim të lartë të karakterit moral dhe psikologjik. Ushtarakët shqiptarë, duke vigjëluar në buzë të kufirit, e përjetonin shpirtërisht dhe moralisht atë që po ndodhte në Kosovë. E njëjta situatë, madje në një sfond më aktiv, u përjetua pas dy dekadash, kur u përsërit e njëjta dramë, por tashmë më e dhunëshme se e para.

2. Dinakëria serbe: shqiptarët kundër shqiptarëve.

Nuk ka njeri të ndershëm në Ballkan që të mos ketë kuptuar se coptimi i Shqipërisë, është një padrejtësi historike. Ky coptim është rrjedhojë e veprimit të nacionalizmit agresiv dhe pabarazive historike të shkaktuara në dëm të popujve në rajon. Ato historikisht kanë mbjellë përçarjen dhe luftën. Edhe lufta në Kosovë ishte nxitje për rifreskimin e vetëdijes njerëzore, një thirrje e mirëdokumentuar dhe një kampanë për rizgjim, për të gjithë ata që kanë filluar të koten e të përgjumen. Ky konstatim nuk dëshmon vetëm mbi origjinalitetin e situatës që jetojmë, por edhe të një përpikmërie kohore veprimi në të ardhmen, mbi bazën e psikologjisë dominuese në hapësirën gjithëkombëtare.

Ky konstatim mbetet njëkohësisht trokitje e zëshme në vetëdijen e njerëzve, që kanë marrë përsipër t'i prijnë këtij populli në rrugën e ndritur të proceseve të vështira të arritjes së pavarësisë kombëtare dhe të integritimit në Evropë. Ky është një apel i fuqishëm për tokenë mëmë,

që pa të drejtë ne vazhdojmë të kërkojmë gjithçka prej saj, pavarësisht se e duam më shpirt atë, se e dëshirojmë në këmbë të fortë e të zonjën. E ardhmja e saj do të varet nga vlerat morale e njerëzore që do t'i japim ne bijtë e bijat e saj, të prirur nga ndjenjat e përgjegjshmërisë dhe të përgjegjësisë së lartë kombëtare.

Kjo është një shpresë për ne shpresëhumburit në të gjithë hapësirat shqiptare, një privilegj për të gjithë bashkëkombasit tanë, që nuk e patën fatin të identifikohen natyrshëm si shqiptarë, pa atë emrtim poshtërues që u kishte krijuar bezdinë nën diktatin terrorist e policor. Vlerat e luftës çlirimtare na kanë bindur, që edhe ne duhet të kemi fatin të besojnë në një të ardhme më të mirë, duke mos baritur pas të tjerëve si fajtorë pa faj, por për të merituar atë që na takon, me dinjitet e me krenari të lartë kombëtare.

Po le të kthehemi përsëri tek qëndrimi politik ushtarak i shtetit federativ përballë faktorit shqiptar.

Shqiptarët në Armatën Jugosllave.

Elementi shqiptar, në strukturat ushtarake jugosllave, përbënte përherë një veçori specifike e problematike të kësaj armate. Kosova kishte popullsinë me moshën më të re në Jugosllavi dhe në Evropë. Fakti që në shumë reparte dhe nënreparte, shqiptarët zinin rreth 30%, e në disa raste deri në 50 % të efektivave, ishte një arsye më shumë, për t'i parë e vlerësuar ata me një sy tjetër. Janë këto një pjesë e të dhënave, që janë deklaruar nga vetë ish SHSHP të Armatës Jugosllave, Viktor Bubanj, në një takim të zhvilluar në atë kohë në Akademinë Ushtarake në Beograd.

Brenda këtij realiteti dinakëria serbe ishte përherë zgjuar e në veprim. Jo vetëm kaq, por synimi i tyre ishte që në rast të një konfrontimi të mundshëm me ushtrinë shqiptare, të vendosnin në skalionet e para, pikërisht kontigjentet me shqiptarë të armatës së tyre. Kjo veçori, njihej asaj kohe dhe ndiqej me seriozitet të veçantë nga lidershipi politik - ushtarak i Tiranës, i cili tërhoqte vëmendjen shtamadhorisë dhe komandave e shtabeve të njëjësive të mëdha se "...konfrontimi me ushtrinë jugosllave do të jetë një operacion shumë delikat e me përgjegjësi".

Shqiptarët si shtetas të federatës kishin detyrimin për të kryer shërbimin ushtarak në këtë armatë. Shumë prej tyre emigruan në mosh të re në vendet e Evropës Përfundimtare, sepse nuk e duronin dot këtë angazhim juridik. Ata nuk mund të pranonin betimin përpara flamurit federativ. Opinioni shqiptar është i informuar nga fakte rrënqethëse mbi diskriminimin që u është bërë shqiptarëve në strukturat ushtarake. Ata ishin kontigjenti I dyshimtë, i pabësueshëm dhe provokoheshin në mënyrë sistematike. Nuk janë të pakta rastet kur djemtë shqiptarë sillleshin në arkivole pranë familjeve të tyre, me motivin "të vrarë aksidentalisht".

Dinakëria serbe: shqiptarët kundër shqiptarëve.

Lidershipi ushtarak jugosllav vlerësonte krijimin e vështirësive të paramenduara në rast të një konfrontimi ushtarak, të cilat do të zbatoheshin me fanatizëm nga shtabet e tyre. Në kushtet e planizimit operativ strategjik, ishte parashikuar që forcat shqiptare të viheshin para faktit, jo vetëm me ushtarë shqiptarë të kërcënuar në shpinë, por edhe të skalioneve me civilë shqiptarë, qysh në momentet e para të përhapjes së strukturave të tyre.

Përgatitja morale e psikologjike e trupave shqiptare synonte përballjen qysh në atë kohë me forcat paramilitare, të cilat konceptoheshin me qëllime të qarta nga kundërshtari. **Këto forca, nga ana e Shtatmadhorisë Shqiptare baraspeshoheshin me repartet e rregullta të ushtrisë jugosllave, madje më të rrezikëshme për misionin që u ishte ngarkuar. Këto struktura, nuk ishin gjë tjetër, veçse skalione të zeza të krimit dhe dhunës pa kufij, gjë të cilën e vërtetoi lufta së fundi në Kosovë.**

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Zbulimit të Ushtrisë Shqiptare, ishte bërë fakt tashmë që në vitin 1981, se shteti jugosllav evakuo i nga afërsitë e kufirit me republikën e Shqipërisë të

gjitha familjet me kombësi sllave. Në këto kushte, një operacioni i mundshëm i Ushtrisë Shqiptare, ishte shumë delikat dhe mjaft i vështirë.

Hapi i parë i Shtatmadhorisë Shqiptare, konceptohej përgatitja e lartë moral psikologjike dhe ushtarake e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë edhe përballë një situatë të tillë, dhe si hap i dytë, në kuadrin e detyrimeve të sigurimit kombëtar, realizimi i masave të plota të karakterit ushtarak, për një veprim të mundshëm ekstrem. Ideja e këtyre masave, në raport me zhvillimet ndërkombëtare, ishte përgatitja dhe gatishmëria e lartë për të realizuar në çdo kohë një mbështetje të fuqishme, e deri ndërhyrje për çështjen shqiptare në Kosovë.

Vizioni politik dhe ushtarak i kapërcente kufijtë shtetërorë.

Sipas deklaratës së ish Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare në vitin 1981, Veli Llakaj, vlerësohej; "...kapacitetet e ushtrisë shqiptare u përgatitën, jo vetëm për të pritur shqiptarë që do të shpërnguleshin nga Kosova, jo vetëm për të siguruar integritetin territorial të shtetit shqiptar, por dhe për të qënë plotësisht të aftë për të ndërmarrë veprime ushtarake mësimore të suksesëshme, madje të tilla që do të mund të korrigjonin edhe padrejtësitë historike".

Populli dhe ushtria shqiptare ishin të përfshirë në një veprimtari të gjërë në kuadrin e përgatitjes së mbrojtjes së përgjithëshme. Në vitet 70-83, në drejtimin verilindor ishin të disllokuara 3 Korpuse gjitharmëshe, shumë Brigada Sulmuese, disa batalione kufiri, tanke dhe një potencial i fuqishëm i artillerisë së kalibrave të ndryshëm.

Veç kësaj në hartën e Drejtorisë së Zbulimit të Shtatmadhorisë Shqiptare mbi dislokimin e forcave ushtarake në drejtimin Kosovë - Shqipëri, pasqyroheshin ekzaktësisht Br5K me vendodhje në Prishtinë, BrAT në Golesh, R5K në Gjakovë, BrK Mek në Pejë dhe bk po në Pejë. Në Nish, qëndër e Z2U ishin të vendosura, Krahu i dytë Ajror, D2K, Br211T, Br135K në Vranjë dhe forca të desantit ajror. Në Rashka ndodhej Br53K, në Kravevo Br312T dhe forcat e një BrDA. Në kufirin juglindor të Kosovës ishin të disllokuara një sasi e madhe forcash të Z3U me qëndër në Shkup, të cilat ishin rrezik real në të dy drejtimet.

Forcat e Brigadave Sulmuese të ushtrisë shqiptare në planin operativ strategjik, ngarkoheshin me detyra speciale për veprimtari të gjerë luftarake partizane në prapavija të kundërshtarit. Në arkivin e Drejtorisë së Zbulimit të ushtrisë Shqiptare ekziston harta me Nr 927 datë 29/12/1980, e cila përfshinte krahinën e Kosovës, e shkallës 1 me 200 mijë, në të cilën parashikoheshin 27 pika dhe rajone të paracaktuara për depërtim dhe veprimtari në prapavijë të armikut, të koduara sipas rregullit ushtarak. Kjo hartë u ndje e nevojëshme për t'u formuluar në kohën e pragngjarjeve dhe gjatë ngjarjeve të 81-shit në Kosovë, të cilat kishin karakter të theksuar popullor.

Ushtria shqiptare mbante peshën e sigurisë.

Kundërshtari tradicional vlerësohej si një fatkeqësi në kufi, jo vetëm për faktin se mbante nën presion politik, ekonomik dhe ushtarak shtetin shqiptar, por dhe për faktin tjetër se të njëjtin qëndrim, madje shumë më ekstrem, ai ushtronte realisht mbi popullsinë shqiptare të Kosovës. Ky motivim i dyanshëm shtronte për kohën opsionet e veta.

Qeveria dhe shteti shqiptar, në Politikën e Sigurimit Kombëtar, zbatonte masa konkrete të karakterit edukativ, organizativ, strukturor, ekonomik dhe kishte një platformë të plotë rritjes së treguesve të profesionalizmit ushtarak, për të krijuar dhe mbajtur kurdoherë në strukturat ushtarake një gjëndje të lartë moral - psikologjike, gatishmërie, duke parashikuar dhe vlerësuar deri situata ekstreme të një konfrontimi të drejtëpërdrejtë me Armatën Jugosllave. Përballja me të, mendohej se nuk do të ishte një veprim i lehtë.

Në shërbim të formimit të vlerave morale dhe psikologjike e ushtarake për t'u përballur në një rast eventual me një kundërshtar të egër, ishte vënë në veprim gjithë mekanizmi i shtetit.

Në konceptin ushtarak, me përparësi u përpunuan çështjet dhe drejtimet e reagimit të forcave të armatosura. Realizimi i stërvitjeve komando - shtabi në nivelet operative, deri dhe strategjike, si ato të koduara "Kështjella", "Drini", "Shebeniku", "Taraboshi", "A-81" etj. duke vlerësuar përballë kundërshtarit tradicional, ishte një veçori specifike e këtij reagimi.

Korpusi i Pukës mbulonte kufirin shqiptar me Kosovën

Këto veprimtari të karakterit ushtarak nuk kalonin pa lënë gjurmë në mënyrën se si reagohej matanë kufirit shtetëror. Planizimi i veprimeve të mundëshme luftarake me objekt Prishtinën dhe më larg, ishte një realitet domethënës, që vërtetonte jo vetëm shkallën e përjetimit dhe vlerësimit të situatave të rënda, por dhe synimet strategjike të këtyre strukturave.

Parashikimi në doktrinën ushtarake të kohës i elementëve të luftës partizane, që realizoheshin nga trupat sulmuese dhe ato të zbulimit për veprime në prapavijë të armikut, vlerësoheshin maksimalisht, si çështje ushtarake të paramenduara e të planizuara, në kushtet e gjëndjes politiko ushtarake dhe të relievit të Kosovës.

Në detyrat kryesore të K5K në vitin 1980, ishte mbrojtja e objekteve të rëndësishme në brezin kufitar dhe në thellësi, si fusha e Cërnicës, Helshani, fusha e Kukësit, Kroji i Bardhë, qyteti i Bajram Currit, qyteti i Kukësit, mali i Dhinës, mali i Dobreit etj. Repartet e vijës së kufirit tentonin të realizonin kohën e kompletimit 50-60 minuta, një nivel shumë i lartë dhe tregues cilësor i gatishmërisë luftarake. Në të tre Korpuset e veriut, të cilët mbulonin drejtimet me shtetin jugosllav, tërhiqte vëmëndjen veçanërisht K5K me qendër në Pukë.

Zona e mbrojtjes së K5K (Korpusi i 5 i Këmbësores), që mbulonte drejtimet operativo strategjike të rëndësishme me Kosovën, ishte objekt me përparësi i Shtatmadhorisë Shqiptare. Hapësira Operative dispononte 7760 QZ për mitroloza, 546 QZ për topat KT, 41 PZ të artilerisë, 135 km transhe e hendeklidhje. Vetëm në drejtimin Morinë – Kukës, ishte realizuar ndërtimi dhe funksionimi i 3769 QZ për mitroloza. Korpusi dispononte 12 Grupe të artilerisë dhe 3 bateri të lartësisë, 19 kompani mortajash, 15 bateri KT me një sasi 360 gryka zjarri të AT dhe 104 topa KT.

Forcat e gatëshme përballë ushtrisë jugosllave kishin përparësi. Në gatishmëri të përhërëshme luftarake ishin 8 grupe të artilerisë, 3 bateri lartësisë, 5 bateri të batalioneve armitralierë, pra 40% e artilerisë së përgjithëshme.

Situata në Kosovë impononte masa të veçanta

Analiza politiko ushtarake e kohës, duke u mbështetur në të dhënat e zbulimit që dispononte udhëheqja e lartë shtetërore, diktonte masa suplementare në kufirin verilindor. Në vitin 1980, realizohen 5 prova kushtrimi me njësitë dhe shtabin e K5K, dhe në shkallë ushtrie 43 të tilla (6 në korpusin e Shkodrës, 3 në korpusin e Burrelit) pra 14 të tilla vetëm në frontin verilindor. Në këto kushte, situata evoloi me riorganizimin e strukturave ushtarake në verilindje, duke parashikuar nevela të ndryshme të karakterit operativ, me perspektivë në përmasat operativo strategjike të karakterit kundërmësymës.

Në vitin 1981, përballë presionit jugosllav, ushtria shqiptare shikonte prespektivat e mundëshme të veprimeve të ardhëshme. Kështu, do të marrim si shëmbull planifikimin dhe realizimin pjesërisht të planit, me emrin kodik "A-81", me idenë: Të realizohej, në kushte të situatës së veçantë, një organizim i ri luftarak i forcave nëdrejtimin lindor dhe verilindor, duke pasur si qëllim kryesor idenë e lëvizjes dhe përqëndrimit të trupave sipas një plani të ri rigrupimi të paracaktuara qysh më parë.

Të krijohej ideja e një riorganizimi të ri në sistemin e ndërlidhjes e të komandim drejtimit sipas organizimit të ri të forcave dhe të mjeteve. Të përforcohej ideja e një riorganizimi të ri të forcave dhe mjeteve të ushtrisë në kushte dhe situata të paparashikuara. Kjo stërvitje u realizua

me disa komanda dhe shtabe të nivelit operativ, me mjete ndërlidhje dhe pjesmarrje e çvendosje të pjesëshme e të kufizuar trupash, teknike luftarake përfshi këtu dhe tanket.

Plani i koduar "A-81"

Studimi i hartës së planit të koduar "A-81", na jep të kuptojmë se realisht, lidershipi ushtarak shqiptar vlerësonte një veprim të mundshëm të Armatës Jugosllave dhe përgatitej për një riorganizim të ri në kushtet të reja, në veçanti për përdorimin e rezervave të Komandës së Përgjithëshme. Një plan metodik i tillë, na çon në idenë e planifikimit dhe realizimit të një kundërmësymjeje të përgjithëshme, në drejtime të kufirit me Jugosllavinë. Shkalla e këtij mobilizimi, nuk lidhet thjeshtë me ruajtjen e kufirit shtetëror, por me një kundërmësymje aktive, nëse do ta impononte situata.

Në vitin 1981, ka ndërhyrje të lidershipit ushtarak shqiptar, për të fuqizuar me forca e mjete njësitë ushtarake në drejtimin e Tropojës dhe të Kukësit, me forca mitraliere, artileri 76 mm, mortaja 120 e 160 mm, për të rritur prezencën e K5K në brezin e sigurimit. Element i rëndësishëm ka qënë vlerësimi i fortifikimit në zonën ndarëse me shtetin jugosllav.

Deri në vitet 1976, ky drejtim kapte 28% të fortifikimit të përgjithshëm, në vitet 1980-81 arriti në masën 37% dhe pas viteve 1981, ky fortifikim kapi shifrat e 51% të fortifikimit të përgjithshëm në Shqipëri. Parashikimet e përfundimit të këtij fortifikimi, që ishte i veçantë në llojin e vet, arrinin në 44 % të sasisë së përgjithëshme në shkallë vendi. Vetëm në K5K Pukë, ishin parashikuar dhe funksiononin 78 rajone mbrojtje batalioni këmbësorie, këto të tepër të fortifikuara.

Stërvitjet e ushtrisë shqiptare dhe reagimet e shtetit jugosllav

Stërvitja komando - shtabi "Drini", e parashikuar të realizohej më pas, me pjesmarrje të madhe trupash, deri në 40 mije të tillë me korpusin e veriut, vuri në lëvizje tërë mekanizmat e shtetit shqiptar. Kjo situatë në zhvillim intensiv mbante në tension dhe shkaktonte reagim tek shteti fqinj. "Në të kaluarën ne nuk kemi praktikuar ndonjëherë, që t'u bëjmë atyre (jugosllavëve, shën. im) lajmërimi për stërvitjet tona, prandaj mendoj se nuk është nevoja as kësaj radhe t'ua bëjmë". (material i E. Hoxhës, f 7 viti 71, vënë në dispozicion të MM në 21/04/82).

Korrektesa e ushtarakëve shqiptarë në veprimtari të tilla madhore përballë kundërshtarit, e vinte atë në pozitë të vështirë me lidershpin e vet politik. Në vitin 1981, në drejtimin e K5K Pukë, realizohet rikonicioni nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, me idenë e përsosjes së elementëve të rendimit të luftimit, rritjen cilësore të kapaciteteve luftarake dhe manovrueshmërisë së forcave në interes të veprimeve luftarake kundërmësymëse. Vlerat e këtij rikonicioni paraqiten në dokumentet arkivore të shumëfishta në raport me situatën që ekzistonte në Kosovë. (mat. Nr 611 dt. 21/07/81).

Stërvitja komando - shtabi "Kështjella" me K5K, por dhe me njësi të tjera të ushtrisë shqiptare, ishte një stërvitje me ide luftarake dhe planizim domethënëse. Veçojmë konceptimet e situatave ushtarake të zgjidhura nga shtabet e njëjsteve: "...si rezultat i vazhdimit të mësymjes së forcave tona, armiku pësoi humbje të mëdha dhe tërhiqet në thellësi të territorit të tij"(situata f 24). Trajtimi i problemeve të stërvitjes dhe tendenca e zgjerimit të hapsirave të mendimit ushtarak dhe vlerësimit të komandave e shtabeve të njëjsteve, në konceptin ushtarak, e kishin bazën në vlerësimin politiko - ushtarak të situatës. Stërvitjet komando -shtabi dhe ato me trupa të nivelit taktik, kanë qënë më të shpeshta.

Kohë më vonë, në vitin 1984, ish shefi i zbulimit të Z3U në armatën jugosllave të Maqedonisë, do të pohonte me gojë e vet se, "...ata (jugosllavët. shën im) mund të kalonin në regjimin e zakonshëm të gatishmërisë së reparteve të tyre përballë, vetëm atëherë kur siguroheshin se, me përfundimin e stërvitjeve të reparteve dhe njëjsteve shqiptare, ishin bërë konkluzionet dhe gjërat kishin shkuar në vendet e tyre".

Vijon nesër

3. Titulli i parë – Lufta në Kosovë drejt gjithëpërfshirjes. Titulli në faqen e dytë - Kosova drejt pavarësisë

Dr. Sulejman ABAZI (NESHAJ)

Vijon nga numri i kaluar

Nacionalizmi shqiptar ka kohë që kërkon të rigjallërohet, duke rivlerësuar hapësirën e sistemit të vlerave në sfondin e historisë sonë kombëtare. Zhvillimet në terren kishin zgjuar luanin brenda shqiptarëve dhe ata, si në shumë raste kulmore në të kaluarën historike, u përfshinë në lëvizjen në sensin e duhur të jetës shqiptare, krejt ndryshe nga sa më parë. Përballë qëndrimeve politike që vuanin nga pagjumësia, apatia, debulesa, stresi dhe pasojat e ndikimeve platonike nën frymën pacifiste, njerëzit idealistë kishin filluar të lëviznin nga vendi levat e kombit.

Jemi të prirur të pranojmë, se jetojmë në një kohë, që na duket sikur nuk ka vlerë. Edhe pa ndërhyrjen e qëllimshme ose të dhimbshme të pjesës platonike të shoqërisë shqiptare, pa ndikimin e marionetave “të verbra” politike, duke anashkaluar e shkelur rast pas rasti mbi mendimin e qartë për vlerësimin e interesave dhe të fuqisë sonë kombëtare, tani vërejmë, se shumë drejtime të jetës sonë nuk shkojnë për mirë, por agresohen deri në atë masë, sa shpesh na krijohet mendësia se jetojmë në kufijtë e një paradoksi me përmasa gjigante e pasoja të pariparueshme.

Vallë do t’ia lejojmë vetes që nesër këtë ta quajmë një tragjedi tjetër shqiptare? Pse vallë vazhdojmë të lejojmë, që të ndodhë tërë kjo “muharrebe”, ndaj një kombi të vuajtur, që meriton më shumë vëmendje në jetën e tij? Vallë, kombi shqiptar nuk ka sy për të parë, nuk ka zemër për të ndier, nuk ka gjak për t’i dhënë forcë trurit dhe shpirtit të tij, nuk ka vullnet shpirtëror për të ngritur në majat e mendimit të tij më të çmuar njerëzit më të mirë, përfaqësuesit elitë të vlerave të tij historike kombëtare?

Nacionalizmi shqiptar ka kohë që ndihet shumë keq. Na akuzojnë për të tillë, por ne nuk ndihemi sa duhet të tillë. Shqiptarët në këtë periudhë të stërgjatur kalimtare po jetojnë në dekadën e depresionit të madh shpirtëror, të kushtëzuar nga fenomenet negative, të cilat provojnë humbjen e besimit tek politikat e veta me tendenca drejt rrënimit të psikologjisë dhe frymës sonë kombëtare.

E shtrojmë problemin kaq drejtpërdrejt, pasi ndihet e nevojshme në këtë kohë sfidash, të shpërbëhet ajo psikologji e sofistikuar mbytëse, terrorizuese e deri antikombëtare, që po synon heshtjen, mënjanimin e mbylljen në vetvehte të energjive kombëtare dhe përfaqësuesve të saj më të mirë, duke i lënë hapësira veprimi dominimit në situatë të njerëzve populiste, militantë, avokatë mbrojtës të së keqes.

Po le të kthehemi tek rrjedhat e ngjarjeve në një kohë tjetër, që vuri në lëvizje mekanizmin shqiptar në hapësirën mbarëkombëtare.

Lojë e rrezikshme në të dy anët e kufirit.

Kërcënimi jugosllav ka qenë i pranishëm në çdo rast, por ky kërcënim kishte ndikimin e vet, në të shumtën e kohës, më tepër mbi vetë komandat dhe shtabet jugosllave. Do ta fragmentizoj me një ngjarje të jetuar. Rasti i ndeshjes së futbollit dhe skualifikimit të “Partizanit” të Beogradit, në vitin 1988, kalimi i njësisë të ushtrisë jugosllave të vijës së kufirit me Kosovën, në gatishmëri luftarake të lartë, tregon se Jugosllavia vlerësonte çdo situatë që ndodhte në Shqipëri. Fitorja futbollistike në Shqipëri dhe Kosovë, u vlerësua dhe u shndërrua në fitore politike dhe pikërisht kjo i trembte jugosllavët.

Në atë kohë ndodhesha në një stërvitje terreni të kursit të Lartë të Shtatmadhorisë në Tropojë. Ndeshjen e pamë nën shoqërinë e komandantit të Divizionit. Kur futbollisti i mrekullueshëm vlonjat, Kushta, shënoi golin e skualifikimit të skuadrës serbe, si një shpërthim nga dheu, dëgjuam brohoritjen e popullit të Tropojës, që ndiqte ndeshjen në ekranet televizive. Ky moment shpërthimi si me komandë, ishte shprehje e ndjesisë së lartë morale e psikologjike që zotëronte tek shqiptarët, përballë një kundërshtari të egër, e cila shkonte përherë në rritje.

Pas 25 minutash komandat dhe shtabet në tërë vijën e kufirit me Kosovën kaluan në gatishmëri të lartë. Çfarë kishte ndodhur vallë? Organet e zbulimit kishin raportuar gatishmërinë e forcave të gatshme jugosllave dhe udhëzimet e shtabeve të tyre për mobilizim. Këta ishin jugosllavët.

Në dhjetor 1981, janar të vitit 1982, realizohet një lëvizje masive e reparteve dhe nënreparteve të ushtrisë shqiptare drejt kufirit verilindor. Njësi dhe reparte, me rreth 42 mijë trupa aktive, me komanda dhe shtabe, me mbështetje të fuqishme logjistike, u zhvendosën në një kohë relativisht të shkurtër. Misioni i këtyre trupave ishte, së pari, një test për situatën matanë kufirit shtetëror, dhe së dyti, pjesëmarrja e tyre për fortifikimin masiv në terrenin shkëmbor të vijës së kufirit verilindor.

Publikimi dhe trajtimi serioz i ngjarjeve të 81-it në Kosovë, në shtypin zyrtar të kohës, krijoi një situatë mobilizimi në Republikën e Shqipërisë. Tirana zyrtare, reagoi me forcë ndaj gjenocidit jugosllav mbi popullsinë shqiptare në Kosovë dhe kërkonte të rriste presionin mbi qeverinë jugosllave, nëpërmjet sensibilizimit të faktorit ndërkombëtar.

Kush mbjell erën, do të korrë furtunën

Nuk do ta quaja utopi apo idealizëm apo një pamundësi, kur pranojmë se nuk ka asgjë të pamundshme, por ka gjëra të vështira për t'u bërë. Kjo sfidë ndaj vlerave të mendimit njerëzor, humanizmit dhe situatës në terren, atëherë e kishte pikën e saj të dobët ndaj kundërshtarit. Kjo kishte të bënte me vetë mjedisin jugosllav, të verbuar nga ndjenjat e tij shovene dhe i mbarsur me idenë fikse të supermacisë së kombit superior.

Ai nuk arrinte të kuptonte vlerat e së keqes që e kishin zënë për fyti dhe po i merrnin frymën. Ai nuk arrinte të raciononte raportet midis së mirës dhe së keqes së tij, duke i parë ato të ngërthyera, por lehtësisht në konceptin dhe veprimin shkatërrimtar me emrin, luftë. Dhe kush mbjell erën, do të korrë furtunën. Koha e vërtetoi këtë.

Vitet rrodhën të mbushura me shqetësime e privacione të rrezikshme, që do t'i kushtonin shumë shtetit shqiptar dhe ai do ta kuptonte njëkohësisht, se ishte e nevojshme ndihma, mbështetja dhe ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar, për të arritur synimet dhe për të dalë nga rrethi vicioz, në të cilin ishte mbyllur çështja jonë kombëtare.

Ushtria Shqiptare në kapërcimin e saj historik

Pas çlirimit të vendit, Ushtria Shqiptare përbënte forcën kryesore të Forcave të Armatosura. Fati i ushtrisë ndoqi tronditjet dhe kthesat e forta politike të udhëheqjes strategjike të vendit, fillimisht nën trysinë e instruktorëve jugosllavë (1945 – 1948), më vonë të këshilltarëve dhe specialistëve sovjetikë (1949 – 1960) dhe së fundi, të specialistëve kinezë. Më 10 korrik të vitit 1945, ajo u emërtua “Ushtria Kombëtare”, ndërsa në vitin 1949 “Ushtria Popullore”.

Fillimisht, në organizimin ushtarak, u ruajt struktura e divizioneve, kurse në vartësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, u krijua Divizioni i Mbrojtjes së Popullit. Në vitin 1945 – 1949 u përsos organizimi i llojeve të armëve e shërbimeve, të krijuara në ushtrinë shqiptare paraardhëse. Në vitin 1949, gjatë provokacioneve të gushtit, për herë të parë u provua sistemi i kompletimit me rezervistë në dy njësi. Në vitet ‘50 u kalua tërësisht në njësitë e kompletuara me efektiv aktiv dhe me rezervistë.

Në këtë periudhë ushtria u organizua mbi bazën e strukturës së korpuseve (deri në vitet '83, me 9 të tillë), duke arritur kulmin e fuqisë në historinë e ushtrisë shqiptare. Në periudhën 1983 – 1990 ajo u riorganizua mbi bazën e strukturës së Divizionit, gjithsejt 24 të tillë. Me një popullsi prej mbi 3 milionë banorësh në shtetin shqiptar, afërsisht ¼-ta e shtetasve shërbenin në Forcat e Armatosura në një strukturë prej 60 mijë trupash aktive dhe 380 mijë rezerviste. Pjesa tjetër ishin të inkuadruar në rininë shkollore të armatosur, në forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore dhe në Mbrojtjen Civile të Republikës.

Ndryshime strukturore në Ushtrinë Shqiptare

Në vitin 1983, tentohet dhe krijohen tre grupe drejtimi, në bazë të propozimit për krijimin e shtabeve të armatave në Ushtrinë Shqiptare: Armata Verilindore, Perëndimore dhe ajo Juglindore në drejtimin me Greqinë. Në frontin verilindor në kontakt me shtetin federativ u përfshinë divizionet e Shkodrës, Bajram Currit, Kukësit, Peshkopisë, Laçit, Bulqizës dhe Librazhdit. Masat e veçanta me karakter ushtarak në këtë periudhë, i shtoheshin veprimtarisë së dendur politike dhe diplomatike, duke hedhur hapa konkrete në terren. Kundërzbulimi shqiptar ofronte të dhëna reale dhe rrënqethëse, për gjendjen dhe situatën e rëndë në Kosovë.

Elementët e sigurisë kombëtare që zbatoheshin nga shteti shqiptar, i jepnin atij mundësinë e rizgimit të faktorit politik panshqiptar, larg “politikës pacifiste të moçalit”. Në rritjen e vlerave të saj ndikimi ishte i drejtpërdrejtë nga pasojat e rënda të politikës dhe represioneve ushtarake të shtetit federativ. Periudha e mbushur me ngjarje të rëndësishme solli në skenë atë që nuk pritej nga agresorët terroristë. Koha e dhunës dhe terrorit shtetëror mund të konsiderohej pa asnjë dyshim si një motivim dhe mekanizëm lëvizës i rizgimit politik të shqiptarëve.

Politika e Sigurimit Kombëtar në tranzicion

Aktualisht, pas viteve 1992, rrjedhojë e ndryshimeve në sistemin politiko-social në Shqipëri janë përjetuar realitete të reja, të cilat vazhdojnë të përjetojnë edhe sot, në zgjidhjen e mjaft ngjarjeve që ndryshuan sistemin politik në Republikën e Shqipërisë dhe dhanë efektet e tyre në zhvillimin e problemeve të çështjes sonë kombëtare. Dalja e shtetit shqiptar nga izolimi i gjatë, krijoi hapësirat e nevojshme për një këndvështrim të ri të çështjeve të Sigurisë Kombëtare.

Shteti shqiptar do t'ia nënshtronte strukturat e sigurisë fillesave të një reformimi rrënjësor, duke rivlerësuar ndryshimet gjeopolitike në rajon e më gjerë. Tashmë, rajoni ynë, aq i përfolur tradicionalisht, i cilësuar si "fuçi baroti", po bënte përpjekje të "zhbunkerizohej", duke synuar të linte prapa "memorjen e padëshiruar historike". Ai po orientohej drejt mbështetjes në Aleancën Euroatlantike dhe politikave të integritit në Evropë. Në këtë tranzicion të brishtë, faktori shqiptar, dita-ditës po reflekton në sy të botës mesazhe mbi prezantimin e politikave të reja të sigurisë, si një faktor i pranueshëm që kërkonte të gjeneronte siguri e paqe në rajon.

Në periudhën 1993 – 1994, stukturat ushtarake në Ushtrinë Shqiptare filluan t'i nënshtrohen riorganizimit të tyre. U shkurtua numri i divizioneve deri në 1/3-tën. Në vitin 1995, efektivi i përgjithshëm i ushtrisë shqiptare, numëronte 28 mijë vetë në shërbimin aktiv dhe 32.400 vetë në strukturat rezerviste. Në krizën e vitit 1997, si në të gjitha institucionet e vendit, ushtria shqiptare mori goditje të rënda dhe pësoi shkatërrime masive. Pas kësaj periudhe u bënë përpjekje serioze për ringritjen e saj.

Megjithatë situata gjeopolitike në rajonin ballkanik nuk ishte me ngjyrë “rozë”, po të kemi parasysh se në shtetin jugosllav mbizotëronte e njëjta situatë politike e ushtarake, pa ndryshuar aspak qëndrimin ndaj lëvizjeve të fundit në Kosovë. E megjithatë, si një rrugë e nisur pa kthim, militarizimi i skajshëm i shtetit shqiptar nuk mund të ruante përparësinë e tij si më parë. Fillesat ndaj demilitarizimit të strukturave të shtetit shqiptar, tashmë ishin një realitet.

Çështja shqiptare, një çështje e shtruar për zgjidhje

Analizat e situatës në dekadën e fundit dhe kërkesat që burojnë nga e drejta kulturore dhe etnike në Ballkan, si për të gjithë popujt e tjerë, u ka dhënë të drejtën shqiptarëve të jenë të ndjeshëm në elementët thelbësorë të sigurisë kombëtare. E veçanta e saj mbetet një domosdoshmëri joformale, por nevojë historike e kohës, për të mos humbur shanset e klimës politike të pranueshme në rajon.

Në këto kushte, çështja shqiptare në Ballkan, është një problem i shtruar për zgjidhje. Ajo është rrjedhojë e vullnetit të shprehur të shqiptarëve në dekadën e fundit të shekullit që lamë pas. Pavarësia e Kosovës, çështja e popullsisë shqiptare të Çamërisë, në Luginën e Vardarit, në Malësinë e Madhe, Kosovën Lindore, Sanxhak etj, janë probleme të mëdha, të cilat kanë specifika të veçanta. Ato, në kuadrin e kompleksitetit të vetë përmbajtjes së Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, janë një fushë e hapur, në të cilën, vullneti i kombit shqiptar duhet të gjejë prioritetet dhe forcën, për të shkurajuar tërë agresivitetin nationalist të fqinjëve tanë, të cilët, asnjëherë nuk i kanë reshtur përpjekjet e tyre në dëm të Shqipërisë.

Duke respektuar vlerat e situatës gjeopolitike në rajon, filozofia e sigurisë kombëtare duhet të shtrojë për zgjidhje arsyen historike, kundër mosdashjes historike, duke shtruar në mënyrë shencore pse shqiptarët duhet të jenë të bashkuar shpirtërisht dhe politikisht. Ky qëndrim duhet të argumentohet dhe të mbështetet jo mbi frymën antibalkanike, antieuropiane, antiprogresiste apo antiintegritet, por në arsyen e argumenteve të pakundërshtueshme historike dhe politike, përballë padrejtësisë historike, e cila ka përcjellë pasojat deri në ditët e sotme.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe konfliktit të armatosur në Kosovën Lindore dhe në Maqedoni, miratimit dhe zbatimit hap pas hapi të marrëveshjeve politike, duhet të pranojmë se situata gjeopolitike percepton çdo ditë e më shumë në favor të çështjes sonë kombëtare. Ky është një realitet dhe shanset ka kohë që trokasim në derën tonë. Sa i vlerësojmë ne ato?!!

Shqiptarët në vite e në shekuj kanë qenë të dëshiruar e të prirur të përfitojnë nga klima dhe situata e mirëkuptimit dhe mbështetjes së faktorit ndërkombëtar. Në këto kushte, është detyra dhe misioni ynë politik, të bëhemi protagonistë të këtij zhvillimi, që mban në arkiv dinjitetin dhe krenarinë tonë kombëtare për historinë tonë tragjike, por dhe të lavdishme. Momentet më të spikatura të mbasluftës së Dytë Botërore, siç janë ato të provokacioneve të gushtit të vitit 1949, të pranverës shqiptare të 81-shit, të luftës për çlirimin e Kosovës në vitet 1998-99, qëndresa, sakrificat dhe dinjiteti ynë kombëtar që ende ndihet i nëpërkëmbur, bëjnë apel edhe sot, për të ecur të sigurtë në rrugën tonë të bashkëpunimit, me vështrimin përpara e me përgjegjësi të reja drejt bashkimit kombëtar dhe integritetit euroatlantik.

Për të qenë më realistë në përfundimet e karakterit përgjithësues, është me vend të hedhim një vështrim të shkurtër në dekadën e fundit, për të arsyetur me gjakftohtësi se shanset që na ka ofruar historia, ende nuk po përfillen dhe shfrytëzohen në mënyrë efektive nga faktori politik shqiptar.

Lufta në Kosovë drejt gjithëpërfshirjes.

Këto ngjarje të rëndësishme të kësaj periudhe u bënë shkak, në pasqyrimin e disa prej momenteve më të rëndësishme të veprimtarisë së protagonistëve të luftës në të dy anët e kufirit shqiptar - shqiptar. Gjetja e re e rinisë shqiptare në Kosovë, duke ruajtur karakterin kombëtar të angazhimit të saj, bëri që “guri të fillojë rrokullisjen”, në pritje që ai të shkojë në vendin e tij. Karakteri kombëtar i këtij angazhimi heroik, mbarti brenda vetes produktin më të mirë të historisë sonë kombëtare, vlerat e traditës më të mirë luftarake, duke i bërë një shërbim të çmuar Shqipërisë.

Ndoshta nuk do ta quajmë të tepërt, që përballë asaj gjendjeje me ndikime në përmasa të mëdha, ndërhyrjes vendimtare të faktorit ndërkombëtar gjatë luftës në Kosovë, të arrijmë që të mos lëmë në hije disa nga vlerat më të mira që shfaqën strukturat institucionale të shtetit shqiptar,

formacionet çlirimtare shqiptare të UÇK-së në Kosovë dhe strukturat ushtarake shqiptare, në ditët e nxehta të tragjedisë në përmasat biblike, që po ndodhte në Kosovë. Këto vlera janë një pasqyrë modeste e kontributit dhe veprimtarisë operacionale, për t'i radhitur ushtarakët e Forcave të Armatosura Shqiptare përkrah UÇK-së, koalicionit ndërkombëtar dhe NATO-s, për të vlerësuar sadopak mundin, sakrificat dhe privacionet që u imponoi situata e rëndë e krizës humanitare dhe e luftës në hapësirën shqiptare.

Duke parë rrjedhën e ngjarjeve, deri në realizimin hap pas hapi të ëndrrave e idealeve të popullit shqiptar në Kosovë, tashmë jemi bindur se ato muaj e vite, me pasojat që mbartnin brenda tyre, ishin mjaft eksplozive e të rrezikshme për situatën në rajon, për popullin e Kosovës, për shtetin shqiptar, për të gjithë rajonin e Ballkanit.

Mbi të gjitha, ato vite ishin vite të lavdishme, të finalizuara me përpjekjet titanike mbarëkombëtare, frutet e së cilës do t'i gëzonte Kosova më pas. Themi do t'i gëzonte, sepse situata e ngjarjeve të mëvonshme na ka bindur se amaneti dhe betimi i luftëtarëve të UÇK-së, sot është i përealizuar.

Populli me vullnetin e tij zgjoi luanin brenda vetes dhe doli në terren për të kërkuar lirinë dhe drejtësinë. Ishin kohë të momenteve tronditëse, kur "zonja e hekurt" e Departamentit të Shtetit Amerikan, takohej me "Ivanovët" e të gjitha ngjyrave dhe shtronte kërkesën legjitime të shqiptarëve për liri, për t'i thënë "NDAL" dhunës, terrorit e masakrës, për t'i hapur rrugën së drejtës, demokracisë dhe prosperitetit. Ishte koha kur NATO dhe SHBA-të, përballë qëndrimit arrogant e mospërfillës të Milosheviçit, qëndronin gati për të vepruar, në emër të paqes dhe në mbështetje e ruajtje të vlerave të demokracisë.

Ecejake politikanësh të tjerë, propozime për zgjidhje nga më të çuditshmet, preferenca shtetërore e personale, pleksje interesash, por vetëm zgjidhje ende nuk kishte. Ishin muaj e vite të vështirë, kur Kosova u ndodh nën një represion të paparë, të tipit nazist e terrorist, kur bisha serbe e hipur mbi tanke e avionë, bënte masakrën më çnjerëzore dhe kërdrinë mbi një popull të vuajtur e të pambrojtur, që kërkonte flamurin, lirinë, shkolonizimin, demokracinë, prosperitetin dhe ekzistencën në jetën e vet.

Ky angazhim ka kohë që ka dhënë sinjalet e ringritjes së vetëdijes kombëtare, duke përfshirë të gjitha hallkat e çoroditura të shoqërisë shqiptare. Ata ishin bijtë më të mirë të këtij populli dhe treguan se e meritojnë vlerësimin e tij. Një popull, që di të ruajë kujtesën historike, që di ta krijojë ndërgjegjen historike, që punon për ta konsoliduar atë, që di të shkruajë mirë atë, që di ta bëjë pjesë të formimit dhe të edukimit atdhetar të kombit të vet, që di të respektojë gjakun e derdhur për lirinë kombëtare, ai njih "alfën" e filozofisë së tij kombëtare, ai mban një qëndrim modern ndaj ndjenjave të tij.

4. Madhështia e njeriut që ndryshoi shekullin për shqiptarët Koha e provës për kombin shqiptar

Ndoshta larg ngjarjeve, por dhe afër tyre, Republika e Shqipërisë, shteti administrativ, me Qeverinë, njerëzit dhe potencialet e saj, ishin pranë Kosovës dhe sëbashku me të. Ato përjetonin situatën me dhimbje e tronditje të thellë, për atë ç'ka po ndodhte. Ishte koha e provës, por dhe prova e kohës, një binom që do të sinkronizonte përpjekjet dhe sakrificat, qëndrimet dhe vullnetin e të gjithë palëve të angazhuara për zgjidhje, e që do t'i hapte rrugën të drejtës dhe lirisë.

Në këto kushte, nuk mjaftonte vetëm solidariteti dhe përkrahja për atë ç'ka po bënte komuniteti ndërkombëtar, por duhej një mbështetje e përgjithëshme mbarëkombëtare për vëllëzrit shqiptar të Kosovës, duhej mbështetje, gjakftohtësi e vigjilencë, diplomaci, lëvizje të studjuara politike, mbështetje morale dhe materiale për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, mbështetje dhe ngrrohtësi për një popull të traumatizuar, të persekutuar në ekstrem, të shpërngulur me dhunë në përmasa biblike nga trojet e veta, duheshin përpjekje titanike të përbashkëta për të përballuar një dhimbje të madhe njerëzore e mbarëkombëtare.

Koha na donte më të bashkuar se kurrë. Kishte muaj të tërë që Kosova ishte kthyer në një "ferr" për vetë njerëzit e saj. Ishte koha kur masakrat kishin marrë dhenë, vrasje, masakrime, djegie e shkatërrime në themel, përdhunime e diskriminim total, varre masive me të gjallë e të vdekur. Ishte koha e përballimit të agresionit në përmasa të mëdha, me synime strategjike të megallomanisë ultranacionaliste serbe, ishte koha për të marrë me mënçuri, fisnikëri e trimëri një vendim. Dhe tashmë duhej mbështetur një vendim.

Vendimin, kishte kohë që e kishin marrë djemtë dhe vajzat e Kosovës dhe ata ishin pozicionuar përballë lubisë ushtarake, për të mbijetuar në një realitet të ashpër e te zymtë, duke luftuar për jetë a vdekje me okupatorin. Ata ishin të bindur, të sigurtë dhe mbi të gjitha ishin të vendosur, se jeta nuk mund të kishte vlera e nuk mund të çmohej pa lirinë, dhe kjo liri duhej fituar me çdo cmim.

Kush e shkatërroi ushtrinë shqiptare

Ishte koha kur ushtria shqiptare punonte për ringritjen e saj. Usharakët shqiptarë përpiqeshin të bënin maksimumin, sepse vetë situata ishte e ndërlikuar dhe kishte vetëm një emër, praglufte dhe luftë. Shpërthimi në këtë periudhë i luftës në Kosovë dhe gjëndja e ushtrisë Shqiptare pas ngjarjeve të Marsit 97-të, përherë ka qënë një shqetësim pa përgjigje në gjykimin e popullit shqiptar. Ishte koha kur tanket shqiptare ropateshin ende rrugëve të braktisur në anë kanalesh, me siglën gëlqerore, "shitet". Një paradoks shqiptar i kohës, që nxori në ankand strukturën më të rëndësishme të Sigurisë Kombëtare, dhe kjo në prag të luftës në Kosovë!!

Shumëkush është bindur se lëvizja çlirimtare në Kosovë kishte kohë që ishte projektuar. Momenti ishte delikat, por ai nuk mund të priste më. Me të drejtë jemi përballur me pyetjen në vlerat e një aktakuze, për ata që shkaktuan tragjedinë shqiptare të marsit 97-të. Përse lufta në Kosovë duhet të shpërthente në një kohë që strukturat ushtarake shqiptare morën një goditje shkatërrimtare me pasoja të rënda për shtetin shqiptar? Kujt i interesonte që shteti administrativ shqiptar në prag të një shpërthimi me përmasa kombëtare, të ishte i dobët politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht? Në këtë kontekst, mund të shtrohen mjaft pyetje të tjera, të cilat përherë do të mundojnë opinionin shqiptar e do të kërkojnë përgjigje.

Lufta "trokiti" në kufirin shqiptar – shqiptar

Megjithatë, lufta filloi dhe ajo shumë shpejt "trokiti" në kufirin shqiptar – shqiptar. Opinioni shqiptar ndiqte me vëmendje situatën dhe vërente, se çdo ditë që kalonte e ndërkombehtarizonte më shumë çështjen dhe ushqente shpresën, se një ditë kësaj lufte në praglirive do t'i vinte fundi. "Ne nuk e duam luftën, deklaronte atëherë komandanti i Divizionit të Kukësit, gjeneral Kudusi Lamaj, por nëse ajo do të na imponohet, do të dimë të mbrohemi". Kjo ishte detyra dhe ajo kishte filluar të funksiononte.

Ditët e nxehta të tragjedisë së popullit shqiptar në Kosovë dhe të luftës së tij, janë përjetuar thellë, me shumë dhimbje e emocion, me të gjitha peripecitë e një situatë të dhimbëshme, mjaft të rrezikëshme e në përmasa eksplozive. Ishte një moment, i cili i kërkoi kombit shqiptar të kryente detyrën e tij. Ishte një moment, që na kërkonte të rrinim zgjuar, të merrnim masa të plota organizative e ushtarake, për të përballuar çdo të papritur. Shteti shqiptar dhe Forcat e Armatosura të tij po lëviznin në sensin e duhur. Përgatiteshin për luftën dhe të gjithë e dinin dhe e kuptonin, se nuk ishte e lehtë të përballeshin me luftën.

Makina ushtarake serbe në veprim

Ngjarjet që zhvilloheshin në Kosovë po e orientonin opinionin shqiptar drejt psikologjisë së luftës. Shteti shqiptar u angazhua tërësisht në publikimin e fakteve dhe ngjarjeve rrëqethëse, në pritjen dhe akomodimin e qindra mijra të shpërngulurve me dhunë, duke kontribuar nëpërmjet

komunikatave zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Rendit Publik, për atë që po ndodhte në terren.

Publikimi i të dhënave krijonte ndjesinë e përhapjes së veprimeve ushtarake në drejtim të shtetit shqiptar, fakt ky që tërhoqte fort vëmendjen e autoriteteve zyrtare shqiptare për të ndalur me masa parandaluese një fatkeqësi me përmasa shumë të mëdha.

Makineria ushtarake serbe ishte hedhur në veprim dhe kërkonte të shtynte qëllimisht konfliktin në jug, pa e vrarë mendjen se ç'mund të ndodhte përreth. Përballë situatës, Shtatmadhuria Shqiptare ndiqte me vëmendje zhvillimet në terren dhe në këtë kuadër realizoi një sërë masash të karakterit ushtarak, të cilat kë në qenë të mirëpritura në opinionin e brendshëm e të jashtëm. Për 22 muaj, trupat shqiptare u ndodhën përballë një situatë luftarake kërcënuese dhe vepruese me pasoja të rënda. Ato përjetuan realitetin e luftës, duke ndjekur me vëmendje dhe shqetësim veprimet intensive të formacioneve të UÇK-së në territorin e Kosovës. Një agresion i pritshëm serb në drejtim të kufijve veriorë të shtetit shqiptar, ishte i mundshëm dhe kjo e komplikonte më shumë situatën.

Cështjet shqiptare objekt i “emërtesës së lartë”

Vite e dekada më parë, në panoramën historike kemi kuptuar se shteti shqiptar në vorbullën e ndikimeve dhe luhatjeve politike, e ndjente detyrimin dhe ka pranuar koston që i la historia në çështjen kombëtare, në veçanti për të ardhmen e Kosovës dhe hapsirave të tjera mbarëshqiptare.

Është kjo një çështje, e cila në vite ka qënë e mbyllur, në kuadrin e veprimeve të cikluara si “emërtesë” e udhëheqjes së lartë të shtetit shqiptar. Qëndrimi dhe veprimtaritë e karakterit politiko - ushtarak të asaj periudhe, duke qënë në axhendën e lidërshit të lartë, u shoqëruan me veprime pa shumë bujë e publicitet. Është ky një aspekt i rëndësishëm, që tregon seriozitetin e qëndrimit zyrtar për të parashikuar e përballuar veprimtari, deri ekstreme të karakterit ushtarak.

Qëndrimi zyrtar nga opinioni merrej vesh vetëm atëherë kur në mediat e kohës publikoheshin fjalime të lidërshit partiak, që vinin në lëvizje elementët e ndërjegjes kombëtar. Hermetizimi ndaj masave të tjera konsiderohej një detyrim i lartë për këdo që ishte pranë “burimeve të informacionit”.

Gjithësesi, pas kësaj "heshtjeje" të shtetit zyrtar shqiptar, filozofia e sigurisë kombëtare ka ekzistuar në ato linja dhe detyrime, që shtronte platforma e çështjes kombëtare shqiptare. Kjo filozofi buronte dhe e kishte bazën e vet, në të drejtën e kombeve për të vetvendosur, sipas parimeve të legjislacionit ndërkombëtar dhe Kartës së OKB-së. Historia vërtetoi se shqiptarët, në të gjitha trevat, ku bukës i thonë bukë dhe ujit i thonë ujë, kanë pasur dhe kanë të drejtë të projektojnë dhe realizojnë të ardhmen e tyre.

Kosova dhe Liria

Çdo njeriu të ndershëm në cdo vend të botës, që e do dhe e respekton paqen, lirinë, demokracinë, përparimin njerëzor dhe e urren tiraninë, fashizmin, terrorizmin dhe dhunën, kur dëgjon ose kujton sot emrin e Kosovës, njëherësh parafytyrohen ngjarjet e tmerrshme të periudhës tragjike 1998-1999-të. Drenica, Kosharja, Rahoveci, Prekazi i Skënderajt, Prishtina, Gjakova, Reçaku janë tablotë e përmasave rembraniene të betejave të përgjakëshme, të një lufte të tmerrshme, të sakrificave dhe privacioneve të një populli i vënë përballë dhunës dhe makinërisë ushtarake të krimit.

Këto tablo sa tragjike, e po kaq heroike e madhështore, janë perludi i një përpjekje të filluar dekada më parë, të një populli të lidhur këmbë e duar me zinxhirë robërie, kundër një gjaksori të pangopur me gjak shqiptari, i cili me një nacionalizëm të shfrenuar i ishte vërsulur atij dekada vitesh më parë, me thikë ndër dhëmbë dhe me urën e zjarrit në dorë, për ta asimiluar, masakruar e shfarosur atë.

Pas këtij përbindëshi, në sfondin e përgjakur, dallonim qartë falangat dhe legjionet politike, me lloj lloj formash e fytyrash të shëmtuara, që i jepnin kurajo dhe mbështetje këtij përbindëshi terrorist. Xhelati hijerëndë, komandonte dhe jepte urdhëra, për të marrë qindra e mijra jetë njerzish, duke u përbetuar në ekranet televizive, mbi "të drejtën ndërkombëtare", "agresionin ndaj vendit të tij", "integritetin", "legjitimitetin", e dokrra të tjera të fabrikuara në skutat e errëta të famëkeqes UDB-ë etj.

Tashmë, kur flasim për luftën në Kosovë, përulemi me respekt para qindra e mijra djemve dhe vajzave shqiptarë të Kosovës, që dhanë jetën e tyre për lirinë në lulen e rinisë, përulemi para shumë të tjerëve nga të gjitha trevat shqiptare, që ranë dëshmorë të Atdheut, në emër të lirisë dhe demokracisë. Këta vullnetarë të lirisë do të meritojnë në çdo kohë nderim e respekt prej kombit shqiptar. Sot, populli i Kosovës ka fatin dhe dëshirën e zjarrtë që të ndihet i lirë. Ai është i vendosur të mos lejojë kurrë më një tragjedi tjetër, më të tmerrshme nga e para.

Rinia shqiptare, shpirti i revoltës

Nuk marr përsipër të bëj analiza të thella politike, sepse të tjerë mendimtarë, personalitete e burra shteti i kanë pasqyruar ato me vërtetësi, por jeta dhe përvoja e gjatë në strukturat ushtarake, më kanë bindur se ngjarjet në Kosovë nuk rrodhën ashtu si rastësisht. Roli nismëtar i studentëve të Prishtinës në demonstratat e përgjakëshme të vitit 1981, me parrullën fundamentale "Kosova Republikë", është sa heroike po aq historik. Këto demonstrata do të pasonin me ato të 11-të marsit, të 26-27-të marsit, me demonstratën gjithëpopullore të 1-2 prillit, me tubimet masive në tërë vendet e Evropës Perëndimore e më gjërë. Ishte koha, kur populli i Kosovës shpalosi shpirtin dhe vlerat komëtare dhe i hapi rrugën luftës për liri.

Gjendja e jashtëzakonëshme e shpallur nga shteti militar serb në Kosovë, veprimet e dhunëshme ushtarakopolicore, nxitën më shumë urrejtjen, forcuan shpirtin e bashkimit e të qëndrës në popull dhe i hapën rrugën shkatërrimit të ëndrrës së Milosheviçit për "Sërbinë e Madhe".

Rinia kosovare derdhi gjak, e mbi gjakun e të rënëve u betua, se do të flijohej për lirinë e vendit të vet. Vite të tëra më pas, ngjarjet evoluan dhe u zhvilluan mbi bazën e kërkesës për drejtësi, të jetës së lirë; ato ishin një denoncim i hapur dhe një sfidë për vet falsitetin e krijimit dhe të ekzistencës së shtetit federativ jugosllav, të brutalitetit dhe superioritetit të fabrikuar sërbomadh mbi shqiptarët dhe etnitë e tjera.

Sërbomania nuk mund të pajtohej me shpërbërjen, me erën e re të demokracisë perëndimore. Ajo do të kërkonte të mbijetonte, duke nxjerrë dhëmbët, tanket, topat, avionët, diplomacinë deri dhe lëndët kimike helmuese mbi rininë shkollore. Bosnja dhe Kosova, në këto pak vite janë në vetvetë një aktakuzë e hapur, të cilat për shumë kohë në të ardhmen, do të akuzojnë dhe do të kërkojnë drejtësi.

Madhështia e njeriut që ndryshoi shekullin

Djemtë e Kosovës që dhanë jetën në luftë, janë kurora e shqiponjës në fushën e flamurit kombëtar. Shpirti i tyre fluturon sot në qiellin e lirë të Kosovës, duke kërkuar të largojë retë e zeza dhe vështrimet e përgjakura të dajve të zinj. Gjaku i tyre është derdhur në themelet e lirisë dhe çështjes sonë kombëtare. Shqiptarët nga të gjitha trevat dhe viset shqiptare, kanë kohë që shkojnë në Prekaz të Drenicës, e të gjithë duhet të shkojnë atje. "Sikur të kishte çmim NOBEL për sakrificë – thoshte atëherë ish-kryeadministratori i Kosovës, Bernard Kushner - këtë do t'ja dhuroja pikërisht familjes Jashari". Madhështia e këtij simboli nuk ka kufij.

Familja e tij simbol, u sakrifiku për të ngritur peshë zemrat e shqiptarëve, për t'i thënë hapur botës edhe një herë, se liria për shqiptarët ka një çmim shumë të lartë, ajo ka çmimin e heroizmit masiv të patrizanëve trima që çliruan Shqipërinë, ajo ka çmimin e jetës së burrave, grave, djemve dhe vajzave të Kosovës, por ajo ka dhe çmimin e fëmijëve motakë e dyvjeçarë, që

sot prehen në vorrezat e dëshmorëve të lirisë. Kjo është një simbolikë drithëruese, por tepër krenare për kombin shqiptar.

Megjithatë NËNA SHQIPËRI do ta ndjejë gjatë mungesën e bijve të saj: **“Mos më qaj se kam vdekur/ Më fal shumë nënë që të lash gjirin zbrazët/ Më fal që t’i prisha ëndërrat e të lash pa birin tënd/ Më fal që nuk munda ta shpaguaj mundin që bërë për të më rritur/ Më fal që të lash pa nipa...”**, dhimbja njerëzore do të mbetet pranë nesh për të na kujtuar dhimbjen tonë...Ah kjo luftë.

Rasti i familjes Jasharaj është unikal në historinë tonë kombëtare. Lufta clirimtare kërkonte simbolikën e saj, dhe ajo doli nga vetë gjiri i popullit të martirizuar. **“Ka raste në botë – thotë akademiku i nderuar Rexhep Qosja – që nga një familje janë sakrifikuar një apo disa njerëz, për t’u kthyer në simbol për interesat kombëtare, por nuk mund të gjëndet një rast i tillë, që një fis i tërë, me mbi 50-të martirë, deri dhe fëmijë, të kthehen në simbol të qëndresës dhe të lirisë, si Jasharajt e Drenicës. Drenica duhet të jetë “Meka” e shqiptarëve”**.

Mesazhi i mendimtarit të madh flet shumë. Atje gjithë brezat sot e në të ardhmen do të mësojnë historinë e Kosovës dhe të Shqipërisë dhe Prekazi përherë do të rrezatojë shpirtin e qëndresës shqiptare për liri e drejtësi. Shpirti dhe gjaku i dëshmorëve të Kosovës, siç thotë rapsodi i Labërisë, Lefter Çipa, ka buzëqeshjen e Adem Jasharit, bukurinë e Xheva Lladrovcit, ka vështrimin e Abedin Rexhës, shpërthimin e Indrit Carës”. Ky nuk është murim për kalanë e Rozafës, por sakrificë më sublimë për Kosovën me një shekull robëri.

“Supermacia” serbe është e destinuar të humbasë

S’ka pikë dyshimi se çdo veprim i armatosur mbart në vetvete pasojat të tmerrshme, pasi në vorbullën e problemeve dhe fatkeqësive që shkakton lufta e pësojnë edhe të pafajshmit. Ata janë njerëzit e pambrojtur që e urrejnë luftën, ata janë qytetarët e thjeshtë që kërkojnë të respektohen liritë dhe të drejtat e tyre, ata janë të moshuarit që kërkojnë mbështetje e përkrahje, ata janë fëmijët që në momente të tilla nuk e marrin dot me mend marrëzinë dhe çmendurinë e të rriturve, ata janë populli që kërkon liri.

Pasojat dhe mundimet e luftës për popullin janë të rënda, por në kushtet e kolonizimit në kohët moderne, pacifizmi i pavend shpie ujë në mullirin e tiranëve dhe fanatikëve që i ndjekin nga pas. Ata nuk janë të aftë dhe nuk kanë asnjë skrupull moral që t’i ndalojnë dorën tiranit. Forca e të mirës ndaj të keqes qëndron në shpirtin lridashës të njerëzimit, ajo buron nga shpirti dhe vullneti i popullit dhe i martirëve të tij, të cilët në çdo rast, bëhen simbol i shpirtit të revoltës, bëhen simbol i bashkimit, qëndresës, fisnikërisë, bukurisë njerëzore, humanizmit për ta mundur të keqen.

Dhe e keqja është e destinuar të humbasë. Tani, pas kaq kohësh, i përcjell me emocion e respekt momentet e përkuljes me nderim para atyre që dhanë jetën në altarin e lirisë, takimet me ata që bënë historinë. Është ky një motiv më shumë, që na obligon dhe na kurajon, për të thënë e shkruar të vërtetën. Kjo e vërtetë ju duhet të rinjve e fëmijëve tanë, që aspirata e kombit shqiptar i nëpërkëmbur nga historia e kancelerive të kohës, të ketë “lokomotivën” e tij në rrugën e gjatë drejt integritit, bashkimit dhe jetës më të mirë.

Shqipëria sy e vesh nga Kosova. Në Ministrinë e Mbrojtjes bien “kambanat” e alarmit.

Ndodhemi në një situatë të veçantë. Është hera e dytë në historinë e Shqipërisë së pasluftës, që kufijtë shtetëror provokohen me forca të shumta ushtarake. Viti 1949-të, është viti kur ushtria shqiptare i jep një mësim të mirë trupave ushtarake të monarkofashistëve grekë. Ishte koha kur përkrah forcave të Divizionit të Korçës, Rezerva e Komandës së Përgjithëshme ishte e pranishme në kufi dhe realizonte me sukses misionin e vet. Drejtuesi i atyre veprimeve ushtarake

të nivelit të lartë të pasluftës, ish komandanti i Divizionit të Korçës, Petrit Dume, e meritoi plotësisht yllin e gjeneralit për shërbimet e çmuara ndaj Shqipërisë.

Vitet 1998 - 99-të, janë vitet e një veprimtarie intensive të strukturave ushtarake për sigurimin e kufijve shtetëror, përballë një agresioni të mundshëm të forcave ushtarake serbe, në kuadrin e tentativave të tyre për të mbytur në gjak dhe për të eliminuar lëvizjen çlirimtare të popullit shqiptar në Kosovë. Sipas analistëve më në zë, ishte i mundshëm një destabilizim i Ballkanit, me të vetmin synim të politikës serbe, që përgjegjësia e një gjenocidi masiv të përhapej gjithandej dhe të krijoheshin kushtet për një zbrazje të përgjithëshme të trevave shqiptare të Kosovës. Ishte një situatë plotike dhe ushtarake në përmasa gjithpërfshirëse, e cila kërkonte një vëmendje e vlerësim të veçantë.

Në terrenin praktik, ushtria serbe, ishte angazhuar tërësisht në veprime luftarake operacionale të të gjitha shkallëve e me të gjithë forcat dhe mjetet e saj. Ajo po përdorte një taktikë të kombinuar të «tokës ë diegur» dhe terrorit psikologjik, e cila kërkonte kundërvënje të kombinuar, në shumë raste larg formave klasike të zhvillimit të një beteje apo disa betejave.

Llojshmëria e strukturave të specializuara paramilitare për të kryer në radhë të parë operacione luftarake të karakterit psikologjik dhe veprime të dhunëshme me strukturat e rregullta të trupave ushtarake speciale, diktonin domosdoshmërinë e analizës së thellë, mbi parashikimin e masave mbrojtëse por dhe të mundësisë së kundërveprimit, duke realizuar kështu kërkesat patashikuese me profesionalizëm të lartë.

Nga studimi i gjëndjes në terrenin e luftës dhe ballanca e forcave midis strukturave ushtarake serbe dhe atyre të UÇK-së, Shtatmadhuria Shqiptare arsyetoi të krijonte një prani ushtarake të qëndrueshme, për të realizuar mbrojtjen me drejtime, e cila nuk do të përjashtonte vëmendjen në të gjithë shtrirjen e kufirit të përbashkët Kosovë – Shqipëri. Provokacionet tani po përhapeshin në të gjithë këtë gjatësi, në një vijë terreni 187 km.

Të dhënat e organeve të zbulimit dhe vrojtimit të drejtpërdrejtë në terren, saktësonin, se formacionet serbe në vijën e kufirit po merrnin masa, për të kryer një minim me dëndësi të plotë. Ishte koha, që ushtarakët shqiptarë të vepronin, por dhe të parashikonin bashkëveprimin në sinkron të plotë me mundësitë që ekzistonin, duke u venë në mbështetje të plotë të strukturave ushtarake të NATO-s, që ndërvepronin brenda territorit të Shqipërisë dhe formacioneve të UÇK-së.

Një situatë e re, por dhe një përvojë e re. Në këtë kuadër janë të shumtë urdhërat dhe udhëzimet e shtatmadhorisë Shqiptare, të cilat orientojnë komandat dhe shtabet për përgatitje serioze dhe masa të veçanta të karakterit organizativ e ushtarak. Strategjia serbe ishte e orjentuuar dhe paracaktuar tashmë drejt luftës. Amanetet e famëkeqit Çubriloviç kishin errësuar mendjen dhe sytë e elitës drejtuese serbe, po e shtynte atë drejt krimin të veçantë në llojin e vet, në përmasat e një gjenocidi ekstrem. Por, tashmë jo gjithçka do të shkonte sipas parashikimeve të politikës serbe.

5● "Nëse nuk tërhiqeni nga Kosova, ne do t'ju godasim"

Jemi në rrezik, ku e kemi ushtrinë.."?

UÇK-ja, aleate e NATO-s në terren, ishte faktori që po luante rolin e vet në fatin e Kosovës. Kjo ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila ishte vënë përballë strukturave kriminale serbe, me bindje se i kishte ardhur koha të bënte detyrën dhe të kthente në realitet ëndrrën shekullore të shqiptarëve, të fitonte lirinë.

Situata e ndezur luftarake matanë kufirit shtetëror, po jepte ndikimet e saj në brezin kufitar. Goditjet e artillerisë serbe, penetrimet brenda kufirit të trupave komando, mbjellja e vendit me “mina kasetë”, shkatërrimet e pasurisë, minimet e drejtpërdrejta nga distanca, goditjet me

snajper, shkëmbimet e ashpra të zjarrit, shkeljet e hapësirës ajrore, ishin bërë një ritual i zakonshëm, që jepte të kuptonim e të vlerësonim se çdo gjë mund të ndodhte.

Çlirohet qyteti i Rahovecit

Shtirja e veprimtarisë luftarake të UÇK-së dhe marrja nën kontroll e mbi 40 për qind të territorit të Kosovës, çlirimi i qyteteve të tilla si, Rahoveci, në pranverën e vitit 1998, ishin ngjarje të pazakonta që kërkonin vëmendje, analizë të thellë politiko - ushtarake dhe mbështetje. Në këto kushte, ishte i pritshëm një reagim i menjëhershëm i makinës ushtarake serbe me të gjitha potencialet e saj kundër UÇK-së.

Në opinion bëri përshtypje atëherë shkrimi i mikut tim, Dilaver Goxhaj, në një të përditshme të pavarur shqiptare në pranverën e vitit 1998, kur UÇK-ja çliroi qytetin e Rahovecit. Analiza ushtarake e këtij veprimi, jepte të kuptohej se diçka kishte filluar të kristalizohej në strukturat ushtarake të UÇK-së dhe mendimi ushtarak i drejtuesve të saj tani kishte kaluar në nivelin taktiko- operativ të veprimeve në terren. Krahas mendimit të rezervuar se ky mund të ishte një veprim i nxituar në kohë, natyrisht kjo na gëzonte dhe na jepte shpresë.

Por ajo që pritej ndodhi, megjithë paralajmërimet dhe sanksionet e komunitetit ndërkombëtar, të cilat po vepronin intensivisht kundër regjimit të Milosheviçit. Ushtria serbe, jo vetëm kaloi në ofensivë të përgjithshme, por e shoqëroi atë me një gjenocid të paparë mbi popullin e pambrojtur dhe me shpërngulje masive të tipit nazist, të padëgjua ndonjëherë, "...me të njëjtin zell e bindje që Hitleri spastroi Evropën nga hebrejtë" (Vargasllosa, f.17)

Veprimet luftarake të Armatës Jugosllave u përqendruan në Kosovën përendimore e jugperëndimore. U krijua një situatë e rëndë luftarake, kur në tërë Kosovën krimi kishte shfaqur një fytyrë të shëmtuar mbi popullin shqiptar.

Shtabi i Përgjithshëm lëshon urdhrin operacional

Në këto kushte, detyrat e strukturave ushtarake ishin të shumta dhe të natyrës së veçantë. Strukturat e sigurisë së shtetit shqiptar ishin vënë në gjendje alarmi dhe gatishmërie të lartë. Detyrat operacionale në kohë për Divizionin e Kukësit dhe të Shkodrës, u pasuan me urdhrat paraoperacionale për njësitë e tjera ushtarake, të cilat mund të vepronin në zonën e luftës.

Ekipet e shumta të specialistëve ushtarakë u drejtuan në veri të Republikës së Shqipërisë: u ndje nevoja e bashkërendimit të shumë problemeve me organet e pushtetit qendror e vendor, me organizatat humanitare e joqeveritare. Shteti shqiptar po riorganizonte dhe mobilizonte potencialet e veta për të përballuar pasojat e spastrimit etnik dhe të veprimit të mundshëm ushtarak serb.

Ushtria do të luante rolin e saj dhe do të përballonte peshën kryesore në situatën e rënduar politike dhe ushtarake. Në këto kushte, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura lëshoi direktivën komandës së Divizionit të Tiranës, Brigadës së Këmbësisë së Mekanizuar në Laç, Brigadës Xheniere dhe njësisë e reparteve të tjera të vartësisë së drejtpërdrejtë, për të marrë masa të plota operacionale për kryerjen e një manovre të mundshme në verilindje të Shqipërisë.

"Jemi në rrezik, ku e kemi ushtrinë..!"?

Së brendshmi, çdo ushtarak në Forcat tona të Armatosura e ndiente dhe e kuptonte se tashmë i kishte ardhur radha përdorimit të forcës. Ishte një moment që kishte ndryshim nga e zakonshmja. Në kushtet e rrezikut dhe kërcënimit populli kthente sytë nga ushtria e tij, ai e shikonte dhe e bekonte atë për misionin dhe detyrën. Në këto raste, si i zgjuar nga ndonjë ëndërr e keqe, "kujtohet" edhe dikush, deri ndonjë deputet në Parlament, që të pyesë në panik: "...jemi në rrezik, ku e kemi ushtrinë..!"?

Mjedisi ushtarak shqiptar do të përjetonte ngarkesat emocionale, psikologjike dhe ushtarake. Ai u përfshi në këto ngjarje, duke plotësuar detyrimin kushtetues. Ky ishte misioni ynë. Gjatë shpërthimit të konfliktit dhe acarimit të skajshëm të situatës, në bazë të detyrës paraprake të Shtabit të Përgjithshëm të FA, hallkat e drejtimit e të komandimit shkuan disa herë në rajonin e Kukësit, për të njohur terrenin dhe për të përcaktuar në vija të përgjithshme rajonet e mundshme të detyrave operacionale, me idenë e një ndërveprimi të plotë me forcat e Divizionit të Kukësit dhe të njësisve të tjera.

Analiza e gjendjes në kufirin shtetëror, na jepte të kuptonim nga të dhënat e zbulimit se ushtria serbe kishte kryer një minim të plotë të kësaj vije dhe e mbulonte atë me zjarrin e artilerisë. Nën goditje permanente ishin qendrat ku mendohej se ishin strehuar reparte të UÇK-së që prisnin të kalonin kufirin shtetëror. Goditjet shkaktonin situata të rënda në radhët e popullsisë civile, situata këto që nuk kaluan pa pasoja deri në lëndime e humbje të jetës së njerëzve.

Padeshi, fshati që banohej vetëm nga burrat

Nën këto efekte, asnjëherë nuk është folur edhe për një “eksod” të brendshëm të popullsisë së tre rretheve veriore të shtetit shqiptar. Për t’i shpëtuar masakrës serbe, mbi 20 mijë vetë u shpërngulën atëherë në brendësi të vendit.

Padeshi, ky fshat i vogël në rrethin e Tropojës, vetëm 30 metra larg kufirit, me 20 shtëpi, u kthye në një emër të njohur. Padeshi ishte fshati pa gra dhe fëmijë, aty në kohën e luftës banonin vetëm burrat. Snajperët serbë qëllonin shpesh nga matanë vijës së kufirit. Por burrat aty ishin. Së bashku me policinë kufitare dhe forcat e brigadës së Tropojës, ata mbanin dyert hapur për luftëtarët e UÇK-së. Në këtë zonë ushtria serbe kishte pësuar humbje dhe e shfrente inatin me zjarrin e armëve në çdo mënyrë. Ky fshat i vogël u bë porta e hyrjes së më shumë se 17 mijë të shpërngulurve nga Kosova, shumë prej tyre me lidhje fisnore në zonë. Kufiri në Padesh për shumë kohë ishte i minuar "sa edhe miza të mos kalonte", siç thoshin njerëzit atje. Por shqiptarët e Kosovës kaluan. Ndërhyrje e UÇK-së e zhbllkoi këtë portë hyrjeje, duke marrë edhe postën kufitare serbe të Koshares.

Forcat ushtarake paramilitare serbe shpesh granatonin Padeshin dhe synonin pozicionet e luftëtarëve të UÇK-së. Tërbimi i tyre për Kosharen e humbur nuk njih kufij. Përkrahja e burrave të Padeshit për luftëtarët e UÇK-së kishte simbolikën e vet.

Serbët kapardiseshin në kufi si “gjeli majë plehut”

Ishte krijuar një situatë shumë e rëndë për popullsinë e pambrojtur. Ngado njerëz të traumatizuar, nën efektin e krimeve të forcave paramilitare serbe, të padëgjuaara ndonjëherë. Do të sjell një episod të thjeshtë, që tregon arrogancën e forcave serbe në kufi.

Pas mbarimit të punëve në shtabin e Divizionit të Kukësit, me komandantin, gjeneral Lamën, vendosëm të shkonim në doganën e Morinit. Drejtimi i Morinit kishte një rrugë të asfaltuar e të ngushtë, në një gjatësi 24 kilometra, me shumë kthesa të forta. Mbërritëm në Morinë. Dogana ishte e mbyllur. Në krahun e djathtë të rrugës automobilistike nga dogana për në drejtim të Kosovës, në pjerrësitë malore buzë kufirit, ndodhej fshati Morinë. Ishte ora e mesditës, kohë kjo kur fëmijët shkonin në shkollë. Çuditërisht shikoja se ndiheshin të qetë, a thua se në këtë zonë për ta nuk ekzistonte lufta?

Na prit komandanti i postës kufitare, një oficer i policisë me gradën kapiten. Pas përshëndetjeve sipas zakonit të vendit, ai informoi për situatën. U mundova të “lexoj” diçka në fytyrën e tij, por ishte e pamundur. Shprehte qetësi dhe fliste pa u ngutur. Mjedisi përreth më ngjalli trishtim kur pashë postën tonë kufitare, pa dyer e pa dritare dhe mbi konturin e saj, në një shtizë të gjatë, valëvitej flamuri kombëtar.

Përse duhet të ishte kjo gjendje këtu? Gjenerali e kapi shqetësimin, më pa drejt në sy dhe më thotë: "...e shikon atë objektin atje lart, në faqen lindore të kurrizit të Tregtanit, poshtë malit

të Pashtrikut, atje ku i thonë fshatit Pogaj? Ajo është një postë kufitare dhe atje kryejnë shërbim 8 djem nga zona përreth, atë postë e kemi ringritur në kushte të vështira, mbasi këta të rendit nuk e kanë shumë mendjen për këto punë".

E kuptova se intuuta si një kapacitet parashikues për njohjen e brendshme, na bënte që të njihnim menjëherë gjendjen pa arsyetuar ose analizuar. Ky lloj gjykimi na bënte të kapërcenim etapat e njohjes. Kjo na ndihmonte të "të njihnim" të tjerët, pavarësisht "nëse kishim apo jo të drejtë". Kjo "epërsi" e ndihmonte dhe gjeneralin të arsyetonte e të shprehej kështu. Nuk e zgjata më. Rreth 500 metra përballë kësaj poste, matanë kufirit, ishte posta kufitare jugosllave me 36 policë, e cila kishte disa kohë që ishte bërë një bazë mbështetëse për një batalion këmbësorie të ushtrisë serbe, deri në 520 ushtarë.

Ndërkohë që po bisedonim, u afruan tre policë kufitarë të postës sonë. Tek kufitarët vërejta qetësi e siguri të plotë, kuptova nga mënyra se si i tregonin dhe interpretonin ngjarjet dhe situatat, se morali i tyre, të paktën në pamje të parë, dukej i lartë. Ata e dinin shumë mirë se në çdo rast e kishin rrezikun mbi kokë.

Vazhdoja bisedën me gjeneral Lamën, ndërkohë më vrau syrin një shkëlqim i fortë nga reflektimi i një objekti në vijën e kufirit. Vërejmë me kujdes dhe dallojmë ushtarët serbë, të cilët qëndronin në këmbë, jashtë strehimeve të tyre. Kapardiseshin tamam siç thotë populli ynë "si gjeli në majë të plehut". I tradhtoi për momentin shkëlqimi i helmetave nga rrezet e diellit. Me sa duket, kishin vrojtuar gjithçka që po ndodhte në pikën e doganës, i kishin fiksuar "vizitorët" dhe tashmë po tregonin hapur kapadaillëkun e tyre.

Gjenerali u revoltua. Me sa kuptova, ata kishin shkelur rregullat e qëndrimit në kufi. Ishin ushtarë të një ushtrie të huaj, që kishin filluar raprezaljet, spastrimet dhe vrasjet në Kosovë, e jo pak po e tregonin kriminalitetin e tyre dhe në anën këtej kufirit. Për ata nuk kishte më rregulla e norma e as moral.

Mendoja të nesërmen, kur ndoshta do të na e impononte situata, të ndesheshim fytafyt me këta kriminelë, për jetë a vdekje, me këta njerëz të shkatërrimit të jetës së lirë.

Kuptova se Gryka e Morinit matanë kishte kohë që ishte "populluar" nga shumë njësi dhe reparte ushtarake të ushtrisë serbe. Natyrshëm lindte pyetja: "A do të mundnin serbët të hapnin front lufte në drejtimin tonë, pa synuar më parë në eliminimin e UÇK-së dhe nëse do ta bënin këtë, cilat do të ishin drejtimet më të mundshme të veprimit në Morinë"? Mendja më shkoi tek djemtë e UÇK-së. Hallall bekimi i Shqipërisë. U kthyem në Tiranë me një premtim....

Ministri i Mbrojtjes: Duhet të shkosh komandant i Divizionit të Kukësit

Pas kthimit nga Kukësi u vura detyra plotësuese gjithë komandave të njëjësive vartëse dhe shtabit të Divizionit, për të përsosur më tej masat e gatishmërisë luftarake dhe kërkesat për një përgatitje të plotë operacionale. Planizimi që kishim dhe çdo veprimtari tjetër që parashikonim, tashmë kryhej në interes të detyrës operacionale të pritshme.

Situata dhe gjendja psikologjike tek njerëzit kishte pësuar ndryshime dhe këtë kisha kohë që po e vija re. Në shtabin e Divizionit, oficerët bisedonin dhe shkëmbenin mendime për gjendjen në Kosovë. Ishin të vëmendshëm ndaj njoftimeve dhe informacioneve dhe kërkonin informacione shtesë nga organet e specializuara për të gjitha zhvillimet në terren. Në opinionet e tyre, dalloja vlerësimin në rritje mbi vlerat e UÇK-së, e cila tani ishte hedhur në veprim. U rrit mjaft interesi i tyre për të njohur më mirë Kosovën në planin geografiko- ushtarak.

Ushtarakët kishin filluar të ndryshonin e po orientoheshin gradualisht drejt psikologjisë së luftës. Të mobilizuar, ata me korrektësi zbatonin detyrat. Divizioni i Tiranës ishte një nga njësitë kryesore të ushtrisë shqiptare. Ai dispononte një arsenal të mirë të armatimeve të rënda, të cilat ishin në gatishmëri të mirë teknike. Shtabet e Brigadave në vartësi, bënin përpjekje të vazhdueshme për të rritur kapacitetet dhe për të forcuar elementët operacionale.

Më njoftuan se të nesërmen duhet të paraqitesha tek ministri i Mbrojtjes, në orën 10.00. Takimi me ministrin nuk ishte diçka e veçantë ose e papritur. U befasova. Përvoja më impononte se në raste të tilla ka të papritura. E ndjeva veten ngushtë dhe pa e zgjatur, i kërkova arsyet përse më bëhej një propozim i tillë, kur në Kukës kishte një komandant, i cili po kryente detyrën.

E kuptoi reagimin dhe nuk e zgjati bisedën. E mbylli, duke më thënë se do të më priste në zyrë pas tri ose katër ditësh, pasi të mendohesha mirë për këtë propozim. Pasi e nderova, dola nga zyra. Një takim i shkurtër që nuk zgjati më shumë se 20 minuta. E qetësova veten me idenë se kisha kohë për t'u menduar. Ka momente të jetës, kur njeriu ndihet ngushtë, e ndonjëherë i duket vetja në udhëkryq.

Nuk më mundonte çështja e karrierës në ushtri, as ndjenja e frikës se do të shkoja në zonën e luftës, nuk më mundonte stepja përballë sfidës së veriut, e cila sigurisht që nuk ishte e lehtë. JO. Arsyetja qetë dhe thjesht: "Ne të Tiranës", nuk po shkonim pa objektiv në rikonicionet tona në Kukës. Isha bindur se, në një kohë shumë të afërt, do të shkonim atje me forcat e Divizionit të Tiranës...

Analiza e ngjarjeve, çdo ditë perceptonte shpejt dhe gjërat do të ndryshonin. Kjo ishte një logjikë. Ndoqa intervistën e gjeneral Lames në TVSH. Komandanti shprehte siguri e besim dhe ky ishte një mesazh për të gjithë popullin shqiptar, i cili i kishte drejtuar sytë nga Kukësi dhe Kosova. Konceptimi ushtarak i situatës nuk mund të shihej jashtë realitetit të asaj që po ndodhte në kufijtë e Shqipërisë.

Situatën në Kukës e njihja dhe propozimi i ministrit të Mbrojtjes nuk më pëlqeu. Çfarë kërkonte dhe çfarë bënte gjeneral Lamaj që nuk u pëlqente eprorëve të tij, vallë kjo ishte zgjidhja në një situatë kritike? Për këto e të tjera arsye që më befasuan, më dhanë të drejtën të mendoja ndryshe nga ministri im...

Kisha kohë që studioja praktikatat e emërimeve në detyra të ushtarakëve, kisha një vit plot që kryeja "i komanduar" detyrën e komandantit të Divizionit të Tiranës dhe nuk kisha kërkuar ndonjëherë që të më emëronin në këtë detyrë. Dija, që detyrat në ushtri jepen dhe nuk kërkohen, e drejta për të kërkuar mendim, e drejta e eprorit për të vendosur etj, etj teori si këto, por gjithsesi, e lashë analizën e këtij takimi në vetë rrjedhën e ngjarjeve që do të pasonin...

24 Mars 1999: NATO fillon bombardimin.

Po bëheshin shumë negociata dhe paralajmërime ndaj Milosheviçit për tërheqjen e trupave ushtarake nga Kosova. Emra shpresëdhënës si Hollbruk, Solana, Klarku, ishin në fokusin e tërë mediave botërore. Por Milloshi ngeletej Miloshe - viç.

Më ka mbetur ndër mend vështrimi i guximshëm e i patundur i gjeneralit brilant, komandantit Suprem të forcave të NATO-s, Uesli Klark, mbi kasapin e Ballkanit në selinë e tij në Beograd. Mesazhi i shkurtër se "Nëse nuk tërhiqeni nga Kosova ne do t'ju godasim" nuk linte vend për alternativë tjetër. Por kasapi ngeli kasap dhe nuk u bë dot kirurg.

Ndodhem përballë qendrës televizive të TVA-së këtu në Tiranë. Ndërkohë dëgjoj në transistorin e makinës lajmin se aeroplanët e NATO-s sapo kishin filluar bombardimet kundër Serbisë. "Filloi" thashë me zë dhe kujtova se fola me vete. Menjëherë, komunikova në radion e dorës "Aselsan" me grupin e drejtimit të Divizionit. Me shërbim ishte shefi i MKA-së në Divizion. E kishte ndjekur situatën. I dhashë disa porosi të përgjithshme. E dija se ai më kuptonte mirë.

Ndërkohë, para meje ndalon një makinë dhe prej saj zbret Preç Zogaj. Më pa ushtarak dhe m'u drejtua. I dhamë dorën njëri-tjetrit, sikur të ishim njohur kohë më parë. Nuk më njihte, por meqë më pa ushtarak mendoi se mos isha me shërbim, aty diku pranë. Më pyeti, se ku ndodhej godina e TVA-së. Ja tregova, me sa duket, e kishin njoftuar për t'u prononcuar në televizion mbi gjendjen dhe situatën që sapo kishte ndryshuar.

Përsëri fillova të flisja me vete...filloi ...filloi...më në fund erdhi momenti që paralajmërimet nuk "pinin më ujë" dhe së fundi botës i ishte mbushur mendja se me Milosheviçin

kishte vetëm një gjuhë. Kjo ishte gjuha e forcës. Në mbrëmje, në zyrën time pashë pamjet televizive të goditjeve të avionit ushtarak të Aleancës.

Të lumtë NATO..... Nata e 24 dhe 25 marsit do të mbetet në mendjet dhe zemrat e shqiptarëve, brenda dhe jashtë atdheut, si nata e dhimbjes dhe e shpresës së madhe. E dhimbjes sepse përgjithësisht jemi kundër luftës së imponuar dhe e shpresës së madhe, sepse kjo luftë është shansi shqiptar për çlirimin e Kosovës. Luftën klika e Milosheviçit e zgjodhi vetë, megjithë paralajmërimet që i janë bërë deri tani.

Mijëra sy ndoqën atë natë atë çka po ndodhte në Kosovë, kur u panë dhe dëgjuan bombardimet e para të NATO-s kundër Serbisë. Të gjithë njerëzit në botë dhe veçanërisht shqiptarëve që u binte barra e rëndë e kësaj lufte, ndoqën me ankth atë që po ndodhte. Vetëm 4 orët e para të passulmit të NATO-s, në RTV Shqiptar, u realizuan mbi 400 telefonata nga të gjitha anët. Shprehej dhimbja, solidariteti dhe falënderimet për NATO-n, SHBA-në, UÇK-në dhe për mbështetjen e vetë Qeverisë Shqiptare.

Ishin Alfons Gurashi dhe Agron Çobani, këta gazetarë të njohur me një përvojë 30-vjeçare, të cilët bënë që të dëgjoheshin komunikimet njerëzore me dhimbjen dhe atë çka tashmë kishte marrë udhë. Nuk pranonte askush të largohej nga detyra, vëzhgonin, komunikonin, hamendësonin, ndiqnin pronocimet nga të gjitha anët e botës dhe shpresonin. Mbresa kanë lënë Valbona dhe Enkeli në TVA, e shumë të tjerë.

Në Shqipëri, Kosovë e kudo ishte "vrrarë" gjumi. Telefonata të shumta nga Zvicra, Greqia, Kroacia, Bosnja, Sllovenia dhe shumë të tilla nga brenda vendit. Të gjithë telefonuesit shfaqnin solidaritetin dhe njëkohësisht u bënë thirrje politikanëve, që në këto momente të vështira, të linin mënjane grindjet politike. Atdheu mbi gjithçka!!

Dikush telefonon dhe thotë: "E dua mëmën time Shqipëri, jam 58 vjeç e nuk do të më tresë dhe, pa e parë Kosovën të lirë...nëse duhem jam gati". Natë shumë e gjatë, një natë maratonë.

Aventurizmi ushtarak serb nuk kishte kufij

Në datën 21.04.1999, rreth orës 10.30, forca të shumta serbe të mbështetura me artileri sulmuan territorin shqiptar në Has në një vijë disa kilometërsh. Luftimet midis tyre dhe forcave shqiptare vazhduan për 8 orë dhe më pas serbët u tërhoqën. Në këtë kohë bombardohet me artileri fshati Papaj. Nga të dhënat është minuar tërësisht kufiri Kosovë - Shqipëri. Në orën 12.15 ushtarët serbë ndërmorën një sulm për rreth një orë me armë automatike në drejtim të pikës kufitare në Zogaj. Mos vallë e kanë të domosdoshme serbët ballafaqimin ushtarak me forcat tona? Nuk besojmë se duhet të jetë kështu. Tjetërkund synojnë shtabet jugosllave, por ata nuk do të arrijnë kurrë të shkëpusin lidhjet shpirtërore të ushtrisë shqiptare me luftatarët e lirisë të UÇK-së, lirisë në të dy anët e kufirit shtetëror.

Në datën 22.04.1999 vazhduan provokimet e ushtrisë serbe në kufi. Qëllohet me armë automatike posta kufitare e Dobrunës në Has ku plagoset një nënoficer. Serbët, sipas vrojtimeve, vazhdojnë të fortifikojnë vijat e tyre të mbrojtjes në kufirin shtetëror. Realizohet masivisht vendosja e fushave të minuara. Minat e vendosura apo të hedhura nga distanca, janë mjete të vdekjes, të cilat nuk janë në gjendje të dallojnë hapin e një ushtari nga hapi i një fëmije.

Në çdo rast, kur mbi to shkelet, ato lëndojnë dhe gjymtojnë, marrin jetë njerëzish. E megjithatë agresorët nuk ndalen përballë krimin, por ata vazhdojnë t'i përdorin këto mjete të shëmtuara vrasëse. Ata vazhdojnë të zbatojnë urdhrat e eprorëve të tyre edhe kur janë të bindur se pasojat bien mbi gratë, fëmijët, të moshuarit, mbi njerëzit e pafajshëm.

Më datën 25.04.1999 serbët përsëri hapin zjarr me armë automatike në drejtim të pikës kufitare të Zogajt në rrethin e Tropojës. Në datën 26.04.1999 rreth orës 22.00, një grup ushtarësh serbë hyjnë në thellësi të territorit shqiptar me synimin për të minuar zonën e Qafës së Prushit. Për 6 orë u krye shkëmbim zjarri në një vijë prej 3 km. Forcat serbe përdorën artilerinë dhe

mortajat. Goditen me artileri tanket e Brigadës së Krumës, të cilët shkojnë në përforcim të forcave tona në vijën e kufirit shtetëror.

Në datën 29.04.1999 forcat serbe godasin me 7 predha fshatin Vlahen, 6 km larg qytetit të Krumës. Po këtë ditë goditet me artileri fshati Cahan, dëmtohet fshati Tropojë e Vjetër. Në fshatin Zherkë vazhdon minimi në anën e kufirit tonë. Në datën 01.05.1999 në fshatin Zapod ranë 20 predha artilerie. Në vendin e quajtur Qafa e Arushit, në rrethin e Hasit, një grup komandosh serbe prej 20 vetësh dogjën postën kufitare. Vazhdojnë granatimet mbi fshatrat Letaj e Dobrunë, Golaj e Zahishtë. Përse kryejnë veprime ushtarake në befasi dhe mandej tërhiqen në strofullën e tyre?

6. Sulmohet Pashtriku, Operacioni “Shigjeta – 2”

Në kushtet e këtij kundërveprimi të përgjithshëm politiko - ushtarak, ushtria serbe do të kompensonte inferioritetin e saj me veprime të dhunshme brenda territorit të Kosovës dhe me krijimin e një "brezi agresiv dhe të pakapërcyeshëm" në kufirin shtetëror, për të shkëputur lidhjet në të dy anët e kufirit. Mbajtja në një gjendje tensioni ushtarak e psikologjik, me bazë kërcënimin për "përgjegjësitë shtetërore" në rast të shtrirjes së konfliktit, krijoi në brezin kufitar prej 187 km dhe në një thellësi deri në 20-25 km, një situatë të ndezur, e cila u shoqërua me provokacione dhe veprime ushtarake me pasoja të rënda për këto zona.

Mbështetur mbi studimin e dokumenteve të kohës, jemi në gjendje të kuptojmë dhe vlerësojmë se çfarë ka ndodhur në periudhën më të nxehtë të konfliktit dhe cila ka qenë fizionomia e veprimit të strukturave ushtarake jugosllave përballë qëndresës shqiptare, në të dy anët e kufirit shtetëror. Faktet nuk flasin për "ngacmime" në kuadrin e një operacioni psikologjik të paramenduar, por të një veprimtarie operacionale tepër agresive e me pasoja dhe të një shkërmoqjeje psikologjike të të gjithë strukturave të saj përballë presionit dhe kundërveprimit ndërkombëtar.

Prefektura e Tiranës “non stop”

Kishte disa ditë që kishin filluar bombardimet ndaj Serbisë nga forcat e NATO-s. Ishte krijuar një situatë e rëndë me të papritura në të gjithë rajonin. Shqetësimi i të pranishmëve, kuptohej lehtë nga bisedat që bënin dhe nga pyetjet që drejtonin për problemet ushtarake, për veprimet e NATO-s mbi Kosovë, për armët që po përdorshin, efektet e tyre, për llojin e aviacionit ushtarak, për mundësinë e futjes së trupave nga toka etj. Shpjegonim sa mundnim për të qenë bindës në ato që trajtonim. Lajmet e stacioneve të ndryshme televizive, ishin nga më të çuditshmet e nga më të padëgjuarat ndonjëherë.

Në këto biseda të lira, nuk mund të flitej absolutisht për asgjë tjetër. Në mbledhjen e Këshillit Administrativ të Prefekturës diskutohet e merreshin vendime për masat urgjente të pritjes dhe akomodimit të të shpërngulurve nga Kosova. Probleme e halle të shumta, që kërkonin zgjidhje të shpejta. Autokolonat e ushtrisë e mjete të tjera, çdo ditë ulnin para pallatit të sportit "Asllan Rusi", në Tiranë, me qindra e mijëra njerëz të traumatizuar që kërkonin mbështetje.

Kryeqyteti pa sistem të kushtrimit ajror

Në këtë mbledhje, shtrova problemin e ndërhyrjes për ripërtëritjen e një pjese të sistemit të lajmërimit e të kushtrimit ajror për qytetin e Tiranës, pasi kishte rreth 9 vjet, që ky sistem ishte abandonuar krejtësisht dhe ishte jashtë gatishmërie. Nga 83 elektrosirena që ishin të instaluar në Tiranë, asnjë nuk funksiononte, e mbi të gjitha, gjithë instalimet e tyre ishin jashtë funksionit, objektet të mbyllura dhe askush nuk ndiente përgjegjësi për to.

E njëjta gjendje ishte edhe për strehimet nëntokësore. Me hallkat që ishin krijuar në këto vite, në pushtetin vendor dhe privatizimet që ishin bërë, mungonte kuadri ligjor për funksionimin e tyre edhe në qoftë se ato do të mund të riparoheshin.

Prefektja Çeço kërkoi mendim se si mund të veprohej. E dëgjoja me vëmendje këtë grua që rrinte “non stop” në zyrën e saj. Kuptoja se ishte shumë e interesuar të dinte, me sens veprimi në përmirësimin e gjendjes. I kërkova konceptimin e raportit të shkurtër mbi gjendjen për Qeverinë Shqiptare. Brenda 18 orësh projektvendimet e dërguara nga Ministria e Mbrojtjes u miratuan dhe oficerët filluan nga puna në mbështetjen e pushtetit vendor në Tiranë. Kjo ndërhyrje pati vlerat e veta.

Ishte kjo një ndër veprimtaritë tona, kur njësi të tjera, si Regjimenti i MCR-së, Brigada e Transportit, Regjimenti i Policisë Ushtarake, vazhdonin të kontribuonin në pritjen dhe akomodimin e të shpërngulurve nga Kosova. Kriza humanitare vlerësohej përditë dhe nga Tirana bëhej shpërndarja e të shpërngulurve në rrethe të tjera të vendit. Prefektura punonte "non stop" 24 orë.

Replika bajate në një situatë të tensionuar

Bombardimet e NATO-s mbi objektet ushtarake dhe institucione të rëndësishme brenda Serbisë dhe në Kosovë, vazhdonin intensivisht, e megjithatë çdo ditë që kalonte na servirte lajme të çuditshme. Ndiqja detyrat e gatishmërisë luftarake në Divizion dhe herë pas herë shkoja në objektet e pritjes së të shpërngulurve nga Kosova. Isha i pranishëm në mbledhjet e Prefekturës dhe të Bashkisë së Tiranës.

Më bënte shumë përshtypje fakti, nga ato çfarë shikoja e dëgjoja në kontakte të tilla. Bëja çudi se si ishin mësuar të punonin shumë funksionarë në sektorin civil. Nuk e kishin konceptin se çdo të thoshte emergjencë, veprimtari humanitare e njerëzore, u dukej diçka e zakonshme, pavarësisht se gjithë shteti punonte me gjendje mobilizimi të jashtëzakonshëm.

Duke mos mjaftuar kjo, kishte kundërshti nga lloj - lloj "kompetentësh", të cilët me argumente foshnjore nuk e vrisnin trurin se shumë njerëz ende ishin në kufijtë e depresionit, të emergjencës, të traumatizuar nga dhuna, nuk dinin ku i kishin familjet e të afërmit, ende flinin jashtë, të uritur, që kërkonin minimalisht të mbijetonin.

Bëra bilancin e punës së grupit të riparimit të sistemit të elektrosirenave dhe mbeta i shokuar. Punët ishin marrë zvarrë nga Ndërmarrja e Ndriçimit të qytetit. Debatova ashpër me z. Brojka dhe gjeta mirëkuptimin e tij.

Çeço e Brojka, kundërshtarë politikë

Edhe këtu dalloja replikat e tij me prefekten. Eh!!...thosha me vete, nuk i lanë një herë këta njerëz këto debate edhe atëhere kur duhet të jenë së bashku, të paktën në këto momente. Edhe për sa kohë politika dhe bindjet do të na ndajnë. Kur do të arrijmë të kuptojmë, se në këto kushte të vështira, më shumë se sa interesa të tilla vlejné bashkërendimi i punëve për emergjencën, por në fund të fundit, vlejné interesat e Shqipërisë dhe të çështjes kombëtare, vlen toleranca, mirëkuptimi dhe përkushtimi për t'u dalë punëve të shumta ballë për ballë e për t'i zgjidhur sa më mirë ato.

Edhe për këtë rast, që e shikoja me sytë e mi, i tronditur gjykoja se ata nuk kanë faj, nuk kanë faj sepse rreziku është ende larg, predhat e artilerisë serbe godasin njëherë për njëherë diku larg, larg Tiranës, se po të ishte ndryshe, ndoshta dhe këta njerëz do të mund të shpresonim që të sillëshin ndryshe. Dhe kjo nuk ishte një rastësi.

Të tilla replika dëgjonim përditë të publikuara në mediat shqiptare. Jo rrallë këto reflektoheshin në nivele të ndryshme të përfaqësimit të politikës shqiptare. Nuk më takon t'i gjykoj, por jo pa tronditje dua të pohoj se në këto situata kjo nuk më dukej një rastësi...

Njerëz të vegjël që vetëm dinë të ankohen

Ishin mbledhur rreth 17 veta në zyrën e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Një mbledhje e rëndomtë dhe pa shumë sens serioziteti e pune efektive. Raportime të pakonceptueshme për atë çka ishin mbledhur. E ndjeva veten keq që ndodhesha në një mjedis të tillë. Njerëz të paprincipitë, neglizhues, "qanin" për çdo gjë dhe vetëm kërkonin nga Kryetari, deri dhe lopata e kazma, a thua se Brojka duhet të bënte punën e tyre dhe ishte përgjegjës pse ata nuk dinin, ose nuk donin t'u dilnin për zot punëve për detyrat që kishin marrë.

Mesa kuptova, çdo gjë rrihte tek fondet. Ndryshimi i gjendjes nuk këkonte qarje dhe ankesa, por kërkonte punë, vetëveprim, sensibilizim të të gjithë opinionit. Tirana ishte kryeqyteti ynë, që tashmë kishte shumë halle dhe kishte filluar të përballonte shumë nga pasojat e krizës humanitare.

I drejtohem njërit prej tyre duke i thënë: "Si mendoni ju zotni, kush do të mbajë përgjegjësi nëse një ditë Tirana mund të ketë pasoja nga kjo luftë, a do ta ndienit veten të qetë nëse njerëzit në një moment nuk do të kenë ku të fusin kokën? ...Eshtë normale që në këto kushte të kemi dhe vështirësi, por nuk është koha që të qahemi, është koha të bëjmë më shumë, deri dhe të pamundurën, për të realizuar këto detyrime, për të cilat ju shteti ju paguan. Ktheni më mirë sytë nga detyrimet tuaja dhe lereni kryetarin të bëjë detyrat e veta".

Foli murit më mirë. Më pa si i hutuar dhe nuk më ktheu përgjigje. Me këto mendime nuk dua aspak të fyej e të rëndoj njeri, por isha shumë i shqetësuar për një papërgjegjshmëri që më irritonte jashtë mase.

Drejt Kukësit, atje ku fillon Kosova

Filluam lëvizjen me trupa në drejtim të Kukësit. Forcat e Divizionit tashmë filluan zbatimin e urdhrin operacional. Shtabi i Divizionit në një kohë të shkurtër realizoi planizimin e lëvizjes, duke parashikuar një marshim të vështirë, por të realizueshëm. Në orën 03.00 kishte filluar lëvizjen batalioni i artilerisë së rëndë 152 mm, në drejtimin Babrru – Kamëz - Ura e Milotit – Qafa e Malit - Kukës dhe në orën 05.00 batalioni i artilerisë së "*katjushave*" 130 mm, me pikënisje nga Mëzezi.

Vazhdoja të ndiqja situatën dhe ndërkohe shtabi i Divizionit po përgatitej për të filluar lëvizjen. Kisha disa ditë që me vartësit po përballoja ngarkesat e punës, shikoja shqetësimin e njerëzve dhe tashmë po kuptoja se të gjithë punët e tyre i kishin marrë shumë seriozisht.

Në orën 09 u nis autokolona e shtabit të Divizionit. Gjatë kësaj kohe kisha qenë edhe disa herë në Kukës me grupe oficerësh për rikonicione. Kollonën e dytë të artilerisë e kapëm në maloret e dushkajave të Rrëshenit. E kishim parashikuar që do të na ndodhnin shumë defekte rrugës, sepse makinat e batalionit 130 mm kishin mbi 9 vjet që nuk lëviznin dhe përgjithësisht ishin lënë pas dore nga ata që e konceptonin shpesh reformimin e ushtrisë shqiptare me letra e sllogane. Gjatë një viti e gjysmë, kishim punuar shumë me këtë batalion, për ta vënë në gatishmëri.

Rrugë e vështirë, sidomos në drejtimin matanë Rubikut. Në orën 18.00 mbërrita në Divizionin e Kukësit. Artileria e rëndë e kalibrit 152 mm, kishte mbërritur me kohë e pa probleme dhe ishte vendosur në Myç Manzë, në rajonin e paracaktuar të pozicioneve të zjarrit.

U lidha me Tiranën dhe mora informacion. Nuk po më mbante vendi, sepse e dija që kolona e "*katjushave*" ishte e shkëputur dhe po lëviste me mjaft vështirësi. Ishin marrë masa të plota për ta siguruar me personel teknik dhe pjesë këmbimi, por gjithsesi, shumë nga shoferët ishin ushtarë rekrutë dhe çdo gjë mund të ndodhte. Në dalje të Fush - Arrëzit ishte paracaktuar një pikë pushimi dhe rigrumbullimi të këtij batalioni.

Në orën 24.00 ndodheshim në kthesën e rrugës për në Myç Manzë. Deri në atë kohë aty kishte mbërritur vetëm një pjesë e makinave luftarake të batalionit të artilerisë 130 mm. Tashmë ishim larg Tiranës. Përpara kishim të panjohura dhe të papritura, të cilat do të na shoqëronin për

shumë kohë në qytetin verior. Në hapësirën e zezë qiellore ndieja zhurmën e avionëve luftarakë të NATO-s, dalloja momentin e shkëputjes së raketave luftarake dhe nata na diktonte ndriçimin e shpërthimeve të fuqishme matanë kufirit.

Po këta çfarë janë?!!

Shtabi i Divizionit u vendos në fshatin Kolsh. Fshati ndodhej rreth 800 metra larg fushimit. Gjatë lëvizjeve na takon që të kalonim përherë mospërmas fshatit. Në Kolsh ishin strehuar shumë familje të ardhura nga Kosova. Shikoja përditë shumë fëmijë e gra, që merreshin të qetë me punët e tyre. Përgjithësisht ishte një fshat i qetë. Kuptoja se ndienin kënaqësi që ndodheshim aty pranë e në çdo rast banorët dhe të ardhurit na përshëndesnin me përzëmërsi.

Ditë më pas u takova rastësisht me kryeplakun e fshatit. Një ditë që ktheheshim në orët e vona të natës në fushimin e shtabit e mora në rrugë në automjetin tonë. Ishte i veshur me një xhakëtë kadife dhe kapele në kokë, veshje tipike të banorëve të zonës.

Qysh në kontaktin e parë, kuptova se ishte një njeri i pashkolluar e që e rrente mendja se ishte i ditur, vetëm e vetëm se ishte kryeplak. Kishte shumë fjalë, nuk të linte radhë në bisedë dhe, me sa kuptova, ishte me shumë ngarkesa dhe emocione politike. Më lllomotiti shumë një ditë tjetër, për gjoja atdhetarizmin që po tregonte se u kishte dhënë pa para disa objekte tip tunel disa forcave ushtarake, sipas tij "të UÇK-së". Nuk u mora më asnjëherë me këtë njeri dhe nuk kisha dëshirë ta takoja përsëri.

Në këto ditë oficerët e shtabit më informojnë se në mjediset e fshatit vërejnë ushtarake të veshur me kamuflazh e me bereta të kuqe. Disa oficerë të tyre, shpesh dalin në klubin e fshatit dhe kalojnë disa orë të ditës atje. Janë vendosur në objektet tunel në jugperëndim të Kolshit, dikur objekt i rëndësishëm i Divizionit të Kukësit.

Informacionin e vlerësova dhe nuk e lamë me kaq. Ishin forca deri të një kompanie, të armatosur mirë me armë konvencionale dhe me mundësi të mira telekomunikimi. Më pas morëm vesh se nuk ishin nga ata kontigjente "të UÇK-së", siç pretendonte kryeplaku i Kolshit, por nga ata "mëmëdhetarë" për të cilët "ende nuk kishte ardhur koha të shkonin në luftë", kur në Kosovë luftohej për jetë a vdekje.

Në biseda me oficerë të shtabit ata shpreheshin hapur se "...edhe ata ishin për luftën, por nuk kishte ardhur ende koha për të luftuar". Heu, përsëri avazi i "Epopesë së Ballit Kombëtar", në kohët moderne. Kontaktoj me komandantin e Divizionit të Kukësit dhe kërkoj shpjegime mbi prezencën e tyre. Sugjerova se këto struktura ushtarake nuk mund të integroheshin në veprimet tona me mënyrën se si e konceptonin praninë e tyre afër zonës së luftës.

Ato duhet të largoheshin andej. Pas disa ditësh ata morën rrugën drejt Tiranës, një veprim i paprecedent në kushtet e situatës së mbingarkuar me probleme. Falë ndërhyrjeve për "të zhbërë atë që u bë", pasi dorëzuan armatimin dhe pajisjet logjistike që dispononin ata u larguan nga Kolshi. Shumë prej tyre u rreshtuan në formacionet e UÇK-së në qendrat stërvitore në Kukës. Më mirë kështu...

Sulmohet Pashtriku, Operacioni "Shigjeta – 2"

22 maj 1999. Sot në orët e vona jemi informuar se një Brigadë e UÇK-së (e cila u përgatit në zonën e Burrelit), kaloi kufirin dhe kapi malin e Pashtrikut. Po zhvilloheshin luftime të ashpra me forcat serbe. Ky lajm më entuziazmoi pa masë. Në grykën e Morinit ishin shpeshuar zhurmat dhe ndiqnim me shqetësim shpërthimet e artilerisë serbe. Me siguri ata godisnin Brigadën dhe ishin vënë në gjendje të plotë alarmi.

Informohem se veprimtaria operacionale e njësisë ushtarake me djem e vajza të Kosovës, ishte kodifikuar me emrin "Shigjeta - 2". Sedra profesionale nuk më lë pa shfaqur disa mendime dhe pa bërë disa pyetje, për të cilat do të doja sinqerisht që dikush dhe të më jepte përgjigje. Ky veprim luftarak me pikënisje tokën e shtetit shqiptar më ka bërë atëherë shumë përshtypje.

Si mund të fillohet një operacion i tillë nga toka e shtetit shqiptar i shkëputur nga veprimtaria operationale e reparteve dhe njësisve luftarake të ushtrisë shqiptare, që aktualisht ishin të dislokuara në zonën e mbrojtjes së Divizionit të Kukësit? A do të arrihej sukcesi në objektivat e paracaktuar pa mbështetjen e trupave të ushtrisë shqiptare?

Nëse fillon një veprim ushtarak nga toka, në anën jugore të kufirit, a mund të konceptohen kapacitetet ushtarake të kësaj njësie jashtë këtyre veprimeve? A do të mundte njësi kosovare të realizonte objektivat e saj, të cilat mendoj se në planifikim ishin parashikuar drejt? Cilat mund të ishin këto objektiva në raport me sasinë e forcave dhe mjeteve në dispozicion të kësaj njësie?

A duhej konceptuar operacioni jashtë pjesëmarrjes së forcave aktive të Ushtrisë Shqiptare? Kush mund të jetë iniciatori dhe ideatori i veprimeve të tilla me shumë përgjegjësi? Nëse lidhshipi shqiptar kishte dhënë pëlqimin që të realizohej një mësymje e tillë, kush e "bindi" të linte jashtë kësaj veprimtarie strukturën aktive të Ushtrisë Shqiptare?

Nuk flitej për një eksperiment, por për një veprim luftarak serioz që duhet t'i kushtonte rëndë pushtuesit matanë kufirit. Si mund të heshte artileria jonë aktive në kushtet kur po e shikonim me vrotim të drejtpërdrejtë goditjen e artilerisë serbe mbi formacionet e njësisë kosovare?

Mund të kem pyetje të tjera, por jam shumë i rezervuar dhe skeptik në rezultatin e këtij veprimi ushtarak. Nuk kam gjykuar asnjëherë në kushtet e situatës që mbizotëronte në rajon se mund të realizoheshin edhe operacione të tilla, ku disa luftonin e disa të tjerë bënin sehir me duar "të lidhura". Veprime të tilla do t'i konceptoja më shumë se një aventurizëm ushtarak.

Më ka rënë rasti në kohë të tanishme të kontaktoj me ushtarë dhe oficerë të kësaj Brigade në Kosovë. Mendimet dhe gjykimet tona janë përputhur me atë që ata kanë pohuar. Megjithatë luftë është dhe mund të veprohet edhe kështu....

Krimi nuk ka të sosur...

Ndodhem në zyrën e shefit të shtabit të Divizionit të Kukësit, kolonel Selimit. Njoftohet në radio se në pozicionet e zjarrit të artilerisë në fshatin Golaj, bien 7 predha të artilerisë serbe. Ishte momenti, kur në fshat po zhvillohej ceremonia e varrimit të një vajze 15- vjeçare, e cila vdiq nga predhat serbe një ditë më parë. Reagimet e popullsisë u ndjenë edhe mbi repartin ushtarak. Është e çuditshme.

Ndërkohë që mund t'i gëzohesh paqes për momentin, mundet ndoshta ta kesh të vështirë të mendosh se çfarë mund të ndodhë më pas në situata të tilla. Diku ky repart ushtarak do të vendosej për të kryer detyrën.

Një telefonatë tjetër informative dhe në zyrë vjen grupi i oficerëve amerikanë i Forcave Ajrore. U përshëndetëm shqip. Ishin të sjellshëm. Kishin filluar të mësonin disa fjalë nga gjuha jonë. U hapën hartat mbi tavolinë dhe filloi shkëmbimi i informacionit. Kërkuan të dinin me koordinata të sakta, nga shefi i zbulimit të Divizionit të Kukësit, se ku mund të ndodheshin bateritë e artilerisë serbe.

U kufizuan në një sipërfaqe 4 km² nga Qafa e Prushit, Krajlicë deri në fshatin Zhep në thellësi të territorit të Kosovës. Kërkonin, me sa kuptuam, garanci për praninë e popullsisë civile në këtë zonë. Punuan me kujdes në hartë dhe mbajtën shënim koordinatat.

Vëreja se hartat e tyre nuk kishin të njëjtën kuadraturë me hartat tona. Për disa nga objektivat për të cilat kishte të dhëna u përcaktuan koordinatat me saktësi. U larguan pas 30 minutash duke përshëndetur "allashqiptarçe". Në orën 20.30 avionët e NATO-s realizuan një "spektakël" të vërtetë mbi këtë zonë mbi objektivat ushtarake serbe.

Serbët godasin spitalin e Krumës

Në orën 21.30 dëgjojmë në drejtim të Krumës shpërthime të forta artilerie, të cilat përcilleshin deri tek ne me një zhurmë të mbytur. Në krahun e majtë të vendvendosjes sonë shtrihet kurrizi i malit të Tregtanit. Nën këmbët e tij, në pjerrësitë perëndimore shtrihet qyteti i Krumës. Nga raportimet e menjëhershme në radio kuptova se po goditej spitali i qytetit.

Kruma ishte një qytet me mbi 5 mijë banorë, por tani i trifishuar nga të ardhurit nga Kosova. E kam thënë dhe më parë që në këtë spital kuroheshin luftëtarë të plagosur të UÇK-së, pjesëtarë të Brigadës që sulmoi disa ditë më parë malin e Pashtrikut. Pas 7-8 shpërthimeve të para, në të gjithë zonën e Krumës dhe të Kukësit u ndërpre energjia elektrike.

Ndodhemi në një kuotë të favorshme ku na jepej mundësia të vrojtonim një pjesë shumë të madhe të zonës së Kukësit dhe drejtimeve më kryesore drejt kufirit. Nga raportimet e para në radio u konstatua panik dhe mungesë informacioni të saktë për atë që po ndodhte në Krumë. E ndjemë veten ngushtë, por ne nuk na lejohej të ndërhynim.

Pas disa minutash dëgjojmë zërin e qetë e të sigurt të shefit të shtabit të Divizionit të Kukësit, i cili u kërkoi të gjithëve të ruanin gjakftohtësinë dhe të komunikonin në bazë të rregullave. Më erdhi mirë. Para disa orësh serbët kishin hedhur disa predha artilerie në fshatin Nikoliq dhe kishin plagosur disa fëmijë e kishin dëmtuar shtëpi.

Banditizëm tipik kolerik serb dhe asgjë tjetër. Në hapësirën mbi zonë pas 10 minutash u dëgjuan zhurmat e avionëve të NATO-s. Goditjet e artilerisë serbe u ndërpre. Tashmë përvoja kishte treguar dhe të gjithë e dinim se serbët ishin të papërgjegjshëm e të pabesë në veprimet e tyre. Të zotë vetëm për të goditur prapa shpine.

7. “Shkërmoqja” psikologjike, fundi i ushtrisë serbe.

Pas shtatë vitesh të përfundimit të luftës në Kosovë, a do të vijë ndonjëherë koha që në Serbi të mendohet me mendje të kthjellët e me gjak të ftohtë, për atë që ka ndodhur në dekadën e fundit me shtetin e tyre, për fatkeqësitë që ata u shkaktuan popujve në Ballkan?

Vallë ka hapësira politike e qytetare në Serbi, që klasa politike të reflektojë për t’u përfshirë me kurajo në proceset e ndryshimeve demokratike dhe të ketë vullnetin të kërkojë falje ndërkombëtarisht popujve të Ballkanit dhe të Evropës për fatkeqësitë e shkaktuara në dekadën e fundit të mijëvjeçarit që lamë pas?

A do të kenë kurajon civile e qytetare politikanët dhe teoricienët ushtarakë jugosllavë të mendojnë dhe analizojnë në të ardhmen dukuritë e luftrave të fundit agresive që zhvilluan strukturat e tyre?

A do të mundin ata të gjykojnë me gjakftohtësi për "huret" e ushtrisë së tyre dhe strukturave të tjera paramilitare famëkeqe, për bëmat dhe fytyrën e krimit, për dallimin esencial antihuman që ata kanë indoktrinuar në formimin e këtyre strukturave, duke e ushqyer atë me frymën famëkeqe të “supermacisë” kombëtare, dhe në fund të fundit, a do ta pranojnë ata se ideologjia e tyre sunduese ultranacionaliste ka humbur përfundimisht?

A do të pajtohen ata me situatën e re në Ballkan dhe veçanërisht në Kosovë, duke menduar seriozisht se ëndrra e “Serbisë së Madhe” ishte një vegim i largët nacionalist që i përfshiu në rrugët arkaike e mesjetare të historisë?

Megjithatë kjo është punë e tyre.

Takim shpresëdhënës

Do të vinte një ditë që luftës do t’i vinte fundi. Është mometi të vlerësojmë ditën kur delegacionet e të dy palëve u ulën për bisedime. Nga transmetimet radiofonike kuptuam se ushtarakët serb kërkonin kohë për “t’u konsultuar” me udhëheqjen e tyre politike.

Për turpin tuaj bastardë të ndyrë, vrasës, të pacivilizuar, kërkoni ende kohë se nuk jeni ngopur akoma me krimet që keni bërë në Kosovë. Takimi, megjithatë, u vlerësua si një ogur i mirë për popullin e Kosovës dhe për të gjithë shqiptarët kudo. Të gjithë shpresonim se liria dhe paqja do të vinin shumë shpejt.

Ruhu prej ujkut, kur i vjen ngordhja...

Në mbrëmje u informuam se ishte nënshkruar marrëveshja midis gjeneralëve të NATO-s dhe përfaqësuesve të ushtrisë serbe në Kumanovë, një qytet shqiptar në veriperëndim të Maqedonisë. Dëgjojmë shumë të shtëna me artileri. Janë të shumta incidentet e serbëve në vijën e kufirit. Në këto kushte, vërejmë reagime të pazakonta të tyre. E njëjta situatë kur ata nuk përfillën as kushtet e bisedimeve në Rambuje. Këta ishin serbët.

Nga ky moment ata vepruan për të fituar kohë në terren. Nuk na çudit ky qëndrim. Kjo është "fytyra" e tyre. **Sot u informuam se serbët në doganën e Morinit, në largim e sipër kishin qëlluar mbi gazetarët që po filmonin. Një gazetar kilian ishte goditur për vdekje. Këta njerëz kanë brenda vetes kënaqësinë që janë në gjendje dhe të aftë të urrejnë, të shkatërrojnë dhe të vrasin.**

Ata nuk ishin në gjendje të arrinin vetëkontrollin për t'i shpëtuar disfatës dhe ky ishte fundi i tyre. Shkërrmoqja morale e psikologjike tashmë po i çonte drejt "lavdisë". Me sa duket, urdhri për t'u larguar po u merrte dhe atë pak mendje që u kishte mbetur. Kriminelët mbeten të tillë deri në vdekje...

Informohemi se trupat gjermane të KFOR-it këto ditë do të vijnë në Kukës për të hyrë, sipas marrëveshjes, nga Morini në Prizren. Vërehen lëvizje të shumta njerëzish. Duket se vetë qyteti i Kukësit do të fillojë së shpejti të marrë frymë lirisht, tashmë jo për të pritur njerëz, por për të përcjellë të ardhurit nga Kosova.

"Shkërrmoqja" psikologjike...fund i pashmangshëm

Çdo njeri me pak informacion, që e njeh historinë e zhvillimit të luftërave, arrin të kuptojë se Evropa në përgjithësi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, nuk do ta toleronin Serbinë për agresionin e dytë që po i shkaktonin rajonit të Ballkanit. Drejtimet e kundërvënies do të ishin të shumëllojshme dhe në radhë të parë ato do të synonin faktorin ushtarak të shtetit agresor. Ëndrra e vjetër e supermacisë serbe për "hapësira jetësore" në Ballkan, ishte realizuar shkallë - shkallë nëpërmjet dhunës.

Në vitet e pasluftës së Dytë Botërore u duk qartë se nuk mund të aplikoheshin më marrëveshje të reja dhe udhëheqja jugosllave e përfshiu përfundimisht Kosovën nën diktatin e saj administrativ. Instalimi i pushtetit politiko- ushtarak në Kosovë dhe rritja e ritmeve të zbatimit të reformës agrare kolonizuese, e fshiu përfundimisht të drejtën për "vetëvendosje".

Në këtë kontekst, çdo tentativë për të kërkuar liritë dhe të drejtat do të shtypej vetëm me dhunë. Fakti që kjo ka ndodhur disa herë në format e gjenocideve dhe masakrave, tregon qartë se instrumentet ushtarake të Serbisë ishin në qendër të vëmendjes dhe të kujdesit të liderit të tyre. Ato fituan përvojë në terrorin psikologjik dhe në shtypjen me forcë të revoltave, duke u bërë shërbime të çmuara strukturave politike jugosllave.

"Pathyeshmëria e ushtrisë jugosllave

Vetë përbërja e strukturave ushtarake jugosllave dhe diskriminimi i shtresave shqiptare brenda dhe jashtë saj, ishin në bazën e filozofisë së dhunës dhe agresivitetit. Ato ishin strukturat ushtarake të edukuara me një ndjenjë talljeje dhe përbuzjeje për qytetërimin dhe shqiptarët në veçanti. Ky mbetet një atribut i njohur i banditëve dhe kriminelëve, kur janë të hipur mbi tanke dhe autoblanda, kur e kanë thikën e krimit ndër dhëmbë.

Ky atribut mbetet ushqimi shpirtëror në çdo kohë, deri në ekstazë, për ta çuar krimin më tej, deri në kufijtë e të paimagjinueshmes. **Pompoziteti i fuqisë dhe "pathyeshmërisë" së ushtrisë jugosllave përballë reagimit të shqiptarëve dhe qëndrimit të komunitetit ndërkombëtar, nuk ishte vetëm falsiteti i një propogande të dështuar, por dhe baza e veprimit praktik me natyrën më kriminale në terren.**

Mali me krime ishte mesazh dhune për shqiptarët, për të mbjellë tmerrin e për të realizuar më lehtë synimet e tyre të asimilimit nacionalist. Kjo fasadë, në thelb shoviniste, do ta shoqëronte çështjen tonë kombëtare deri në ditët e shpërthimit të konfliktit dhe do ta vinte atë përballë kësaj makinerie famëkeqe ushtarake, për t'u ndeshur e ballafaquar me të.

E nëse në këtë periudhë, vërejmë një mobilizim total të faktorit shqiptar për t'u ballafaquar në terren me këtë kundërshtar të egër, në krahun tjetër vërejmë një degjenerim të misionit dhe qëllimit të strukturave ushtarake jugosllave, të paktën formalisht për mbështetjen e slloganeve dhe deklaratave të lidërshiptit të tyre të çmendur politik. Por tashmë, këto struktura po tregonin se ishin futur në një rrugë pa krye, të përfshira në një batak moral dhe psikologjik, nga i cili nuk mund të dilnin dot më.

Dekompozimi moral dhe profesional

Lufta ka pasojat e saj dhe ato bëhen shkak i analizave për t'u vënë "notën" forcave pjesëmarrëse në të. Kjo duhet të ndodhte edhe me ushtrinë serbe. Një gjendje krejt tjetër konstatohej brenda strukturave ushtarake të saj, gjatë dhe në përfundim të luftës. Përballë misionit të saj qëndronte opinioni kontradiktor serbe, i cili ndiente mbi shpinë pasojat e luftës.

Veçanërisht rinia dhe njerëzit e mobilizuar në radhët e strukturës ushtarake, "të çoroditur" dhe me pikëpamje të ndryshme për ndryshimet radikale në Serbi, nën frymën e ndryshimeve në Evropën Lindore, u bënë pikënisja e kësaj "shkërrmoqjeje" psikologjike të ushtrisë serbe, e cila kishte vetëm një fund, dështimin dhe kapitullimin përballë forcës dhe mobilizimit të komunitetit ndërkombëtar dhe faktorit ushtarak shqiptar në terren.

Por kjo nuk mund të ishte gjithçka. Ndryshimet nuk mund të realizoheshin vetëm me dëshirën e mirë e deklarata, pa ia gjetur rrënjët së keqes dhe pa e goditur atë. Kjo frymë në Serbi mungonte atëherë, mungon edhe sot. Kjo mund të konsiderohet pa ngurrim fatkeqësia e tyre.

Gjatë ditëve të qëndrimit në Kukës, rashë në kontakt me disa publikime të deponimeve të robërve serbë, që kishin rënë në duart e luftëtarëve të lirisë, në një dështim të plotë në kufirin shtetëror në Tropojë. Faktet e dëgjuara nga goja e tyre për mënyrën e veprimit dhe krimet që kishin kryer ishin më shumë se tronditëse. Kuptonim gjithashtu se kishte kohë që vepronte ngërçi dhe shkërrmoqja psikologjike në radhët e tyre, dekompozimi moral dhe profesional i një ushtrie që kishte dalë jashtë natyrës njerëzore, jashtë moralit, jashtë rregullave të fushëbetejës, tashmë e kthyer në një turmë që vetëm vriste dhe masakronte në emër të "misionit" dhe ndjenjave të nacionalizmit ekstrem.

Robërit serbë pohojnë me gojën e tyre

Ndoshta për të qenë më bindës është e arsyeshme të flasim me gjuhën e tyre, ashtu sikundër janë shfaqur: "Kriza është e rëndë. Paniku gjithashtu, çdo ditë ka bilance të shumta me ushtarë të vrarë në front, por edhe me ushtarë të vrarë nga komandantët e tyre, pse kundërshtojnë urdhrat. Dezertorë ka përditë. Të ndëshkuarit "disiplinarisht", që i shkëpusin eprorët nga fronti dhe i çojnë kushedi në çfarë ferri, numërohen me dhjetëra në çdo repart. Ka ndërkaq edhe të "vetëvlarë"..."!

Pra të vrarë, të vetëvlarë, të hequr nga vija e frontit dhe të dënuar, dezertorë që nuk duan të lënë lëkurën në këtë luftë famëkeqe ose që nuk kanë dëshirë të luftojnë. Morali dhe fytyra e një ushtrie agresive.

Kodi moral ushtarak (antimoral) i ushtrisë serbe kishte kohë që jepte efektet e tij në kundërshtim me dëshirën e eprorëve të saj. Historia botërore dhe jeta në përgjithësi janë të mbushura me shumë raste të mospëlqimeve dhe të urrejtjeve pa shkak, të cilat kanë shpërthyer në gjenocide duke kaluar kufijtë e misionit ushtarak. Kështu ndodhi me ushtarakët serbë. Bindja ndaj autoritetit ka një kufi dhe Tahiroviç, ky rob lufte e kupton mirë këtë. E kundërta do ta çonte atë në krim dhe para drejtësisë.

Në Luftën e Dytë Botërore, ushtria naziste gjermane vrau dhe zhduku miliona hebrenj, çekë, polakë, romë dhe kundërshtarë politikë. Ndërkohë kur liderët ushtarakë gjermanë dolën para gjyqit ndërkombëtar të Nurembergut, u mbrojtën me shprehjen standarde "Unë zbatova vetëm urdhrin". Në të njëjtën natyrë është pozicionuar edhe ky epror serb që predikon urrejtje dhe rrugën e krimit pa kufij tek vartësit e tij. Jam i bindur se kështu do t'i ndodhë edhe këtij eprori serb para gjykatës ndërkombëtare.

Ky rrëfim na jep të kuptojmë se përplasja në terren u kthye në një luftë shumë të ashpër, për jetë a vdekje. Këmbëngulja për arritjen e qëllimit dhe synimeve nga shtabet serbe, i bëri ata të mos ndalen para krimeve dhe të mos shikonin e vlerësonin fenomenet që po u lulëzonin çdo ditë në radhët e tyre. Ishin këto ngjarje me pasoja tragjike që parapërgatitën humbjen dhe kapitullimin. Radhët e tyre u kthyen në një ferr të vërtetë për vetë ushtarët dhe oficerët serbë.

Ja çfarë pohohet më poshtë në gojën e Tahiroviçit: "70% e shokëve të mi refuzojnë të zbatojnë urdhrat dhe kërkojnë të kthehen pranë familjeve. Sytë e tyre kanë parë mizori të tmerrshme, jo vetëm ndaj shqiptarëve, por edhe ndaj shokëve të tyre. Janë vrarë shumë në front. Janë asgjësuar pas shpine shumë "rebelë". Për ata që dyshohet, u kërkohej kartë besnikërie që të nisen në fshatrat shqiptare e t'u sjellin koka fëmijësh. Nëna ime, ç'kanë parë sytë tanë! Ç'të rrëfej më parë!"

Mosbindja në strukturën ushtarake është një fenomen i dënueshëm që nuk pranohet. Por gjithsesi ajo ndodh, atëherë kur ndikohet nga morali njerëzor. Një ushtri e rregullt, e disiplinuar, që lufton për të plotësuar misionin e saj nuk mund të shpërfytyrohet. Ushtria serbe gjatë intervenimit të saj në Kosovë shfaqti në realitet atë urrejtje nacionale e racore të indoktrinuar nga ideologjia serbe antishqiptare, e cila i ka rrënjët e saj thellë në histori. Këta ishin ushtarët dhe oficerët serbë.

“Karta e besnikërisë” jepej mbi koka të prera fëmijësh

Këtë kishin filluar ta kuptonin shumë prej tyre. Pa këta elementë nuk do të arrihej lehtë “shkërmoqja psikologjike”, morale dhe pse jo dhe ushtarake e agresorit serb. Kjo gjendje ishte rrjedhojë e propogandës së dështuar serbe, e cila nuk kishte më efekt dhe tashmë operacioni psikologjik në radhët e ushtrisë serbe, nuk vepronte më mbi ushtarët dhe oficerët e saj.

Tashmë, ata po kuptonin me tmerr se kjo ishte një rrugë pa krye. Rritja në masë e "kundërshtarëve" i detyronte oficerët që karta e besnikërisë të vërtetohej me koka të prera fëmijësh shqiptarë, me çmimin e krimit. Kush mund të jetë ai që jep urdhra të tillë? Kush mund të arrinte në kufijtë ekstremë të mosarësyes njerëzore?

Këta njerëz të verbër e të nënshtruar plotësisht ndaj eprorëve të tyre tepër autoritarë, u shfaqën me agresivitetin e tyre ekstrem ndaj vartësve për t'i shtyrë ata plotësisht në rrugën e krimit. Kush i detyronte këta njerëz të bëheshin vegla qorre dhe viktimë të këtij brutaliteti, mbështetur në ndjenjat e nacionalizmit ekstrem? Ata ende dhe sot pas kaq vitesh të përfundimit të luftës, nuk e kuptojnë që akoma janë viktimë e këtij nacionalizmi. Por kriminelët kanë vetëm një fund: atë të dështimit dhe ndëshkimit.

Kush mund të flejë i qetë pas këtyre veprimeve kriminale, kë mund të zërë gjumi "rehat"? Këta oficerë të shfarosjes në masë, çdo gjë mund të jenë, por vetëm njerëz JO. Urrëjtia etnike i ka nxjerrë ata përfundimisht "nga binarët e jetës". Jo vetëm gjendja në front, por dhe efektet e trysnisë ndërkombëtare mbi komunitetin serb dhanë efektet e veta. Rrugë tjetër nuk kishte.

Kjo çka dëshmon Tahiroviçi, 23- vjeçar, është vetëm një pjesëz e asaj që ndodhte në radhët e ushtrisë serbe, e cila ishte e kryqëzuar dyfish, nga ajri me bombardimet e NATO-s dhe nga toka me goditjet e njëpasnjëshme të njërive të UÇK-së.

Rrëfimi i tij, si dhe dëshmitë e dhjetëra robërve të tjerë që u kapën ditët e fundit në front, hedhin dritë mbi ferrin që makina ushtarake- fashiste serbe, mundohej me çdo kusht e me çdo mjet, ta mbante të mbuluar. Por gjithësesi, robërit janë "spiunët" e parë, të traumatizuar, që sjellin lajmet e para të këtij ferri të madh.

"Morali i shokëve të mi, ushtarë e rezervistë të vjetër, por të mobilizuar rishtaz nën armë, është shumë i ulët. Është, si me thënë, një gjendje depresive që ka mbërthyer tërë efektivin që ndodhet në front. Edhe pse mundohen ta fshehin veten, të tillë paraqiten edhe eprorët tanë më të ulët. Por gjithësesi më e dukshme e më e shfaqshme kjo gjendje "shoku" shfaqet tek ushtarët".

“Cërni” parakalon me një kokë të prerë fëmije

Për shumë nga oficerët, propaganda e Beogradit ishte e pabesueshme. Komandanti i një njësie tankiste ka hedhur poshtë menjëherë pretendimet serbe, se fushata e Kosovës kishte për synim shtypjen e separatistëve shqiptarë. "Gjatë gjithë kohës që kam qenë në Kosovë, – pohon ai, - nuk kam parë asnjë ushtar armik dhe njëzia ime nuk është përfshirë asnjë herë në luftime apo nuk ka hapur zjarr ndaj objektivave ushtarake. Tanke moderne janë dërguar kundër fshatrave të pambrojtura shqiptare. Tanket, të cilët kushtojnë 2.5 milionë dollarë amerikanë secili, janë përdorur për të masakruar fëmijë shqiptarë, unë për këtë kam turp."

Një oficer zbulues i një brigade xheniere, pohon se rezervistët e Ushtrisë Jugosllave në Kosovë ishin krejtësisht të pakontrolluar dhe komandantët e tyre nuk kanë bërë shumë për të ndërhyrë. "Gjatë një operacioni të spastrimit etnik në një fshat në Kosovën juglindore, ne u dhamë fshatarëve gjysëm ore kohë për t'u larguar nga shtëpitë. Ata qëndronin në një rresht të gjatë përgjatë rrugës që të çonte jashtë fshatit. Një rezervist i mbiquajtur Crni (i Ziu) iu afrua një plaku, i cili mbante në dorë një fëmijë rreth tre ose katër vjeç. Ia mori fëmijën nga duart dhe kërkoi një pagesë prej 20.000 marka gjermane.

Shqiptari kishte vetëm 5.000 marka. Crni e mori fëmijën nga flokët, nxorri një thikë nga brezi dhe i preu kokën". Krimineli nuk kishte të ngopur. "5.000 janë të mjaftueshme vetëm për trupin, - thoshte ai dhe ecte përpara fshatarëve të tjerë, duke mbajtur kokën e fëmijës nga flokët." Më tej, Vladimiri vazhdon: "E gjithë kjo ka ndodhur në sytë e dhjetëra njerëzve.

Ne ishim të gjithë në një gjendje shoku: disa ushtarë vullën, ndërsa nëntogeri ynë i ri në moshë humbi ndjenjat para një pamjeje të tillë makabre të trupit pa kokë në tokë". Dhe Cërni u deklarua i papërgjegjshëm, u dërgua në shtëpi dhe tani është akoma i lirë. O Zot, ma mbaj gojën mbyllur kur nuk kam gjë për të thënë.

Oficeri Drazhen, pjesëmarrës në fushatën e Kosovës, ka thënë: "Unë kam parë me sytë e mi se si një rezervist rreshtoi para një muri rreth 30 gra dhe fëmijë shqiptarë. Unë mendova se ai vetëm donte t'i frikësonte, por ai më pas shkoi pas një mitralozi të rëndë antiajror dhe tërhoqi këmbëzën. Plumbat 12 mm i prenë në mes trupat e tyre.

Më dukej si një skenë e ndonjë filmi të lirë, por në fakt ajo ndodhi me të vërtetë". Më tej ai përfundon: "Nuk e di se si do të jetoj me këto kujtime, se si mund të rrisë fëmijët e mi. Unë nuk jam i gatshëm të pranoj fajin kolektiv. Unë dëshiroj t'i shoh ata që kanë kryer këto krime përpara një gjykate."

Eliminimi nga “të vetët” me vdekje “të jashtëzakonshme”

Por, për çfarë morali do të pretendonte ky serb i veshur me uniformë ushtarake, që nuk i shkulen dot nga sytë skenat e masakrimit të njerëzve të pafajshëm, por që në të njëjtën kohë është thellësisht i tromaksur për rrezikun që i rri mbi kokë prej eliminimit "nga të vetët"? Gjendja depresive në të shumtat e rasteve të çon në vetëvrasje dhe vetësakrifikim.

Morali i shkatërruar nga streset, dhe tmerret e luftës në kushte të tilla janë me efekte të pashmangshme. Nuk besoj se eprorët e tyre nuk e kanë ditur këtë, por gjithsesi ata kanë qenë të pafuqishëm për ta ndryshuar këtë gjëndje. Në kushtet e një rënimi të tillë moral, kjo ishte një situatë që nuk gjente shërim.

Më tej rrëfimi vazhdon: "Komandanti i kompanisë sime e ka emrin Liskoviç. Humbjet e fundit e kanë bërë si të tërbuar fare. I gjithë efektiv i kompanisë i ka kërkuar pardje të linte frontin e kësaj lufte të çmendur. Na kërcënoi hapur me vrasje. "Provojeni, - tha, - por askush s'ka me mbetë gjallë. Biles do të keni rast të provoni vdekje, jo si ato të zakonshmet.". Si lojtarët e lojërave të fatit, të cilët nuk heqin dorë nga humbjet e vazhdueshme, të ndikuar nga iluzionet e sigurisë së kontrollit mbi veten, ata vazhdonin të besonin se do të fitonin. Kështu ndodhi me serbët...

Po cilat mund të ishin vdekje "të jashtëzakonshme", sipas këtij oficeri të papërgjegjshëm serb? Përvoja e tij kuptojmë, se tashmë është e "pasur", me ato ç'ka kanë eksperimentuar në kurriz të shqiptarëve. Këtë vdekje "në modë", tashmë ata ua rezervojnë dhe vartësve të tyre. Presioni psikologjik i imponimit të nënshtrimit ndaj gjëndjes, e detyron oficerin të kërcënojë vartësit me ekzekutim, biles jo me vdekje të zakonshme! Zoti ju ndihmoftë të pastroni shpirtin tuaj nëse jeni ende gjallë....!!!

Më tej rrëfimi vazhdon: "Këtu vrasjet, sidomos të eprorëve, mbahen sekret i madh, jo vetëm për ne ushtarët, por edhe për eprorët e tjerë. Çdo lloj informacioni për të vërtetën, për humbjet, sekretohet rreptë".

Kasta e lartë e oficerëve serbe ndjente vështirësi përballë realitetit të luftës. Po a mund të mbulohet dielli me shoshë, a mund të mbulohet krimi, a mund të mbulohen humbjet, a mund të mbulohen vetë amullia dhe përshtjellimi në radhët e ushtarëve dhe eprorëve, a mund të mbash në këmbë një ushtri me moral të rënë, që nuk ka më besim në "fitoren" ndaj kundërshtarit? Kriza e besimit e shfaqur në masë, në kufijtë e saj ekstrem e detyroi kastën ushtarake të aplikonte me papërgjegjshmëri terrin informativ mbi strukturat e veta..!

9. Gjeneralbrigade Kudus Lama për luftën në Kosovë

Pas kaq vitesh nuk do të ishte e tepërt të sillnim një panoramë të asaj kohe, në vlerësimin e gjeneral Kudus Lames, kur kombi shqiptar i mobilizuar po shfaqte potencialet për t'i bërë ballë luftës. Ngjarjet precipitonin shpejt dhe kërkonin veprim. Jemi në kohë për të kuptuar atë që ka ngjarë, por dhe për të kuptuar momentin që kemi mbërritur, duke vlerësuar mesazhet e një lufte që lamë pas.

Divizioni i Kukësit në vijën e parë të frontit

Gjenerali tregon: "Do të vlerësoja fillimisht vendin dhe rolin e Divizionit të Kukësit gjatë luftës në Kosovë. Kjo luftë në projektimin e saj, mori mbi vete barrën e çlirimit të një pjese të Shqipërisë nga robëria e Serbisë. Në këto kushte ishte detyrë e çdo shqiptari që luftën jo vetëm ta përkrahte, por edhe ta mbështeste me të gjitha forcat e mjetet, që ajo të ishte e suksesshme. Ne u angazhuam për të qenë në mbështetje të synimeve që ishin në programin politik-ushtarak të UÇK-së.

Divizioni i Kukësit, si njësi operative e FA Shqiptare, përfshinte një zonë të gjerë përgjegjësie, që shtrihej në vijën e frontit 187 km të gjerë, që nga maja e Korabit e deri në Alpe, përballë Plavës e Gucisë. Brenda këtyre kufijve, shtrihej gjithë vija kufitare ndërmjet RSH-së dhe Kosovës së pushtuar.

Pra kjo njësi, që ishte njëkohësisht përballë ushtrisë serbe për sigurimin e integritetit të shtetit, ishte gjithashtu element organik në skalionin e dytë të UÇK-së. Duhet të jemi të qartë se pa një pozicionim të saktë të Divizionit të Kukësit, në interes të situatave, ngjarjet mund të kishin rrjedhoja të tjera. Prandaj vlerësoj se Divizioni, gjatë luftës heroike çlirimtare, ka patur dhe luajtur një rol shumë të rëndësishëm”.

Detyra kërkonte gjakftohtësi

Rolin do ta konceptoja kështu: Divizioni duhet të reflektonte aftësi luftarake për të siguruar integritetin territorial të vendit dhe paprekshmërinë e kufijve të tij. Detyrën e realizuam duke përballuar një seri provokacionesh të njëpasnjëshme e të përditshme të forcave serbe, të cilat ishin shumë të interesuara të përfshinin në konflikt Republikën e Shqipërisë, pasi do të krijohej për ta një situatë e favorshme për të realizuar synimet në Kosovë.

Pra, të shmangësh luftën duke pasur përballë një armik që kërkon me çdo kusht të angazhojë në të, është jo vetëm detyrë e vështirë, por përgjegjësi e madhe. Ajo kërkonte studim të hollësishëm të të gjitha mundësive dhe vlerësim të rrugëve për zgjidhje, duke përcaktuar atë që ishte më e favorshme.

Divizioni duhet të transmetonte siguri tek populli shqiptar, që akoma nuk besonte se mund të kishte një forcë të armatosur për t'i bërë ballë armikut, pas shkatërrimeve të vitit 1997. Duhet të përsosnim çdo ditë elementët e sigurisë, duke bërë përpjekje për eliminimin e hendekut të imagjinuar që ishte krijuar midis ushtrisë e popullit.

Të krijonim lidhjen e qëndrueshme e serioze në marrëdhënie me strukturat politike e ushtarake ndërkombëtare, si NATO, SHBA, OSBE, KE, strukturave të OKB-së, OJQ-ve etj, të cilat me praninë e tyre transmetonin siguri, qëndresë dhe bashkëpunim serioz në përballimin e krizës humanitare.

Duhet të krijonim një panoramë mediatike të qëndrueshme të veprimit tonë. Në atë periudhë, mediat nga e gjithë bota ishin të interesuara të transmetonin informacion. Kjo kishte shumë rëndësi për ne, pasi nëpërmjet tyre bëhej e mundur pasqyrimi i gjendjes reale të gjenocidit serb mbi popullin e Kosovës.

Bashkëpunimi me ta kërkonte kujdes, pasi jo të gjithë ishin miqësorë. Shumë prej tyre vinin për lajme sensasionale, ndokush edhe me prirje për aventurizëm. Gjithashtu, komunikimi me mediat në Kukës shihej me njëfarë dyshimi e smire nga segmente të ndryshme ushtarake e shtetërore në Tiranë. Këto probleme duheshin kapërcyer e detyra duhej kryer. Kjo detyrë nuk ishte e lehtë, pasi kërkohesh angazhimi maksimal për drejtimin ushtarak të njësisë.

UÇK-ja dhe strukturat drejtuese të saj ishin të pranishme dhe kërkonin mbështetjen e duhur për të realizuar objektivat luftarake. Duhej mbajtur parasysh, që këto obligime duhet të realizoheshin në kushtet kur Divizioni ishte në proces ringritjeje pas goditjeve që mori në mars 1997.

Vlen të veçojmë lidhjet shpirtërore të formacioneve të Divizionit me strukturat vepruese të UÇK-së. Ajo ishte e pranishme kudo. Për të dhënë një vlerësim më të saktë, duhet pranuar se Divizioni i Kukësit, megjithëse ligjërisht ishte njësi e FA të RSH, praktikisht konsiderohej si pjesë përbërëse e UÇK-së.

Ky konceptim na bënte që elementët luftarake të Divizionit të ishin të ingranuara me pozicionet që mbanin djemtë e UÇK-së. Ata ishin të njohur për të gjithë ushtarakët, pse jo edhe nga populli në zonën veriore. Përkushtimi i tyre dhe gatishmëria për të dhënë jetën për atdheun, u bë burim frymëzimi për të gjithë ushtarakët. Kjo ndikoi shumë në konsolidimin e strukturave të Divizionit për të arritur parametra operacionale në atë nivel që e kerkonte situata.

Prania e idealistëve të lirisë dhe shqiptarizmi i tyre, bënte që lidhjet shpirtërore dhe fizike midis dy strukturave të ishin në nivelin më të lartë. Nuk është momenti për të dhënë detaje por, nëse një ditë do të marrë dikush përsipër ta komentojë e të shkruajë për ta, secili ushtarak i

Divizionit të Kukësit apo UÇK-së do të mund të përshkruajë një histori më vete e shumë interesante.

Kriza humanitare linte gjurmë tek ushtarakët

Dua të theksoj një moment tjetër shumë delikat, veçanërisht për krizën humanitare. Përjetimin e kësaj situatë e kam bërë të qartë edhe më parë në shkrime e intervista të ndryshme. Kuptohet, kjo ishte një goditje e rëndë, të ballafaqoheshe me 700 mijë të shpërngulur, kur kishim parashikuar vetëm rreth 30 mijë të tillë.

Në pamje të pare, kjo ishte një katastrofë. E tillë konceptohej ajo në sytë e opinionit të gjerë. Ne ushtarakët kishim të pranishme dy pamje, atë të të shpërngulurve dhe rritjen intensive të UÇK-së, kalimin e saj nga pozicionet në mbrojtje, në pozicionin e mësymjes së përgjithshme.

Pra shihet se shpirtërisht vërtet kishim dhimbje për atë që po i ndodhte popullit, por kishim edhe bindjen se një dukuri e tillë ishte e përkohshme, pasi lufta e UÇK-së që po zgjerohej çdo ditë, do të sillte lirinë, duke marrë në konsideratë, që tashmë mbështetja e NATO-s ishte prezente.

Kriza e shfaqur nuk sillte për ne vetëm elementin e dhimbjes, por dhe angazhimin tonë për të dhënë ndihmesën e duhur në zbutjen e efekteve negative të ngjarjeve. Ata duhej të sistemoheshin në kushte minimale të mundshme për të jetuar.

UNHCR-ja, si organizëm kryesor në këtë ndërmarrje humanitare, arriti të vendosë në funksion hallkat e saj vepruese vetëm pas datës 10 prill. Pasojat e krizës humanitare prej datës 24 mars deri në 10 prill u përballuan kryesisht nga popullsia e zonës, pushteti lokal dhe strukturat e FA.

Sidoqoftë, vlerësoj se në këtë periudhë, ne ishim të vetmit që e dinim se ç'po bënim. Të gjithë të tjerët i merrte rryma me problematikën e saj të rënduar dhe bënin sa të mundnin e ç'tu dilte përpara.

Ushtarakët sfidonin rrezikun

Do të veçoja gjithashtu cilësitë më të mira të personelit të Divizionit në përballimin e ngarkesave psikologjike e privacioneve në situatën e vështirë. Nuk kam dëshirë të më merret për keq, nëse do të them se në atë periudhë në personelin e Divizionit janë evidentuar vetëm cilësi e veti shumë të mira nga të cilat do të veçoja: Gatishmërinë për të luftuar pa kursyer as jetën, për të arritur jo vetëm ruajtjen e integritetit të vendit, por edhe për çlirimin e Kosovës.

Kjo ka qenë bashkudhëtare për ushtarakët, pa dallim grade e funksioni. Kur unë deklaroja në atë kohë që jam ushtari i parë i Divizionit, e kisha bindje, por kjo nuk ishte vetëm imja, bindje të tillë kishte i gjithë personeli. Ishte kjo një periudhë që të gjithë duhet të ishim ushtarë të lavdishëm të Atdheut.

Disiplina në situatën luftarake mendoj se u arrit e plotë në Divizionin e Kukësit, ku do të veçoja se nuk kishte nevojë t'i kujtoje askujt se ç'duhet të bënte. Disiplina që në rutinën e përditshme ha mjaft kohë të punës së komandantëve, në atë periudhë kjo kohë ishte e fituar.

Unitetin midis individëve e strukturave, si një akt themelor për fitoren në luftë. Uniteti, dashuria dhe respekti midis ushtarakëve dhe popullsisë, bënë të mundur që gjithçka të vlerësohej si veprimtari e të gjithëve. Secili përpiquej të mbante barrën më të rëndë për ta lehtësuar sa të ishte e mundur mundimin e shokëve. Ashtu sikurse kur një strukturë gjendej në vështirësi, të gjithë ishin në këmbë për t'i vajtur në ndihmë.

Ndjenja e sakrificës ka qenë bashkudhëtare me efektivat e Divizionit në veprimtarinë e tyre. Me gjithë vështirësitë e punës e të familjeve, ushtarakët nuk u ankuan asnjëherë, por qenë në ballë të detyrave, pa marrë parasysh rrezikun dhe pa u ndalur përballë vështirësive. Dashuria e pakufishme për Atdheun, i bëri ata që të provojnë rreziqe të mëdha dhe t'i dalin zot detyrës, të ripërtërinin trimërinë dhe burërinë e të parëve, pa marrë parasysh rrjedhojat.

Profesionalizmi ushtarak i komandave e shtabeve ishte një tipar i spikatur deri në përfundim të luftës. Komandat dhe shtabet, në të gjitha nivelet, kanë luajtur rol të madh për planifikimin, koordinimin dhe drejtimin e veprimeve luftarake në procesin e zbatimit të detyrave e të misionit.

Gjenerali: “Do të luftoja si ushtar dhe si komandant”

Si detyrë të parë ushtarakët kanë pasur atë të ushtarit. Në Divizion, në të gjithë strukturën ka pasur tre lloje planizimi të veprimtarisë operacionale. Së pari, ishte planifikuar që të gjithë efektivat aktive, duke filluar nga komandanti i Divizionit dhe gjithë personeli oficer e nënoficer të organizoheshin deri në hallkat kompani e bateri për të mbuluar në rendim luftimi drejtimet më të rrezikshme në një situatë të rrezikshme.

Të gjithë do të luftonin si ushtarë, ndërsa në të pastajmen me fillimin e kompletimit, do të bëhej kalimi gradual i kuadrove nga detyra e ushtarit në atë të komandantit të togës, kompanisë e batalionit. Për të realizuar detyrën sipas këtij planizimi, u bënë mjaft prova gatishmërie, ashtu si edhe u kryen veprime të mirëfillta luftarake gjatë ndeshjeve me forcat ushtarake serbe.

Në këtë kuadër, funksiononte planizimi i trupave aktive, sipas të cilit, nënrepartet dhe repartet do të kryenin detyrat në front. Ky planizim deri në tetor të vitit 1997 u vu në efikasitet në masën 60% dhe vazhdoi të perfeksionohej në proces sipas shkallës së kompletimit. Planizimi u shtri në përdorimin e forcave me strukturën rezerviste. Komandantët dhe shtabet punuan intensivisht, duke ngritur repartet me kompletim në kushtim e stërvitje, me një nivel 60% deri në 70%.

Gjatë gjithë periudhës, komandat dhe shtabet në të gjitha veprimtaritë operacionale kanë manifestuar profesionalizmin ushtarak në shkallën më të lartë, aftësi këto, të cilat u reflektuan më së gjëri për mbi 22 muaj të luftës në Kosovë dhe në stërvitjet madhore si, “Drini 98” dhe “Drini i Bardhë 99”, apo në përgjigjen që u është dhënë forcave serbe nga repartet e Divizionit në Tropojë dhe Qafë- Prush.

Populli i rretheve të Veriut pranë nesh

Disa vlerësime do t’i pasqyroja për mbështetjen e popullit të rretheve të Veriut dhe organeve të pushtetit vendor për strukturat e Divizionit. Populli i zonës e kuptoi se pas marsit të vitit 1997, luftën e kishte në prag, por ai kuptoi më së miri se çfarë tragjedie i kishte shkaktuar vetes me goditjen që i kishte dhënë ushtrisë së tij. Në kushtet e vlerësimit të situatës ai u bë mbështetës i zhvillimeve për ringritjen dhe fuqizimin luftarak të Divizionit.

Do të veçoja pa mëdyshje: Mbështetjen morale. Ushtarakët gjetën ngrohtësinë e prehrit të zonës dhe miratim për të gjitha veprimtaritë ushtarake që u zhvilluan. Mbështetje njerëzore. Komandanti i Divizionit, në atë periudhë, ka pritur përfaqësues dhe përfaqësi nga të gjitha fshatrat, të cilët na jepnin garanci e mbështetje për trupat që do të vepronin në front. Ishin pikërisht këto kontakte që jepnin siguri se, nëse do të fillonte një luftë në front të gjërë me Serbinë, nga zona do të ishin në frontin e luftës mbi 30 mijë luftëtarë.

Por mendoj që kur kemi të bëjmë me mbështetje të popullit, unë nuk mund të bëj një ndarje midis mbështetjes nga populli i zonës, prej mbështetjes nga populli shqiptar në tërësi. E them këtë pasi, në atë periudhë, unë kam marrë një sasi letrash nga krahina të ndryshme, nga individë, grupe njerëzish, pensionistë, të rinj etj, të cilët shprehnin gatishmërinë dhe sigurinë se, sapo të shpallej lufta, do të ishin pranë meje në front.

Ishin këto arsye që më detyruan mua të ngre struktura të veçanta të mobilizimit me kuadro të zotë dhe të caktoj terrene, kazerma e mjete për mobilizimin e vullnetarëve, pavarësisht se ç’do të bënte shteti në planin e tij.

Mbështetje mirëkuptimi – ku çdo veprimtari ushtarak ishte e mirëpritur dhe secili përpigjej të sillte sa më shumë lehtësi për veprimtarinë e trupave. Ashtu si edhe respekti e kujdesi

që tregojnë në çdo rast ndaj familjeve të ushtarakëve. Po kështu edhe organet e pushtetit lokal kanë pjesën e tyre të kontributit në atë periudhë. Me gjithë problemet që ishin prezente për ta, angazhimi ka qenë mjaft i gjërë dhe ka ndikuar në fuqizimin e mbrojtjes dhe përbalimin e situatave.

Ne “e mbrojmë” vetë fshatin, nëse sulmohemi nga serbët

Përveç ndikimit në mobilizim, në kompletim, në furnizim, në rritjen e sigurisë e të informacionit, angazhimi i tyre ka qenë edhe për sigurimin e zbatimit të masave për mbrojtjen nga goditjet ajrore, kryesisht të qendrave të banuara, veçanërisht të qyteteve.

Marrja e masave paraprake dhe përcaktimi i strukturave për furnizimin e popullatës, për furnizimin me ujë, për energjinë elektrike, për sigurimin e rrugëkalimeve, për sigurimin shëndetësor, për evakuimin e popullatës nga zonat e rrezikuara të luftës etj.

Sigurimin e kushteve për përbalimin e të shpërngulurve jashtë planifikimeve dhe jashtë konceptit për një situatë lufte, ishte një problem për të gjithë. Kështu ndodhi realisht me të shpërngulurit nga Kosova në vitin 1998 në drejtim të Tropojës, ku i takonte që në Tropojë për çdo tropoan të kishte 1.5 kosovar. Dhe në vitin 1999 në Kukës ku i takonte që për çdo kuksian të kishte 5 – 7 kosovarë.

Pra, angazhimi ka qenë i gjithanshëm. Megjithatë, ka pasur edhe dy probleme për të cilat u detyruam të mbanim qëndrime shumë të rrepta. Këto qëndrime ishin: Së pari; tentativat për rebelime popullore, për hyrje në luftë me Serbinë, si rrjedhojë e pasjes së armëve nëpër duar nga i gjithë populli, kur dihej që nga ana e forcave serbe nëpërmjet provokacioneve bëhej çdo ditë ftesa për konflikt për të rënë në kurthin e tyre, të ngritur me kujdes, për të siguruar ndeshje ndërshtetërore dhe për të kaluar në hije veprimet e tyre në Kosovë. Na është dashur të punojmë shumë për të ruajtur disiplinën në këtë plan.

Mendimet e disa pushtetarëve që “unë mbaj përgjegjësi për fshatin tim dhe kur të vijë armiku përballë fshatit e mbrojmë vetë, por më tej nuk shkojmë”. Ky koncept nuk qe masiv, por aq sa ishte, nëse nuk do të qëndronim rreptë, do të prishte shumë punë e do të sillte dëme për mbrojtjen.

Gjenerali: “Këtu nuk ka vend edhe për mua edhe për juve”

Bashkëveprimi ynë me NATO-n në mënyrë të veçantë është zhvilluar gjatë bombardimeve mbi forcat serbe në Kosovë e Serbi. Por ne kemi pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm me strukturat e NATO-s që gjatë vitit 1998.

Por ardhja e disa drejtuesve nga NATO, (gjeneralë e kolonelë) diku nga qershori i vitit 1998, për mua ka qenë i padëshirueshëm, për arsye se, në atë periudhë disa organizma ndërkombëtare, por edhe të shtetit tonë, kishin një bindje të gabuar, se në qoftë se Serbia do të na sulmonte, mund të na pushtonte, se nuk kishim mundësi të mbroheshim.

Kështu që në atë kohë u bë publike një kërkesë që NATO duhet të vendosej midis Shqipërisë e Kosovës për të mbrojtur Shqipërinë nga ndonjë agresion i mundshëm serb. Kjo natyrisht ishte mosnjohja më e trashë e gjendjes, e traditave të trevave dhe e kapaciteteve që dispononim në atë drejtim. Dhe meqenëse ne iu dorëzuam popullit tonë në marsin e vitit 1997, dikush mendonte se kështu do t'i dorëzoheshim edhe Serbisë.

Ishte pikërisht kjo arsyeja, që atë ekip rikonicioni të NATO-s unë nuk e prita me dashamirësi dhe arritëm deri atje sa që u thashë që “këtu nuk ka vend edhe për mua edhe për ju” dhe se këtë drejtim unë jam në gjendje ta mbroj vetë. Ashtu sikurse u thashë që “ju, nëse vërtet doni t'i kontribuoni paqes mund të vendoseni në kufirin midis Kosovës e Serbisë. Pra, fillimisht u vendosëm në pozicione të pakëndshme. Por në vazhdim jemi mirëkuptuar për të gjithë elementët e ndërveprimit kundër një armiku të përbashkët.

Ardhja e Divizionit të Tiranës, moment kthese

Disa konsideracione do të shfaq edhe mbi rolin dhe vendin e njësive rezervë të SHPFA, të cilat u rreshtuan në rendimin e luftimit të Divizionit deri në përfundim të luftës. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, që nga viti 1998, ka mbajtur disa forca në zonën tonë, siç kanë qenë, disa kompani të brigadës komando, kryesisht për stërvitje e vrojtim, një kurs i Akademisë Ushtarake “Skënderbej” në vitin 1998, si dhe në pranverën e vitit 1999, struktura të batalionit special komando.

Këto trupa kanë qenë të mirëpritura për ne dhe jemi përpjekur t’i respektojmë e të bashkëpunojmë me to, pavarësisht se ato ishin trupa që Shtabi i Përgjithshëm i kishte në dorë të tij.

Ndërsa planifikimi dhe sjellja në Kukës e trupave të Divizionit të Këmbëtorisë Tiranë, ishte për ne një veprim, ku për herë të parë ne kuptonim se shteti do të na mbështete edhe me forca e mjete të tjera. Ardhja e forcave të Divizionit të Tiranës krijoi një panoramë tjetër, jo vetëm për forcat e Divizionit tonë, por edhe për gjithë popullin e zonës.

Me këtë veprimtari u mundësua që të zgjerohej ndjeshëm forca mbrojtëse e vendit dhe njëkohësisht u bë më intensiv interesimi ndërkombëtar për të marrë vesh qëndrimin shqiptar në periudhën në vazhdim. Duhet të mbahen parasysh dy momente në atë periudhë, sepse Shqipëria e mbipopulluar, me gati një milion qytetarë të ardhur nga Kosova, mori vendimin të mbante brenda vetes të gjithë këta qytetarë pa i lënë që ata të derdhen dyerve të Evropës e të Botës.

Nuk dihej se sa do të zgjaste lufta. Ajo në ato momente as që mendohej se do të përfundonte shpejt. Përkundrazi, të gjithë shprehnin mendimin se ajo do të ishte një luftë e gjatë, që mund të shkonte edhe deri në vjeshtën e vitit 1999, apo më tej. Duke mbajtur parasysh këto momente, përcaktohet se ardhja e forcave të Divizionit të Tiranës ishte një moment kthese, kur u kuptua se tanimë shteti po angazhohej drejtpërdrejt me situatën dhe nuk e konsideronte mbrojtjen e vendit detyrë vetëm të atij populli që jetonte në ato treva.

Trupat e ardhura u futën menjëherë në dinamikë. Ato prej meje meritojnë respekt dhe konsideratë të lartë për faktin se ata erdhën me bindjen se do të futeshin në luftë për mbrojtjen e Atdheut. Kishin një disiplinë për t’u vlerësuar. Komandat e shtabet e udhëhiqnin trupën me objektiva konkretë. Kishin bindje se ishte detyrë e tyre të ndodheshin aty ku ndodheshin dhe e ndienin veten të nderuar për këtë.

Të gjithë kuadrot e trupat ishin shumë optimistë dhe entuziastë. Kishin një unitet shembullor dhe zotëronin aftësi profesionale dhe punonin me intensitet për rritjen e tyre. Ato u integruan lehtë me situatën e rënduar të zonës dhe reflektuan guxim dhe qytetari, kishin dëshirën të merrnin përgjegjësi etj.

Mesazhi i gjeneralit

Duke vlerësuar arritjet e çështjes sonë kombëtare në këto vitet e fundit kombi shqiptar kaloi edhe një herë në këtë ndërrim shekujsh në luftë. Kjo luftë ka qenë nga më të suksesshmet në historinë tonë. Nëpërmjet kësaj lufte u vunë në rrugë të mbarë zgjidhjet për shumë probleme të kombit tonë që rruga historike i ka krijuar si rrjedhojë e kënaqjes së interesave të të fuqishmëve.

Kjo, mendoj se ishte lufta e fundit e kombit shqiptar. Prej këtej shqiptarëve nuk u kërkohet më të luftojnë, por të kenë unitet dhe të jenë të zgjuar. Pra llogoret e luftës sonë prej këtej janë uniteti dhe zgjuarësia, kush ulet në këto llogore është shqiptar i mirë, kush del jashtë tyre është shqiptar i keq e gjakprishur. Shpresoj të mos kemi të tillë.

10. Serbët sulmojnë ambasadën shqiptare në Beograd

Titulli i dytë : Flet Lordi Robertson i Port Ellenit.

Të gjithë studiuesit e konflikteve ushtarake e dinë më së miri, se psikologjia e luftës, stresi i betejës dhe nevoja për vendime konstante e të rëndësishme, shpesh u lënë shteg përpjekjeve burokratike, përplasjes së mendimeve, gabimeve dhe mungesës së analizave të thella të situatës. Por gjithsesi, kjo ndodh atëherë kur situata vepron, përballë kompleksit të ndikimeve të faktorëve në terren, kur stresi vepron jo vetëm mbi individin drejtues, por dhe mbi masën e gjërë të ushtarakëve. Me ose pa pasoja, problemet gjejnë zgjidhjen e tyre.

Dhe zgjidhja më e drejtë u referohet përherë fundit të luftës ose konfliktit. Për këtë konstatim sot shumëkush mund të ndihet mirë dhe të mendojë se e ka kryer detyrën.

Kështu, duke mbartur pasojat, dinjiteti i kohës nuk është i cenuar dhe i rrezikuar, por është i goditur seriozisht në zemër të tij. Kalimi nga individ i kriminel, në filozofi dhe në shtet kriminel, shënon cenimin historik të dinjitetit njerëzor të kohës që jetojmë. Në këtë kontekst, nuk kishte arsye që këtë ta pësonin popujt e Ballkanit, e veçanërisht shqiptarët në prag të mijëvjeçarit të ri.

Ngjarjet e vendosura në kuadratin e natyrshëm të kohës në të cilën ndodhën, brenda arsyes njerëzore, asnjëherë nuk i ngarkojnë të pafajshmit me faj, por në të njëjtën kohë, nuk i falin as fajtorët që shkaktojnë tragjedi të tilla.

Gjykoj se kjo nuk është e gjitha. Sipas publikimeve të lidërshiptit ushtarak të luftës kundër Serbisë, vërejmë me kujdes se, pas përfundimit të luftës në Kosovë, analizat dhe opsionet nuk kanë pasur të sosur. Ato janë bërë objekt studimesh, rekomandimesh për të vendosur në bazë teori të reja, për të gjitha fushat e veprimit të faktorëve ndërkombëtarë në planin politik, diplomatik, ekonomik dhe ushtarak. Ndoshta deri aty sa të rekomandohet, si model i menaxhimit të rezultateve të luftës prej bashkësisë ndërkombëtare.

Duke vlerësuar arritjet e një lufte të drejtë, nuk mund të lemë në hije, mendimin analitik të drejtuesit të Aleancës së Atlantikut Verior, Lordin Robertson të Port Ellenit. Gjykoni vetë se sa të drejtë kishte ai para disa vitesh, dhe se në çfarë rruge pa krye kanë precipituar ngjarjet sot në pritje të zgjidhjes së statusit të ardhshëm të Kosovës.

Lordi Robertson, një vit pas përfundimit të luftës

Lordi Robertson, në emër të Aleancës dhe të funksionit të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, pas një viti të përfundimit të luftës në Kosovë, jepte vlerësimet e tij. Është me vend që pohimet, ndonëse në një kohë të shkurtër nga përfundimi i kësaj lufte, tani pas gjashtë vitesh, të rivlerësojmë situatën me ngjarjet e mëvonshme, për të qenë më kritikë ndaj asaj që ka ndodhur në realitet në Kosovë dhe sfidave që kanë venë para përgjegjësive faktorin politik ndërkombëtar në zgjidhjen e statusit të saj.

Në mendimin e ish- funksionarit të lartë të NATO-s, vizioni i tij për Kosovën e ardhëshme, na bën përshtypje dhe njëherazi na shkakton habi, se si pasardhësit e tij ndiejnë vështirësinë e zgjidhjes së problemeve të rajonit, duke shfaqur ngurrimin e tyre dhe duke lënë padrejtësisht kohën të shfaqë pretendimet e saj.

Lordi Robertson: Aleanca mbi bazën e kësaj përvoje kërkon të përmirësojë strukturën e saj të veprimit në të ardhmen dhe elementët e paqëruajtës e humanitarë për të qenë në çdo kohë efektivë". Prej këtyre përfundimeve duhet të reflektojnë të gjitha strukturat që kanë vendosur sot urat e bashkëpunimit me të.

Në formë të përmbledhur, me ndonjë koment personal, po i referohemi gjendjes në Kosovë, nën këndvështrimin dhe vlerësimet e Lordit, i cili së bashku me shumë personalitete të tjera të SHBA-ve e të Evropës, për atë që bënë do të mbeten përherë miq të nderuar të shqiptarëve.

Serbët sulmojnë ambasadën shqiptare në Beograd

Lordi Robertson: "Në morinë e mendimeve që janë dhënë, duket e lehtë të shqyrtosh këtë fakt të thjeshtë. Shumë gjëra keqkuptohen mbi atë çka ndodhi. Tashmë është koha e përshtatshme t'u rikthehemi veprimeve të NATO-s gjatë konfliktit, të analizojmë arritjet e KFOR-it dhe të hedhim një vështrim në të ardhmen". Vizioni i Lordit të nderuar është aktual edhe sot.

Rreziku që kanosej ishte i madh dhe Shqipëria në atë periudhë u përball me shumë probleme. Çmimi, në kushtet në të cilat vepronin tërë strukturat e shtetit, do të ishte i madh. Fakti që NATO ndërhyri në Kosovë, ushtria serbe u tërhoq dhe u vendos 150 km larg kufirit shqiptar, fakti që populli shqiptar u rikthye në Kosovë, strukturat ushtarake iu rikthyen normalitetit, është një e vërtetë që tashmë vepron, por këtu nuk ka vend për iluzione të rreme.

Lordi Robertson: "Fillimi i bombardimeve në Kosovë s'ka dyshim që konsiderohet një hap strategjik i NATO-s për zgjidhjen e krizës në këtë vend. Gjatë fazës përgatitore të Aleancës forcat serbe kryen goditje me mortaja dhe artileri në të gjitha fshatrat e brezit kufitar shqiptar, duke krijuar premisa për shpërnguljen e popullsisë dhe dëme të konsiderueshme materiale.

Po kështu, si rezultat i situatës së tensionuar në kufirin midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe si rrjedhojë e ndërprerjes së njëanshme të marrëdhënieve diplomatike nga qeveria jugosllave, në datën 28.03.1999 në orën 12. 25 minuta në Beograd demonstruesit serb sulmuan ambasadën shqiptare atje, duke i vënë asaj zjarrin".

Kriza politike në Kosovë ka qenë dhe do të mbetet dhe për shumë kohë një fenomen i përmasave kombëtare për vetë faktin, sepse priten që shumë gjëra të shkojnë në vendin e tyre. Themi priten, sepse realiteti sot ende flet me gjuhën e tij. Vetëm atëherë ajo do të pushojë së qeni një krizë politike rajonale. Është fakt siç thekson Lordi Robertson se "askush nuk mund të jetë i kënaqur me situatën e tanishme".

Planifikimi: Të vrasim fëmijë, të thejtmë qëndresën e të rriturve

Udhëheqja jugosllave kishte planizuar dhe zbatonte një fushatë dhune e terrori kundër popullsisë civile shqiptare në Kosovë. Në atë kohë, askush nuk ishte i sigurt se çfarë do të ndodhte. Të papriturat shfaqeshin çdo ditë me efektet e tyre psikologjike torturuese e ngjethëse. Ishte planifikuar që forcat e sigurimit serb të vrisnin fëmijë për të terrorizuar e thyer psikologjikisht qëndresën e strukturave të UÇK-së dhe kundërshtimin e të rriturve.

Nëse komuniteti ndërkombëtar nuk do të vepronte me të gjithë potencialin e vet, atëherë, përdorimi i dhunës dhe persekutimi fizik do të rritej së tepërmi e po kështu numri i të vrarëve do të ishte edhe më i madh. Dhe ajo që ishte parashikuar veproi me fanatizëm terrorist.

Si në kohën e veprimit, por dhe tani kuptojmë se situata e shpërnguljeve masive me dhunë do të krijonte një gjendje destabilizimi në tërë rajonin ballkanik. Kjo nuk ishte gjë tjetër veçse një trysni dhe imponim që shteti jugosllav u bënte fqinjëve të vet për të zgjidhur "i qetë" problemet e veta në Kosovë.

Sot populli i Kosovës dhe lidhshipi i vet politik-ushtarak përballet me një sfidë të fuqishme. Me të gjitha format dhe metodat demokratike që mundëson klima e favorshme që ka krijuar komuniteti ndërkombëtar, të realizojë synimet e veta dhe t'i shkojë qëllimit deri në fund. Tashmë janë hedhur themele të forta në rrugën e nisur, por që t'i dilet mbanë, kërkohet në radhë të parë vullnet e përgjegjësi politike e vijueshme, në mënyrë që këto arritje të mos përfundojnë në një veprim të dështuar.

Urrejtja etnike, sfiga shekullore

Urrejtja etnike ka qenë e do të mbetet për shumë kohë një nga fenomenet më të dukshme të jetës politike e sociale në Kosovë. Pa kapërcyer këtë sfidë, është e vështirë të ringrihesh mbi atë që ka kaluar. Kjo urrejtje shekullore ka shkaktuar shumë tragjedi e dhimbje, ka kushtuar

shumë gjak, por dhe, nëse nuk do të kapërcehet, do të shkaktojë dhe të tjera ngjarje të tilla në të ardhmen.

"Sot, - thekson Lordi Robertson, - duhet të arrihet bashkëjetesa që e nesërmja të jetë vetvetiu krejt ndryshe. Urrejtja etnike është një e keqe që vepron. Ajo nuk duhet të infekttojë dhe të tjerë. Kjo do të ndodhë, nëse njerëzit e mirë të Kosovës sot dhe në të ardhmen nuk do të rrijnë duarkryq, por do t'i dalin kësaj së keqeje përpara".

Vlerësoni ku jemi sot pas gjashtë vitesh?! Prania ushtarake e trupave ndërkombëtare ka krijuar një klimë besimi, një stabilitet më të mirë. Në aspektin e situatës dhe gjendjes psikologjike, kanë ndodhur e po ndodhin ndryshime pozitive, janë kapërcyer streset e fuqishmë që shkaktonin situatat e rënda shpirtërore e sociale, fëmijët shkojnë në shkolla, njerëzit i janë kthyer punës, janë shëruar shumë plagë të luftës me ndërtime të reja, është gjallëruar biznesi e shumë e shumë të tjerë, por e parë me syrin jashtë ndikimit politik, është bërë shumë pak nga sa është parashikuar dhe premtuar.

UÇK-ja, rezultat i dhunës shekullore serbe

Në kontekstin e kronologjisë së ngjarjeve më kryesore të kohës, Lordi Robertson konstatonte: "Në të vërtetë UÇK-ja ishte rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shtypjes serbe. Dalja e saj në skenë u shfrytëzua nga shteti serb për të rritur e përshkallëzuar dhunën, duke mbjellë e ashpërsuar më tej urrejtjen e popullsisë. Kosova po jetonte ditët e dhunës e të terrorit. Shkelej me forcë çdo gjë që rezultonte e drejtë. Shkeleshin ligjet, rregullat e jetës, të drejtat dhe liritë e njeriut me veprime sistematike e të planizuara mirë".

Lordi Robertson: "Më 15 janar 1999, masakrohen 40 civilë në Reçak nga forcat e sigurimit serb, veprim ky që tronditi tërë opinionin ndërkombëtar. Ky veprim i kalonte përmasat e krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit. Në fund të janarit 1999, forcat jugosllave nën pretekstin e fillimit "të stërvitjeve dimërore" filluan goditjet me artileri dhe shpërnguljen me dhunë të qytetarëve drejt kufijve jugorë. Filloi taktika e djegies dhe shkatërrimit të shtëpive të civilëve, nën pretekstin e zhdukjes së bazave të UÇK-së".

Këto konstatime në gojën e ish - funksionarit të lartë të NATO-s janë një rrëfim i drejtpërdrejtë i asaj që ndodhi në realitet në Ballkan, që vuri përpara detyrimin faktorin politik dhe ushtarak ndërkombëtar. E vërteta edhe pse kalon koha, nuk mund të tjerësohet dhe të analizohet me mendësitë jashtë një realiteti të jetuar.

Këtë detyrim për atë që ka bërë NATO për Kosovën, nuk mund ta tjetërsojnë "lordët" e tjerë që janë në drejtimin e saj. Ata, sido që të jetë, kanë përgjegjësinë e madhe, detyrimin moral dhe politik t'i qëndrojnë vazhdimësisë së analizës dhe konstatimeve tronditëse e të vërteta të paraardhësve të tyre. Kjo është fisnikëri, por dhe qëndrim intelektual e qytetar.

Në Rambuje delegacioni serb tërhiqet nga bisedimet

Lordi Robertson: "Fillimi i bombardimeve të NATO- mbi Jugosllavinë pa dyshim që do të ketë ndikime frenuese mbi forcat ushtarake serbe. Kjo do t'u japë më shumë mundësi forcave të UÇK-së, që të rrisin më shumë veprimtarinë e vet luftarake".

Ky konstatim nuk ka qenë një rastësi, por një faktor veprues që bëri atë që duhet të bënte. E nëse sot qarkullojnë zëra që kërkojnë të zbehin rolin e UÇK-së në ato vite, kjo nuk është përgjegjësia e luftëtarëve të lirisë, por e atyre njerëzve që vuanë nga megallomania dhe bëhen trima pas beteje.

"Më 6 shkurt të dy palët fillojnë bisedimet e tyre në Rambuje jashtë Parisit, për të diskutuar marrëveshjen e paqes. Bisedimet zgjatën 17 ditë. Pala jugosllave nuk ra dakord dhe u tërhoq nga bisedimet. Ata nuk i kishin marrë seriozisht ato.

Kjo për faktin se dhe gjatë bisedimeve, forcat ushtarake jugosllave e shtuan dhunën dhe veprimet ushtarake kundër UÇK-së". Kokëfortësia politike serbe, e shfaqur në kushtet e

inferioritetit, shfaqet edhe sot më dhunshëm mbi çështjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës. Humbësit e luftës kanë treguar se nuk kanë nxjerrë mësim historike dhe rruga e tyre edhe sot është një rrugë pa krye.

Operacioni serb "Patkoi"

Në fillim të prillit u zbulua hapur në opinionin e gjerë ndërkombëtar se udhëheqja politiko- ushtarake serbe po zbatonte një shpërngulje të organizuar të popullsisë nga Kosova nëpërmjet planit të emërtuar "Operacioni Patkoi". Ky plan ishte hartuar muaj më parë dhe po zbatohet me përpikëri.

"Prirja për mospërdorimin e armëve, thekson Lordi i nderuar, është një meritë e demokracive perëndimore". Por në këtë parim themelor ka dhe një kufi të veprimit të tij. Mosbindja e udhëheqjes serbe ndaj parimeve të demokracisë perëndimore dhe dhuna e krimi masiv në terren, u dhanë të drejtën organizmave ndërkombëtare dhe NATO-s, të fillonin në shkallë të gjërë operacionet ushtarake.

Në 12 prill 1999, Këshilli i Atlantikut Verior deklaronte: "Sulmi i shfrenuar i forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, nën udhëheqjen e presidentit Milosheviç, kundër popullsisë civile kosovare ka krijuar një katastrofë masive humanitare, e cila kërcënon qëndrueshmërinë e rajonit përreth. Qindra mijëra njerëz janë dëbuar mizorisht nga Kosova prej autoriteteve të RFJ-së. Ne i dënojmë këto dhunime të tmerrshme të të drejtave të njeriut dhe përdorimin pa dallim të forcës nga qeveria jugosllave.

Këto veprime të skajshme dhe kriminalisht të papërgjegjshme, që nuk mund të mbrohen me asnjë arsytim, e bën të domosdoshme dhe e përligjin ndërhyrjen ushtarake të NATO-s". Me çfarë "argumentesh" të tjera mund të mbrohet kasapi i Ballkanit në gjyqin e Hagës?! Sot misionarët e shumtë politikë që merren me çështjen e Kosovës, nuk mund të bëjnë më shumë se sa konstatimet dhe rekomandimet e para gjashtë viteve.

"...Veprimet ushtarake të NATO-s kundër RFJ-së mbështetin qëllimet politike të komunitetit ndërkombëtar për një Kosovë të qetë, shumetnike dhe demokratike, në të cilën të gjithë njerëzit të mund të jetojnë në siguri dhe të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore në mënyrë të barabartë". Çfarë thuhet më shumë sot më pak, dhe çfarë pranohet po më pak nga shqiptarët sot për të ardhmen e Kosovës?! Çfarë ka ndryshuar në qëndrimin e faktorit politik ndërkombëtar që krijohen hapësira për llastimin e politikës serbe, duke u përballur me kokëfortësinë dhe megallomaninë e saj të shpifur?!

"Deklaratat e liderëve serbë mbi "pathyeshmërinë e ushtrisë së tyre", mbi "qëndresën" e dokrra të tjera të kësaj natyre foshnajrake etj, nuk ishin gjë tjetër veçse një demagogji dhe realitet serb i dështuar. Ballafaqimi ushtarak në terren vërtetoi të kundërtën.

Fushata ajrore e NATO-s kundër Serbisë

Nga më shumë se 38.000 aviofluturime luftarake, përfshirë 10.484 aviofluturime goditëse, nuk pati asnjë humbje, çka përbën një fitore të shkëlqyer. Shpesh strukturat ushtarake perëndimore u vunë para vështirësive në terren.

Taktika e serbëve, duke përdorur civilët si mburoja njerëzore për objektet e tyre, ishte sa çnjerëzore, por dhe shumë delikate. E çfarë mund të thuhet tjetër për këtë makineri luftarake terroriste, e cila guxon të tregojë dhëmbët edhe sot?!

Politika e mbrapshtë serbe duhet të bindet përfundimisht se koha tashmë punon për vendosjen e drejtësisë. Ajo mbetet faktor reflektimi për humbësit, agresorët, dhunuesit dhe është faktor zhvillimi për fitimtarët, në krahun e të cilëve sot janë të rreshtuar edhe shqiptarët. Për herë të parë pas 10 vjetësh të sundimit kolonizues e shkombëtarizues serb, u krijuan kushtet dhe u mundësua që 300 mijë nxënësve shqiptarë në Kosovë t'u jepet mësim në gjuhën shqipe.

* * *

Shqiptarët nuk kanë qenë asnjëherë agresivë, atyre u ka mjaftuar të mos ndiejnë mbi vete asnjë pushtet të huaj, të mos u paguajnë atyre taksa, të luftonin e të merreshin me hallet e problemet e tyre. Në trajtimin e çështjes kombëtare kemi pasur përherë një pikënisje, e natyrisht që do të kemi edhe një pikëmbërritje.

Njohuritë themelore dhe platforma e shtruar, kur janë të plota, hapin horizonte të afërta e të largëta për ardhmërinë kombëtare, por kjo materializohet dhe merr jetë, atëhere kur inteligjenca dhe djemtë dinë të duan vendin e tyre dhe të luftojnë për vendin e tyre.

Sot duhet të kujtojmë se ende agresorin e kemi përballë, të armatosur si më parë, me pretendime si më parë, me ëndrrën gjakatare të rikthimit ushtarakisht në Kosovë, pra hasmi edhe për shumë kohë, nuk do të harrojë grushtin e hekurit që mori në fytyrën e shëmtuar të kimit. Kjo na mjafton për të qenë përherë vigjilentë ndaj së keqes.

Çdo lëvizje kombëtare, përmban në vetvete dy momente të rëndësishme të lidhura ngushtë me njëra- tjetrën. Nga njëra anë janë përpjekjet me dhunë, veprimet me armë për të shkundur zgjedhën e huaj dhe këto sigurisht përbëjnë dhe boshtin e lëvizjes kombëtare për të fituar lirinë.

Nga ana tjetër janë orvatjet për të përgatitur shkëputjen nga shteti shtypës për të hedhur themelet e shtetit të ri, drejt shoqërisë demokratike. Kjo është një nga veprimtaritë gjithëpërfshirëse, që ka si pikësynim krijimin e kushteve të brendshme e të jashtme, të përshtatshme e të favorshme për një ngjarje të tillë. Megjithatë, në çdo rast duhet të kuptojmë në mënyrën më definuese se liria asnjëherë nuk mund të dhurohet, ajo fitohet.

Në vlerat e luftës çlirimtare, nuk është rasti i subjektivitetit të një drame apo një tragjedie, por mbështetur mbi një realitet gjaku, dhune, krimi, shfarosjeje, përdhunimi, përzënie, djegie e shkatërrimi, mbi një realitet fort të dhimbshëm në kurriz të popullit shqiptar, është rasti i një mesazhi të fuqishëm tejet atdhetar e në thelb kombëtar, se dhe në të ardhmen nuk do të jetë aspak e lehtë.

11. Klarku, gjenerali i luftës kundër Serbisë

I nderuar lexues i gazetës Ballkan,

Ky cikël shkrimesh mbi ngjarjet e dhjetëvjeçarit të fundit në Kosovë nuk është një rastësi. Është koha kur kamerat dhe mikrofonët kanë shkuar pranë opinionit të gjerë qytetar kudo në hapësirë shqiptare dhe kërkojnë të zbulojnë mendimin popullor se çfarë do të bëhet me Kosovën dhe statusin e saj në të ardhmen.

Është koha kur populli shqiptar në Kosovë pret me durim e gjakftohtësi, se cili do të jetë qëndrimi i faktorit politik ndërkombëtar mbi statusin e vendit të tyre, çfarë ruge do të marrë Kosova në vitet që do të vijin.

Është koha kur politika dhe diplomacia serbe me qëndrimet e saj ultranacionaliste, ka treguar se në thelb ka mbetur ajo që ka qenë dhe po bën të gjitha përpjekjet për ta mbajtur Kosovën pjesë të Serbisë. Ajo është gati të bëjë gjithçka që Kosova të mbetet nën Serbi, duke i provokuar shqiptarët përditë, duke synuar një destabilizim të ri të Ballkanit. Në këtë çështje delikate skenarët serbë nuk kanë të sosur.

Vlerat e ndërhyrjes ushtarake të NATO-së në Kosovë dhe të luftës së UÇK-së, janë vlera të karakterit shumëdimensional, për mënyrën se si ato e zgjodhën rrugën, për realizimin e misionit të tyre historik. Ne duhet të nxjerrim më mirë në dritë e të zhvillojmë më tej ato ndjesi të brendshme, që trazuan dhe vunë në lëvizje mekanizmin potencial të kombit shqiptar dhe që i bëri ata promotorë të reagimit të fuqishëm në terren, drejt vlerave të dëshiruara të lirisë.

Shqiptarët do të përcjellin përherë me shumë dhimbje e emocion këto realitete të gjalla, dhimbjen e thellë njerëzore dhe në të njëjtën kohë, ata bindshëm bëjnë apelin, se e vërteta historike mbi mbështetjen e faktorit ndërkombëtar dhe e luftës çlirimtare të bijve të Kosovës dhe të Shqipërisë nuk duhet harruar, prej saj duhet të nxjerrim mësim.

Ndonëse sot jemi paksa në distancë kohore me ato momente, e kemi për obligim të kontribuojnë sadopak, në njohjen e së vërtetës dhe vlerave të një periudhe historike, që do të jetë e pranishme për shumë kohë në memorijen tonë kombëtare, do të mbahet mend gjatë dhe do t'u kujtojë brezave, se përherë për interesat e çështjes sonë kombëtare, duhet vigjilencë, gjakftohtësi, bashkim e mençuri, tolerancë e mirëkuptim, mbështetje tek njëri - tjetri, që çështja jonë të fitojë dhe ne të bashkuar të integrohemi në botën demokratike.

Ripërtëritja e moralit të nëpërkëmbur dhe kohezionit, ridimensionimi dhe ripërtëritja në çështjet e edukimit me frymën e unitetit kombëtar, është dhe duhet të mbetet detyra më urgjente, ku padyshim, kontributi i inteligjencës dhe i rinisë mbetet i artë dhe i pazëvendësueshem.

Gjenerali Klark: Kjo është rruga dhe vizioni i së ardhmes...

Ish- Presidenti i SHBA-së, Bill Klinton, ishte arkitekti i sulmeve ajrore ndaj Serbisë, ndërsa gjenerali brilant Klark, në drejtim të Aleancës, e gjuhëzoi shtetin agresor përfundimisht në planin psikologjik dhe ushtarak. Të flasësh për luftën është e lehtë, të studiosh luftën është edhe më e lehtë, por të marrësh pjesë në luftë është një angazhim shumë i vështirë, që kërkon karaktere, mençuri, qartësi politike dhe profesionalizëm të lartë. Pikërisht këtë realizoi gjenerali në Kosovë.

Fushtata ajrore kundër Serbisë ishte në prag të shpërthimit të saj, me tërë potencialet politike dhe ushtarake. Vëmendja çdo ditë e më shumë, fokusohet në një figurë mjaft të veçantë të udhëheqjes politiko- ushtarake, dhe një nga këta ishte dhe gjenerali i famshëm, Uesli Klark.

Po të mos ekzistonte udhëheqësi ushtarak i NATO-së do të duhej të trillohej një figurë e tillë si ajo e gjeneralit brilant, Uesli Klark, sepse agresori ishte i dhunshëm, kokëfortë dhe nuk kishte sensin më të vogël të zbatonte rregullat e luftës. Gjenerali, që në rininë e tij luftoi dhe u plagos në Vietnam, që udhëhoqi NATO-n në Kosovë, më vonë qëndroi në një pozicion kritik ndaj luftës në Irak.

Personaliteti i tij kishte mbështetjen në traditën dhe etikën ushtarake, duke u sinkronizuar në një harmoni të plotë me elegancën e tij profesionale, me pamjen e këndshme, me pikëpamjet liberale, si studentin më të mirë të Uest Pointit dhe në kërkim tashmë të personalitetit të krahasuar me njerëzit më të mirë të Amerikës. Opinioni, ndoshta sot ka arritur të vlerësojë, se gjenerali ishte një kandidat ideal i demokratëve për postin e lartë në Shtëpinë e Bardhë.

Kandidati sfidant për President.

Duke mos e fshehur simpatinë, kemi vërejtur se tek gjenerali i luftës ekzistonte në thelb harmonia, e cila i lejon atij të paraqitet me shumë dinjitet në funksionin e tij. Ai kishte kredibilitetin e nevojshëm për të qenë në drejtimin e NATO-s në një situatë kaq të trazuar e me rreziqe.

Ai ishte i gatshëm për të sfiduar këdo kundërshtar në fushëbetejë, edhe pse ai publikohej se ishte shumë i fortë dhe e sfidonte krahun e armatosur të botës demokratike. Kohë më vonë, njerëzit pranë tij mësohet të kenë thënë se **“..kjo e detyron gjeneralin sfidant, që në planin e politikës së brendshme, të jetë afër me pikëpamjet e idhullit të tij Klinton, ndërsa në planin ushtarak, ai është një ideator i luftës së fundit moderne për çlirimin e Kosovës...”**

Harmonia dhe vlerat e vërteta të figurës së tij kanë bërë të mundur, që në prapavijat e veprimtarisë së tij të gjithanshme të një karriere të pasur, të rreshtohen personalitetet më të larta të jetës amerikane. Ai me përmbajtjen dhe vlerat e biografisë së tij, të përvojës së gjatë në karrierë,

do të kthehej në një shtyllë qëndruese, duke e vënë para përgjegjësisë kasapin e Ballkanit, "...nëse ju nuk do tërhiqeni nga Kosova, atëherë ne do t'ju godasim".

Përvoja e gjatë në njohjen e çështjeve të Sigurisë e bëri atë të shfaqte një përparësi potenciale pas ngjarjeve të 11 shtatorit në Amerikë.

Gjenerali që drejtoi luftën në Kosovë.

Gjenerali Klark ishte Komandanti Suprem i NATO-s gjatë luftës në Kosovë. Gjenerali, nuk mund të ishte jashtë vëmendjes së opinionit të gjerë botëror për aftësitë e tij në profesionin e ushtarakut dhe të liderit kryesor, në krye të koalicionit, gjatë konfliktit ballkanik.

Momentet e fillimit të operacionit ushtarak, nuk ishin të lehta për gjeneralin e NATO-s. Tensionet filluan të paraqiten edhe brenda aleancës ushtarake, për shkak të tendencave të disa shteteve anëtare, të cilat kishin si qëllim që ta neutralizonin natyrën luftarake të Uesli Klarkut dhe të bashkëpunëtorëve të tij.

Kundërshtarët e tij do ta përkuqtojnë gjeneralin krenar, për një çast të shfaqjes së kokëfortësisë drithëruese gjatë luftës në Kosovë, kur ai kërkoi nga gjenerali britanik Majkell Xhekson, që të godiste forcat ruse, që nxituan dhe kapën para kohe aeroportin e Prishtinës gjatë penetrimit në brendësi të territorit të Kosovës.

Përgjigjja e shkurtër e Xheksonit se ai, "...nuk ishte i gatshëm, që për Klarkun të fillonte Luftën e Tretë Botërore...", ishte ironizuese, por dhe një tregues i sfidës që i kishte përgatitur politika gjeneralit largpamës dhe impulsiv.

Tashmë, të gjithë e kanë kuptuar sfidën, kjo është politika, e cila ende nuk po vlerëson se pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në të gjitha luftërat lokale në botë, janë kapërcyer shifrat e humbjeve të kësaj lufte të tmerrshme.

Gjenerali nuk kishte nevojë t'i kujtonin fillimin e Luftës së Tretë Botërore, gjatë ushtrimit të detyrës më të lartë në karrierën e tij ushtarake. Tashmë ai e dinte se kjo luftë ishte duke vazhduar më e tmerrshme se dy të parat. Por gjeneralin e shqetësonte pabesia e "aleatëve", ajo pabesi interesash të politikës së mbrapshtë, që sot vë në dyshim vlerat e sigurisë, kudo në botë.

Këtë e kemi parë e ndier edhe në trajtimin e rezultateve të luftës në Kosovë, pas përfundimit të saj. Gjenerali kishte marrë përsipër të zhvillonte një luftë kundër luftës, e në këto rrethana, ai urdhëronte ndryshe nga kushdo tjetër, për të shfaqur dhe garantuar vlerat e forcës dhe të sigurisë së NATO-s, për të mos lejuar askënd të lëkundte rolin e saj, për të shtrirë në të gjithë hapësirën evropiane e më gjerë vizionin e ri modern të sigurisë me bazë bashkëpunimin dhe jo me bazë pabesinë.

Ky qëndrim i prerë e rigoroz i gjeneralit, buronte nga dimensionin human i shpirtit njerëzor të tij, përballë krimeve dhe gjenocidit serb në Kosovë. Ai nuk mund të pajtohej me qëndrimet tolerante ndaj agresorit dhe kriminelëve.

Ai do të mbetet në historinë e Forcave të Armatosura Amerikane dhe të NATO-s, si njeriu i vizioneve të reja në zhvillimin e teorisë së mendimit ushtarak modern, bazuar në rritjen e aftësive operacionale dhe në mënyrën e bërjes së luftës. Ai, do të mbetet si gjenerali i famshëm, që startoi misionin e ri të NATO-s, në fushën e sigurisë me bazë bashkëpunimin.

Kjo e bën atë të ndihet krenar për vlerat që i dha një epoke të re në fushën e sigurisë. Të gjitha këto janë pak, për të vlerësuar figurën e gjeneralit që mposhti Serbinë dhe bëri që kriminelin Milosheviç për turpin e tij të përfundonte në arkivolin politik të Hagës.

Dikur ai punonte dhe luftonte për rritjen e prestigjit të Amerikës, por dhe më pas ai nuk qëndroi indiferent në lëkundjen e vlerave të saj, duke kritikuar përfshirjen e Amerikës në luftën në Irak. Ai nuk iu referua drejtpërdrejt kësaj lufte, por ka folur hapur për humbjen e respektit për Amerikën, në një masë të madhe njerëzish në të gjithë botën. Fatkeqësisht, ky parashikim i gjeneralit sot po mundon opinionin e gjerë amerikan.

Togeri i luftës në Vietnam

Rruga e Uesli Klarkut, nga vendlindja e tij në Little Rock, e deri tek Komanda e Përgjithshme e NATO-s në Mons të Belgjikës, ka qenë mjaft e mundimshme. Ai është i lindur në 23 dhjetor të vitit 1944. Babai i tij i vërtet ishte me origjinë hebreje, i ardhur në Amerikë nga Rusia në fund të shekullit të 19-të. Uesli i Riu, studioi në Kaliforni.

Detyra ushtarake e çoi oficerin e ri të ushtrisë amerikane direkt në luftë. Si pjesëmarrës në luftën në Vietnam, togeri në moshë të re, Uesli Klark komandonte tri kompani, me një operacionalitet të dukshëm. Është dekoruar me shpërblimin “Silver Star” (Ylli i Argjentë). Në profesionin e tij kishte si specialitet bazë njësitë e blinduara.

Pas luftës, komandoi brigadën e tretë në Divizionin e katërt të Këmbësisë. Gjatë “Luftës së Ftohtë”, në vitet 1986-1988, Uesli Klark ishte komandant i brigadës së tretë në divizionin e katërt të Këmbësisë. Si komandant i divizionit “Cavalery”, gjatë viteve 1992-1994, ai e transformoi këtë njësi në një forcë të reagimit të shpejtë.

Gjenerali Uesli K. Klark, deri në korrik të vitit 1997, ishte komandant i forcave në Komandën Jugore të Shteteve të Bashkuara në Panama, dhe pas kësaj periudhe ai mori detyrën e Komandantit Suprem të Forcave të Bashkuara në Europë, në 11 korrik të vitit 1997.

Ai, ishte gjithashtu edhe Komandant i Shtabit të forcave ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Europë. Ai kaloi pesë vite në Qendrën Kombëtare të Stërviçjes (NTC) në Fort Irvin të Kalifornisë, duke u aftësuar si komandant i njësive taktike. Përfundoi studimet në Qendrën Kombëtare Operacionale, duke marrë njohuri në komandimin e njësive të përziera luftarake.

I aftësuar thellë në përvetësimin e metodologjisë së planizimit dhe të drejtimit të njësive të mëdha, në nivel divizioni dhe Korparmate, në kushtet e luftës moderne konvencionale dhe bërthamore.

Gjenerali Klark përfundoi Akademinë Ushtarake të Vest Pointit në Nju- Jork, si një kadet i suksesshëm. I diplomuar në Universitetin e Oksfordit në Angli, në degën e ekonomisë politike në vitin 1966-1968. Është posedues i një numri të madh diplomash të kurseve dhe kualifikimeve ushtarake dhe civile.

Në vitet 1976-1977, gjenerali Klark ishte asistent special në Drejtorinë për buxhetin në Shtëpinë e Bardhë, Asistent Profesor i Shkencave Sociale në Akademinë Ushtarake të SHBA-së. Për meritat e veçanta civile dhe ushtarake, gjenerali brilant sot mban një numër të madh dekoratash, nga më të lartat, prej të cilave, 13 çmime për merita të veçanta.

Gjenerali urdhëroi fillimin e luftës kundër luftës.

Shqiptarët kurrë nuk do ta harrojnë rolin e Perëndimit dhe në veçanti të Amerikës si përfaqësuesit kryesorë të politikës frytdhënëse për situatën që kaloi kombi shqiptar. Merita më e madhe për këtë ndryshim cilësor i takon padyshim ish- presidenti të SHBA-së, Bill Klinton, sekretares së Shtetit, Medllin Ollbrajt, duke mos harruar punën dhe kontributin e shkëlqyer të kryeministrit britanik Toni Blair, Zhak Shirakut dhe shumë personaliteteve të politikës europiane.

Në harmoni me këtë politikë, spikat roli i pazëvendësueshëm i ushtarakut të talentuar, komandantit të vendosur, gjeneralit Klark, i cili drejtoi të gjitha veprimet operacionale të Aleancës Ushtarake kundër Serbisë.

Pa Klarkun dhe ushtarët nën komandën e tij, shporrja e ushtrisë serbe nga Kosova dhe rikthimi i të shpërngulurve do të mbetej në jetë të jetëve një ëndërr. Uesli Klark nuk duhet të kuptohet si individ, por si një nga ata njerëz që ndihmuan me të gjitha potencialet e tyre intelektuale e njerëzore për të administruar atë situatë që mbizotëronte në Kosovë.

Klark në drejtimin e fushatës ajrore kundër Serbisë

Më 23 mars 1999, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana urdhëroi komandantin e NATO-s, gjeneralin Klark për fillimin e fushatës ajrore mbi ushtrinë dhe objektivat ushtarake të shtetit serb. Objektivi kryesor i NATO-s ishte ndalimi i dhunës dhe shtypjes ndaj popullsisë civile në Kosovë dhe marrja e përgjegjësisë dhe barrës kryesore për të siguruar paqen dhe qëndrueshmërinë në rajonin e Ballkanit.

Më 24 mars 1999, gjenerali Klark urdhëroi fillimin e sulmeve ajrore mbi objektivat ushtarake serbe. Të gjithë kemi qenë dëshmitarë të operacionalitetit të fuqishëm të Aleancës nga ajri, duke vënë në veprim avionët strategjikë B-52 dhe B-2. Në ditët në vazhdim, përkrahja për gjeneralin e luftës do të vinte në rritje.

Masakrat ekstreme të ushtrisë serbe në Reçak, ishin pikënisja e formimit të frontit solid të komunitetit ndërkombëtar kundër kriminelit Milosheviç. Ky front ishte mbështetja më e fuqishme për gjeneralin për të vazhduar misionin e tij luftarak e çlirimtar.

Gjenerali viziton Shqipërinë

Ishin ditët e nxehta të luftës, kur gjenerali nuk harronte të vizitonte vendet e tjera të përfshira nën ombrellën e sigurisë. Ai vizitoi Shqipërinë, Maqedoninë dhe mori sigurinë e lëshimit të hapësirave ajrore në interes të operacionalitetit nga Bullgaria, Rumania, duke parapërgatitur depërtimin e trupave tokësore nga tri drejtime të mundshme drejt Kosovës.

Pas përfundimit të luftës, gjenerali Klark ka vizituar disa herë Kosovën. Për ushtarakun kënaqësia më e madhe ishte fitorja në luftë. Këtë kënaqësi gjenerali nuk ngurroi ta ndante me popullin shqiptar në Kosovë, i cili nuk e humbi kurrë shpresën e lirisë. Për një zgjidhje të tillë shqiptarët i janë mirënjohës gjeneralit të madh.

Madhështia e figurës së tij për shqiptarët nuk do të ketë përmasa, ai do të mbetet mik i shqiptarëve në jetë të jetëve. Një verdikt i tillë do të mbetet për të gjithë jetën një sadsifikacion shpirtëror e moral për gjeneralin. Në këtë kontekst, shqiptarët do të përshëndesin me sinqeritet sa herë që do të përkujtohen ngjarjet e luftës në Kosovë. Ata do ta shprehin simpatinë e tyre të thellë për gjeneralin e madh Klark, dhe për këtë kanë të drejtë, sepse ai u bë pjesë e ëndrrave të tyre, së bashku me ideatorin e lirisë së Kosovës, Bill Klinton.

Klarku do të mbetet një mik i ngushtë dhe pjesëmarrës në sprovën e rëndë të shqiptarëve. Ai e meriton nderimin dhe respektin e kombit shqiptar. Ndërgjegjja e popullit shqiptar ka respektuar dhe vlerësuar të gjithë personalitetet botërore që ideuan dhe realizuan luftën kundër Serbisë.

Shembulli i tyre për ndërgjegjen, humanizmin dhe guximin e lartë për të mbrojtur dinjitetin, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut në Ballkanin e trazuar, në interes të zgjidhjes së problemit shqiptar, çlirimin e Kosovës dhe vendosjen e paqes, do të mbetet monument në historinë e kombit shqiptar. Ndoshta ka pak vende në botë, ku ish- presidenti Klinton dhe gjenerali Uesli Klark, gëzojnë një popullaritet të gjerë si në Kosovë dhe në mbarë kombin shqiptar.

Gjenerali ato që tha i realizoi

Bota për shumë arsye, në rrafshin politik dhe ushtarak ndryshoi në Kosovë. Meritat janë në radhë të parë të burrave të shtetit amerikan, Bill Klinton dhe Uesli Klark. Ata janë drejtuesit dhe fitimtarët e luftës mbi Serbinë e djallëzuar e brutale të Milosheviçit. Komandanti Suprem i NATO-s, të gjitha ato që tha dhe vendosi, i realizoi.

Ai me një qetësi dhe këmbëngulje të habitshme, sfidoi me përgatitjen e tij të lartë moralo - psikologjike dhe profesionale diktatorin Milosheviç, por në një farë mënyre, këmbëngulja e tij ishte një shembull i mirë edhe për shumë politikanë të lëkundur të Evropës. Gjatë vizitës së tij në Kosovë, mesazhet nuk ishin vetëm për shqiptarët, por edhe për matanë kufirit.

Gjenerali atëherë kishte të drejtë, sepse mesazhet e tij vlejné edhe sot. Nuk mund të jetë kurrë i lirë populli serb, që në fundshekullin që lamë pas, u bë vegël e verbër në duart e udhëheqjes së tij shoviniste për shtypjen e popujve të tjerë në Ballkan, për këtë s'ka mëdyshje e ekuivoke.

Por ai nuk mund të jetë i lirë edhe sot, në qoftë se shkon pas politikave shoviniste e ultranacionaliste të ithtarëve të Milosheviçit, të cilët ende ruajnë format e fantazmës së «Serbisë së Madhe».

Gjenerali e shtriu vizionin e tij në shërbim të Amerikës.

Ushtarakët, përballë politikës përherë do të ndihen në dilemë. Aftësitë e tyre në përgatitjen e lartë moralo – psikologjike, politike dhe dimensionet e gjera humane e profesionale, janë në vetvete një sfidë përballë realiteteve të zymta që imponon lufta. Ata synojné dhe luftojné që të ngrihen në nivelin e elitës, duke shfaqur vlerat më të mira të liderit të merituar.

Kur gjenerali brilant pranoi të kandidonte për partinë e tij, atëhere demokratët në Amerikë morën frymë të lehtësuar. Mbështetësit e tij shikonin tek gjenerali njeriun e përshtatshëm, që pretendonte ta çonte Amerikën më përpara.

Gjenerali do ta shtrinte gjeneralitetin e tij në shërbim të Amerikës, në qëndrimin e tij ndaj angazhimeve amerikane në botë. Duke kritikuar platformën e presidentit Bush në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, ai do të citonte se “Çelja e konflikteve të mëdha në botë njëherazi, pa siguruar më parë mbështetjen ndërkombëtare është e gabuar”.

Njeriu që gjunjëzoi Milosheviçin politikisht, moralisht, psikologjikisht dhe ushtarakisht, njeriu i vullnetit, qëndrueshmërisë dhe iniciativës, njeriu që shpërndau mesazhe të paqes dhe të sigurisë në Evropë dhe në botë, njeriu i shpresës për shqiptarët, tashmë shikohej si njeriu i vizioneve të reja. Dhe atëherë gjenerali kishte të drejtë.

Kujtoni qëndrimin e Milosheviçit në Hagë, para drejtësisë ndërkombëtare. Deliret nuk privojné askënd. Ato janë të pranishme dhe veprojnë edhe atëhere kur arsyeja të thotë të kundërtën. Kjo nuk është e çuditshme, as e pabesueshme, por është shumë tronditëse, kur mendon se efektet e këtij delirantizmi tek një leadership reflektohen në masën e njerëzve ithtarë, që u është mbushur mendja të rendin ende pas të marrit.

* * *

Sot gjenerali me katër yje, Klark, është në pension, i respektuar në vendin e tij, por i mirënjohur dhe shumë i respektuar nga shqiptarët, të cilët në veprimtaritë e tij të ardhshme, nuk ka pse të mos shprehin admirimin dhe përkrahjen e tyre për gjeneralin brilant të kombit amerikan, mikun e mirë të kombit shqiptar.

Mesazhet e gjeneralit Uesli Klark do të mbeten mishërim i asaj që duhet të veprojnë historikisht në memorjen e kombit shqiptar. Krimet mbi shqiptarët në Kosovë dhe në konfliktin në Maqedoni janë rasti më i fundit, që duhet të na bëjë të mendojmë se ka vetëm një rrugëzgjdhje thelbësore: të ndryshojmë prerazi qëndrimin dhe sjelljen tonë përballë realitetit të dhimbshëm dhe ëndrrës për të arritur paqen.

Veç kësaj, në kohë jemi përballur me disa forca të veçanta në Evropë, të cilat kanë qenë në parim dhe realisht kundër kësaj beteje të kombit të shumëvujtur shqiptar. Atëherë ata kishin kurajon të kundërshtonin edhe vizionin e gjeneralit për të mposhtur Serbinë. E nëse ka ndodhur kështu, nuk ka qenë plotësisht faji i tyre.

Faji, në kontekstin historik, është i njerëzve që në momente të caktuara humbasin logjikën njerëzore dhe shpërftyrohen përballë ngjarjeve historike. E megjithatë, shqiptarët nuk kanë bërë sa duhet, që të gjitha forcat përparimtare e vepruese të Evropës të kuptojné me kohën dhe të arrijné të vlerësojnë tiparet unikale kombëtare të popullit shqiptar në Ballkan.

Këto duhen parë si shfaqje e opinionit më të ndriçuar të vendit, një formë e manifestimit të ndërgjegjes së mbarë kombit, përballë mospërfilljes e dhunimit që u janë bërë të drejtave të shqiptarëve deri më sot. Duke mësuar nga karakteri i figurave të tilla me përmasa botërore, të

orientohemi pa mëdyshje në pavarësinë e mendimit në marrjen e qëndrimeve, për çështjen shqiptare.

Ky konstatim duhet të na shkundë ndërgjegjen kombëtare, duke na çliruar nga problemet tona larg pikave të vdekura. Situata në Kosovë është një kabanë për ne.

Historia është një mësuese e madhe, sepse pësimet t'i kthen në mësim. Ajo do të na orientojë drejt në rrugën që na çon në afirmimin e të drejtave dhe në emancipimin tonë të plotë. Këtë mendoj se bëmë mirë ne shqiptarët në fundshekullin e kaluar. Merita pa dyshim i takon edhe gjeneralit brilant, Uesli Klark.

12. Ku janë kriminelët e vërtetë të luftërave në Ballkan

Shqiptarët janë të rreshtuar në anën e fitimtarëve dhe ata sot kanë të drejtë të ngrenë zërin e arsyes, për ta çuar deri në fund amanetin e papërfunduar të dëshmorëve të luftës për çlirim.

Është koha e evidentimit të vlerave universale njerëzore, të një periudhe tronditëse, por të lavdishme, të mbushur me sakrifica, të cilat mund t'i bënte vetëm rinia dhe patriotët shqiptarë. Prej Drenicës, mesazhet e lirisë janë për të gjithë kombin shqiptar, nga Guri i Prerë e deri në Prevezë, kudo ku shtrihet Shqipëria jonë.

Në këtë çështje të madhe bartësit e ideve fisnike dhe traditave më të mira historike, djemtë dhe vajzat e UÇK-së, të gjithë luftëtarët e lirisë, me gjakun e tyre kanë hedhur themele për një të ardhme më të mirë. Në këtë rrugë ata i mbetën pavdekësisë. Ky është nderimi më i madh që ne u bëjmë dëshmorëve të lirisë dhe të çështjes kombëtare shqiptare.

Përballë këtij nderimi buron edhe detyrimi për të çuar deri në fund objektivat tona në çështjen kombëtare. Koha e pasluftës mbetet koha e sfidave të mëdha, përballë të cilave kërkohet përsëri vigjilencë e maturi.

Politika e UNMIK-ut në prag të dështimit

Pas përfundimit të luftës në Kosovë filluan të funksionojnë institucionet përfaqësuese të organizmave ndërkombëtare, të cilat morën përsipër zhdukjen e plagëve të luftës dhe kthimin e jetës së vendit në normalitet. Por jo të gjitha planet u realizuan ashtu siç u parashikuan. Administrata e OKB-së u përball me gjendjen e rëndë, me një vend të shkatërruar nga lufta, pa mbështetjen financiare, duke u ndodhur përballë sfidës së dështimit të misionit të saj.

Pesë vjet, deri në ngjarjet e marsit të vitit 2004, ishin të mjaftueshme për të kuptuar se populli shqiptar në Kosovë filloi të besonte në efektivitetin e institucioneve ndërkombëtare dhe shpresonte se shumë shpejt do të fitonte statusin e shtetit demokratik qytetar, për t'u integruar në jetën rajonale e më gjerë.

Paaftësia e strukturave të OKB-së për të zgjidhur problemet e mprehta, bën që në Kosovë të lulëzonin fenomene negative mbi një varfëri të skajshme. Kosova u kthye në një vend pa burime financiare, me një papunësi deri në 75 % e në rritje, me një proces privatizimi të dyshimtë, me një sistem energjetik të ndërvarur, dhe në shumë drejtime të jetës së saj nën veprimin e legjislacionit të vjetër të sistemit federativ, veçanërisht në drejtësi.

Jeta elektorale shënoi një arritje të re, por kjo vetëm në kulturën dhe qytetarinë që shfaqën masa e gjerë e njerëzve paqësore, dhe vetëm kaq. Arsimi dhe shëndetësia janë përballur me vështirësi serioze, duke mbijetuar me "thërrimet" e UNMIKUT, në prag të krizave institucionale. Jo vetëm kaq, por si rrjedhojë e lëshimeve graduale ndaj faktorit serb, në Kosovë filluan të funksionojnë strukturat paralele të shtetit serb, dhe ndërhyrjet e tyre brutale në jetën e brendshme politike të Kosovës.

Kjo përkëdheli e faktorit politik serb dhe vështirësitë në rritje të jetës ekonomike, bënë që jeta në Kosovë të ecte midis shpresës dhe zhgënjimit dhe të akumulonte brenda vetes urrejtjen dhe pakënaqësinë. Kjo situatë mbizotëron edhe sot.

Panorama institucionale në Kosovë kishte dhe ka shumë probleme, por kjo nuk do të thotë se populli shqiptar atje duhet të shtrojë kurrizin kur e ndien se në shpinë të tij vepron padrejtësia dhe hipokrizia politike. Këtë e kanë kuptuar jo vetëm shqiptarët, por ballkanasit dhe vetë politika evropiane.

Kombet dhe të drejtat e tyre legjitime nuk mund e nuk duhet të trajtohen si të ishin parti politike, për të vepruar si në pozitë dhe në opozitë, për të sunduar njëri - tjetrin dhe, në jo pak raste, për ta poshtëruar njëri - tjetrin. Faktori politik serb në Kosovë është bërë bartës i pretendimeve më të këqia dhe absurde, në të njëjtën gjuhë me politikën zyrtare të Beogradit.

Në këto kushte, politika shqiptare në Kosovë e kudo, e ka pasur të nevojshme në këto shtatë vjet të administrimit ndërkombëtar, të tregojë hapur pikëpamjet e saj para gjithë botës mbi të ardhmen e Kosovës, mbi qëllimet dhe aspiratat jetësore, duke shprehur qartësinë politike dhe vendosmërinë atdhetare, për të kryer detyrimet ndaj trojeve, sakrificave dhe gjakut të derdhur për liri. Metamorfoza politike që ka mbisunduar në këto shtatë vjet, tregon për të kundërtën.

Sot në Kosovë mbizotëron një situatë – krizë, së cilës i frikësohen të gjithë. Çdo të ndodhë në Kosovë, nëse asaj nuk i akordohet pavarësia dhe sovraniteti aq shumë i shumëkërkuar?!

Holker: Të shtrojmë pyetjen për statusin diku nga 2005

Në një klimë të trazuar politike në rajon, arenë e përplasjeve të interesave politike shtetërore e kontinentale, duket sikur BE-ja në kontekstin “e mungesës së progresit të reformave” në Kosovë, i është larguar në kohë çështjes së statusit final të saj. Një qëndrim me pasoja negative. Mesazhet e përtejatlantikut duket sikur bien në vesh të shurdhër.

Politika e OKB-së realisht, duke u mbështetur në analizën e faktorëve në rajon dhe gjendjen e etnive, kërkoi nga institucionet kosovare, që ato të bëjnë reforma demokratike, të sigurojnë sundimin e ligjit dhe të respektojnë të drejtat e pakicave serbe dhe komuniteteve të tjera, para se të fillohen bisedimet për pavarësinë.

A duhej besuar kjo deri në fund? Opinioni i gjerë në Kosovë sot mendon ndryshe, duke akuzuar se ky qëndrim u shfaq në shtatë vjet me natyrën e një manovre, e cila nuk kaloi pa pasoja.

Por gjithsesi, mendimi i ish- administratorit Holker se “të mund të shikojmë çështjen e statusit apo të paktën të fillojmë të shtrojmë pyetjen diku më 2005”, pa pasur një vizion të qartë mbi pasojat e ngjarjeve të marsit 2004, tregoi mungesën e seriozitetit të politikës ndërkombëtare, veçanërisht asaj evropiane. Vetë ngjarjet e marsit 2004 vërtetuan se ky qëndrim duhej parë me rezerva.

Politikës shqiptare në Kosovë sot i është vënë një rreth i hekurt në kokë, që synon kalimin e përgjegjësisë në shpinë të faktorit shqiptar. Duke analizuar kalvarin e gjatë të ngjarjeve dhe faktet kompromentuese që janë shfaqur, është vërejtur se ka pasur dhe ka premisa të rrezikshme në tensionimin e situatës në terren, mbas të cilave sot qëndron veprimtaria kriminale e strukturave paralele të Serbisë.

Tashmë, shteti serb ndodhet përpara zgjedhjeve, të cilat për nga misioni dhe qëllimet e realizimit të tyre me shtrirje edhe në Kosovë, kërkojnë të kompromentojnë dhe të paragjykojnë situatën dhe ta destabilizojnë atë, duke synuar që përgjegjësinë ta kalojë mbi shqiptarët.

Pavarësisht nga pretendimet gjoja ligjore dhe të së drejtës demokratike për të marrë pjesë në zgjedhje, të predikuara nga ish- zëdhënësja e UNMIK-ut në Prishtinë, zonja Heneker, pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në zgjedhjet e Serbisë dhe mundësia e zgjedhjes së liderve të tyre në dy funksione, janë një piruetë politike e rrezikshme e segmenteve politike të Beogradit, për të kompromentuar të ardhmen e statusit final të Kosovës.

Agresioni politiko- diplomatik, është një vazhdimësi dhe faktori politik shqiptar në Kosovë ka kohë që është vënë përpara dilemave dhe befasive në veprimtarinë e tij.

Sot është ende në fuqi Rezoluta 1244 e OKB-së, e cila mbetet e kaluar në kohë. Ngjarjet kanë vërtetuar se zgjidhjet në çështjen e Kosovës janë të vonuara dhe me pasoja. Një pjesë e serbëve, banorë të Kosovës, janë të pajisur me dokumente udhëtimi të lëshuara nga Misioni i OKB-së në Kosovë.

Në këtë kontekst, politika serbe pretendon se Kosova është pjesë e Serbisë, se ekziston e drejta e qytetarëve serbë për të votuar sipas fushatave të Beogradit, dhe kjo na qenka “një e drejtë demokratike”.

Por ndryshe mendojnë shqiptarët në Kosovë. Ata i kanë parë këto ndërhyrje brutale si një skenar për të përligjur kushtetutën serbe që e mban Kosovën pjesë integrale të Serbisë me pasojë gjendjen e tensionuar në vend dhe në rajon. E gjithë kjo ndodh përballë indiferencës së strukturave të UNMIK-ut në Kosovë.

Opinionin ndërkombëtar tashmë e di se situata në Kosovë është në një gjendje të brishtë dhe se atje po bëhen përpjekje, që të formulohen dhe të krijohen kushte për të përmbushur standardet e saj. Në të njëjtën kohë vlerësohet se duke e lejuar mbajtjen e zgjedhjeve serbe në Kosovë, ka zëra tek vetë ndërkombëtarët, që kjo situatë e nënvleftësuar lehtësisht nga organet ligjore ndërkombëtare, mund të paragjykojë seriozitetin ndërkombëtar dhe objektivin mbi statusin përfundimtar të saj. Dhe ajo që pritej, ndodhi.

Pavarësisht se statusi përfundimtar, do të përcaktohet nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, situata kalimtare në Kosovë, mbetet një tregues i lëshimeve hap pas hapi të ndërkombëtarëve ndaj politikës dhe diplomacisë serbe, duke e llastuar atë nën pretekstin e zbatimit të normave të së drejtës ndërkombëtare. Ky qëndrim rrezikon, që në të ardhmen, politika serbe të kërkojë të bëjë “viktimitë” dhe të dominojë situatën e sigurisë në rajon.

“Surprizat” e politikës në Serbi

Jeta politike në Serbi ka surprizat e saj. Për shumë kohë ajo u dominua nga momente delikate, përballë trazimit për shkak të procesit gjyqësor në ngarkim të vrasësve të ish-kryeministrit Xhinxhiç dhe të gjyqit ndërkombëtar ndaj ideatorit të masakrës ballkanike, Millosheviçit. Zoran Xhinxhiç konsiderohej si një udhëheqës me prirje properëndimore, i cili ndihmoi në rrëzimin e Slobodan Millosheviçit. Ndërkombëtarët panë tek ky njeri bashkëpunëtorin e aftë për të zgjidhur çështjet e shumta delikate, më të cilat lidhej e ardhmja e Serbisë dhe e rajonit të trazuar ballkanik.

Nacionalistët serbë dhe pjesëtarët e mafias politike në këtë vend, e shikonin atë si një rrezik për nëpërkëmbjen e synimeve të tyre të mbrapshta. Kjo vrasje nuk tronditi vetëm Serbinë, por njëkohësisht ajo tregoi se sa thellë krimi i organizuar është futur në strukturat politike të këtij vendi. Agjencitë e lajmeve kanë pohuar se vrasësit e vërtetë të liderit demokrat serb, janë ende të lirë.

Faktorit politik shqiptar, nuk i ka interesuar ky fakt, sesa thelbi i kësaj ngjarjeje të rëndë, e cila nuk ka kaluar pa ndikime në jetën politike të Kosovës. Si vrasës të ish- kryeministrit serb Zoran Xhinxhiç, janë të akuzuar në bashkëpunim tridhjetë e gjashtë persona, të cilët janë të skeduar për veprimtari kriminale në kuadër të bandave që veprojnë në Serbi. Çfarë përfaqësojnë këto struktura dhe ku shfaqet vlera politike e vrasjes së llojit të veçantë?

Prokurorët në Beograd e konsideruan atë si “vrasje të kryer nga nacionalistët serbë, që kishin qenë kundër bashkëpunimit të Xhinxhiçit me gjykatën për krime lufte”. Ata kanë pranuar se “vrasja ishte planifikuar dhe ndërmarrë nga grupe kriminale të lidhuara me ato parashtarake të krijuara gjatë regjimit të Slobodan Millosheviçit”. Një funksionar i lartë serb, mik i afërt i Xhinxhiçit, e vlerësonte vrasjen si, "një moment të tmerrshëm për të gjithë ne".

Duke u marrë me këtë fakt, nuk na intereson se çfarë bëjnë serbët, ajo është puna e tyre, por vetë vlerat e qëndrimit të tij politik. Pra, veprimtaria e përshkallëzuar e nacionalizmit serb, e

pohuar nga zyrtarët e tij, nuk godasin vetëm njerëzit me pikëpamje demokratike brenda Serbisë, por ata janë bërë një pengesë serioze dhe nuk lejojnë hapësira për reformat demokratike dhe për ndryshimin e imazhit të Serbisë, si një vend luftënxitës dhe agresor në Ballkan.

Ky është problemi thelbësor kokëfortë që duhet vlerësuar nga faktori politik shqiptar në Kosovë dhe në Shqipëri, i cili ndodhet nën presionin e vazhdueshëm që ushtrohet prej Serbisë kundër statusit përfundimtar të Kosovës, pavarësisht të saj. Dhe për këtë qarqet nacionaliste serbe po bëjnë të gjitha përpjekjet për ta mbajtur rajonin në tension. Janë pikërisht këto tendenca që herë pas here shkaktojnë kriza politike në shtetin serb, duke synuar që pasojat t'ia faturojnë faktorit politik shqiptar.

Deklaratat ultranacionaliste që shfaqin qëndrimin e politikanëve serbë se “nëse Kosova do të marrë pavarësinë, atëherë serbët janë të gatshëm që të shpallin autonominë në Kosovë“, janë një rrezik i pranishëm. Cinizmi serb bën karrshillëk pa kufij faktorit shqiptar dhe politikës ndërkombëtare.

Tendenca e vlerësimit të bisedimeve si “shumë simbolike” dhe se, “fatkeqësisht ato nuk do të jenë produktive”, e ka bërë faktorin politik ndërkombëtar të pranojë sot se çështja e zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës për politikën serbe ka mbetur thjesht, “një proces i filluar”...

Ku janë kriminelët e vërtetë të luftës në Ballkan?!

Dorëheqja e ish- kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe paraqitja në Tribunalin e Hagës, i dha një goditje të fortë politikës së vjetër dhe nacionalizmit agresiv serb, duke e çarmatosur atë përballë pretendimeve absurde.

Tendenca për të vënë përpara përgjegjësisë ligjore në një plan kriminelët e luftës dhe vlerat e luftës çlirimtare të UÇK-së, është një absurd politik i radhës, përballë të cilit qëndrimi i shqiptarëve mbetet befasues. Kjo tregoi se njerëzit e ndershëm e të përkushtuar në çështjen kombëtare dinë të luftojnë jo vetëm me uniformën ushtarake, por dhe me zgjuarësi përballë egërsisë politike të armiqve të kombit shqiptar.

Pavarësia e plotë e Kosovës kërkonte “kurbanin” e vet. Këtë e kuptuan ish- luftëtarët e UÇK-së, të cilët u paraqitën vullnetarisht në Hagë për t'i treguar botës se ata ishin të pafajshëm dhe ishin të gatshëm të përballeshin me akuzat absurde me përmbytje politike, dhe jo të fshiheshin rrëzave e gjirizeve si Karaxhiçët, Mlladiçët dhe tufa e kriminelëve serbë, që sot bredhin të lirë në Serbi, Kroaci dhe Bosnje.

Nga vlerësimet e personaliteteve nuk munguan atëherë përcaktimet mbi «aktin kurajoz», «të qytetarisë», «të vullnetit të mirë», «të trimërisë» e plotë elozhe të tilla, të cilat si në të gjithë rastet e tjera, përmbanin doza politike dhe diplomatike. Nga ana tjetër, Tribunali i Hagës me pompozitetin e tij dhe autoritetin ndërkombëtar, përballë një formaliteti të rëndomtë juridik, mudohej të ruante paanësinë dhe të deklaronte në sytë e opinionit ndërkombëtar, se ai ishte një instrument apolitik.

Kështu do të dëshironim të ishte në realitet, por opinionin ka mbetur skeptik përballë fakteve që e bënin atë të dyshonte mbi informalitetin e këtij instrumenti politiko – juridik. Kjo lidhej edhe me paaftësinë e strukturave ndërkombëtare të sigurisë, për zbatimin e mandatarresteve për kriminelët e vërtetë të luftës në Ballkan. Analisti i BBC, Partosh, pranonte hapur atëherë se «nuk është faji i gjykatës që Karaxhiçi, Mlladiçi e të tjerë ende nuk janë në gjykatë. Për këtë mund të fajësohen paqëruajtësit e udhëhequr nga NATO-ja në Bosnje, mund të fajësohen autoritetet lokale» etj.

Më mirë kështu, të dihen fajtorët, të cilët janë shkaktarët sot që drejtësia nuk ka shkuar në vend. Atëherë, përse u paragjykuan vetëm shqiptarët në një proces kaq të rëndësishëm që ushqente më kot ndjenjat e njerëzve të thjeshtë mbi drejtësinë?! Pasojat e paaftësisë nuk janë vetëm konstatimi. Ato kthehen në shkak për pasoja të tjera edhe më të rënda.

Përballë paaftësisë gjallonte përditë rritja e frymëmarrjes prej politikës së Beogradit, e cila ka treguar deri tani se nuk ka dëshirë të bashkëpunojë me këtë gjykatë për kriminelët e luftës. Ata duhet të kishin dalë para drejtësisë në krah të Milosheviçit.

Mbi 16 mandatarreste të pazbatuara

Nuk do të mbetemi në konstatime retorike, por bindëse, duke iu referuar mandatarresteve të lëshuara nga kjo gjykatë. Nuk janë pak, por mbi 16 kriminelë luftë të akuzuar për t'u gjykuar nga drejtësia për krime kundër njerëzimit. Ku janë sot personat e akuzuar publikisht për krime lufte, të akuzuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish –Jugosllavinë. Ata lëvizin ndoshta të lirë në hapësirat serbe, kroate dhe boshnjake dhe nuk do të dëshirojnë kurrë të shkojnë përpara drejtësisë!

Ku është Brovqanin Lubomir, nga Pijesak, me nofkën “Lubisha”, ku është Borovnica Goran, nga komuna e Prijedorit, me nofkën që ende nuk i dihet, ku ndodhet sot Gjergjeviç Vllastimir nga komuna e Vladiqinit, me nofkën “Roxha”, ku është Radovan Karaxhiç nga Pejtница, me nofkën “Rasha”, ku është sot Haxhiç Goran nga Vinkovçi i Kroacisë me nofkën që ende nuk i dihet, ku ndodhet Gojko Jankuviç nga komuna e Foçës me nofkën “Haxhia”, ku ndodhet Milan Llukiç nga komuna e Vishegradit me nofkën që ende nuk i dihet, ku ndodhet Sredoje Llukiç, nga komuna e Vishegradit me nofkën që nuk i dihet, ku ndodhet sot Sreten Llukiç nga Bosnje- Hercegovina, që ende nofka nuk i dihet, ku ndodhet sot gjenerali famëkeq Ratko Mlladiç, nga Bozhanoviçi, që ende nofka nuk i dihet, ku ndodhet sot Drago Nikoliç nga Batunaci me nofkën “N”, ku ndodhet sot Vinko Pandureviç nga komuna e Sokolacit, që nofka ende nuk i dihet, ku ndodhet Nebojsa Pavkoviç nga Senjsiki Rudnik, Serbi dhe Mali i Zi, që ende nofka nuk i dihet, ku ndodhet sot Vujadin Papoviç, nga Shekoviçi, që ende nofka nuk i dihet, ku ndodhet Dragan Zelonoviç, nga Foça me nofkën, “Zekla Zeleni”, ku ndodhet Stojan Zhuplanin nga Kotorr Varosh, të cilit ende nofka nuk i dihet. Ka më të tjerë?!!

Zonja me pamje të hekurt, Karla del Ponte rri akoma e pret që ata të shkojnë vetë «vullnetarisht» në Hagë. Kriminelët nuk shkojnë me këmbët e tyre përpara drejtësisë. Edhe Milosheviçi u dorëzua nga të tjerët. Më kot do të presë gjykata në Hagë njerëzit që për vite të tëra fshihen rrëzave duke fantazuar ndoshta për masakra të reja në Ballkan.

Dhe kanë të drejtë. Prapavijat e tyre politike nuk mund të fshehin dot gjurmët kriminale përballë realitetit që po mbizotëron në Ballkan, e veçanërisht në Kosovë.

Anëtarët e Tribunalit të Hagës dhe faktori politik ndërkombëtar, duhet të kuptojë se krimet e luftës kundër njerëzimit në ish – Jugosllavi, nuk kishin vetëm fytyrën e Milosheviçit, por të një sistemi të tërë politik, që duhet vënë në bankën e të akuzuarve dhe që po mbahet gjallë nga vazhduesit e tyre sot në Serbi.

Kriminelët e luftës nuk janë vetëm 16 të tillë, sipas mandatarresteve të zonjës Ponte, por ata janë shumë, sepse kanë qenë përfaqësues të një sistemi politik kriminal, protagonistë të tragjedisë disavjeçare në Ballkan, kanë tmerruar njerëzimin me krimet e tyre, ndonjëherë edhe në sytë e ndërkombëtarëve, dhe sot janë të lirë. Kush mund t'i fshihet drejtësisë?

Vetëm kriminelët dhe frikacakët, ata që e dinë se i kanë borxhe të rënda njerëzimit, shpirti i të cilëve e ka vendin vetëm në FERR.

Paradokset vërtet duhen parashikuar, ndaj tyre duhet të mbahen qëndrime politike konsejkuente, për të mos lejuar askënd që të bëjë pazare me sinqeritetin dhe ndershmërinë e shqiptarëve, me interesat e tyre kombëtare. Protagonistët e Tribunalit të Hagës dhe politika e kontinentit të vjetër ende nuk e kanë kuptuar se “po i hipe mizës, ajo të çon vetëm në hale, por dhe mjalti më shumë vret miza sesa bletë”.

Cilido që nuk ka kuptuar deri më sot se ku është djepi i atdhetarisë shqiptare, do të gabojë në vlerësimet që do t'u bëjë shqiptarëve dhe kërkesave legjitime të tyre. Njerëzit e thjeshtë e kuptojnë politikën me thjeshtësinë dhe sinqeritetin që i karakterizon, dhe ata asnjëherë, qoftë edhe në heshtje, nuk pajtohen me dhunimin që po u bëhet, edhe kur ajo merr ngjyrat e demokracisë.

13. Një komb i arsyeshëm nuk e nxit konfliktin

Sipas pikëpamjes së Nobelit, “asnjë komb i arsyeshëm nuk do të nxiste një konflikt, nëse pasojat për vetë atë do të ishin shkatërrimtare”. Historia botërore na jep të kuptojmë se njerëzimi shpesh në momente të vështira ka ndier të nevojshëm mobilizimin, tendosjen e mbështetjen, duke i dhënë një sadsifaksion të gjallë dhe besim qenies njerëzore mbi të ardhmen.

Dëmet dhe pasojat e luftërave të mëdha që janë zhvilluar mbi tokë, pas përfundimit të tyre përherë tek njerëzimi kanë zgjuar dhe ripërtëritur interesin për vendosjen e paqes.

Kjo tendencë mbizotëroi edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë. Nën shpresën e përkujdesjes prej organizmave ndërkombëtarë, populli shqiptar besoj dhe shpresoi për një jetë më të mirë, duke hedhur vështrimin e tij në të ardhmen. Funkcionimi sot i mjaft organizmave ndërkombëtarë për këtë qëllim, mbështetur mbi funksionimin e arsyes njerëzore dhe e dëshirës për paqe, bëri që në periudhën e pasluftës në Kosovë të dominojë mendimi i pavarësisë dhe kthimit në një faktor stabiliteti në rajon.

Këto dëshira të motivuara nga ndjenja e besimit dhe sakrificave të shumta mbi pasojat e luftës e mbajtën zgjuar shpresën e mirë se një ditë do të jetë ndryshe.

“Meka” e shqiptarëve

Vlerat dhe sakrificat e luftës çlirimtare i kanë ndier më mirë ata të cilët kanë parë se çfarë ka ndodhur në Prekaz të Drenicës, ata që kanë pasur rastin të falen në “Mekën” e shqiptarëve, ata që janë përkulur me respekt e dhimbje përpara varrezave të dëshmorëve të atdheut. Kjo dhimbje brenda shqiptarësh i ka bërë ata të ndihen krenarë dhe të kuptojnë se e meritojnë lirinë dhe pavarësinë.

Përvoja e historisë sonë kombëtare dhe vlerat që rrezatojnë prej saj, janë ndoshta, mënyra më e mirë për të respektuar veçanërisht rastet unike të saj, në të cilat ka funksionuar përsosmërisht algoritmi: mendimi intelektual kombëtar ka induktuar mendimin politik shqiptar, duke e veshur e pasuar atë me aksionet politiko – ushtarake. Kosova është dhe do të mbetet shembulli unikal në historinë tonë.

Vlerësimet maksimale për UÇK-në

Tashmë lufta ka mbaruar, Shqipëria dhe Kosova shpresonin t’i ktheheshin normalitetit. Themi shpresonin, pasi shumë ngjarje kanë treguar se jeta në hapësirën shqiptare është përballur me sfidat që i ka rezervuar koha. I rreshtuar në anën e fitimtarëve, populli shqiptar kërkoi besimin drejt rrugës së proceseve të demokratizimit të jetës në vend.

Është momenti që në këtë kohë tjetër të gjykimit të arritjeve të fitores mbi kolonizatorët serbë, të arritjeve dhe pasojave të luftës së përgjakshme, duke e krahasuar me realitetin sot, të arrijmë në përfundime të karakterit përgjithësues, të cilat nxjerrin në pah vlerat e faktorëve madhorë që vepruan në kohën dhe terrenin e luftës, që mbajtën gjallë shpresën e popullit shqiptar në Kosovë e kudo për fitoren e lirisë dhe të demokracisë, por dhe të faktit që ende nuk dihet se kur dhe ku do të përfundojë.

Në mënyrë të përmbledhur në retrospektivën e ngjarjeve kryesore, do të ishte me vlera interesante të rikujtonim edhe një herë sistemin e vlerave mbi arritjen e objektivave të një lëvizjeje me karakter kombëtar, e cila ndryshoi shekullin për shqiptarët.

Vlerësimet e para për këtë periudhë të lavdishme të historisë shqiptare, i takojnë protagonistet kryesore të saj, UÇK-së. Ajo u bë faktor vendimtar që çështja jonë kombëtare të

merrte përmasat gjithëpërfshirëse dhe të nxitej angazhimi i faktorit politik ndërkombëtar në zgjidhjen e krizës ballkanike të shkaktuar nga regjimi i Beogradit në Kosovë.

Kam qenë i pranishëm në diskutime dhe analiza për trajtimin e së vërtetës mbi luftën e popullit shqiptar në Kosovë në vitet 98-99. Me miqtë e mi kam pasur fatin të kem qenë i ftuar në odën e madhe të Jasharajve. Bisedat për luftën kanë qenë shumë prekëse dhe nën gjykimet e mprehta të protagonistëve në një realitet të jetuar, ato rrezatonin pjekuri, dhimbje, por dhe shpresë për të ardhmen.

Evidencimi i vlerave të luftës në Kosovë dhe të UÇK-së na kanë bindur se nëpërmjet publikimeve të herëpashershme të ngjarjeve që ndryshuan shekullin për shqiptarët, i është bërë një shërbim i madh pasqyrimin të së vërtetës mbi këtë periudhë lufte dhe sakrificash, të cilat kanë investuar vlerat më të mira morale, psikologjike dhe luftarake në thelbin e identitetit tonë kombëtar. Kjo do t'u shërbejë brezave që do të vijnë.

Simbolika e ushtrisë më të re të kohës

Vlerat e UÇK-së janë vlera të karakterit shumëdimensional për mënyrën se si u lind e u rrit dhe se si ajo e realizoi misionin e saj. Të shkruash për ushtrinë më të re të fundshekullit, nuk është e lehtë, aq më tepër për një ushtri që me vullnetin e saj dhe të popullit që e lindi dhe e rriti, shënoi faqe të lavdishme në historinë e Kosovës dhe tërë Shqipërisë. Ajo i dha vetes dhe popullit të vet atributet e një qëllimi të lartë dhe të një misioni tepër fisnik, në kërkim të lirisë së shumëdëshiruar në një shekull.

Mbartës të ideve fisnike dhe traditave më të mira historike, djemtë e UÇK-së, luftëtarët e lirisë me gjakun e tyre hodhën themelet e një të ardhmeje të sigurt për Kosovën dhe mbarë çështjen kombëtare. Me rrënjë të thella në popull dhe në pranverën e viteve 81, Ushtria Çlirimtare e Kosovës u lind dhe u rrit në kushtet e një represioni të paparë policor e ushtarak, sfidoi klikën e egër fashiste të Beogradit dhe u ngrit mbi lavdinë e vet duke sfiduar, duke sakrifikuar deri në vetëfljijim, duke bashkëvepruar e kërkuar mbështetjen e forcave përparimtare demokratike të botës, për një ideal të madh.

Me heroizmin dhe vullnetin e vet popullor, duke pasur udhëheqjen shpirtërore, morale të intelektualëve dhe mendimtarëve shqiptarë të Kosovës, ajo krijoi fizionominë e vet të një formacioni popullor e luftarak dhe meritoi notat superiore të komunitetit ndërkombëtar.

E akuzuar si “bandë terroriste”, si lëvizje “marksiste-leniniste”, si “ekstremiste nacionaliste” prej forcave, qarqeve e segmenteve kolaboracioniste të politikës shoviniste të Beogradit dhe bashkëpunëtorëve të tyre shqipfolës, UÇK-ja u ngrit mbi metamorfozën e së keqes dhe meritoi statusin e qytetarisë moderne, ajo u bë pjesë e shoqërisë demokratike. Të flasësh për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, nuk është e lehtë. Ajo bëri atë që duhet të bënte.

Në një periudhë të pashkëputur 10- vjeçare, analistët dhe publicistika shqiptare ka ndjekur dhe pasqyruar nga afër lëvizjen për çlirim në Kosovë. Ata janë bërë protagonistë të pasqyrimin të realiteteve pranë afshit të demonstratave, pranë afshit të barutit e të luftës, duke ndjekur hap pas hapi rritjen e koloseut të lavdisë, burimin shpirtëror të këtij koloseu, duke rezervuar për intelektualët dhe mendimtarët e Kosovës një vend nderi në publikimet e tyre, ashtu sikundër ata e kanë merituar atë.

Nëpërmjet takimeve dhe intervistave të drejtpërdrejta me burra të shquar të Kosovës, nëpërmjet burimeve jetësore nga luftëtarët e lirisë, nga fronti i luftës dhe i diplomacisë, nga njerëzit e shpërngulur e të traumatizuar, janë hedhur në memorjen e kombit, kohë pas kohe të vërtetat historike.

Historia e Kosovës moderne gjen pasqyrim në idetë dhe mendimet e figurave të shquara të popullit shqiptar të Kosovës, të cilët vlerësuan dhe u mbështetën në faktorin ndërkombëtar për të institucionalizuar një çështje të madhe e jetike të popullit të shumëvujtur. Ato janë pasqyruar me kujdes e zgjuarësi, duke nxjerrë në pah vlerat e pazëvendësueshme të shtresës intelektuale e patriotë, të cilët gjithsesi ishin pranë, por dhe në mes të rreshtave të luftëtarëve të lirisë.

“Furtuna shqiptare”, lavdia e popullit që e lindi

Pasqyrimi me vërtetësi i fakteve të karakterit ushtarak, politik e diplomatik të aktorëve potencialë të dramës shqiptare në Kosovë, vlerat e këtyre publikimeve ia shtojnë vetë vlerat kësaj periudhe, duke e radhitur këtë "furtunë shqiptare" në një nga veprat e spikatura të periudhës së lavdishme të luftës për liri dhe pavarësi të popullit të Kosovës.

Nga analiza e ngjarjeve që pasuan në lëvizjen mbarëkombëtare për liri, kemi kuptuar dhe vlerësuar disa përfundime kryesore, të cilat janë përzgjedhur dhe trajtuar me vërtetësi, me kujdes e mjeshtëri etike e profesionale nga historiografia shqiptare.

Së pari, evidentimi i një fryme të lartë kombëtare, e cila në kushtet e fundit të shekullit spikati në të gjitha trevat shqiptare dhe u bë promotor i lëvizjeve të fuqishme për liri e pavarësi. Shqiptarët kanë kohë që po shikojnë në horizont një klimë të favorshme që arrin të ndikojë në interes të çështjes sonë kombëtare dhe kjo i obligon më shumë për t'i shërbyer asaj me çdo çmim edhe në të ardhmen.

Së dyti, evidentohet me mjeshtëri roli i inteligjencës shqiptare në Kosovë, si faktori vendimtar i ushqimit shpirtëror për luftëtarët e lirisë, për të mobilizuar energjitë e rinisë shqiptare, që ajo t'i vinte shpatullat fatit të vendit të vet deri në sakrificë. Emra të njohur që humbën jetën e tyre nën represionin serb sot i mungojnë Kosovës dhe Shqipërisë. Ata do të përkujtohen me nderim e respekt, si përçuesit më të mirë të ideatorëve të tyre rilindas.

Së treti, evidentohet zhvillimi i faktorit ushtarak, si një domosdoshmëri përfaqësuese e vullnetit dhe forcës që mbart brenda vetes një komb që vuan dhe kërkon lirinë. Faktori ushtarak u bë shpresa si dielli që lind në horizont, që ngrohu me energjinë e tij dhe bashkoi uraganin popull për realizimin e aspiratës shekullore, këputjen e prangave të robërisë dhe zhdukjen e kolonializmit shtetëror serb.

Aspirata kërkonte mekanizmat dhe forcën e saj dhe ajo doli në dritë në kohën e duhur. Komandantët dhe luftëtarët e UÇK-së nuk u formuan në akademitë e ushtrive tradicionale. Shkollë për ta u bë lufta, fushëbeteja, u bë tradita luftarake e popullit shqiptar, u bë historia me fitoret dhe mësimet e saj.

Aktet e heroizmit të përshkruara në publicistikën shqiptare e më gjerë, emrat dhe vepra e dëshmorëve të lirisë, pasqyrimi i vlerave të kthimit në simbol të luftës të Jasharajve, e shumë të tjera, janë fakte dhe vlera të njerëzve të betuar dhe të përgatitur për të çuar deri në fund realizimin e idealit dhe betimit të tyre. Dhe këtë djemtë e Kosovës e bënë mirë.

Së katërti, lufta për liri përgatiti politikanët dhe diplomatët e urtë e të zgjuar, të cilët në momente delikate i bënë thirrje ndërgjegjjes kombëtare dhe duke u ngritur mbi interesat e ngushta të elementëve të veçantë politikë, arritën të kuptojnë botën, ta vlerësojnë atë dhe të marrin vendimet e duhura për të mos venitur sakrificat e popullit, të rolit të UÇK-së dhe luftës së saj të drejtë. Përkundrazi, ata kontribuan për ta radhitur atë përkrah botës së qytetëruar demokratike.

Së pesti, qëndresa heroike në kushtet e një represioni të paparë ushtarako-policor, jo vetëm mbi strukturat e UÇK-së, por dhe mbi popullin e pambrojtur e të pafajshëm, u bë një faktor i rëndësishëm për të bindur botën se kush ishte makineria ushtarake serbe dhe udhëheqësi i saj, fashisti Milosheviç, se kush ishte Serbia dhe çfarë luante ajo me ashpërsi në shpinë të popullit shqiptar të Kosovës, që kërkonte të drejtat e tij.

Kjo qëndresë heroike e shoqëruar me gjenocidin dhe spastrimin etnik të përmasave biblike, nuk e la shpresën për liri të vdiste, por ajo e mbajti atë gjallë. Kjo qëndresë ndërgjegjësoi politikën dhe diplomacinë amerikane e evropiane se këtu kishin të bënin me një agresion të tipit fashist, me një luftë në thelb shkombëtarizuese e shfarosëse ndaj një populli të ndëshkuar në shekuj që kërkonte liri.

Së gjashti, nëpërmjet analizës së fakteve me të drejtë historia fshikullon. Fshikullon atë pjesë të pseudopatriotëve dhe "të moderuarve" shqipfolës me mendje të ndryshkur, të cilëve u vinte keq se po shkeleshin gjoja disa të drejta ndërkombëtare të "shtetit fantazëm" jugosllav dhe

të verbuar nuk ishin në gjendje të shikonin se çfarë po ndodhte në Kosovë, ku kasapi dhe Hitleri i Ballkanit kishte shpalosur strategjinë dhe aftësinë e tij të shfarosjes, kur ky nxënës besnik i famëkeqit ideolog Çubriloviç, po zbatonte platformën e shkombëtarizimit të shqiptarëve në trojet e tyre.

Këtë Milloshi e kishte bërë dhe disa vite më parë në Kroaci, Bosnje- Hercegovinë. Ai e zhyti veten dhe tërë sistemin politik federativ në krim, për të dhënë një ditë llogari për krimet kundër njerëzimit, atje ku dhe e mbylli edhe jetën e tij të shëmtuar. Pasojat janë të ndjeshme edhe sot. Koha po vërteton çdo ditë se qëndrimet ultranacionaliste të politikës së Beogradit janë një çështje që tregojnë më shumë se kaq.

Së fundi, të përshkruash një dramë, por dhe një tragjedi që në fakt nuk është e realizuar sipas modeleve letrare, por mbështetur mbi një realitet gjaku dhe krimi, shfarosjeje, përdhunimi, përzënieje, diegieje e shkatërrimi, mbi një realitet fort të dhimbshëm në kurriz të popullit shqiptar në Kosovë, kjo nuk është e lehtë.

Pasqyrimi i këtij realiteti të dhimbshëm do të lexohet e rilexohet kohë pas kohe, për të mbajtur gjallë atë frymë luftarake të idealeve të lirisë, për të mbajtur të ndezur në gjirin e popullit nderimin, respektin dhe përkuljen për dëshmorët e lirisë, të cilët u kthyen në simbol të luftës dhe tashmë meritojnë vendin e nderit në sfondin e artë të historisë së popullit shqiptar. Amaneti i tyre sot është pezull dhe për këtë brezat që do të vijnë kanë detyrimin e tyre moral e kombëtar për ta çuar kauzën më përpara.

Sa më tepër të largohemi në kohë nga lufttrat e popullit tonë për liri e pavarësi, aq më tepër ato do të rrezatojnë në brezat që do të vijnë vlerat më të mira të identitetit tonë kombëtar, të qëndrimit dhe pasurimit të ndërgjegjes kombëtare për të punuar çdo ditë e çdo orë në interes të çështjes sonë kombëtare. Për këtë historia bën apel, të mos harrojmë. Në vepra të tilla të përmasave historike, vetë historia mbetet e shkruar me gërma gjaku.

Mbartësit e ideve fisnike dhe traditave më të mira historike, djemtë e UÇK-së, luftëtarët dhe dëshmorët e lirisë, me gjakun e tyre hodhën themelet e një të ardhmeje të sigurt për Kosovën dhe për mbarë çështjen kombëtare. Ne e kemi për detyrë t'i nderojmë ata, sa të kemi jetën, për jetën e tyre që ata i falën lirisë. Kjo nuk duhet të na lodhë e mërzisë asnjëherë, përkundrazi, me forcën e shpirtit dhe të zemrave tona, idealeve të tyre t'u japim jetë nga jeta jonë, që ato t'i mbeten në histori pavdekësisë.

Ky është nderimi më i madh, që ne u bëjmë dëshmorëve të lirisë dhe çështjes kombëtare. Historia e Kosovës moderne gjen pasqyrim në idetë dhe mendimet e figurave të shquara të kombit shqiptar, të cilët me zgjuarsinë dhe vullnetin e tyre, institucionalizuan një çështje të madhe e jetike të çështjes kombëtare në Kosovë.

Me historinë tonë duhet të ndihemi krenarë, sepse ajo me vlerat e saj do të na bëjë që të shikojmë më mirë në të ardhmen tonë. Dhe këtë ne e ndiejmë në mendjet dhe në zemrat tona, e ndiejmë në amanetin e paplotësuar të të rënëve të kombit shqiptar. T'i ruajmë të paprekura e të shenjta simbolet e luftës sonë.

Të mos harrojmë atë që ka ndodhur.

Rinia shqiptare në Kosovë derdhi gjak, e mbi gjakun e të rënëve u betua, se do të flijohej për lirinë e vendit të vet dhe për bashkimin kombëtar. Vite të tëra më pas, ngjarjet evoluuan dhe u zhvilluan mbi bazën e kërkesës për drejtësi, të jetës së lirë; ato ishin një denoncim i hapur dhe një sfidë për vetë falsitetin e krijimit dhe të ekzistencës së shtetit federativ jugosllav, të brutalitetit dhe superioritetit sërëbomadhi mbi shqiptarët dhe etnitë e tjera.

Politika serbe e mbarsur me delirin e madhështisë nuk mund të pajtohej me shpërbërjen, me erën e re të demokracisë perëndimore. Ai do të kërkonte të mbijetonte, duke nxjerrë dhëmbët, tanket, topat, avionët, diplomacinë deri dhe lëndët kimike helmuese mbi rininë shkollore.

Bosnja dhe Kosova, në këto pak vite janë në vetvete një aktakuzë e hapur, që edhe për shumë kohë në të ardhmen, do të akuzojnë dhe do të kërkojnë drejtësi. Djemtë e Kosovës që

dhanë jetën në luftë, janë kurora e shqiponjës në fushën e flamurit kombëtar. Shpirti i tyre fluturon sot në qiellin e lirë të Kosovës, duke larguar retë e zeza dhe vështrimet e përgjakura të djajve të zinj.

Gjaku i tyre është derdhur në themelet e çështjes sonë kombëtare. Shqiptarët nga të gjitha trevat dhe viset shqiptare, kanë kohë që shkojnë në Prekaz të Drenicës e të gjithë duhet të shkojnë atje. Atje gjithë brezat, sot e në të ardhmen, do të mësojnë historinë e Kosovës dhe të Shqipërisë. Prekazi përherë do të rrezatojë shpirtin e qëndresës për liri e drejtësi.

S'ka pikë dyshimi se çdo veprim i armatosur mbart në vetvete pasoja të tmerrshme, pasi në vorbullën e problemeve dhe fatkeqësive që shkakton lufta e pësojnë edhe të pafajshmit. Ata janë njerëzit e pambrojtur që e urrejnë luftën, ata janë qytetarët e thjeshtë që kërkojnë të respektohen liritë dhe të drejtat e tyre, ata janë të moshuarit që kërkojnë mbështetje e përkrahje, ata janë fëmijët që në momente të tilla nuk e marrin dot me mend marrëzinë dhe çmendurinë e të rriturve, ata janë populli që kërkon liri.

Privacionet e luftës për një popull janë të rënda, por në kushtet e kolonizimit në kohët moderne, pacifizmi i pavend shpie ujë në mullirin e tiranëve dhe fanatikëve që i ndalojnë dorën tiranit. Ata nuk janë të aftë dhe nuk kanë asnjë skrupull moral që t'i ndalojnë dorën tiranit.

Forca e së mirës ndaj së keqes qëndron në shpirtin lirishtës të njerëzimit, ajo buron nga shpirti dhe vullneti i popullit dhe i martirëve të tij, të cilët në çdo rast të tillë, bëhen simbol i shpirtit të revoltës, bëhen simbol i bashkimit, qëndresës, prosperitetit, fisnikërisë, bukurisë njerëzore, humanizmit për ta mundur të keqen. Dhe e keqja është e destinuar të humbasë.

Këto momente u kushtohen përpjekjeve të mëdha të kombit shqiptar për përballimin e situatës, u kushtohen ushtarakëve që sakrifkuan e dhanë jetën, që u lënduan gjatë luftës në Kosovë, u kushtohen komandantëve dhe luftëtarëve heroikë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që me luftën, gjakun dhe sakrificat e tyre shkulën nga vendi një diktator, për ta çuar atë para drejtësisë dhe tronditën një perandori, u kushtohen atyre që u bënë një faktor i rëndësishëm politik në terren dhe e detyruan botën të kthente sytë nga tragjedia një populli që kërkonte jetë e liri, luftëtarëve çlirimtarë që falën jetën dhe derdhën gjakun e tyre në themelet e lirisë së Kosovës.

* * *

Është detyrë që idealet e lirisë t'i respektojmë, t'i bëjmë pjesë të gjakut, të mendjes dhe të zemrës sonë, të mos lëmë që ato të rrënohen sot, në kushtet kur armiqtë e kombit shqiptar me dosjet e hapura, po çojnë para gjyqeve të Evropës djemtë e Kosovës. Fitimtarët nuk mund të gjykohen. Koha duhet të gjykojë dhe të ndëshkojë kriminelët. Ky është amaneti i dëshmorëve dhe për këtë duhet të ngremë të gjithë zërin e arsyes.

Vlerat universale të luftës për çlirim duhet t'i mbajmë gjallë që t'i kujtojmë kujtdo që kërkon të martirizojë ende Kosovën dhe viset e tjera shqiptare se nuk është koha e pazarllëqeve. Çdo shqiptar duhet të përkulet me respekt përpara flamurit simbol të luftës çlirimtare të popullit në Kosovë, komandantit trim dhe legjendar të UÇK-së, birit të Drenicës, Kosovës dhe gjithë Shqipërisë, Adem Jasharit. Homazhet u takojnë të gjithë dëshmorëve të kombit shqiptar.

Tani, pas kaq kohësh, kombi shqiptar i përcjell me emocion e respekt momentet e përkuljes me nderim, para atyre që dhanë jetën në altarin e lirisë, takimet me ata që bënë historinë. Është ky një motiv më shumë, që na obligon dhe na kurajon, për të thënë e shkruar të vërtetën. Kjo e vërtetë u duhet të rinjve e fëmijëve tanë, që aspiratat e kombit shqiptar të nëpërkëmbura nga historia e kancelerive të kohës, të kenë "lokomotivën" e tyre në rrugën e gjatë drejt bashkimit kombëtar, integritetit dhe jetës më të mirë.

Këto veprimtari do t'u kujtojnë brezave se kjo sakrificë e përmasave njerëzore, nuk do të venitet kurrë. Ajo do të rrezatojë sa të kemi jetën në shqiptarët. Tashmë, populli shqiptar është i rreshtuar në anën e fitimtarëve dhe ka të drejtë të ngrejë zërin e arsyes për t'i çuar deri në fund idealet kombëtare dhe amanetin e të rënëve për liri, pavarësi e bashkim kombëtar.

14. Rreziku për “një mars tjetër” në Kosovë

Kosova nuk është një shoqëri multietnike. Ajo banohet nga 96% shqiptarë dhe kjo është e mjaftueshme për të hedhur poshtë me përbuzje të gjitha përcaktimet dhe pretendimet për «multietnicitetin» që gjoja mbizotëron në këtë vend. Pakica serbe në Kosovë nuk shkon më shumë nga 3 %.

Deri në vitin 1999, diktatori serb, Slobodan Milosheviç kishte bërë katër luftëra agresive, duke shkaktuar një masakër me 300.000 të vdekur, me afro 4 milionë njerëz të zhvendosur. Kosova sot ka mbi 2 milionë banorë.

Edhe pse sot popullsia e këtij vendi ka frymë properëndimore dhe një proamerikanizëm të admirueshëm, me një besim të zellshëm në mbështetjen e faktorit ndërkombëtar, progresi i saj ekonomik dhe politik deri më sot është mbajtur peng i zvarritjeve të pajustificuara për shpalljen e statusit të saj përfundimtar.

Mbi 70% e popullit të Kosovës është nën moshën 30- vjeçare, me moshën mesatare më të re në Evropë, sot nga kjo popullsi mbi 60% janë të papunë. Pesë vite pas përfundimit të luftës, gjendja vazhdon të rëndohet, duke mbërritur në kufijtë e durimit.

Dhuna që shpërtheu në Kosovë më 17 mars është një indikator, jo i gjendjes së problemeve ndëretnike, por tregues i dështimit të faktorit politik ndërkombëtar për një politikë më pragmatiste që do të mundësonte pa ekuivoqe shkëputjen juridike të Kosovës nga Serbia dhe do të hapte perspektivat e zhvillimit të saj.

Strukturat ndërkombëtare për të shmangur dhe mbuluar përgjegjësinë e tyre në ushtrimin e detyrës mbi protektoratin i kanë vlerësuar me gjuhë të ashpër ngjarjet nga 17 deri më 19 mars, të cilat shkaktuan 28 të vdekur dhe 600 të plagosur. Akuza që nuk u vërtetua ndonjë herë, si një “akt i orkestruar nga shqiptarët për të spastruar etnikisht” Kosoven nga pakica serbe, ishte mënyra më e mirë për ta kaluar këtë përgjegjësi në shpinë të shqiptarëve.

Në zhvillimin e ngjarjeve grupe të shkëputura ekstremistësh politikë dhe kriminelë, si nga shqiptarët dhe nga pala serbe, të paguar nga strukturat serbe, bënë që të shmangej qëllimi paqësor i protestave masive të qytetarëve, duke krijuar një situatë kaosi, e cila doli nga kontrolli.

Pesë vjet pritje pa shpresë

Përsëri do të ndalemi në ngjarjet e marsit në Kosovë. Pas pesë vitesh, dhe jo rastësisht pesë vjet nga përfundimi i luftës. Të inkurajuar nga qëndrimi që mbanin organizmat ndërkombëtare, UNMIK-u, KFOR-i dhe struktura të tjera, si GNK-ja, nuk dëshiruan të praninin atë që ishte normale brenda anormalitetit që mbizotëronte në Kosovë.

Mendohej me plot vetëdije se problemi ishte futur në një “vit të artë”, ndërsa vazhdonin të përkëdheleshin pakicat serbe dhe të ushtrohej presion politik dhe psikologjik ndaj popullsisë shqiptare.

Nën hundën e instrumenteve ndërkombëtare, ndërsa lejoheshin individë dhe struktura paralele, të cilat në mënyrë arrogante parapërgatisnin ndarjen e Mitrovicës veriore nga Kosova, duke e bërë atë fakt të kryer, po simuloheshin në mënyrë të vetëdijshme dhe krejt të pakujdesshme çrregullimet në zonat e tyre të përgjegjësisë. Vallë, kjo ishte një rastësi apo diçka më shumë sesa kaq?

Të gjitha këto, çuan në atë që ndoshta qëllimisht një vit më pas u quajtën me habi si “një qëndrim i çuditshëm i kosovarëve”. Një simulim i hapur dhe provokim që tek shqiptarët në Kosovë të shpërthente urrejtja kundër strukturave ndërkombëtare, duke përgatitur kushtet që ata të ndienin përgjegjësinë e fajit. E çfarë duhej më tepër?

Një situatë me ngarkesa psikologjike që synonte ekstremin, duke i detyruar njerëzit e lodhur dhe të varfër t'i ktheheshin psikologjisë së luftës dhe dhunës, drejt rrugëve të kërkuara e të munguara në pesë vitet e "lirisë" në Kosovë. Një karshillëk përballë kërkesave të drejta.

Në veri të Ibrit vriten 3 fëmijë shqiptarë

Një pjesë e realitetit. **Më 16 mars 2004 agjencitë e lajmeve bëjnë të ditur se në qytetin e Mitrovicës në Kosovë, tre fëmijë shqiptarë kanë gjetur vdekjen të mbytur në lumin Ibër, pasi janë ndjekur me qen nga serbët. Një lajm i hidhur që shkaktoi reagime të menjëhershme të shqiptarëve në qytet.**

Më 17 mars 2004 mijëra shqiptarë në Mitrovicë, janë mbledhur për të protestuar kundër këtij akti kriminal, kur ende nuk ishte gjetur akoma trupi i fëmijës së tretë. Të ndodhur përballë kordonit të policisë së UNMIK-ut, ata çajnë radhët e tyre dhe përleshën me protestues serbë. Përleshja përfundon me përdorimin e armëve të zjarrit, granatave luftarake dhe atyre lotsjellëse. Bilanci, 3 të vrarë dhe mbi 300 të plagosur.

Brenda ditës, kjo situatë zhvillohet me shpejtësi dhe pasdita i gjeti të gjitha qytetet kryesore të Kosovës në protesta të fuqishme, të shoqëruara me dhunë e vrasje ndaj komunitetit serb në katër enklavat kryesore në Pejë, Fushë - Kosovë dhe në Prishtinë. Ishte koha kur ish-Presidenti Rugova dilte në konferencë shtypi me çehre të prishur, me duar që i dridheshin dhe me vështirësi u jepte përgjigje gazetarëve.

Ish- kryeministri Bajram Rexhepi shkon në familjet e viktimave dhe prej andej kritikon ashpër strukturat e UNMIK-ut. Në Kosovë 26 të vrarë prej trazirave. Deklarimet e politikanëve shqiptarë në Kosovë, japin të kuptohej se duhej vetëpërmbytje dhe lëshonin kritika drejt strukturave të UNMIK-ut, të cilat nuk ishin në gjendje të siguronin qetësinë në Kosovë.

Në krahun tjetër, deklarimet e politikanëve serbë ishin nxitëse për të hedhur në veprimtari protestuesit në Serbi. Demonstratat në Beograd dhe në qytete të tjera të Serbisë përfundojnë në përleshje me policinë dhe në djegien e disa kulteve islamike në këtë vend.

Skenari serb në veprim

Tendenca doli hapur shumë shpejt. Të zbatohen skenarë të nxitur nga strukturat paralele të Serbisë në Kosovë për ta ndryshuar rrjedhën e jetës social – politike dhe për të ndryshuar raportet në marrëdhëniet e qytetarëve të Kosovës me strukturat ndërkombëtare. Kjo situatë nxiti më tej qëndrimin qytetar me kërkesën "për largimin e UNMIK-ut nga Kosova".

Synimi serb, drejt vendosjes së marrëdhënieve të reja me rastin e ndërrimit të kontigjenteve të KFOR-it në Kosovë. Dalja në skenë dhe riciklimi i politikanëve të rinj. Mburrije për të krijuar përshtypjen e "administrimit" të trazirave(!)

Krijimi i klimës mbytëse për komunitetin serb, që ata ta konsiderojnë një pamundësi jetesën në Kosovë. Krijimi i premisave për riciklimin e ekstremistëve të ardhur në pushtet në Serbi, duke lozur me kartën e nacionalizmit. Mundësia e veprimit të skemës për të ekspozuar strukturat paramilitare serbe të depërtuara, veçanërisht në Mitrovicë, me kartën e identitetit të studentit të universitetit të qytetit verior. Tendencat dinake për të parë reagimin e opinionit qytetar në Kosovë dhe të atij serb ndaj rekomandimeve të GNK-së.

Provokacione për ta kthyer revoltën në një përplasje fetare, duke vënë në lëvizje strukturat e shërbimit sekret serb nëpërmjet pagesave për bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë, për të nxitur djegiet dhe shkatërrimet e objekteve respektive të kultit. "Viktimizimi" i kombësisë serbe në prag të bisedimeve dhe të pranimit të kërkesave të planit "Çoviç" për të ardhmen e Kosovës. Veçanërisht faktimi i ndarjes së qytetit problematik verior të Mitrovicës, në pjesën shqiptare dhe atë serbe, duke shpërfillur përmbytjen e Rezolutës 1244 të OKB-së.

Një tentativë e dështuar për të nxjerrë në dritë mundësinë e daljes në skenë të strukturave politike dhe ushtarake që mund të jenë të organizuara në Kosovë dhe evidentimin e tyre.

Paralelisht synimi dashakeq se cili do të ishte reagimi dhe ndikimi i strukturave ushtarake të TMK-së në një situatë të tillë.

A janë të besueshëm politikanët shqiptarë në Kosovë për opinionin dhe sa janë në gjendje ata të administrojnë lëvizje të tilla popullore? Gjithmonë sipas skenarit serb, cili nga politikanët do të ishte “i preferuari amerikan” dhe si do të mund të riciklohej ai në jetën politike pas kësaj situatë? Çfarë tjetër duhet të bënte Serbia për të destabilizuar jetën në Kosovë?

Qytetarët e Kosovës nuk kanë më respekt për UNMIK-un.

Një situatë e pritshme. Në opinionin e qytetarëve të Kosovës nuk ekzistonte më ndjenja e respektimit të strukturave të UNMIK-ut dhe ato ngarkohen me përgjegjësinë e favorizimeve të pamërituara ndaj pakicave serbe në Kosovë. A kanë qenë të kënaqur politikanët radikalë serbë nga takimi i fundit me Holkerin dhe deklarata e tij për të ardhmen e Kosovës?

Ngjarjet e marsit 2004 folën me “gjuhën” e tyre. Qytetarët e Kosovës shprehën atë që kishin akumuluar në 5 vjet. Padurimi përballë zvarritjes për shpalljen e statusit final dhe tendencat politike drejt një “pavarësie të kushtëzuar” me komuna serbe në Kosovë.

Tendencat për të “shpëlarë trurin” e qytetarëve dhe inteligjencies së Kosovës nëpërmjet një operacioni psikologjik të parapërgatitur për zbehjen graduale të vlerave të luftës çlirimtare dhe të UÇK-së. Përballë tyre një politikë vendase pa nerv, pa opozitë vepruese sipas skemave evropiane, me lidhje të dyshimta me segmentet politike shqiptare, e diktuar në çdo hap për vendimmarrjen politike dhe aspektet e tjera të jetës në Kosovë. Jeta për qytetarët nuk ka ndryshim esencial. Varfëria dhe papunësia thellohen më tej.

Gjenerali francez: KFOR-i do të reagojë ashpër

Sa do të jenë në gjendje strukturat e OKB-së të kontrollojnë situatën në Kosovë? Cila është gjendja e elementëve të sigurisë në vendin që pret të bëhet shtet i pavarur? Kujt i intereson destabilizimi i Kosovës dhe i rajonit ballkanik?

Dy vite më vonë, opinionin mbi atë çka ndodhi në Kosovë ka mbetur i dyzuar. “A do të kemi një mars të qetë” në Kosovë? Para dy vitesh ishte një nga problemet që shqetësonte më shumë faktorin politik ndërkombëtar. Pas dy vitesh nga ngjarjet tronditëse, nuk munguan reagimet e shprehura në rekomandimet e GNK-së dhe në deklaratimet e insitucioneve dhe individëve, duke shfaqur hapur qëndrimin kontradiktor mbi perspektivën e Kosovës.

Variantet që serviroshin mund të ishin të pranueshme, por përballë faktit që marsi “fliste ende me gjuhën e tij”, i kujtonte popullit shqiptar në Kosovë se përsëri edhe pas një viti ai ishte atje ku e kanë lënë të tjerët. Ato ngjarje nuk mund të harrohen lehtë, për faktin e thjeshtë, se ato në mënyrë të njëanshme vunë nën akuzë faktorin shqiptar dhe akoma sot e kësaj dite nuk ka dalë në dritë e vërteta e tyre.

Nuk mungoi atëherë gjuha e ashpër e gjeneralit francez, ish - komandantit të trupave të NATO-s në Kosovë, i cili paralajmëronte se “në rast të trazirave dhe të prishjes së rendit, strukturat e KFOR-it do të reagojnë ashpër dhe nuk do të lejojnë një destabilizim të ri”.

Përballë përgjegjësisë protektoriale të strukturave të OKB-së, të cilat plotësonin misionin në sigurinë e brendshme, konstatohej se përgjegjësia kalonte në potencialet e KFOR-it. Megjithatë, të gjitha strukturat e sigurisë në Kosovë edhe sot janë të prirura drejt dëshirës së tyre për qetësi, po të kemi parasysh se ende fajtorët e trazirave të marsit 2004 janë akoma në hije.

E vërteta e paragjykuar mbi trazirat

Më thjesht pranë problemit. Pse nuk arriti të zbulonte UNMIK-u kush i organizoi trazirat e marsit në Kosovë, kur ai dispononte të gjithë elementët institucionalë në dorën e tij?! Në kushtet e shpërthimit të tyre strukturat dhe mjetet e këtij organizmi paqëruejtës ishin të pranishme dhe ato

ishin në gjendje të shfytëzonin të gjitha burimet e informacionit të shërbimeve që operojnë sot në Kosovë. Asnjë nga këto struktura nuk ndërhyri kur u dogjën kishat. Pse ndodhi kështu?

Përfundimet sot mbeten të qarta, po të kemi parasysh se kush përfitoi nga këto ngjarje, kush u anatemua, kush u kërcënua. Faktet nën peshën e logjikës dhe të arsyes të çojnë në variantin më të besueshëm se shkaktarë të trazirave kanë qenë strukturat e shërbimit sekret serb që veprojnë në Kosovë.

Ky konstatim mbështetet në faktin se ende dhe sot nuk janë gjetur shkaktarët e kësaj tragjedie. Nëse përgjegjës për këtë, vërtet do të ishin shqiptarët, shkaqet dhe shkaktarët e trazirave do të ishin gjetur menjëherë dhe do të viheshin nën akuzë. Hetimet mbi shqiptarët e arrestuar nuk dhanë rezultate, sepse përgjegjësia nuk qëndron mbi ta. E vërteta është se shqiptarët u ngritën për të shuar flakët e trazirave dhe u gjetën të rrethuar dhe të provokuar nga forcat e UNMIK-ut dhe strukturat e agjenturave serbe në Kosovë.

“Serbia e Madhe”, vepër e llastimit politik

Zhënjimi në pritjen e gjatë të ditës së lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës, dinakëria e një qëndrimi përçmues, duke synuar ndoshta që një ditë të bukur t’u thonë me plot gojën shqiptarëve që të kthehen atje ku kanë qenë. Në versionin historik evropian shqiptarët e kanë të qartë se vetë Evropa e ka bërë Serbinë e Madhe dhe është po ajo që tenton me çdo kusht ta ruajë atë.

Kjo është një filozofi e njohur dhe e mbrapshtë. Nëpërmjet nxitjeve dhe provokimeve që u bëhet në mënyrë sistematike shqiptarëve në Kosovë, tregohen skenarët se si duhet të veprohet për të hedhur përgjegjësinë mbi popullin shqiptar. Skenarë të tillë politikë, bëhen me qëllim që të personalizohet anarkia në Kosovë, duke ua hedhur përgjegjësinë shqiptarëve.

“Frika” mbi trazirat në Kosovë nuk është gjë tjetër veçse një nxitje e njëanshme. Ku e dinë strukturat se vërtet në Kosovë edhe në këtë fundviti do të ketë trazira? A do të provokohen përsëri shqiptarët dhe të shpresohet për një skenar tjetër ogurzi në Kosovë?

Kur do të binden të pabindurit që nuk duan të binden?!

Çdo vit shqiptarët janë përballur me rekomandimet e GNK-së. Është vënë në ekuivalencë “sjellja” e tyre duke u kujtuar përsëri e përsëri se ata “duhet të sillen më mirë”. Çfarë duhet të kuptojnë shqiptarët se ndoshta, “bashkësia ndërkombëtare këtë vit të bëjë diçka rreth aspiratave të tyre për pavarësi”? Diçka e përsëri diçka, e po mirë le të mbetet edhe kështu!

Përherë është lënë të nënkuptohet se “edhe serbët mund të veprojnë duke e rënduar situatën”. Pse duhet t’u kujtohet serbëve se çfarë duhet të bëjnë në një rast të tillë?! Serbët e Kosovës mund t’i ftojnë forcat e armatosura serbe që t’i mbrojnë këta dhe rajoni edhe një herë mund të zhytet në telashet e luftës. Me sa duket, forcat e shumta ndërkombëtare në Kosovë nuk janë në gjendje t’i sigurojnë serbët në jetën e tyre(!) Atëhere përse rrijnë ato në Kosovë?!!

Deklarata e gjashtë shteteve për një afat kohor të mundshëm “për zgjidhjen e statusit”, ku “do të qartësohen katër rregullat themelore”, nuk ka pse të mos vihet përballë “aktakuzës” që i bëjnë asaj deklaratimit e personaliteteve të ndryshme, veçanërisht në opinionin amerikan, në paralajmërimet serioze për zhvillimin e ngjarjeve në Ballkan.

Të ndjekësh strategji dhe taktika të zgjuara, duhet të luftosh dogmatizmin dhe skematizmin. Këto fenomene të shmangin nga misioni dhe detyrat kryesore. Kjo ka ngjarë shumë herë me përfaqësuesit e “kullës së xhamtë” në Nju- Jork, duke e rrëzuar autoritetin e tyre në Kosovë përtokë. Ata duhet ta vlerësojnë realitetin, duke parashikuar zhvillimet dhe jo duke u bërë pjesë dhe palë në to.

Si mund të binden serbët në Kosovë për garantimin e të drejtave të tyre, kur ata për më shumë se shtatë vjet, si dhe momentalisht, veprojnë kundër vullnetit të tyre si banorë të Kosovës! Ata nuk e ndiejnë veten si të tillë, duke i shërbyer qorrazi politikës dhe qëndrimeve të Beogradit.

Sa kanë kontribuar ata në uljen e tensioneve, kur asnjëherë nuk kanë qenë dakord me zhvillimet politike në Kosovë, qoftë edhe kur ato kanë qenë në nismën e faktorit politik ndërkombëtar? Kusht dogmatik mbetet rekomandimi se “Kosova do të zotohet në mënyrë eksplicite se nuk do të bashkohet me Shqipërinë apo ndonjë vend apo territor fqinj, përveç se në kuadër të integriteteve në BE”. Kjo është vërtet shumë interesante.

Një konstatim i tillë nuk i mërzhit shumë shqiptarët. Këtë e dëgjojmë edhe nga mesazhet e gjeneralit Klark, por a duhet të besojmë se Kosova vërtet do ta fitojë pavarësinë e saj? Këto formula të standardizuara për t’u bërë qejfin të gjithëve, edhe atëhere kur ata nuk e dëshirojnë këtë, janë vërtet luftënxitëse në të dy anët e barrikadës.

Serbët e Kosovës mund të kërkojnë ndihmën e armatës

Kush ka frikë nga pavarësia e Kosovës dhe integrimi i saj me Shqipërinë. Çfarë tregon në thelb kokëfortësia e qëndrimit politik ndërkombëtar kundrejt kërkesave të popullit shqiptar? Si mund të kërkohej garanci të tilla, kur vetë shtetet e GNK-së parashikojnë, se në një rast të tillë, serbët e Kosovës mund t’i drejtohen Serbisë për të futur armatën e saj atje? Këtë konstatim e mësojmë edhe nga deklaratimet e gjeneralit amerikan, që drejtoi NATO-n kundër Serbisë.

Si mund të qetësohet situata në popullsinë vendase, qofshin këta shqiptarët apo banorë serbë, kur vetë GNK-ja u kujton atyre ekstremet në drejtim të Beogradit apo të Tiranës. T’u kujtosh shqiptarëve në Kosovë “se nuk do të lejohet as kthimi i Kosovës nën sundimin e Beogradit”, nuk është ndonjë nder i madh, sepse ata për këtë sakrifikuan, luftuan dhe u gjakosën 7 vite më parë.

Po nëse ndodh e kundërta dhe “lejohet” një rikthim i tillë, si mendojnë iniciatorët, se shqiptarët e Kosovës do ta pranojnë këtë, si “delet e buta në udhën e perëndisë?!! Kjo nuk mund të ngjasë, dhe politika “tërhiq e mos e këput”, për të siguruar punë për të papunët e zotit Anan në botë, nuk duhet të gjejë zbatim në Kosovë.

Shqiptarët në Kosovë nuk kanë folur se çfarë do të bëhet pas pavarësisë, por ata duan të dinë se cili do të jetë statusi i vendit të tyre. Ata përjashtojnë në mënyrë absolute një mundësi, moskthimin kurrë më nën Serbinë, dhe nëse kjo duhet venë në vlerat e saj juridike në bazë të së drejtës ndërkombëtare, atëherë, nuk është vonë që të realizohet. Me situatat që përjetohen sot në Kosovë realiteti nuk duket fort i këndshëm, kur shqiptarët përballen me luhatje të qëndrimit të politikave rajonale e më gjerë.

Zvarritjet burokratike në politikën ndërkombëtare, nuk e zbusin frustimin e shqiptarëve në kërkim të të drejtave të tyre, por ato e ndërlikojnë më shumë problemin. Ka një konstatim që nuk paraqitet në vlerat e ndonjë zbulimi të madh. Gati gjashtë vite pas luftës, serbët dhe shqiptarët ende nuk mund të jetojnë së bashku.

Ka vetëm një shkak që nuk e stimulon këtë mosbashkëjetesë, qëllimi i hapur i Serbisë që Kosova të mos e fitojë pavarësinë e saj. Nuk gabon aspak gjenerali Klark, kur mendon se “...shkaktarët e gjendjes janë serbët dhe vetë përkëdhelja që ata kanë nga faktori politik ndërkombëtar”.

Gjenerali Klark: Shqyrtoni statusin final, parandaloni tragjedinë

Tashmë ka mendime se faktori politik ndërkombëtar e plotësoi detyrimin e tij protektorial dhe koha kërkon një zgjidhje tjetër. Kjo është e vërtetë për një popull mbi 2 milionë banorë, që nuk kanë shtet, garanci, siguri, me papunësi dhe varfëri.

Cila është e ardhmja e zgjidhjes së kësaj gjendjeje pa perspektivë? Pse asnjëra palë nuk është e gatshme “për vendosjen e urave të lidhjes” për bashkëjetesë? “Për çdo ditë që kalon, kujton gjenerali i madh Klark, tensionet në Kosovë rriten”, dhe më poshtë, ai me kurajo dhe objektivitet tërheq vëmendjen e institucioneve ndërkombëtare, duke u kujtuar atyre, se duhet shqyrtuar sa më shpejt statusi final, “para se të bëhet shumë vonë për ta parandaluar tragjedinë”.

Kush ka punuar kaq vullshëm dhe në një terren të hapur për të simuluar psikologjinë e ndarjes, të dhunës dhe të nënshtrimit? Çfarë është ajo që nuk shikon Klarku në rekomandimet e e GNK-së dhe në qëndrimin e dyzuar të Ahtisarit? Çfarë shikon Klarku pas “murit të politikës”?

Atëherë, duke analizuar situatën mund të pranohet se nuk është e keqja se a janë të gatshëm apo jo shqiptarët në Kosovë të pranojnë vendimin e faktorit ndërkombëtar. Problemi qëndron në mospranimin dhe mosbindjen e Serbisë të së vërtetës, tashmë një fakt, se ajo e ka humbur përfundimisht Kosovën.

Edhe sa vite duhet të kalojnë për ta kuptuar serbët këtë?

15. Përgatitjet e ushtrisë serbe në Veri bien erë lufte

Në çështjen kombëtare, Kosova merr një rol shumë të veçantë, sepse sot ajo është trangu i atdhetarisë dhe i pikënisjes për zgjidhjen e çështjes kombëtare. Kjo forcon me tej besimin se shteti shqiptar mbetet një garanci dhe streha e fundit, prej të cilit duhet të gjejnë mbështetjen e duhur tërë veprimtaritë me karakter kombëtar.

Do të dëshironim sinqerisht që të ishte vërtet kështu. Në këtë fazë, objektivat dhe aspiratat kombëtare, do të realizohen shkallë - shkallë. Përparësi duhet të marrë fakti që Kosova duhet të luftojë, në një ide të bashkuar, jo vetëm për pavarësinë dhe sovranitetin e saj, por dhe më gjerë.

Detyra e atdhetarëve shqiptarë në Kosovë e kudo, është që të vënë kërkesat maksimale përballë komunitetit ndërkombëtar dhe ata duhet të ulen me kurajo e “dhëmbë për dhëmbë” e sy për sy, me përfaqësuesit politikë të armiqve tanë tradicionalë. Tashmë dimë që Serbia ka vënë kërkesa maksimale, që të arrijë të marrë minimumin.

Atëherë, politika shqiptare, me kurajo e në unanimitet, duhet të parashtojë kërkesat maksimale, në mënyrë që të krijojë premisa, që Serbia të mos e marrë dot këtë minimum. Këto kërkesa duhet të fillojnë me opsionin e palëkundur, për një Kosovë unike, të pavarur e të pandarë, drejt një zgjidhjeje përfundimtare të çështjes shqiptare, ku Kosova Lindore, dhe pjesët e tjera t’i bashkëngjiten Kosovës, duke synuar që t’i bëhet e qartë edhe faktorit ndërkombëtar se Serbia nuk duhet të ketë më “çështje shqiptare” të hapur për të.

Ky mbetet argumenti bindës se kjo i bën mirë edhe Serbisë, kjo i bën mirë edhe vetë Evropës. Është një nga arsyet bindëse, që realisht i heq bazën konfliktit ndëretnik historik në Ballkan.

Serbia mund të hyjë ushtarakisht në Kosovën Veriore

Mos vallë ata mund të mendojnë se në Evropë mund të ketë kaq shumë politikanë mediokër, sa të mos kuptojnë se egërsia e tyre ndaj shqiptarëve është për të fituar «Republikën serbo - boshnjake» «Serbcka»? Vallë nuk ka arritur të kuptojë Perëndimi, se me investimin e gjithanshëm politik, ideologjik dhe ekonomik, arriti të shpërbente shtetin superfuqi të ish-Bashkimit Sovjetik dhe e paska kaq të vështirë sot të shkëpusë një Kosovë nga Serbia?!

Këto përralla politike nuk i beson më njeri. Ato kanë vetëm një rrugëzgjidhje, pavarësinë e plotë të Kosovës, në mënyrë që në Ballkan të mos ketë më çështje “Kosovë”. Faktori politik ndërkombëtar duhet të vlerësojë faktin (të cilën e di në mes të natës e të ditës), që Kosova është një nga interesat më prioritare të çështjes kombëtare shqiptare dhe ajo nuk mund t’u nënshtrohet gjykimeve dhe vlerësimeve servile të kujtdo qoftë, shqiptar apo i huaj, për të drejtën e vetëvendosjes së saj.

Përvojat që jep historia në zhvillimet e saj të vullshme, nuk duhet të përsëriten për të bindur të pabindurit që nuk duan të binden?

Gjenerali Klark parashikon saktë dhe arrin të shikojë se çfarë ka pas “murit të lartë politik”. Ai paralajmëron se “përleshjet e mëtejshme, si ato në pranverën e kaluar, mund të rezultojnë me një ndarje të territorit të Kosovës, duke krijuar kështu një precedent që kërcënon shkatërrimin e investimeve të SHBA-ve dhe të BE-së në stabilizimin e shteteve multietnike në të gjithë Ballkanin”.

Çfarë bën Serbia sot në një hapësirë me gjerësi 150 km rrotull kufirit me Kosovën? Modernizimi i forcave të saj ushtarake ka bërë progres. **Brigada “Komando” që theu hundët në Koshare, sot e riorganizuar është vendosur në Bujanovc dhe pret rastin të ndërhyjë. Xhandarmëria serbe në Kosovën Lindore provokon përditë shqiptarët dhe është “ballafaquar” me ta. Armatimi i ushtrisë serbe është sofistikuar, duke filluar që nga armët automatike të përdorimit personal, e deri tek snajperët 12.7 mm, raketat e dorës të drejtuara, xhipat me blind mbi 1 cm, përsosja e pajisjeve të tankeve, një situatë me natyrë luftënxitëse. Çfarë mund të ndodhë pas kësaj?**

Mesazhet e gjeneralit Klark janë domethënëse. Komandanti i luftës kundër Serbisë e njeh mirë kundërshtarin e tij të vjetër dhe prapavijat e tij. Gjenerali ndoshta nuhat se në rast të trazirave të reja në Kosovë, forcat e armatosura të Serbisë mund të futen në Kosovën Veriore dhe shqiptarët për kundërpeshë mund të futen në Kosovën Lindore. Çfarë tenton Serbia me fuqizimin e dispozitivit ushtarak në jug të saj? Çdo të bëjë vetë Evropa në një ndërhyrje të tillë të dhunshme, si do ta parandalojë atë? Si mund të gjykohet pas një fakti të tillë?

Pavarësia e Kosovës është rruga e vetme, që sipas gjykimit të gjeneralit Klark, “të mos humbet pagja dhe liria në Ballkan”. Askush nuk ka të drejtë të anashkalojë faktin që në një situatë të tillë Ballkanit mund t’i shkaktohet ndoshta një nga tragjeditë më të rënda në historinë e tij. Ka ardhur koha që të pabindurit duhet të binden se koha nuk punon më për ta.

Xhelozia serbe me motive racore

Çfarë vlere ka jeta dhe dinjiteti i shqiptarëve të Kosovës, përballë xhelozisë racore të paprecedentë, që vazhdon të akumulohet në mjedisin serb dhe që ka shkakuar një situatë të tensionuar në shtatë vitet e pasluftës. Kush u dha pushtet shqiptarëve të Kosovës për të bërë mirë punët e tyre, kush nga administratorët e justifikoi misionin e tij në favor të popullit shqiptar, që tregoi me qytetari optimizmin e tij për të ardhmen?

Për shekuj me pushtet e pa pushtet, shqiptarët, megjithëse në armiqësi me serbët, nuk i dogjën ndonjëherë kishat ortodokse, por dhanë modelin më të mirë të bashkëjetesës fetare. Nga buron sot armiqësia dhe urrejtja fetare serbe ndaj shqiptarëve?

Dhe pas shtatë vitesh “të lirisë” së tyre, të diskriminuar e pa pushtet, ata nuk ka se si të “përmbahen” më. **Edhe durimi popullor ka një kufi. Në këtë çështje, të nxituarit dhe shpirtdredhurit për kultet, që ndoshta nuk i kanë dashur kurrë ato në jetën e tyre, ia kalojnë fajin të ashtuquajturit fenomen “nacionalist dhe separatist shqiptar”, të cilët gjoja u hodhën në veprim për të djegur kishat ortodokse.** Dhe kjo ndodhi në Kosovë, kur struktura e UNMIK-ut duhet të tregonte gatishmëri të lartë për t’i mbrojtur ato dhe jo të largoheshin vetë “për efekte sigurie”, duke u futur nën sjetullën e NATO-s.

Pse i lanë në mëshirë të fatit, deri korpusin e tyre qendror në Prishtinë? Përse nuk ia kaluan në ruajtje TMK-së? Çfarë priste më shumë kjo strukturë që të ndodhte në Kosovë? Çfarë emri do t’u vëmë veprimeve të serbëve, të cilët dogjën xhami në Beograd e diku tjetër, kur dihet se atje nuk ka fare shqiptarë etnikë dhe nuk kishte asnjë shkak që kjo të ndodhte në Serbi?

Çfarë shpjegimi u kanë dhënë deri tani kërkesave “për armatosje dhe për t’u nisur në Kosovë”, parullave se “Kosova është zemra e Serbisë dhe ne nuk e lëshojmë atë”, thirrjeve për “të futur trupat ushtarake serbe në Kosovë”, thirrjeve ekstremiste të Koshtunicës, i cili nuk heq dorë nga synimet e tij mbi Kosovën etj. Çfarë duhet t’u themi këtyre, nëse shqiptarët janë ekstremistë, kur para syve të KFOR-it dhe të UNMIK-ut paramilitarë serbë u futën në të katër enklavat serbe në Kosovë dhe bënë furnizimin e tyre me armatime dhe municione?

Pas kaq kohësh mbi ngjarjet tronditëse në Kosovë me habi vërehet se ende shkaktarët e këtyre trazirave nuk janë gjetur. Është e qartë si drita e diellit se po të ishin shqiptarët shkaktarë të këtyre trazirave, ata do të ishin gjetur me kohë, por këta shkaktarë mungojnë dhe faji mbetet jetim në mes të rrugës.

Gjyqet spektakolare të UNMIK-ut në Kosovë dhe pagesat e larta të dëshmitarëve në dëm të shqiptarëve, janë një realitet i denoncuar, por që askujt nuk i bën përshtypje. Zëri i Avokatit të Popullit në Prishtinë mbetet një zë i vetmuar, që nuk e dëgjon më askush.

Nacionalizmi agresiv serb

Koshtunica është një person, i cili kërkon të mbahet si kampion i nacionalizmit serb pas Milosheviçit. Ai erdhi në pushtet në Serbi, me ndihmën e partisë së këtij të fundit. Dhe shqiptarët mendojnë se do t'i zgjidhin problemet e tyre me Serbinë me këtë Koshtunicë(!) Faktori politik ndërkombëtar mundohet e mundohet të negociojë me pasuesit e kriminelit të Ballkanit, që tashmë kanë ndërruar lëkurën dhe janë bërë “më demokratë”(!), më njerëzorë e humanitarë. Përralla të vjetra që sot nuk i ha më askush, aq më tepër shqiptarët që e kanë ndier deri në kockë e deri në palcë dhunën dhe krimin e shëmtuar të Serbisë.

Nga kjo kuzhinë serbe, këtë lloj gatimi do të presin shqiptarët dhe të tjerët, që janë vënë përballë represionit të ashpër të Serbisë. Çfarë ka shtruar në thelbin e bisedimeve dhe i mbetet besnik Koshtunica, cila është alternativa e tij nacionaliste për të qënë i besueshëm në opinionin vendas? “Pa Kosovë, nuk ka Serbi”. Vërtet, sikur në këto shtatë vjet, Kosova ka qënë me Serbinë dhe vetë Serbia nuk ka ekzistuar pa të(!)

Të argumentojmë faktin pse ekzistenca e Kosovës kushtëzon sot politikisht, ekonomikisht, shpirtërisht Serbinë e sotme, të ashtuquajtur të reformuar dhe e gatshme për t'u integruar në proceset demokratike drejt Evropës, për të cilën politikanët serbë flasin kaq shumë. Këshilltari i kryeministrit serb, Slobodan Samarhiç, para një viti deklaronte pa mëdyshje, se “në Kosovë janë në funksion struktura paralele”, duke e justifikuar këtë me gjoja “pasigurinë e komunitetit serb në Kosovë”.

Kjo të kujton thënien e Jarosllav Hashekut në romanin e tij “Ushtari i mirë Shvejk”, i cili thoshte se, “gjyshja e filan oficeri vdiq, sepse pastruesi i oxhaqeve të pallatit në lagje, nuk e kishte pastruar mirë oxhakun...”, pra një ide pa lidhje, që e nxjerr politikën ekstreme serbe zbuluar nga të gjitha anët.

Kryeministri serb ka shtruar çështjen e kantonizimit të Kosovës, duke pretenduar që në bazë të raportit të përqindjes së popullsisë të merret dhe territori. Si kundërpërgjigje e kësaj, popullsia shqiptare në Kosovë dhe në përgjithësi komuniteti ndërkombëtar nuk po pajtohen me këtë ide. Lojës së standardeve tashmë i doli boja.

Koha do ta sjellë që serbët do të kërkojnë “për hir të standardeve”, shqiptarët të largohen nga këto zona. Po a mund të pretendohet dhe të veprohet si në rastin e Bosnjës? Këtu nuk ka vend për të mbajtur të njëjtin qëndrim, pasi megjithëse atje është ruajtur të paktën formalisht shteti federal me Republikën Serbska brenda saj, në Kosovë nuk ka vend për të bërë të njëjtën gjë.

Këtu nuk ka vend për shpëputje e rindarje kur në fakt ekzistojnë kufijtë historikë të saj. Nacionalizmi serb nuk njih kufij dhe kjo do të mbetet edhe për shumë kohë fatkeqësia e tyre. Zoti i faltë për prapësitë...

“Prit gomar të mbijë bar”

Një nga arësyet e përfshirjes së shqiptarëve në revolta dhe demonstrime, të cilat mund të jenë përsëri të pranishme, është loja që bëhet me statusin, duke analizuar qëndrimin e faktorit ndërkombëtar, që kushtet dhe standardet ende mbeten në veprimin e tyre të njëanshëm dhe me vlera të dyfishta. Paradoksit “standartet para statusit” i doli fytyra e vërtetë.

Kjo lojë ka mbetur për shtatë vjet sipas fjalës së urtë të popullit shqiptar, “prit gomar, të mbijë bar”. Modeli i munguar i shteti të ardhshëm të Kosovës është një prapësi provokuese ndërkombëtare.

Ndoshta pas kësaj me të drejtë bota mund t’i kthejë sytë nga “pauhdësitë e kosovarëve”. P.sh. në BE ka shtete si Spanja, Portugalia dhe Greqia, që janë shumë larg standardeve, nëse do t’u referohemi të drejtave të njeriut dhe problemeve të mprehta nacionale, problemeve të minoriteteve, të cilat nuk njihen, prezenca dhe veprimtaria e organizatave terroriste etj.

Atëherë, përderisa përcaktohen standardet përpara statusit dhe vetë standardet janë relative, të cilat mund të arrihen në një farë mënyre, përsëri “pretendimet” mund të jenë të shumta dhe të larta dhe çfarë është më e çuditshme, edhe vetë shqiptarët në Kosovë nuk e dinë se ku është fundi apo kufiri i tyre.

Haptazi, kjo situatë e improvizuar “me shumë siklet”, flet për naivitët të shtirur ose një djallëzi e kamufluar bizantine, me anë të së cilës politika e vjetër kontinentale kërkon të imponojë dhe të rrëzojë në gjunjë dinjitetin dhe qëndresën e shqiptarëve mbi kërkesat e tyre të drejta, që ata të mos pretendojnë më kurrë për të marrë atë që u takon. Singëriteti i munguar irriton shqiptarët dhe përkëdhel pakicat serbe në Kosovë. E çfarë duhet bërë më shumë?

Në një situatë krejt tjetër, qytetarët do të ishin të bindur në garancinë e së ardhmes së Kosovës dhe të statusit final të saj dhe vetë Serbia do “të mblidhte mendjen” dhe do të hiqte dorë nga strukturat paralele. Kjo do të ulte tensionin në rajon. Kjo do të krijonte një klimë bashkëpunimi dhe jo një tendencë zhvatjeje që do t’i acaronte problemet dhe marrëdhëniet më shumë, drejt konfliktit të hapur tragjik.

Kosova drejt pavarësisë apo jugosllavizimit

Situata politike në Kosovë, me të gjitha treguesit e saj, sjell një panoramë shumë interesante, e cila sigurisht që meriton vëmendje të veçantë. Ajo qëndron në zhvillimet e saj, ndryshe nga deri tani, diçka tjetër duhet të fillojë të funksionojë, me synime dhe objektiva më të qarta.

Arsyeja kryesore është të priset dhe të ndryshohet një farë “statukuoje”, që është krijuar në ndarjen politike të pushteteve, e cila nuk duhet të ketë jetëgjatësi. Ajo duhet të ndryshohet, sepse në këtë mënyrë vetë shqiptarët në Kosovë do ta kuptojnë se u nevojitet ky ndryshim, për të lënë një herë e përgjithmonë pas një nga temat më të nxehta e të diskutueshme për të ardhmen e tyre.

Kontadiksioni i shprehur pas përfundimit të luftës dhe rezultatet e zgjedhjeve të para në Kosovë, ishin befasuese për të gjithë. Por kjo, nuk duhet të shkonte deri në kufijtë e çudisë. Fakti që në një situatë të tillë, lidhshipi politik kosovar i dalë nga lufta, gati gati është ndier i shokuar, dashur pa dashur ka instaluar një fobi politike elektorale, që nuk ka pse të injorohet. Vallë, a duhet pranuar që ende kjo lloj fobie të ketë efektet e veta psikologjike, duke rënduar realitetin social – politik në vend?

Faktori politik kosovar, që në përgjithësi përfaqëson sot një brez të ri politikanësh, nuk duhet ta lejonte këtë situatë. Ndoshta, nuk duhet të përsëriten të njëjtat gjëra, që kanë ndodhur për ta humbur betejën politike, por për ta fituar Kosovën. Deri tani, kemi mësuar se në rezultatet elektorale, është pjesa e vjetër përfaqësuese e politikës që ka fituar dhe janë politikanët e rinj që kanë humbur.

Ka ardhur koha, që populli i Kosovës të kërkojë me këmbëngulje distancimin e njerëzve nga ndikimet e vjetra të strukturave të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Prandaj, sulmi i njerëzve të ndershëm, që e duan Kosovën dhe çështjen shqiptare, duhet të jetë jo në front kundër partive në Kosovë, por kundër elementëve terroriste e tradhtarë, kundër atyre që folën kundër fillimit të bombardimeve të NATO-së dhe që kërkuan ndërprerjen e tyre. Në këtë mënyrë, do të veprohet aktivisht për shpartallimin ideologjik dhe politik të tyre.

Atëhere, si ka mundësi që opinioni në Kosovë nuk arrin të kuptojë se vetë këta politikanë të dalë nga falangat titiste dhe ata që i mbështesin, në përgjithësi nuk dallohen për patriotizmin popullor dhe jo rrallë janë të diskutueshëm në qëndrimet e tyre ndaj çështjes kombëtare dhe ndaj vlerave patriotike të kombit shqiptar?!

Janë kjo kastë politikanësh, që pas luftës, ende nuk kanë shkelur në Shqipëri, që ende nuk kanë shkelur në vendin e simbolit të luftës çlirimtare të UÇK-së, në Prekaz të Drenicës, atje ku nisi simbolika e sakrificës njerëzore dhe Jasharajt i treguan gjithë kombit shqiptar dhe botës se lufta çlirimtare jo vetëm që kishte filluar, por ajo do të fitonte.

Ata që pretendojnë të ndryshojnë parametrat e politikës në Kosovë, këtë kastë politike, e kanë si provën më të mirë për të qartësuar opinionin shqiptar, duke e çuar analizën edhe më tej. Është kjo arsyeja madhore, që në këtë çështje duhet të fillojë të alternohet një politikë e diferencuar. Fillimet e kësaj politike, nuk ka pse të jenë zhgënjyese edhe në rastin më të keq, që të pranohet se qysh në fillim, populli nuk ka për ta ndjekur këtë klasë të re politike.

Edhe kështu mund të ndodhë, por duhet besuar seriozisht, se kjo nuk mund të mbetet një tabu në qëndrimin populist të shqiptarëve në Kosovë.

Serbia: Nuk mund të durojmë Kosovën e pavarur, NATO-n dhe SHBA-të

Sipas analizës së ngjarjeve që kanë pasuar në këto shtatë vjet, është kuptuar se mendësitë e politikës serbe nuk kanë ndryshuar edhe pas rënies së Milosheviçit. Radikalizmi nationalist në Serbi është vënë përballë një konservatorizmi cinik, që po e çon Serbinë akoma më prapa në rrugën e saj.

Serbët në Ballkan ende po luajnë rolin e “viktimit”, duke u ankuar vend e pa vend nga “trajtimi i padrejtë” që po u bëhet prej bashkësisë ndërkombëtare (nënkupto: veçanërisht amerikanët). Një ndryshim i pritshëm në qëndrimin serb është i largët. Disa vite pas bombardimit të NATO-s tani Serbia kërkon të marrë rolin udhëheqës në Ballkan. Sipas kryeministrit serb, janë tri gjëra që serbët nuk mund t'i durojnë: “Kosovën e pavarur, NATO-n dhe SHBA-në”. Atëherë si mund të pretendojnë serbët të integrohen në BE?

Kjo nënkupton faktin që, “përderisa serbët nuk e ndryshojnë qëndrimin ndaj së shkuarës edhe së tashmes, ata vetë po largohen nga ardhmëria e tyre”. Ky konstatim analitik është një sinjal për faktorin ndërkombëtar dhe atë shqiptar. Cilat mund të jenë reagimet e Serbisë pas këtij qëndrimi? A ka diçka të re në marrëdhëniet armiqësore tradicionale midis dy kombeve? Serbia ndoshta është e prirur të shkaktojë përsëri konflikt të armatosur në Ballkan.

Deklaratat e fundit të ministrit të Jashtëm të Serbisë, Drashkoviç, mbi ekzistencën “e kufijve hije”, e zhvlerësojnë politikën serbe. Pa dashur, antishqiptari Drashkoviç, i bën një shërbim të mirë zgjidhjes që pritet në çështjen e Kosovës. Kufijtë “hije” janë dhe ato duhet të respektohen. Kokëfortësia serbe nxit më shumë armiqësinë midis kombeve në Ballkan dhe i kundërvihet hapur institucioneve ndërkombëtare për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës.

* * *

Problemet ndonjëherë marrin për keq kur vihen nën presion. Kështu po ndodh me shqiptarët kudo në hapësirat e tyre të jetesës. Shqiptarët provokohen, duke tentuar në mënyrë të njëanshme të krijohet përshtypja, se ata janë të prirur për t'i zgjidhur vetë hallet e tyre në rrugën e dhunës. Jo.

Filozofia popullore e pranon faktin se, nëse i mbetesh një problemi për ta zgjidhur me çdo kusht vetë, do të bindesh se je duke ndjekur një rrugë të gabuar. Mirëkuptimi i shqiptarëve me politikën ndërkombëtare i ka kaluar kufijtë e respektit dhe të durimit dhe, kur masa prishet, atëherë kërkohet një hop i ri cilësor.

Në besimin ndaj zotit populli beson se duhen lënë gjërat që të shkojnë ashtu siç mund të jenë paracaktuar. Cili mund të jetë presioni që bëhet mbi shqiptarët? Nxitja e tendencës për ta zgjidhur një çështje medoemos sot ose e shumta nesër. Por dhe e sotmja, dhe e nesërmja kanë një

kufi. Kjo këmbëngulje mund të quhet e tepërt, por ajo nuk mund të mbetet e tillë kur vitet ikin, bëhen dekada dhe shkaktojnë pasoja me dëme të pariparueshme.

Konstatimi mund të mos jetë universal, por në rastin e shqiptarëve dhe problemeve të tyre në Ballkan, nuk ka vend për lëkundje dhe paragjykim.

16. Ish-oficerët e KOS-it jugosllav sot militojnë në strukturat e TMK-së.

Në marrëdhëniet ndërshtetërore të politikës ndërkombëtare vihet re një fenomen që vepron, pavarësisht ngjarjeve që shoqërojnë thelbin e këtyre marrëdhënieve midis të mëdhenjve që drejtojnë botën. Tendenca e ruajtjes së ekuilibrave, e cila ka rregulluar në një farë mënyrë këto marrëdhënie duke lëshuar pe sipas interesave që shfaqen.

Këtë pozicion ka zgjedhur dhe SHBA, Rusia, Kina dhe shumë shtete të tjera që kanë peshën e tyre në politikën botërore. Ky fenomen vërehet edhe në trajtimin e çështjes së Kosovës dhe në një farë mënyre shkakton habi në opinionin shqiptar. Nuk kemi arsye të mos kuptojmë dhe vlerësojmë se hapat në këtë drejtim hidhen “të matura”, duke fituar apo humbur kohë, pavarësisht reagimeve që kanë shqiptarët në terren.

Çështja e Kosovës ka shtatë vjet që ndjek kalvarin e saj të gjatë, dhe sot e kësaj dite ende nuk ka një pasqyrë të qartë të përmbajtjes së platformës politike ndërkombëtare për statusin e ardhshëm të saj. “Zarfi” Ahtisari po na shoqëron me misterin e tij dhe shqiptarët presin me pa durim se çfarë do të dalë prej tij. Themi me pa durim, sepse edhe kufijtë e durimit kanë shkuar në sinorët e tyre ekstremë.

Gjendja në Kosovë rëndohet përditë dhe deklaratat që burojnë nga të gjitha drejtimet japin një mesazh domethënës: Nuk ka arsye të zvarritet çështja e statusit të Kosovës pas situata mund të precipitohet deri në kufijtë e destabilizimit të rajonit. Mos vallë është pak për të kuptuar se çfarë shikojnë personalitete të ndryshme të botës demokratike pas murit të politikës? Çfarë mendojnë shqiptarët përballë paradoksit politik me moshë shatërvjeçare?

Masakra politike mbi trojet shqiptare

Në Ballkan vetëm çështja shqiptare nuk është zgjidhur, kurse Kosova është vetëm një pjesë e problemit shqiptar të ndërlikuar mbi bazën e dhunës së ushtruar në më se një shekull nga fuqitë e mëdha. Kjo nuk duhet të tingëllojë vetëm si retorikë politike, por t’u referohet shkurtimisht fakteve për copëtimin e dhunshëm të popullit shqiptar dhe të atdheut të tyre etnik.

Para ngritjes së shtetit të Malit të Zi, të Serbisë dhe të Greqisë, nga fundshekulli XVIII - fillimshhekulli XIX, njësia etnokulturore e gjeopolitike e Shqipërisë arrinte rreth 120000 km². Gjatë ngritjes së Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë si shtete autonome në vartësi nga Perandoria Osmane, nga Shqipëria u shkëputën rreth 5 272 km² të viseve periferike të banuara kryesisht me shqiptarë ortodoksë dhe katolikë. Kongresi i Berlinit, më 1878, Shqipërinë e gjeti me rreth 114.728 km², të ngritur me armë në duar për mbrojtjen e tërësisë së vendit dhe për autonominë e Shqipërisë si hap për pavarësi dhe sovranitet të plotë.

Evropa nuk e ndihmoi këtë lëvizje. Përkundrazi, Fuqitë e Mëdha: Rusia, Anglia, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia vepruan politikisht, me diplomaci dhe ushtarakisht kundër genies fizike të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar për zgjerime territoriale të Serbisë, të Malit të Zi, të Greqisë dhe për interesa të përkohshme të Evropës në Perandorinë Osmane, për copëtimin përfundimtar në rrethana më të përshtatshme.

Kongresi i Berlinit nuk mori parasysh asnjë kërkesë jetësore shqiptare dhe nga Shqipëria shkëputi me dhunë ushtarake e diplomatike rreth 24.458 km². Njësia etnokulturore gjeopolitike e

Shqipërisë, e ruajtur deri në ditën e shpalljes së pavarësisë, më 28 nëntor 1912, në Kuvendin Gjithëshqiptar të Vlorës, kishte 90.100 – 90.270 km², me 3.804.000 banorë.

Së fundi, me këmbëngulje të Vjenës dhe të Romës, Londra ngriti një shtet shqiptar monstrum, me rreth 28.760 km², me rreth 800.000 banorë, në një sipërfaqe anësore të Shqipërisë Natyrale, pa gjymtyrët vitale për jetë shtetërore. Kaq mjafton për të kuptuar se copëtimi i trojeve shqiptare ka qenë një masakër politike e paprecedent, duke kënaqur hap pas hapi orekset e shteteve fqinje.

Vallë e ka harruar Evropa historinë e dhimbshme shqiptare?

Serbët e bëjnë luftën pa shkak

Procedurat “e qeta” kanë filluar të shkaktojnë një reaksion zinxhir të ngjarjeve, të cilat në këto shatë vite kanë qenë të pranishme. Procedurat “e qeta” kanë simuluar maksimalisht politikën dhe diplomacinë serbe që ajo të kalojë në sulm dhe të jetë shumë aktive, duke përfituar llastimin e politikës ndërkombëtare. Kokëfortësia politike serbe nuk njihet kufij.

Ajo vazhdon të sfidojë me arrogancë, dhe në krahun tjetër përgatitet ushtarakisht me struktura paralele që të veprojnë në Kosovë. Arroganca i kalon kufijtë në rastin e referendumit, pas shtatë vitesh të përfundimit të luftës dhe Serbia nuk e njihë humbjen, përkundrazi akuzon rëndë faktorin ndërkombëtar dhe atë shqiptar duke luajtur rolin e “viktimës”. "Siç tregon historia e vjetër, sllavët janë të gatshëm të marrin armët edhe pa pasur arsye (...), e bëjnë luftën pa shkak dhe pa e shpallur atë dhe nuk duan ta mbarojnë me një marrëveshje. Më në fund e fillojnë pa të drejtë dhe e mbarojnë me dhunë".

Çfarë duhet tjetër për t'u bindur se kemi të bëjmë me një politikë të tipit arkaik, mesjetar, bizantine e të përfunduar që nuk bën përpjekjen më të vogël për të dhënë mesazhe të mirëkuptimit. Pse duhet të ndodhë kështu? Pyetja është e drejtë, por përgjigje të sigurtë dhe bindëse për të gjitha palët nuk ka. Çfarë do të ndodhë në Ballkan pas shpalljes së statusit të Kosovës? Kush i mban të kyçura sigurinë dhe garancitë e situatës në rajon?

Qëndrimi i politikës serbe është vërtet i tillë apo presioni politik synon ta përdorë statusin e Kosovës si “kartë këmbimi”, duke i vënë kushte faktorit ndërkombëtar? Edhe kështu mund të jetë, por pabesia që vepron me surpriza politike të përditshme nuk na hiqet dot nga mendja dhe imazhi i keq i ngjarjeve.

Gjuha e ashpër e deputetëve serbë në parlamentin e tyre nuk ka pse të çudisë sot pas shtatë vitesh as zonjën Pak dhe askënd tjetër. Çfarë presin ata ndryshe? Po sikur edhe deputetët shqiptarë në të dy parlamentet të bëjnë të njëjtën gjë, atëherë në cilën qafë do të dalim? Habia e personaliteteve europiane ka një të vërtetë brenda saj. Në një farë mënyre ajo vërteton atë që është thënë vite më parë, që askush nuk ka të drejtë të luajë me aspiratat kombëtare të popullit shqiptar dhe zvarritja nuk ka bërë gjë tjetër, veç duke i dhënë kohë, ka riaftësuar politikën serbe të kundërveprojë edhe në kufijtë e sfidës.

Sfida politike serbe nuk është drejtpërdrejt për shqiptarët, pasi qëndrimi shqiptar tashmë dihet. Sfida është për politikën ndërkombëtare, e cila nuk ka vepruar në kohë në Serbi, dhe sot mban marrëdhënie me një klikë gjenocidiste në pushtet, vazhduese e denjë e politikave të Milloshit. Ky është një problem që nuk kërkon shumë koment. Megjithatë, edhe viti 2006 dhe 2007-a kanë po aq ditë - kohë sa edhe vitet e tjerë që kaluan(!)

Asgjë më shumë, veç një “pavarësi e kushtëzuar”!!

Çështja e pavarësisë së Kosovës mbetet një moment i rëndësishëm i vendimmarrjes së faktorit ndërkombëtar. Në këto kushte del e domosdoshme që të krijohen hapësira të nevojshme për veprimin e tërë elementëve shtetformues, të cilët sot në Kosovë janë formalë dhe ineficient. Në pamje të parë të analizës politike të situatës duket një panoramë normale për të cilën shqiptarët e Kosovës kanë shtatë vite të angazhimit të tyre institucional.

Kërkesat e politikës ndërkombëtare kanë qenë të veshura me një mantel me ngjyrë rozë dhe kanë krijuar mjedisin gjumëndjellës për klasën politike shqiptare në Kosovë. Por nuk është vetëm kjo arsyeja që shqetëson, por diçka më shumë se kaq. Si do të reagojë opinioni shqiptar me shpalljen e statusit të Kosovës, i cili në thelb nuk është gjë tjetër, veçse një “pavarësi e kushtëzuar” nën mbikëqyrjen e faktorit ndërkombëtar me bazën në Evropë?

Personalizimi në shkallën më të lartë i vlerësimeve ndërkombëtare për çështjen më thelbësore të së ardhmes së Kosovës dhe indiferenca e simuluar politike kanë midis tyre një raport të zhdrejtë, që shprehet në anën institucionale të pategjitimuar të shtetit të ardhshëm shqiptar. Duke reflektuar në analizën konkrete të situatës së pritshme, kjo është pse jo dhe revoltuese.

Serbia synon rehabilitimin e saj

Për të qenë më bindës në këtë konstatim të radhës, është e arsyeshme të hidhet një vështrim në krahun tjetër të politikës, në qëndrimin serb. Krejt ndryshe ndodh me ta në këtë situatë. Të diskretituar nga luftërat e zhvilluar për një dekadë në Ballkan, ata përsëri me kokëfortësi i referohen ultranacionalizmit të tyre terrorist tradicional, duke synuar rehabilitimin në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Ata po shkojnë shumë larg, duke e shtrirë sulmin e paskrupullt politik deri aty, sa ta trajtojnë edhe UÇK-në bashkëfajtores, për atë që ka ndodhur në Ballkan dhe në këtë mënyrë, të krijojnë idenë e një loje politike “*remi*”. Reemija e sotme, parapërgatit një ndeshje të radhës me shqiptarët për t’i larë hesapet përfundimisht me ta.

Synimi është i dukshëm dhe i qartë: të krijojnë mosbesimin në ardhmërinë e shqiptarëve në Kosovë, që ata të bëhen pjesë e inkriminimit të skenarit të tyre agjenturor terrorist. Kjo gjendje e trubullt, me skenarë që realizohen hap pas hapi, është parë që faktori politik shqiptar ka rënë përtokë dhe po i përgjigjet me papërgjegjshmërinë e tij, duke shfaqur absurdin shqiptar të kohës. Loja e ndërkombëtarëve në Kosovë zor se mund të dëgjojë deklaratimet presidenciale për përbushjen e detyrimeve për pavarësinë nga ana e shqiptarëve. Kjo është tabloja e një vlerësimi të cekët në elementët shtetformues të perspektivës.

Përballë këtij qëndrimi shpesh opinioni është tronditur nga veprimtaria e ethshme e strukturave politike të Serbisë. Qëndrimi politik serb shkon shumë larg duke kërkuar revanshin në përcaktimin e hegjemonisë në Ballkan. Makina propagandistike serbe është në sulm dhe nuk di të ndalet. Sfidat e saj ndaj faktorit politik ndërkombëtar është në rend të ditës në shumë plane. Situata pasreferendare në Serbi forcon bindjen, se çështja e Kosovës ka një kthim prapa në syrin e politikanëve serbë.

Megjithë reagimet e diplomacisë ndërkombëtare, mbështetur në faktet tronditëse të realitetit politik serb, ndihet një llastim krejt i pajustificuar e me pasoja.

Koloneli serb: “Jemi në krye të lëvizjes separatiste shqiptare”

Para dy vitesh opinioni është befasur nga deklaratimet e kolonelit serb me emrin Stojanoviç, i cili sfidoi atëhere bashkësinë ndërkombëtare, mjedisin shqiptar dhe opinionin politik serb, duke deklaruar se, “...shërbimi i tij e ka ringritur rrjetin e vet operativ në Kosovë”. Më tej ai theksonte se “*ky shërbim ka depërtuar në krye të lëvizjes separatiste të Kosovës...*”.

Në planin politik ky mbetet një provokacion i rëndë i radhës, që realisht nuk është vlerësuar në shumë plane. Në këtë kontekst, ish- shteti jugosllav dhe mbetja e tij, Serbia, nuk e kanë cenuar strukturën e zbulimit dhe të kundërzbulimit. Kjo i jep edhe sot qetësinë dhe sigurinë kolonelit serb në punën e tij. Synimi mund të shkojë edhe më tej. Në opinionin e brendshëm shqiptar, shpesh është shkaktuar çudi prej deklaratimeve të përfaqësuesve të diplomacisë ndërkombëtare dhe liderve politiko – ushtarakë serbë, në lidhje me trajtimin e problemeve thelbësore, që kanë të bëjnë me ardhmërinë e Kosovës.

Shpesh deklarime të tilla janë aq këmbëngulëse, saqë vërtet të çudisin me kurajon dhe cinizmin e tyre, përballë vlerave të vërteta të forcës vepruese të bashkësisë ndërkombëtare, në mbylljen e konfliktit dhe në zgjidhjen përfundimtare të tij. Nuk çudit fakti që, jo rrallë, pjesë e këtij cinizmi, bëhen dhe disa politikanë në zë të Evropës, të cilët në “*avancin*” e tyre demokratik, janë aq të përparuar sa që, “*motori*” i tyre kalon në gjendje “*kantato*”, duke rrezikuar të “*djegë testatën*” e tij.

Këtë e kemi mësuar nga deklaramet në emër të BE-së, të OKB-së, të UNMIK-ut, të OSBE-së, duke nënvleftësuar faktorin shqiptar në rajon. A thua se kombi shqiptar mendon se vetëm përfaqësuesit e UNMIK-ut janë ata që lëshojnë edhe ajrin me racion në qiellin e Kosovës, që të marrin frymë dhe të jetojnë shqiptarët, e pse jo dhe shqiptarët kudo që janë?!

Pse duhet të habitej atëhere Vetoni dhe kujt ia kërkonte që t’i kthehej përgjigje kolonelit serb, Stojanoviç?! Çfarë thotë më shumë ky kolonel, se sa ato që dëgjojmë përditë nga sistemi mediatik për qëndrimin e lidërshiptit politik – ushtarak serb, i cili i bën vërtet karrshillëk politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare, pa merak e droje se ata janë të humburit, se ata ende nuk i kanë kërkuar falje NATO-s dhe SHBA-së për viktimat e luftës së fundit, pra shkurt kjo nuk është një çudi, por një realitet i hidhur që vepron.

Shqiptarët kanë të drejtë të ngrenë zërin e revoltës, përballë një tragjedie, që një djall e di se ku i ka rrënjët sot në Kosovë. Çfarë do të kuptojmë me “*gjqet*” serbe në Kosovë? Kë do të gjykojnë ato në këtë kohë dhe në “*të ardhmen*”? Për çfarë i duhen kolonelit strukturat deri në udhëheqjen “*separatiste*” shqiptare? Çfarë personifikon ky kolonel ditëzi me udhëheqje “*separatiste*” dhe për ç’lloj udhëheqjeje e ka fjalën ai?

A bën ta dimë ndonjë ditë “*rastësisht*” nga goja e kolonelit serb, apo duhet ta “*nënkuptojmë*” po sipas tij?! Deri ku ka arritur veprimtaria subversive e këtij shërbimi, apo është thjesht një “*manovër*” që ai “*të flejë*” për një ditë tjetër të zezë?! A mendon ndoshta koloneli se me këto deklarata i bën karrshillëk KFOR-it dhe UNMIK-ut. Vallë edhe në këtë rast duhet të pranojmë shprehjen “*NO comment*”?!

Ish-oficerët e KOS-it jugosllav sot militojnë në strukturat e TMK-së.

Ndoshta duhet të kthehemi në kostatimin e parë. Më mirë se kushdo tjetër këtë situatë, duhet ta dinë drejtuesit e lartë të shoqërisë kosovare, duhet ta dinë kryetarët e partive politike, duhet ta dinë vetë drejtuesit e lartë në TMK, ish- oficerë të KOS-it jugosllav, të cilët janë të gjithë të pranishëm, jo vetëm në TMK, por dhe në SHPK, biles në këtë të fundit edhe ish-policë të shërbimit jugosllav, të cilët nuk e kanë për gjë të rrahin barbarisht aktivistët e Albin Kurtit.

Një qëndrim politik i rënë përtokë, me servilizëm të skajshëm, që denatyrton natyrën luftarake të paraardhëses që lavdishme, UÇK-së. Në emër të gjoja “*profesionalizmit*”, mbahen në strukturat ushtarake ish- oficerët e KOS-it jugosllav dhe një ish- drejtues i UÇK-së sot firmos që në detyrën e zv.shefit të shtabit të TMK-së të jetë një personalitet serb, përfaqësues i pakicave serbe në Kosovë.

Pa bëni llogari të dashur shqiptarë se sa të tillë janë në detyrat e eprorëve dhe si për ironi të sfidës së hapur, pse të mos e besoni atëherë kolonelin serb?! Ai ka thënë në fund të fundit një të vërtetë, doni apo nuk doni ju, harrëmsëz të gjakut të derdhur të luftëtarëve të lavdishëm të UÇK-së. Nuk dyshohet tek ju, por thjesht analizohen faktet, ë...!

Nuk ka mundësi që drejtuesit e lartë politikë dhe deputetët në Kosovë të mos i dinë këto xhevahire politike, Atëhere, kush ua lidh gojën që të mos reagojnë ashpër ndaj këtyre veprimeve, që çojnë ujë në vijën e ashpër e radikale të politikës serbe?! Akrobacira të tilla politike që bëjnë strukturat ndërkombëtare në Kosovë, pa marrë parasysh ndjesitë morale e politike të popullit shqiptar, janë të dënueshme dhe me pasoja.

Rastet e shumta formojnë një qëndrim të caktuar, të cilin opinionioni shqiptar ka kohë që e ka kuptuar dhe reagon në forma të ndryshme përballë tij.

Opiniononi shqiptar mund të tërheqë një konkluzion, duke nxjerrë një të vërtetë të dyfishtë, se “në Kosovë nuk ka kundërzbulim, por ka shumë kundërzbulime”. Oficerët e TMK-së janë dëshmitarë të veprimtarisë së zbulimeve të shteteve të veçanta, brenda strukturave të KFOR-it, si në rastin e “*arrestimit*” të gjeneral Çekut në Lubjanë.

Majorët e zbulimeve të huaja në përbërje të KFOR-it, jo vetëm që ndiqnin situatën e brendshme në Kosovë, por ata dinin edhe se “*si është koha në Tiranë*”. Atëhere, me të drejtë duhet të shqetësohemi, që të ardhmen e strukturave të sigurisë në Kosovë ta shikojmë me një sy tjetër dhe këtë detyrë duhet ta bëjnë në radhë të parë shqiptarët. Vallë, kështu duhet të jetë gjithmonë? TMK-ja është pozicionuar që të përgatisë vetëm nënoficerë dhe të mbushet me “*uçilishtas*” dhe “*akademikë*” të shkollës ushtarake jugosllave.

Është kjo klimë e mbrapshtë politike që krijon terrene të favorshme për veprimin e strukturave të zbulimit serb. Në këtë kontekst, politika mbarëshqiptare dhe veçanërisht në Kosovë, duhet ta kuptojë se me këtë mënyrë veprimi shqetësimet e saj nuk kanë për të marrë fund asnjëherë. Diskriminimi i vazhdueshëm që po i bëhet popullsisë shqiptare jashtë kufijve të saj, traditave, kulturës dhe gjuhës sonë do të konsiderohet një agresion permanent e i pandalshëm serb me prapavija të fuqishme.

Këtu e ka gjetur kurajon koloneli serb në deklaratimet e tij. Në çështje të tilla delikate që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave kombëtare nuk ka më kohë për të kërkuar falje e për të bërë ndryshime.

* * *

Të shtrojmë disa pyetje në planin konkret. Pse sot nuk shtrohet problemi i rikthimit të shqiptarëve të shpërngulur në të gjitha format nga Mitrovica veriore? Çfarë i ka detyruar ata të braktisin shtëpitë e tyre? Pse shqiptarët në Mitrovicën veriore jetojnë me frikën e ndarjes dhe të mbetjes në pjesën serbe? Kush e nxit këtë hemorragji etnike?

Vallë është e pranueshme “miopia” e faktorit politik ndërkombëtar përballë këtij spastrimi etnik të kryer në heshtje, që i bën shqiptarët të ndihen të braktisur? Ku jetojnë sot mbi 11 mijë shqiptarë të shpërngulur nga Mitrovica veriore? Vallë nuk shihet që ky fenomen është i pranishëm edhe në Kosovën Lindore?

Si ka mundësi që ende Serbia i rrëshqet “pa u parë” faktorit ndërkombëtar rast pas rasti, duke realizuar synimet e veta në kurriz të shqiptarëve? Çfarë tregon paaftësia e Grupit Negociator shqiptar në qëndrimin e tij në bisedimet me palën serbe? Cili është motivimi i tyre përballë pretendimeve serbe? Kush i detyron të nënshkruajnë me dorën e tyre ricopëtimin e trojeve shqiptare, duke u bërë pa dashje pjesë e pretendimeve dhe planeve të kamufluara të politikës serbe?

Kosova nuk është kazino e Ballkanit apo e Europës, por atje aspiron një popull për liri, pavarësi, demokraci, ekonomi dhe një status shpirtëror shumë të lartë. Atëhere pse veprohet kështu dhe ku është pika e mbërritjes për këtë? Kush ka vënë për këmbësh entuziazmin e një populli dhe besimin e tij në të ardhmen?!

Po mbushen shtatë vjet nga dalja në skenë e manovrave politike dhe stadi i mbërritur shton hijen e dyshimit duke qenë çdo ditë e më shumë më pak shpresëdhënëse. Kushdo që qëndron pas kësaj fasade të zymtë nuk besojmë se do të realizojë qëllimet e tij të mbrapshta. Filozofia jonë kombëtare edhe këtë radhë do të dijë t’ia dalë mbanë me kundërshtarët e vjetër tradicionalë.

17. “Çudia magjike” e zarfit Ahtisari

T’i jepte fund terrorit në Kosovë, të fshehur nën maskën e demokracisë.

Kombi shqiptar, veçanërisht popullsia shqiptare në Kosovë, po përjeton ngjarje politike dramatike, të cilat kanë shkaktuar tronditje të thella morale e psikologjike. Përballë alternativave ende të pashpalluara, të besueshme e të pabesueshme, të hedhura nga faktori politik ndërkombëtar për të ardhmen e saj, kriza e besimit ndaj politikës sot qëndron në nivele të larta.

Përballë sfidës dhe presioneve mbi plotësimin e standardeve të dyfishta, shqiptarët kanë shfaqur shenjat e padurimit dhe po i drejtohen vetëdijes kombëtare, të motivuar nga shpresat drejt së ardhmes. Pasojat e tkurrjes territoriale, gjenocideve, represionit, dëbimeve masive dhe masakrave të tmerrshme, nuk mund të harrohen lehtë. Ato thellë në histori e deri më sot kanë lënë gjurmë të ndjeshme, të cilat reflektojnë në reagimin e qytetarëve të Kosovës duke rritur qëndresën e tyre.

Fenomeni i nacionalizmit agresiv dhe politikave të vjetra kanë shkaktuar tragjedi të rënda mbi popujt e Ballkanit. Situata e sotme në rajon nuk është ajo që duket. Manovrat e fundit të politikës serbe në dëm të pavarësisë së Kosovës, kanë sjellë në vëmendjen e shqiptarëve ndjenjën e revoltës dhe reagimit, duke pranuar me vetëdije përballjen me një situatë më të rëndë.

Kërcënimet e gjeneralit francez të KFOR-it dhe të ndonjë tjetri kundër trazirave, të cilët e shikojnë të drejtën e shqiptarëve në Kosovë si një dëshirë dhe mundësi dhe jo si një kërkesë, realitet dhe të drejtë të tyre të patjetërsueshme, janë pjesë e qëndrimit mospërfillës, duke e paragjykuar faktorin shqiptar.

Kjo filozofi, nuk mund të funksionojë më, pavarësisht standardeve që ofrohen, sepse në një farë mënyre ajo ka humbur përkrahësit tradicionalë në politikën evropiane, për shkak të civilizimit të saj dhe parametrave të avancuar standardë, ku vendimtar është shteti i qytetarit.

Atëherë, është e papranueshme që ndaj shqiptarëve, shtetet e Evropës, ato që kërkojnë të futen në bashkësinë evropiane dhe ato që e quajnë veten vende demokratike, të përdorin standarde të dyfishta. Të gjitha ato standarde që kërkohen në hapësirat e tyre, duhet të jenë të lejueshme dhe të pranueshme edhe për shqiptarët.

Rreziku “tek porta”

Zhvillime politike të befta, të cilat kanë natyrën e zvarritjeve insitucionale, duke servurur shkaqe jobindëse, tërheqin vëmendjen e shqiptarëve se ende rreziku është “tek porta”. Mungesa e vendimmarrjes në kohë e realpolitikës nuk po u shmanget deklaratave qetësuese, të cilat e kanë kaluar masën.

Nacionalizmi i egër dhe ksenofobia e politikës serbe ndaj faktorit shqiptar shprehet hapur në çdo kohë. Historia e zhvillimeve në Ballkan ka përcaktuar rrugën e saj dhe ajo do të ketë kohën e nevojshme që të flasë për vlerat dhe aspiratat e kombit shqiptar.

Do apo nuk do Serbia dhe shtetet e tjera koloniale, duan apo nuk duan segmente të caktuara të politikës kontinentale, të cilat i copëtuan e ndanë më 1913 shqiptarët me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, e drejta e popullsisë shqiptare në Kosovë për vetëvendosje e pavarësi nuk mund të tjetërsohet.

Presionet e hapura politike me frikën e trazirave dhe destabilizimit të rajonit nuk justifikojnë zvarritjen e zgjidhjes së problemit shqiptar në pafundësi. Përballë qëndrimit tolerant dhe mirëkuptimit të thellë të popullit shqiptar që aspiron për liri dhe pavarësi, kjo situatë është një mospërfillje politike, e cila zhvlerëson qëndrimin e faktorit ndërkombëtar përballë opinionit të gjerë.

Qëndrimi arrogant i politikës serbe ndaj interesave të shqiptarëve, nuk lejon më hapësira për të shpresuar. Ata që organizuan marsin e vitit 2004 në Kosovë, janë të gatshëm të veprojnë përsëri.

Koha nuk mund të kthehet prapa

Kërkesat politike të shqiptarëve dhe qëndrimi adekuat për ruajtjen e vlerave të identitetit kombëtar, janë nxitje që bota demokratike të dëgjojë më mirë zërin e arsyes. Politika serbe me natyrën e saj dinake, duke shfrytëzuar tolerancën dhe lëshimet e faktorit politik ndërkombëtar, kërkon ta kthejë kohën prapa dhe t'i shkaktojë Ballkanit ndoshta tragjedinë më të rëndë në historinë e tij. Kjo imponon bashkimin dhe qëndresën shqiptare për t'u dhënë fund një herë e mirë pazareve në kurriz të çështjes sonë kombëtare. Ky është mesazhi që duhet repektuar jashtë paragjytimeve të rëndomta, që zbehin vlerat e demokracisë.

Nga ana tjetër, shqiptarët kanë arritur të kuptojnë vërtetësinë e dështimit të misionit të OKB-së në Kosovë dhe paaftësinë e strukturave të UNMIK-ut për të administruar situatën. Koha e pretektoratit ndërkombëtar, mbështetur në Rezolutën 1244, ka përfunduar dhe ajo kërkon zgjidhjen.

Nën vëzhgimin e strukturave të sigurisë, në Kosovë po instalohet paralelisht pushteti i vjetër serb, duke mos përfillur në mënyrë të njëanshme paralajmërimet e faktorit ndërkombëtar. Këtë natyrë kanë kërcënimet politike dhe gjuha e ashpër e parlamentarëve serbë.

Shqiptarët kanë kuptuar se nuk po i dëgjon më njeri dhe e ndiejnë se janë vënë përballë diktatit të dyfishtë. Kjo është padrejtësia e radhës e mbushur me zhgënjim, e cila zor se mund të pranohet. Kosova nuk është më ajo e kohës së Miloshviçit, dhe në këto shtatë vjet ka treguar se e do dhe respekton lirinë dhe pavarësinë e saj, se mbart brenda vetes popullin më optimist të Evropës.

Zvarritjet politike kanë natyrën e qëndrimeve të gabuara pa shkak, të cilat nuk mund ta mbajnë më gjatë Kosovën në këtë gjendje, duke krijuar në popull ndjesinë e pranisë së një sundimi tjetër ushtarak. Psikologjia e popullit shqiptar në Kosovë ka fituar tiparet që duhen respektuar. Shkaku është sundimi i gjatë ndaj lirisë së munguar. Shqiptarët “e prekën” lirinë me dorë në vitin 1999, por sot pas shtatë vitesh nuk do ta ndërronin atë me asgjë tjetër. Makineria ushtarake serbe po përgatitet në hije për një masakër të re ndaj popullit shqiptar.

Kush ka sy le të shikojë. Armata serbe, duke shkelur në mënyrë të njëanshme kërkesat e marrëveshjes së Kumanovës, ka krijuar një dispozitiv të ri e të fuqishëm ushtarak me natyrë sulmuese. Bandat paramilitare serbe veprojnë nën hijen e strukturave ndërkombëtare dhe enklavat serbe në Kosovë janë kthyer në depo armatimi.

Aktet e dhunshme ndaj shqiptarëve janë një sfidë ndaj strukturave të sigurisë të faktorit ndërkombëtar. Beogradi dëshiron ta çojë deri në fund qëllimin e tij. Paralajmërimet për një rikthim të dhunshëm të strukturave ushtarake serbe në Kosovën Veriore, në rast të kërkesës së popullsisë serbe, nuk ka se si të bien në vesh të shurdhër.

Ato janë sinjale të frikshme, duke na kujtuar se jemi në prag të një konflikti të ri, më të tmerrshëm se ai i vitit 1998-99. Indiferenca ndaj paralajmërimeve të personaliteteve botërore, përballë anarkisë së mendimit që mbizotëron në politikën serbe, po shton më shumë ankthin dhe pasigurinë. Kjo nuk duhet të bëhet shkak që shqiptarët t'i drejtohen forcës dhe vullnetit të tyre. Shqiptarët kanë mësuar se tradita mbetet një element i lindur dhe i kultivuar, që përfaqëson koncentratin e mendimit më të mirë të kombit dhe të elitës së tij.

Ajo shpesh është aq e fuqishme, sa që në çdo rast mund të përmbysë pushtete, mund të jetë më e fortë se sa vet sistemet në fuqi. Nuk ka se si këtë të mos e dinë njerëzit e mençur që drejtojnë institucionet ndërkombëtare.

Liria nuk mund të dhurohet, ajo fitohet

Kombi shqiptar nuk e konsideron qenien e tij jetim në mes të Evropës, sepse ai është populli më i vjetër i saj. Uniteti i shqiptarëve me vlerën e tij, si në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, është zëri që thërret në Evropë kundër padrejtësisë, është zëri i të gjithë shqiptarëve kudo që janë, në Veri e në Jug, brenda dhe jashtë Shqipërisë, që kërkojnë drejtësi.

Anashkalimi që po ndodh po imponon arsyen historike, kundër mosdashjes historike, pse shqiptarët e meritojnë lirinë dhe pavarësinë e tyre. Copëtimi i trojeve shqiptare është një realitet i

dhimbshëm, i cili ende sot po shfrytëzohet me hipokrizi dhe dhunë shtetërore. Në këto kushte, nuk mund të ketë një bashkim evropian, veçanërisht një Ballkan të integruar e të qetë, nëqoftëse nuk do të luftohen shkaqet që kanë sjellë nacionalizmin agresiv në gadishullin e trazuar dhe copëtimin e Shqipërisë.

Shqiptarët në Kosovë e më gjerë, sot nuk duan të besojnë se janë të rrezikuar seriozisht në rrugën e zhvillimit të tyre. Tashmë është kuptuar në mënyrë përcaktuese se liria asnjëherë nuk mund të dhurohet, ajo fitohet. Askush nuk ka të drejtë të luajë me ndjenjat e një populli, me varfërinë dhe papunësinë e tij, me jetën e vështirë dhe mungesën e perspektivës.

Shtatë vite pritje dhe shpresë, shtatë vjet ngurrim për të njohur shtetin më të ri të Ballkanit, shtatë vjet qëndrim i dyzuar ndaj politikës dhe diplomacisë së pareformuar serbe, shtatë vjet që nuk mund të shmangin psikologjinë e luftës dhe të dhunës në rajon, shtatë vjet në kërkim të rrugëve të munguara, vetëm zgjidhjet mungojnë. Një situatë politike e improvizuar që shfaq natyrën e saj të shtirur naive, e mbështetur në djallëzinë bizantine, që kërkon të gjunjëzojë dhe të imponojë në mënyrë të njëanshme, për të mos marrë kurrë atë që i takon.

Garanti i statusit final të Kosovës humbet përditë terren, duke llastuar politikën ultranacionaliste serbe. Një lojë politike e lodhshme deri në kufijtë ekstremë. Në funksion të kësaj strategjeme ballkanike, që shkakton trazira, frikë dhe terror, ndoshta nuk është e tepërt që të rindërtojmë ngjarjet, pavarësisht se ato jo të gjithëve u pëlqejnë. Tashmë e ka mësuar edhe bufi i natës në Ballkan se pika e dobët e gadishullit dhe Evropës është çështja e pazgjidhur shqiptare.

Dikush duhet “të paguajë” haraçin moral e historik mbi një fizionomi e personalitet të dalë boje. Shqiptarët jetojnë në kohë të jashtëzakonshme, në të cilën kanë kuptuar se politika e vjetër duhet të paguajë haraçin e padrejtësive historike. Nacionalizmi agresiv serb duhet të diskretitohet në opinionin ndërkombëtar për qëndrimin e tij ndaj çështjes së Kosovës. Në fakt, është konstatuar se ka ndodhur e kundërta.

Nuk është fort e rëndësishme se si mund ta shfrytëzojnë shqiptarët këtë situatë, sepse edhe duke e denoncuar nacionalizmin agresiv, kjo ka vlera përgjithësuese. Politika ndërkombëtare duhet të përjashtojë nga politika individët radikalë ekstremistë, duke filluar nga Koshtunica, i cili ka qenë dhe mbetet një nationalist luftënxitës. Kjo është ajo që mungon.

Filozofia është e qartë, të hedhim baltë mbi shqiptarët që ata të mos kenë më pretendime, t’u trembim dhe t’u dënojmë krerët, t’u vrasim heronjtë, t’i demaskojmë ata dhe t’u ulim kokën dhe atëhere shqiptarët do të detyrohen të pranojnë diktatin e politikës evropiane. Por shqiptarët nuk besojmë se do të binden lehtë ndaj një filozofie të tillë. Kjo mënyrë veprimi dashur pa dashur është shndërruar në një filozofi raciste.

E rëndësishme është të dihet dhe vlerësohet se populli shqiptar i Kosovës dhe i të gjithë Shqipërisë, ka një kujtesë të fortë, e cila nuk ka se si të mos reflektojë dhe në momente të caktuara të shërbejë si një zjarr i fuqishëm atdhetar, si një motiv i fortë me simbolikat e tij epike, për të vazhduar në rrugën e nisur të pavarësisë së plotë kombëtare. Populli shqiptar në Kosovë nuk mund të durojë më të provokohet.

Kosova nën kërcënimin e “vetos” së Ruisë

Pasiguria dhe fobia politike se Rusia apo qoftë edhe ndonjë shtet tjetër në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, mund të vendosin “veton” në çështjen e Kosovës, ka përfshirë edhe opinionin shqiptar. Kjo është e natyrshme po të kemi parasysh se në këtë rast kemi të bëjmë me një rrugë shqyrtimi që do të kalojë në atë derë.

Rusia, veçanërisht është një shtet që ka potencialin e vet në arenën e politikës ndërkombëtare. Nuk na takon të gjykojmë se çfarë qëndrimi mund të mbajë përfaqësuesi rus në KS të OKB-së, kjo është puna e tij. Për atë që mund të ngjasë është me vend të kuptojmë se rasti i një “vetoje” ruse do të mbartë brenda vlerave të saj edhe pasojat e këtij votimi, të cilat nuk mund të shmangin nga përgjegjësia pozicionin kundërshtues ekstrem.

Por një gjë mbetet e vërtetë. Në rast të këtij veprimi, politika ruse duhet të mbajë përgjegjësi ndërkombëtare për pasojat që mund të veprojnë në rajon, kundër kërkesave të drejta të shqiptarëve. Qëndrimi rus nuk ka të bëjë as me favorizimin e shqiptarëve dhe as me ndonjë rast dëmtimi të Serbisë. Çështja e “vetos” së përfolur mund të jetë edhe një mjet presioni ndaj vetë KS të OKB-së për problemet me të cilat përballet vetë Rusia ndaj pretendimeve mbi ish- republikat e BS-së.

Lëvizjet e Kryeministrit të Kosovës mund të konsiderohen të pranueshme, por jo kudo të arsyetuara. Në kushtet e zhvillimeve të sotme synimi i faktorit politik shqiptar dhe udhëheqësive të veprimtarive me karakter kombëtar, është që si të bëhet e mundur që “xhindet të mos dalin nga shishja”.

Pretendimi i “xhindit” serb është i qartë, nëqoftëse shqiptarët “si pjesë e Serbisë” (gjithmonë sipas pretendimit serb) kanë të drejtë të bëjnë shtet, atëherë, pse nuk lejohen të bëhen të tillë edhe serbët e Bosnjes, rusët në Abkazi apo në Gjeorgji? Rastet etnike janë të shumta në hapësirën e Ballkanit, por në stadin e mbërritur, është kuptuar se me luftërat e zhvilluara tashmë është ezauruar gjithçka. Pasojat e tyre kanë vënë në fokus pikërisht fobinë politike për situata të ngjashme, gjë që nuk do t’i interesonte më askujt.

Mendësive të politikës së vjetër të mbarsur me urrejtje e nacionalizëm, kërkojnë t’u vihet përballë organizimin e fortë dhe vullnetin politik të mbështetur në aspiratat e popullit që kërkon liri, pavarësi. Në Kosovë këto kërkesa nuk mungojnë.

“Misteri” i zarfit Ahtisari

Nga sa mund të parashikohet është e mundshme që propozimet e Ahtisarit të nënkuptojnë se statusi i Kosovës do të jetë një ngjashmëri me situatën e Gjermanisë së pasluftës së Dytë Botërore. Do të vlerësohet e rëndësishme në këtë akt ndërkombëtar shkëputja një herë e përgjithmonë e Kosovës nga Serbia në mënyrë juridike. Me këtë akt nuk është e vështirë të nënkuptohet, se nuk do të ketë ndarje apo copëtim të Kosovës, dhe kjo është e rëndësishme, përballë pretendimeve absurde të politikës serbe.

Pjesët me popullsi serbe brenda territorit politik të Kosovës kërkojnë vetëvendosje për administrimin civil, brenda kuadrit të administrimit ushtarak të Evropës dhe NATO-s. Duke vlerësuar pëlqyeshmërinë e palëve, ndoshta brenda kushteve do të përfshihet principi i pranimit në BE të Kosovës dhe Serbisë para vendeve ballkanike, përfshi këtu edhe Kroacinë.

Në këto kushte, Kosova mund të konsiderohet “landi më i ri i Evropës”, duke vijëzuar perspektivën e së ardhmes së rajonit ballkanik. Kosova është rasti i parë në kuptimin klasik të fjalës, të ndryshimit të pritshëm të kufijve pas Luftës së Dytë Botërore. Dihet që ajo juridiksist, në mënyrën më të padrejtë ka qenë pjesë e Serbisë. Ka shumë arsye që Kosova duhet të shkëputet nga Serbia.

Duke parë në syrin analitik të situatës në kushtet aktuale ka një mijë arsye që politika shqiptare të lëvizë duke e detyruar kundërshtarin “të kafshojë gjuhën”. Kjo realisht nuk po ndodh. Në tërë këtë turravrap politiko – diplomatik në hapësirën ndërkombëtare, precedenti më delikat mbetet kjo lloj shkëputjeje.

Në dekadën e fundit Milosheviçi me luftërat në Ballkan bëri që të derdhet kupa e durimit për faktorin ndërkombëtar, dhe veçanërisht me luftën në Kosovë. Kjo nuk ka ndodhur në vende të tjera. Faktikisht, ndodhemi përballë qëndrimit ekstrem të diplomacisë ruse, e cila është e prirur të vendosë “veton” në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Kjo edhe mund të ndodhë, por në thelb duhet kuptuar se rastet e vendeve brenda shtetit rus, kanë dallime esenciale nga rasti i Kosovës dhe nuk mund të pretendohet për ngjashmëri. Zgjidhja e tyre nuk është e njëjta gjë. Luftërat në Ballkan janë një rast i veçantë pas Luftës së Dytë Botërore dhe ato kërkojnë vëmendje e zgjidhje të veçanta.

Përballë kësaj situatë, opinionin pret hapjen e zarfit nga misionari ndërkombëtar, Ahtisari. Çfarë enigme përmban ai brenda tij? Revolta e vitit 2004 dha efektin e vet në të gjitha planet dhe

qëndrimet e mbajtura deri në atë kohë ndaj çështjes së Kosovës. Përsëritja e ngjarjeve të tilla kanë një sens të theksuar negativ dhe kjo nuk do t'i interesonte më politikës ndërkombëtare, pse jo dhe opinionit të brendshëm shqiptar në Kosovë.

Në këto kushte, kur mjeku është në operacion i sëmuri nuk mund të bëjë sherr me të. Kjo është logjika më e thjeshtë në situatën që dominon në Kosovë në prag të shpalljes së statusit të saj. Përfundimi është më pranë se kurrë, megjithatë edhe lëvizjet në të kundërt të saj janë më të ethshme se kurrë.

Gjykimi është i thjeshtë: Duhet lënë Ahtisari të bëjë punën e vet. Fryma antiserbe ndaj tij ka një shpjegim në qëndrimin që ai është i prirur të mbajë në plotësimin e misionit të vështirë që ka marrë përsipër. Duke vlerësuar së fundi deklaratimet e zyrtarëve të lartë të Departamentit të Shtetit Amerikan, nuk është e vështirë të kuptohet se në këto qëndrime janë të përfshira dhe interesat amerikanë, përballë të cilave të tjerët do ta kenë të vështirë të kundërveprojnë.

Është kuptuar se Kosova do të përballlet me një pavarësi të kushtëzuar, e cila kushtëzimet do t'i ketë objekt të faktorit politik ndërkombëtar. Mendohet për një "protektorat të BE-së" me një mandat trevjeçar, mendohet për një forcë shumëkombëshe të BE-së që do të zëvendësojë UNMIK-un, mendohet se Kosova nuk do të ketë Ministri të Jashtme, Ministri të Mbrojtjes, mendohet se qytetarët e Kosovës mund të pajisen me pasaportën e BE-së, e çfarë nuk mendohet se mund të ketë brenda misterit të zarfit Ahtisari.....

Tendencat dinake të politikës serbe që pas tre vitesh ta vlerësojnë revoltën popullore të shqiptarëve si revoltë me pikënisje religjioze, duke vënë në lëvizje strukturat e shërbimit sekret serb në nxitjen e djegies dhe shkatërrimit të objekteve të kultit në Kosovë, tashmë i ka dalë kallaji. "Viktimizimi" i pakicave etnike serbe të vendosura me dhunë në trojet shqiptare në Kosovë në prag të shpalljes së "zarfit Ahtisari", dhe qëndrimet e politikës serbe janë një ogur i keq për të ardhmen e sigurisë në rajon.

Bota mund të mos shqetësohet shumë për këtë, sepse disponon forcën e mjaftueshme të sigurisë në Kosovë, dhe kjo është puna e saj, por gjithsesi është kuptuar tashmë se askujt nuk i dhimbsen shqiptarët, por interesat ndërshtetërore të fuqive të mëdha të botës që lozin politikën botërore. Kaq është e mjaftueshme që shqiptarët t'u drejtohen potencialeve të veta dhe të gjykojnë me gjakftohtësi e zhgënjim të plotë se për politikanë dritëshkurtër e drejta qëndron përherë nga më i forti.

Bërja fakt i ndarjes së qytetit problematik verior të Mitrovicës, në pjesën shqiptare dhe serbe, duke e zhvendosur "kufirin" në urën e Ibrit, shpërfillja e përmbajtjes së Rezolutës 1244 të OKB-së dhe sfida ngaj strukturave ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, është treguesi më real për konstatimin që bëhet në analizën e qëndrimit të politikës evropiane ndaj problemit shqiptar në Ballkan.

Shqiptarët me të drejtë mbeten në dilemë dhe kanë një mijë arsye të shqetësohen se çfarë mund të ngjasë me ta në situata alarmante. Në fund të fundit, kujt i intereson destabilizimi i Kosovës dhe i rajonit ballkanik? Kujt, vetëm shqiptarëve jo.

18. Kosova pa Ministri të Mbrojtjes

Reformimi i strukturave të sigurisë në Kosovë sot shikohet me një sy tjetër. Larg erës së barutit dhe të luftës, sot eprori i lartë i TMK-së pranon që zëvendësin e tij ta ketë një oficer, përfaqësues të pakicës serbe. Dhe për këtë ka firmosur dhe dokumentin përkatës. Dje përballë për ta vrarë njeri- tjetrin, sot krah për krah për të "ndërtuar" ushtrinë moderne të Kosovës. E bukur dhe kjo apo jo.... (!!)

Përfitime të pamërituara në dëm të çështjes kombëtare

Goditja e TMK-së, mbushja e SHPK-së me ish-policë të sistemit jugosllav dhe tendenca për të vënë dorë edhe mbi strukturat e Gardës së Kosovës “Adem Jashari”, mbeten “hala në sy” për renegatët shqipfolës, që sot u janë veshur sytë nga përfitimet e pushtetit. Kjo situatë na bind për dy arsye kryesore.

Së pari: ata nuk kanë bërë më të mirën në radhët e UÇK-së, sepse djemtë idealistë që kanë qenë shpirti i saj, sot nuk jetojnë. Së dyti: Këta individë, të shndërruar në marioneta politike e kanë parë qenien e tyre në luftë për të përfituar prej saj. Nuk ka nevojë për vërtetime e përbetime.

Këtë sot e sheh dhe e beson populli i varfër në Kosovë, që nuk e prishi një herë zemrën me njerëzit e tij. Strukturat e sigurisë nuk janë lodra fëmijësh që me to mund të sillesh si të duash. Ato janë shtylla kryesore dhe më e rëndësishme e shtetit të ardhshëm të Kosovës.

Të tillë janë katandisur edhe disa prej tyre të “dalë nga lufta”, të cilët janë gati tashmë të shkëmbejnë gjithçka të vlefshme, për të siguruar suportin politik që u dhuron si me magji përfitime të pamërituara në kurriz të çështjes kombëtare. Përpyekjet e tyre dhe tendencat shumë të mundimshme, për të shprehur të pashprehurën që nuk i intereson më opinionit shqiptar, është më shumë sesa një dështim, është një shpërfytyrim moral i skajshëm, i katandisur vetëm në luftën e turpshme për pushtet.

Kjo ka mbetur rruga e fundit për ta, që përfundimisht bind opinionin shqiptar mbi shterpësinë e mendimit të tyre, për një betejë të kotë e të panisur, që nuk kanë për ta fituar kurrë.

Forma platonike e mendimit të tyre sot, është mënyra më e mirë e përdorur nga vetë ata, për të humbur të drejtën e pjesëmarrjes në zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare në Ballkan. Rruga e nisur do të vazhdojë dhe këtë do ta çojnë përpara djemtë e Shqipërisë.

Kosova pa Ministri të Mbrojtjes

Tendencave dinake të politikës serbe që, pas tre vitesh ta vlerësojnë revoltën popullore të shqiptarëve si revoltë me pikënisje religjioze, duke vënë në lëvizje strukturat e shërbimit sekret në nxitjen e djegies dhe shkatërrimit të objekteve të kultit në Kosovë, tashmë u ka dalë kallaji. “Viktimizimi” i pakicave etnike serbe të vendosura me dhunë në trojet shqiptare në Kosovë në prag të shpalljes së “zarfit Ahtisari”, dhe qëndrimet e politikës serbe janë një ogur i keq për të ardhmen e sigurisë në rajon.

Bota mund të mos shqetësohet shumë për këtë, sepse disponon forcën e mjaftueshme të sigurisë në Kosovë, dhe kjo është puna e saj, por gjithsesi, është kuptuar se askujt nuk i dhimbsen shqiptarët, por interesat ndërshtetërore të fuqive të mëdha të botës që luajnë boshtin e politikës botërore. Kaq është e mjaftueshme që shqiptarët t’u drejtohen potencialeve të veta dhe të gjykojnë me gjakftohtësi se nuk duhet t’i nënshtrohen zhgënjimit, pavarësisht se politikat e mëdha kanë luajtur përherë me më të fortët.

Bërja fakt e ndarjes së qytetit problematik verior të Mitrovicës, në pjesën shqiptare dhe serbe, duke e zhvendosur “kufirin” në urën e Ibrit, shpërfillja e përmbajtjes së Rezolutës 1244 të OKB-së dhe sfida ndaj strukturave ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë është treguesi më real për konstatimin që bëhet në analizën e qëndrimit të politikës ndërkombëtare ndaj problemit shqiptar në Ballkan.

Shqiptarët me të drejtë mbeten në dilemë dhe kanë një mijë arsye të shqetësohen se çfarë mund të ngjasë me ta në situatë të tilla alarmante. Cili do të jetë bie fjala, reagimi i strukturave ushtarake të TMK-së në një situatë të tillë, po populli çfarë do të bëjë, sehir?! Kush do të jetë në gjendje të administrojë situatë të tilla që mund të dalin jashtë kontrollit?

Ku do të ketë besim populli shqiptar në Kosovë, nëse vërtet pëson një zhgënjim total në shpresën e tij për liri dhe pavarësi? Kush do ta përfaqësojë atë kur lehtësisht vërehet humbja e besimit ndaj njerëzve pa integritet moral dhe të dështuar në politikë? Kush do të përgjigjet në një

rast të tillë, duke parë hapur dështimin e misionit të OKB-së në Kosovë? Në fund të fundit, kujt i intereson destabilizimi i Kosovës dhe i rajonit ballkanik? Kujtdo, vetëm shqiptarëve jo.

Kosova duhet të ketë strukturat institucionale të sigurisë

Zhvillimet e ngjarjeve të vitit 2004 në Kosovë vunë në lëvizje faktorin politik ndërkombëtar, duke dhënë të kuptohej se deri atëherë diçka nuk shkonte në këtë vend. A janë të mjaftueshme shtatë vjet, për të përcaktuar të ardhmen e Kosovës? Zbatimi i kërkesave të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe veçanërisht zhvillimet politike që priten të shpallin statusin e saj final, tregojnë se jo vetëm shtatë vitet, por dhe shtatë të tjerë “nuk mjaftojnë” për faktorin ndërkombëtar me politikën e ndjekur deri tani.

A kemi të drejtë të dalim në këtë përfundim, kur çdokush mund të thotë” po çfarë duan shqiptarët, ne do t’u japim atyre pavarësinë”?! Cilën pavarësi(!). Për SHBA-të dhe BE-në stabiliteti në rajonin ballkanik është me rëndësi thelbësore, po të kemi parasysh angazhimin e tyre në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, ku nuk përjashtohen edhe hapësirat e gadishullit tonë të trazuar. Shumë mirë edhe kjo!

Megjithatë, koha ecën dhe mendohet se edhe mjedisi i sigurisë ka pësuar ndryshimet e veta në rajon. Le të themi se është edhe kështu. Ngjarjet e marsit të vitit 2004 dhe mendimi dominant mbi dështimin e misionit të OKB-së në Kosovë, nuk është pak për të mos diktuar edhe masa të tjera, që lehtësojnë barrën ndërkombëtare dhe përdorjnë qoftë edhe indirekt potencialet në mjedisin social politik të vendeve të rajonit, përfshi këtu edhe Kosovën dhe hapësirat e tjera etnike shqiptare.

Nevoja e zgjidhjeve të shpejta e të qëndrueshme, nuk mendohet se është vetëm atribut i institucioneve të angazhuara deri më sot, kur përballë stërmundimit të tyre, shpesh situatat dalin jashtë kontrollit. Një situatë e tillë shpjegohet me faktin se deri tani nuk është punuar për të zgjidhur problemin thelbësor që qetëson rajonin dhe kryesisht hapësirat shqiptare.

Konceptimi i problemit të sigurisë në rajon domosdoshmërisht kërkon rishikimin e opsioneve që kanë dominuar deri tani dhe që janë kundërshtuar jo pak nga opinionin shqiptar në Kosovë. Ky këndvështrim është i lidhur me të ardhmen e sigurisë në rajonin ballkanik, dhe brenda kësaj edhe kjo fushë kërkon standardet e saj.

Partneriteti ndërkombëtar me probleme në fushën e sigurisë

Në Kosovë tashmë, është pranuar fakti se subjektet ndërkombëtare veprojnë në varësi nga njëri-tjetri dhe në partneritet të plotë. Faktori politik shqiptar në Kosovë është bërë rob i kësaj ndjenje ndërvarësie dhe partneriteti, duke konsideruar të mirëqenë çdo gjë që buron prej saj. Bukur edhe kjo!! Pra, nuk është zor të kuptohet që brenda këtij partneriteti ndërkombëtar të pranuar nga pala shqiptare, kanë filluar edhe mospëlqimet e mospërputhjet e interesave kur shikohet llastimi që i bëhet politikës serbe nga faktori ndërkombëtar.

Reagime të tilla, të cilat rëndojnë dashur pa dashur situatën në hapësirat shqiptare, nuk janë në interes të sigurisë dhe të së ardhmes së Kosovës – shtet. Kjo është dobësia më e dukshme e partneritetit ndërkombëtar në çështjen e së ardhmes së Kosovës, dhe duhet pranuar se jo çdo zgjidhje që vjen e imponuar nga lart mund të jetë e suksesshme.

Kjo dukuri ndërkombëtare, me sa duket, është e kushtëzuar nga preferencat dhe interesat politike ndërshtetërore që gjallojnë brenda këtij partneriteti të mangët, të cilat në këto shtatë vite kanë dalë në sipërfaqe, duke e trazuar opinionin në Kosovë e më gjerë. Në këto kushte, duke zhvilluar vetëpërmbajtjen populull në Kosovë pret që të marrë atë që i takon. Sipas vlerësimit ndërkombëtar, merakun kryesor mbetet siguria dhe garancia e pakicës serbe, së cilës ata pretendojnë t’i dalin vetë për zot. Bukur edhe kjo!!

Por përgjegjësia politike në fushën e sigurisë nuk mjafton. Serbët si qytetarë të Kosovës sot lëvizin lirshëm në Prishtinë e kudo dhe nuk i nget kush. Popullit nuk ka nevojë t’i bëhen

shpjegime për incidentet që kanë ndodhur në këtë periudhë. “Shishja e birrës” në prapnicën e një serbi në ngjarjet e Mitrovicës ishte një turp serb që nuk do koment.

Përballë “gjuhës ekstremiste” të rinisë shqiptare

Realisht, tensionet me kundërshtarët tradicionalë janë ende shumë të larta. Faktori ndërkombëtar ende vëren se “*ka shumë gjuhë ekstremiste*”, veçanërisht nga të rinjtë në Kosovë. Pse çfarë pret tjetër politika ndërkombëtare me gjendjen në të cilën e ka katandisur rininë shqiptare në Kosovë e më gjerë?

Këtu nuk ka ndonjë zbulim të ri, të cilit duhet t’i bëjmë pa tjetër temena si shpëtimtarin e situatës. Cilat do të ishin vendimet më të drejta që edhe në brezin e ri të shqiptarëve në Kosovë të vepronte detyrimisht një sistem i ri edukimi drejt një mënyre të re të të menduarit për të ardhmen e shtetit të tyre dhe të rajonit në tërësi?

Pikërisht sepse mungon kjo alternativë logjike dhe mosvepruese, pikërisht se është parë që zgjidhjet anojnë në mënyrë të njëanshme në favorizimin e minoritetit serb, pa dhe nuk duhet të shkaktojë habi dhe alergji mendimi me “tendencë ekstremiste” në radhët e shqiptarëve. Injorimi i vlerave që përfaqëson një popull i vuajtur, për shkak të persekutoreve të djeshëm që sot janë bërë palë dhe pjesë e zgjidhjes së fatit të tij, është absurditeti më i madh i kohës që jetojmë, dhe kjo faturë i takon politikës konservatore evropianoperëndimore, e cila e ka të domosdoshme të rikrijojë raporte të drejta të marrëdhënieve të saj me kombin shqiptar në Ballkan.

Kanë kaluar shtatë vjet nga ndërhyrja ushtarake në Kosovë dhe faktori ndërkombëtar ende ngul këmbë, se ardhmëria e Kosovës edhe për shumë vite do të jetë në një gjendje të tillë. Frika prej mundësive të shpërthimit të dhunës në rajon nuk është një fenomen i pakapshëm për faktorin politik ndërkombëtar.

Kush më mirë se sa funksionarët e lartë amerikanë e kanë kuptuar popullin shqiptar në Kosovë? Mos vallë këta amerikanët “nuk janë në rregull” kur mendojnë kështu?! Vallë edhe shqiptarët nuk po kuptojnë se çfarë po ndodh me ta?! Dilemat politike të shprehura në nivelet më të larta politiko – diplomatike tregojnë se elementët e sigurisë së brendshme dhe të jashtme në Kosovë, ende kanë probleme dhe ato duhen riparë.

Në këtë aspekt, nuk na duket ndonjë çudi pse Kosova nuk do të ketë Ministri të Mbrojtjes dhe ushtrinë e saj të armatosur. Mungesa e ngritjes dhe funksionimit të strukturave të brendshme të sigurisë në Kosovë, është një nga treguesit më thelbësorë se çfarë ka ndërmend të bëjë faktori ndërkombëtar në të ardhmen në Kosovë.

Kosova edhe për tri vite nën mercenarizëm

Pse të mos pranojmë se një zgjidhje e tillë nuk i plotëson standardet e shtetit që kërkojnë të ngrenë shqiptarët e Kosovës në Ballkan? Kush ka frikë nga ky zhvillim perpspektiv? Vallë tërë jetën Kosova do të mbetet me ushtrinë mercenare brenda saj, që t’i kujtojë dhe vringëllijë në çdo kohë tytat e armëve? Vallë nuk kanë qenë të mjaftueshme shtatë vjet për të parë se si janë trajtuar strukturat shqiptare të sigurisë në Kosovë?

Si mund të operohet në kushtet kur në mjedisin shqiptar veprojnë pasojat e psikologjisë së nënshtrimit të dhunshëm, të cilat kanë shkaktuar revoltën popullore me dhjetëra herë?

Si mund të amortizohet një psikologji e tillë drejt ndryshimit të vlerave të saj në të mirë të bashkëjetesës në rajon? A do të mund të mbeten permanente marrëdhëniet e opinionint shqiptar me strukturat e jashtme ndërkombëtare në një kohë pambarim, po të kemi parasysh se KFOR-i në radhë të parë përfaqëson një aleancë politiko – ushtarake, dhe nuk do të mund të dalë asnjëherë jashtë qëndrimit të udhëheqësisë politike, e cila e ka treguar deri tani se nuk është konseguente për të vënë drejtësinë në vend, përballë kërkesave të drejta të shqiptarëve për shtetin e tyre të pavarur.

Kjo mbetet një vështirësi permanente, që mund të ketë pasoja në të ardhmen.

Gjithashtu, qëndrim i tyre në një mandat të papërcaktuar me siglën e BE-së, që mund të zgjatet pambarimisht, sjell premisa të degjenerimit të këtyre strukturave, të cilat deri tani, janë të përfolura dhe të pranishme në efektet e kriminalizimit të jetës, përballë krimit të organizuar dhe trafikeve të ndryshme që kanë marrë shtrirje në këtë periudhë.

Vallë këto struktura deri tani nuk i kanë pasur mundësitë të godasin strukturat e krimit të organizuar që veprojnë në Kosovë?! Nuk është pak, për të dyshuar në efikasitetin e tyre, për të garantuar një mjedis të brendshëm sigurie stabël. Atëherë, kush do ta plotësonte më mirë këtë boshllëk psikologjik të sigurisë në lidhjet e partneritetit dhe të mirëkuptimit, brenda kuadrit ligjor dhe institucional të pushtetit në Kosovë?

Ndoshta është një pyetje që shumkush e ka kaluar me lehtësi. Shqiptarët në elementët e tyre shtetformues e kanë të nevojshme Ministrinë e Mbrojtjes dhe ushtrinë e tyre brenda standardeve demokratike të një shoqërie në zhvillim, për të mos mbetur pre e inferioritetit institucional dhe të kërkojnë pambarimisht atë që u mungon.

TMK-strukturë e atrofizuar

Përgjegjësinë në fushën e sigurisë do ta kërkojmë edhe në planin e jashtëm, në kushtet kur në Kosovë, nuk ekziston mundësia e kontributit të strukturave ushtarake të TMK-së, për të forcuar elementët e sigurisë dhe që gradualisht të rrisin pavarësinë e tyre në këtë mision. Në këto shtatë vjet është bërë shumë pak në këtë drejtim.

Resurset e kufizuara dhe mefshtësia në rritjen e kompetencave për të trajnuar personelin, për përzgjedhjen dhe kualifikimin e tyre në vende të tjera, mungesa e perspektivës për struktura të reja të standardeve perëndimore dhe të logjistikës, e kanë kthyer strukturën ushtarake të TMK-së, thjesht në një strukturë të gatshme për emergjencën civile. Sa kohë do të duhet të mbizotërojë kjo situatë për “një shtet të ri të standardeve evropiane”?

Pavarësisht këtyre trajtimeve, që shprehin realitetin në Kosovë, roli i strukturave të KFOR-it për sigurinë e jashtme të saj mbetet thelbësor. Ky element veprues, mbetet përvoja më e mirë për strukturat vendase që ato të kthehen në një strukturë nën kontrollin civil demokratik, kundër mendimit se siguria në Kosovë për jetë e mot, do të jetë në duart e ndërkombëtarëve.

Reforma institucionale në Kosovë në fushën e sigurisë kombëtare, ka pasur një pikënisje pozitive, e cila është mbështetur nga pranimi i një strukture me natyrë perëndimore, që e ka të nevojshme të zhvillohet akoma më tej. Themi pikënisje, sepse pas shtatë vitësh nuk kemi parë gjë tjetër, veçse spastrimin e radhëve të tyre nga ish- luftëtarët e UÇK-së.

Përvoja ka treguar se personeli ushtarak në Kosovë ka aftësi për të menaxhuar ngritjen dhe funksionimin normal të elementëve të sigurisë, si një nga shtyllat kryesore të shtetit të ardhshëm demokratik. TMK-ja, e dalë nga ish - strukturat e UÇK-së, sot për sot nuk mund të konsiderohen si struktura të mirëfillta ushtarake.

Ajo ka përgjegjësi të kufizuar, të zhvilluar vetëm në fushën e emergjencës. Përbëhet nga një numër i vogël efektivash, të privuara nga e drejta e armatimit dhe e përgatitjes në teknikë më të zhvilluar luftarake. Personeli drejtues në këtë strukturë, është një përzierje e përzgjedhjes midis kontigjenteve të shkollës sllave dhe atyre të dalë nga lufta, midis të cilëve, sot, për arsye profesionale zhvillohet një rivalitet i brendshëm me pasoja.

Në këto kushte, TMK-ja, nuk mund të përfshihet brenda përgjegjësisë së një force ushtarake e karakterit kombëtar dhe t’u shërbejë interesave të sigurisë së vendit.

Xhelozitë në marrëdhëniet e TMK-së me FA të RSH

Në fushën e sigurisë kombëtare, në kushtet e tendencave për një integrim shpirtëror dhe kombëtar në të gjitha fushat, vërehet një xhelozitë dhe sterilitet, i shprehur nga faktori ndërkombëtar, për zhvillimin e mundshëm të marrëdhënieve të strukturave të TMK-së me strukturat ushtarake të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Një izolim i këtij lloji nuk ka vlera, sepse sido që të ndodhë ose dhe të interpretohet në fushën e justifikimit apo të një qëndrimi fanatik, përballë kërkesave të rezolutës 1244, nuk mund të shmanget fakti, që këto struktura janë shqiptare dhe ato e kanë të ligjshme të bashkëpunojnë me njera - tjetrën në interes të rritjes së elementëve të sigurisë në rajon.

Kjo gjendje pasqyrohet sot në Kosovë edhe në strukturat e tjera të emergjencës, të cilat janë të përqendruara në dorë të faktorit ndërkombëtar. Ky qëndrim përkundër realitetit, nuk ka kurajo të pranojë ekzistencën e dy ushtrive shqiptare në rajon, dhe për këtë arsye nuk krijon hapësira të vlefshme dobiprurëse, për më shumë garanci në rrugën e institucionalizimit të vlerave shtetformuese në Kosovë.

Nuk mund të besohet se faktori ndërkombëtar nuk vlerëson faktin, që synimi do të mbetet gjithmonë drejt përfshirjes dhe në kërkim të elementëve të munguar institucionalë dhe shpirtërorë të karakterit kombëtar.

Por ky është realiteti që vepron në hapësirën shqiptare dhe jo gjithmonë për hatër të principeve, shpesh të dështuara, do të ecet patjetër kundër rrymës. Një Kosovë e pavarur e sovrane, me një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të sigurisë, do t'i shërbente jo vetëm stabilitetit në vend, por edhe atij në rajon. Prania e strukturave ushtarake ndërkombëtare, janë njera anë e stabilitetit, por ai duhet të mbështetet fort nga fuqia kombëtare e mbrojtjes dhe e sigurisë, të cilat kanë vlerat e tyre të pashmangshme.

Në kuadrin e zgjidhjes së statusit të Kosovës ka ardhur koha e shndërrimit të TMK-së dhe strukturave të tjera të sigurisë në institucione të qëndrueshme demokratike, të cilat të kryejnë misionin e tyre, si çdo forcë tjetër e armatosur në rajon. Një zhvillim i tillë, do të ndikojë në qëndrimin dhe mentalitetin e faktorit politik serb, i cili duhet të kuptojë se e ardhmja e rajonit do të kërkojë bashkëjetesën, fqinjësinë dhe intergimin rajonal edhe në fushën e sigurisë.

Një këndvështrim i tillë në fushën e sigurisë kombëtare, duhet të bëhet pjesë e vlerësimit dhe qëndrimit të politikës shqiptare kudo, për të dhënë dhe për të përftuar vlerat maksimale në përqendrimin e tërë përpjekjeve shqiptare, për mbështetjen dhe plotësimin shkallë - shkallë të interesve tona kombëtare. Përherë mjedisi i sigurisë në trevat shqiptare do të kërkojë atë që i mungon.

Të rinjtë shqiptarë në Kosovë nuk e kanë të ndaluar të shërbejnë në TMK, përkundrejt pranimit dhe përgatitjes së tyre profesionale dhe në këtë rast, të mos ndiejnë shumë për kombin dhe çështjen kombëtare. Ata do ta duan në çdo kohë Flamurin, Himnin, Gjuhën dhe Kombin e tyre. Besueshmëria në popull mbi strukturën ushtarake lidhet me një psikologji të fortë, të cilën nuk mund ta shkulë dot asnjë funksionar i lartë ndërkombëtar, vetëm e vetëm se e do TMK-në “të pastër”, sipas modeleve kolaboracioniste moderne të kohës.

Mohimi i Ministrisë së Mbrojtjes në qeverinë e ardhshme të Kosovës “së pavarur” mbetet një nga ndërhyrjet më të rënda dhe më brutale, e cila nënçmon në të gjitha pikëpamjet sistemin e vlerave që përfaqsojmë si kombi më i vjetër në Evropë.

19. Stabiliteti i rrezikuar në rajonin ballkanik

Rreziku i hegjemonizmit serb. Dominimi për shumë kohë dhe rreziku i hegjemonizmit serb në rajon, ka qenë një nga shkaktarët kryesorë të fatkeqësive për shqiptarët dhe ka përbërë burimin kryesor të antagonizmave ndërnacionale në Ballkan. Në Kosovë, në sytë e të gjithë botës së qytetëruar, u thur dhe u zbatua një nga mashtrimet dhe krimet më të mëdha të kohës. Kosova kishte kohë që ishte kthyer në një “geto” politike, ku represioni për ta shkombëtarizuar bënte kërdinë.

Zëri i arsyes së popullit të saj të shumëvujtur ishte burgosur dhe masakruar për dekada me radhë. Askush nuk ishte në gjendje të shikonte përtej perdes së errët të nacionalizmit agresiv.

Strukturat e agjenturës serbe, të cilat funksionojnë edhe sot, mbartin brenda vetes shifra të pranishme në një strukturë me natyrë tmerruese, dëshmi e funksionimit paralel në Kosovë. Ky mbetet rreziku më i madh i lëkundjes së situatës së sigurisë së vendit dhe në rajon. Është një dëshmi e kohës që vetë strukturat e sigurisë ndërkombëtare në Kosovë sot e pranojnë me gjysmë zëri dhe ende nuk kanë se çfarë t'i bëjnë.

Në kushtet e këtij represioni terrorist, Kosova vuante e vuante, pa e ditur askush se ajo ishte vendi i paqes, lirisë dhe djepi i atdhetarisë shqiptare. Ajo nuk ishte dhe nuk është vendi i dhunës. Nëse do të duhej për të bërë bilancin e dhunës ndëretnike në Kosovë, këtë kushdo e di fort mirë se kush duhet të japë sot llogari. Këtë nuk ka për ta harruar populli lirisht shqiptar. Po këtë dikush tjetër e ka harruar sot, ose më së paku bën të paditurin. Politikanët, të cilët me kompleksin e inferioritetit e të diletantizmit që shprehin, që ende vazhdojnë t'u lëpihen dhe zgërdhihen turlisoj mafiozëve politikë e kriminelë, të cilët janë lëshuar për gjah mbi popullin në Kosovë dhe mbi kombin shqiptar, ende kanë pacipësinë të bëjnë hamendje nga më patologjikat për ngjarjet që i kanë kushtuar dhe po i kushtojnë jo pak Kosovës dhe Shqipërisë.

Janë këto ngjarje që e renditën popullin tonë në krah të fitimtarëve. Ato duhen parë si shfaqje e opinionit më të ndriçuar të vendit, një formë e manifestimit të ndërgjegjes së mbarë kombit, përballë mospërfilljes e dhunimit që u janë bërë të drejtave të shqiptarëve deri më sot. Nuk duhet harruar se historia përsëritet. Të kemi pavarësi në mendim e kurajo në përcaktimin e qëndrimeve, sidomos në gjykimin e klimës që po ndikon nën efektet e politikës botërore për çështjen shqiptare e për çështjet e bashkëveprimit e partneritetit me vendet e tjera, duke u dhënë dritë përmasave më të dimensionuara, për të mos lejuar "të fuqishmit" e kësaj bote të marrin në dorë me përtesë problemet tona e t'i trajtojnë sipas interesit të tyre. Kjo do të bëjë që shqiptarët të mbeten përherë në pozitë të vështirë, duke i thënë gjërat me gjysmë zëri. Është kjo një arsye e fortë që siguria në Kosovë do të mbetet përherë e rrezikuar.

Tendenca e denigrimit të vlerave të UÇK-së

Për popullin shqiptar, lindja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që një rezultante e përpjekjeve shumëvjeçare për vendosjen e drejtësisë dhe në kërkim të lirisë. Ajo ishte pika kulmore e organizimit gjithëpopullor. Gjakosjes për të hequr nga qafa zgjedhën serbe, gjatë të cilës ranë mbi 2.700 bij e bija të Kosovës, iu zu rruga kur në lojë u fut politika. Degradimi i vlerave të luftës çlirimtare në një "konflikt civil brendajugosllav" ishte mosmirënjohja më e thellë ndaj sakrificës njerëzore të popullit shqiptar. Pala serbe e refuzoi nënshkrimin në Rambuje dhe botës demokratike iu imponua gjuha e forcës, e cila e gjunjëzoi shtetin separatist serb. Përse përvojat kur i arrijnë të tjerët na pëlqejnë t'i ngremë në art dhe kur janë tonat nuk na hyjnë në sy? Kompromisi politik sollti rezolutën 1244, e cila ende ruan integritetin territorial dhe sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën. Vallë për këtë luftuan shqiptarët?

Pavarësisht motivimit politik të faktorit ndërkombëtar, pa frikë këtë moment kthese do ta quajmë fillimin e rënies së aspiratës së popullit shqiptar në Kosovë. Kush e pranoi këtë në këto shtatë vite të protektoratit ndërkombëtar? Këtë e pranoi populli shqiptar me besim e shpresë se një ditë do ta shikonte veten të lirë dhe të rreshtuar me dinjitet në radhën e popujve të qytetëruar të Evropës. Por koha vërtetoi të kundërtën. Prej 10 qershorit të vitit 1999, UÇK-ja dhe pasardhësja e saj TMK, iu nënshtrua në vazhdimësi dobësimit të pamëshirshëm e të qëllimshëm. Në palën shqiptare u pranua dhe ndodhi çmilitarizimi, si një akt i rëndë që mund t'i bëhet një ushtrie. Nuk ka ndodhur kjo me shtetin e Serbisë dhe strukturat e tij ushtarake.

Nuk ka arsye të aludohet, por t'i referohemi realitetit që mbizotëron në terren, atje ku gjithçka nuk shkon sahat sipas "politikave të mëdha". Le të vazhdojmë më tej. Goditje të njëpasnjëshme pasuan pas çmilitarizimit: burgosjet e komandantëve dhe ushtarëve të shquar të UÇK-së; dënimet ekstreme të njerëzve me reputacion të gjerë në Kosovë; mbajtja e ish-luftëtarëve të UÇK-së në burgje pa asnjë shkak të ndëshkimit të tyre; bastisje dhe poshtërime nga më të padurueshmet, deri mbi vendbanimin e familjes Jasharaj në Drenicë, spastrimet sistematike

të radhëve të TMK-së nga prania e ish- luftëtarëve, degjenerimi i saj në një forcë të emergjencës civile në Kosovë.

TMK në Kosovë e sheh veten jashtë realitetit të sigurisë

Vetë eprorët e TMK-së sot janë përgjegjësit për dobësimin gradual të saj. Është një veprim i pamenduar duke injoruar psikologjinë popullore të pasluftës. Gabim i cili pa dashje sot mund të sjellë në skenë një UÇK të re, e cila nuk është çudi të pranohet se tashmë ka lindur. Cilët janë aktivistët e lëvizjes “Vetëvendosje” në Kosovë? Pa dashur të mbjellim pasiguri, shprehim një të vërtetë, e cila po ndihmohet pa dashur nga vetë politikat e papranueshme që po ndiqen në Kosovë. Krijimi i TMK-së, standardizimi i numrit të personelit të saj, çarmatosja dhe lënia e një numri armësh të lehta në nivel qesharak, kontrolli javor (Inventarizimi i këtij “armatimi”) i tyre nga strukturat e KFOR-it, pajisja me simbole, futja e sistemit të gradave ushtarake, organizimi në katër “komanda” forcash dhe rezultati: një forcë e emergjencës civile në Kosovë, është një veprim që nuk kërkon komente. Shumëkush tani në Kosovë e ka të qartë se TMK-ja nuk do të bëhet kurrë ushtri. Kosovën e mbron NATO dhe OKB (më pas BE). Vallë në analizën e elementëve të sigurisë në Kosovë, duhet pranuar se po ndiqet rruga më e mirë? Reagimi popullor nuk flet për këtë.

Kompromisi i pranuar me Serbinë, rezultat i zhvillimit të disa seancave të bisedimeve dypalëshe nën kujdesjen e faktorit ndërkombëtar, më në fund e dha rezultatin e pritshëm. Kjo situatë politike me mbingarkesa nacionale do t'i kushtojë shumë shtrenjtë Kosovës dhe rajonit ballkanik. Askush nuk e dëshiron këtë, por në analizën e realitetit për një çështje kaq të rëndësishme nuk mund të ekzistojnë dy të vërteta ajo është vetëm një. Kompromisi po i vendos Kosovës kufij të brendshëm, decentralizimi po krijon entitetin serb brenda saj, më të fuqishëm se më parë dhe të institucionalizuar nën dirigjimin e Beogradit. Decentralizimi e ka rrezikuar seriozisht veriun dhe lindjen e Kosovës dhe kjo nuk është pak për të mos rënë në sy.

E gjithë kjo situatë komplekse ndodh në Kosovë nën vëzhgimin dhe praninë e strukturave ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë. Megjithatë, situata zhvillohet edhe më tej. TMK-së dhe SHPK-së i është mohuar prania dhe pozicionimi në veri të Kosovës, nën pretendimin e reagimit të palës serbe, sikurse edhe në zonën e Dardanës në lindje të Kosovës. Kush i mbron shqiptarët në këto hapësira në kushtet e kompromisit politik? Pse shqiptarët ndihen aq të rrezikuar sa po braktisin vendbanimet e tyre në këto zona. Kush do t'i rikthejë në Mitrovicën Veriore mbi 11.800 shqiptarë të dëbuar? Pse ish- komandanti i TMK-së, Çeku, sot kryeministër nuk shkel dot në Mitrovicën veriore dhe Koshtunica na paska të drejtë të vijë deri në zemër të Kosovës? Cilat janë arritjet e kompromisit politik të përfolur me aq bujë që do t'i japë zgjidhje çështjes së Kosovës? Mund të shtrohen edhe njëqind pyetje të tjera, por përgjigje mund të ketë vetëm një: Kosova mbetet e rrezikuar nga funksionimi i strukturave paralele serbe, dhe kjo nuk është pak.

Dëshirat spekulative se TMK-ja do të duhej bërë njëfarë ushtrie, vijnë vetëm nga qarqe joqeveritare, të cilët nuk kanë fuqi politike vendimmarrëse në Kosovë. Ato mbeten vetëm një testim i opinionit dhe asgjë më shumë. Sipas propozimeve mësohet se ushtria e Kosovës do të ketë vetëm 2.000 pjesëtarë (për të mos e “rrezikuar” rajonin, paçka se ushtria serbe ka sot mbi 70.000 efektiva të dislokuara në jug të saj!), të jetë me armatim të lehtë, nën kontroll të NATO-s, e operacionalizuar vetëm në vitet 2011 dhe 2012, dhe pa kurrfarë të drejte në çështjet e sigurisë së brendshme. Në rast të një situatë krize në Kosovë, kjo “ushtri” duhet të bëjë sehir, dhe vetëm kaq. Për më keq, kjo "ushtri", gjithnjë sipas këtyre propozimeve, duhet të jetë vetëm profesioniste dhe jo vullnetare, pra jo e tillë që të mund të rekrutojë ushtarë të rinj, të zhvillohet e të forcohet si çdo ushtri tjetër e botës.

Situata matanë kufirit verior

Jo rastësisht Serbia po armatohet, ajo po e mban ushtrinë në këmbë, të gatshme dhe po i sofistikon çdo ditë armatimin dhe pajisjet e saj. Në mesin e vitit 2001, në Serbi u paralajmërua ndërtimi i bazës së madhe ushtarake në fshatin Boroc, 7 km larg magjistrales A-10, si dhe i 30 bazave të tjera rreth kufirit me Kosovën, secila e paracaktuar për stacionimin dhe mbështetjen taktike të nënrepartëve ushtarake. Nuk është parë e dëgjuar asnjëherë në opinionin e gjerë ndërkombëtar që të kërkohet me këmbëngulje e paralajmërimi një militarizim i skajshëm në jug të Serbisë.

Sipas një marrëveshjeje të ish- kryeministrit të Serbisë, Zoran Gjingjiç me ish- ministrin e Mbrojtjes së Rusisë, Serbia do t'i dërgonte qindra tanke T-84 për t'i riaftësuar dhe sofistikuar në Rusi. Serbia ka porositur 69.200 veshje ushtarake antiplumb dhe 74.000 helmata, me vlerë prej 296 milionë euro. Të dyja këto pajisje janë të destinuar për trupat e këmbësorisë që të rrisin qëndrueshmërinë dhe depërtueshmërinë e tyre. Përveç kësaj, aktualisht një sasi të konsiderueshme e armëve automatike M-70, (version jugosllav i kalashnikovit), po zëvendësohen me tipin M-21, i cili disponon edhe dylbinë optike, duke e rritur efikasitetin e kësaj arme në masën 34,3%. Sipas raportit të fundit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, buxheti vjetor serb për ushtrinë është 560 milionë euro, ndërsa buxheti vjetor i TMK-së është 15 milionë euro(!).

Në anën tjetër, gjatë viteve të fundit Shqipëria ka shkatërruar 1.600.000 mina tokësore; 144.000 armë të lehta; 43.000 tonelata me municion dhe mbi 511 tanke dhe automjete të blinduara. Shqipëria duke qenë korrekte me marrëveshjet e firmosura në kuadër të PFP dhe të Armëkontrollit, vazhdon të përmbushë edhe sot detyrimet e saj. Pra rajoni ballkanik, diku demilitarizohet e diku tejmarmatohet për luftë. Kjo nuk është pak për të mos rënë në sy.

Çfarë bën Serbia sot në kufirin me Kosovën

Afrimi i forcave të frekëta të ushtrisë serbe, njësisive “komando” të saj në Kosovën Lindore (Lugina e Preshevës), efektivave të xhandarmërisë serbe dhe armatimeve të rënda, në gjysmën e tetorit të këtij viti, përqëndrimi i tyre përreth kufirit me Kosovën, përkohë me deklaratat e zyrtarëve të lartë serbë, se ne jemi të gatshëm për t'u futur në Kosovë, “nëse zhvillohet situata atje”. Për këtë ata deklarojnë se kanë të gatshëm 100.000 ushtarë serbë të armatosur me armatimet më bashkëkohore. Këto deklarata të frikshme përforcojnë dyshimet se Kosova mund të rrezikohet nga një veprim “blitz” prej ushtrisë serbe. Vallë do të ndodhë kjo?

Bazuar në përvojën e hidhur që kanë shqiptarët me strukturat militare serbe dhe egërsinë e tyre antishqiptare, situatat mund të zhvillohen në një kohë të shkurtër, duke pasur mbështetjen e strukturave paramilitare, të cilat funksionojnë si: “Srpski Oslobodilacki Antitroristički Pokret” (“Lëvizja Çlirimtare Antiterroriste Serbe”) dhe pjella e saj “Srpska Oslobodilačka Vojska Kosova” (“Ushtria Çlirimtare Serbe e Kosovës”), sipas skenarëve të përgatitura që më parë. Pavarësisht përgënjeshtimeve të UNMIK-ut në Kosovë, struktura të tilla paramilitare veprojnë në Mitrovicën veriore, dhe kjo e vërtetuar në gojën e funksionarëve serbë.

Përballë kësaj gjendjeje të rëndë me pasoja për sigurinë në rajon dhe tendencave të përkeqësimit të saj në rast të një konflikti të brendshëm në Kosovë, nuk ka se si të mbetet jashtë vëmendjes së faktorit ndërkombëtar, ajo çfarë përpiqet të bëjë shteti serb përreth kufijve të tij me Kosovën. Është fakt i pakundërshtueshëm se ushtria serbe pas disfatës së turpshme që pësoi në Kosovë, vazhdon të punojë intensivisht dhe pa u penguar nga askush për të mbajtur në këmbë një forcë ushtarake të karakterit sulmues e vrasës për të ndërhyrë në Kosovë.

Njësitë speciale serbe në kufi me Kosovën

Nuk ka se si të mbetet “sekret ushtarak” një veprimtari, e cila zhvillohet në mes të ditës dhe në sytë e opinionit shqiptar dhe atij serb. Kjo situatë nuk ka se si t'i shpëtojë syrit të faktorit ndërkombëtar dhe veçanërisht strukturave të KFOR-it në Kosovë. Në planin konkret: Brigada 63 parashutiste e ushtrisë serbe, në përbërje të Divizionit parashutist të Nishit, e cila mori një leksion

të mirë në Koshare nga veprimet e koordinuara në mes të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të artillerisë së Ushtrisë Shqiptare, është e destinuar për kryerjen e veprimeve speciale ajrore në thellësinë operativo-strategjike të kundërshtarit.

Një pjesë e personelit të kësaj brigade sot janë të pozicionuara në Luginën e Preshevës, në gjysmën e dytë të tetorit të këtij viti. (në vigjilje të referendumit për Kushtetutën e Serbisë), në përforsim të xhandarmërisë serbe dhe policisë në këtë krahinë. Me siguri që ky ridislokim nuk është bërë për qëllime paqësore. Kjo njësi është e armatosur me pushkët mësymëse M-21 të kalibrit 5.56 mm, me automatik të kalibrave 7,62 mm, pushkë automatike afrikano-jugore të kalibrit 5,56 mm, me pushkët snajper të kalibrave 7,62 mm, 7,9 mm dhe 12,7 mm, pushkë-mitraloz dhe mitraloza të kalibrit 7,62 mm dhe me pistoleta të tipave të ndryshëm.

Nga armatimet e rënda kjo njësi i ka në dispozicion AGS-17 BGA 30 mm, bazuaka dhe raketa që hidhen nga krahu (Zolja M-80 64 mm, Osa M-79 90 mm, sistemin raketor kundërblind “Bumbar” 136 mm, minahedhësit M-69 82 mm dhe M-70 60 mm, si dhe topin malor B-1 76 mm, të gjitha këto të prodhimt serb, si dhe armatime të tjera prodhim i huaj, ku veçohet topi RPG-29 “Vampir”, kalibër 105.2 mm, i prodhimt rus. Këto njësi lëvizin në terren me ndihmën e xhipave të prodhimt serb dhe të huaj, si dhe me transportues të blinduar të tipit M-53/59 “Praga”. Kjo njësi, edhe pse në esencë është njësi e këmbësorisë, ajo mund të përdorë helikopterët Mi-8 dhe aeroplanët An-26.

Njësi të tilla janë të dislokuara matanë kufirit verior të Kosovës dhe ato janë një kërcënim i drejtpërdrejtë i sigurisë së saj. Qëndrimi kokëfortë i politikës dhe diplomacisë serbe e ka një bazë dhe ndoshta ekziston ëndrra serbe që edhe një herë shteti dhe ushtria e tyre të ballafaqohen me NATO-n dhe faktorin ndërkombëtar.

20. Kosova në prag të krizës politike

Politika zyrtare serbe ndodhet përpara faktit të humbjes së të gjitha pjesëve të saj, të cilat nuk ishte në gjendje t’i mbante. Së fundi kjo ndodhi me Malin e Zi dhe nuk ka pse të mos ndodhë në mënyrë juridike edhe me Kosovën. Në kushtet e gjunjëzimit përballë faktorit ndërkombëtar dhe opinionit të saj të brendshëm, nuk është që reagimet e saj në drejtime të tjera të jenë më të avancuara. Duke mos arritur të ndikonte në rezultatin e referendumit në Malin e Zi, politika serbe e ka kuptuar se nuk është në gjendje të ndikojë as në fatin e Kosovës dhe nuk ka shanse të përmbysë situatën në rajon.

Tashmë Serbia nuk do të ketë më dalje në Adritik dhe kjo është një humbje e madhe, për të cilën duhet të paguajë për mënyrën sesi ajo kishte zgjedhur rrugën e saj të historisë. Çdo tentativë e dhunshme me diktat për praninë e saj në hapësirën detare, do të jetë një shteg i hapur konflikti, që na kujton përplasjet midis Ruisë dhe Ukrainës për flotën e Krimësë në Detin e Zi. Ngjarjet pas referendumit kanë hamendësuar edhe faktin se si do të reagohet ndaj shkëputjes juridike të Kosovës nga Serbia. Kjo është vetëm ana e jashtme e shikimit të zhvillimeve në hapësirën problematike të Ballkanit. Për politikën serbe nuk mund të kalojë lehtë një ngjarje e tillë.

Reagimet janë të ashpra në drejtim të Kosovës. Çfarë e nxiton përsëri Koshtunicën që t’i kërkojë Ahtisarit mospavarësimin e Kosovës?! Çfarë mendon se mund të ndikojë në qëndrimin ndërkombëtar ky politikan nacionalist, pasues i Miloshit? Shkëputja e republikës së re është një goditje në planin politik dhe psikologjik, dhe pasuesit e famëkeqes teori të “Serbisë së Madhe”, tashmë e ndiejnë se po humbasin shumë, deri përfundimisht. Ngjarjet janë të lidhura me qeverisjen e Koshtunicës dhe atij nuk i ka mbetur gjë tjetër që t’u tregojë bashkëkombasve të tij se sa “nacionalist” është.

Kjo ngjarje e karakterit historik paralajmëron se ndarja më e vështirë për Beogradin do të jetë ajo me Kosovën. Humbja e saj në një rast të pavarësismit, do të vendoste nën presion të madh qeverinë aktuale serbe, krahun politik radikal dhe nacionalistin ekstremist, Koshtunica. Kosova nuk ka më nevojë për Serbinë. Kurrë më jo. Është kuptuar tashmë se Serbia ka qenë ajo që ka pasur dhe ka nevojë për Kosovën. Por dihet se Kosova është shqiptare dhe aspak serbe.

U mbars mali dhe polli një mi

Pavarësisht “premtimeve” që mund të ketë marrë politika ndërkombëtare nga segmente të caktuara “moderatore” të politikës serbe, duhet të kuptojë dhe vlerësojë maksimalisht dominimin e psikologjisë me frymë nacionaliste që mbizotëron sot në Serbi. Ky është një realitet, ndaj të cilit është punuar shumë pak për ta ndryshuar. Kjo është një e vërtetë që duhet pranuar. Shpallja e propozimit për statusin e ardhshëm të Kosovës nga Ahtisari në datën 22 janar, konsiderohet një veprim parashikues që mendohet se mund të japë rezultat në kompleksitetin e ngjarjeve që mund të pasojnë pas kësaj. Pse zgjedhjet në Serbi lidhen me të ardhmen e Kosovës?

Situata që na serviret sot, pas deklarimeve të bujshme të zonjës Pak, se “...Kosovës do t’i jepet pavarësi e kushtëzuar”, na bind përfundimisht për të besuar atë që pritej. Për shtatë vite u mbars mali dhe polli më në fund një mi. Ky konstatim duhet të na shkundë, për vetë faktin se, duke i mbërthyer problemet tona për një kohë të gjatë në pika të vdekura, ripërtërihet e merr jetë fara e armiqësisë dhe e dominimit të shovinizmit, që e shfrytëzon mirë pacifizmin dhe tolerancën tonë.

Këtu fillon paradoksi që shfaq natyrën e qëndrimit ndërkombëtar. Kushdo që mund të besojë në një “mrekulli” serbe vazhdon të gënjejë veten. Dhe për këtë konstatim të vjen keq kur me idenë e tij janë molepsur edhe emra të njohur të politikës evropiane. Kjo nuk është një rastësi. Serbia, si një shtet humbës, duhet të kërkojë falje ndërkombëtarisht për fatkeqësitë që i ka shkaktuar Ballkanit në një dekadë. Çfarë tjetër pritet prej saj?!

Kosova duhet të çlirohet nga kriza politike

Politika në Kosovë është në rrugën e një gabimi fatal. Nënveftësimi i sakrificës madhore të djemve idealistë të popullit shqiptar, braktisja e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, nënshtrimi dhe lëshimet pa princip në dëm të çështjes kombëtare, konfondimi i revoltës popullore me dhunën dhe luftën, të përfaqësuara këto me qëndrimet e dyshimta të kujtdo që është ulur sot në karriget e pushtetit, qofshin këta politikanë apo ish- luftëtarë të të gjitha ngjyrave, tregojnë për krizën e rëndë sociale e politike që mbretëron në hapësirën shqiptare në Kosovë. Këto konstatime nuk janë nxitje për diskretitim, por janë një arsye më shumë, që rinia dhe njerëzit në Kosovë të dinë të ndajnë “sharpin nga sheqeri”, të shfaqin me kurajo ndjenjën se si ata dinë ta duan vendin e tyre, të mos lejojnë askënd të luajë me idealet e luftëtarëve të lirisë, të duan shqiptarizmin njësoj si fëmijët e tyre, për të mos lejuar një rikolonizim e ricopëtim tjetër të trojeve shqiptare, por të marrin me mençuri e guxim në dorë vetë fatet e Kosovës dhe të së ardhmes së saj. Forcimi i ndjenjave kombëtare, duke respektuar gjakun e të rënëve dhe sakrificat e pjesëmarrësve në luftën çlirimtare, nuk mund të ngatërrohet me asgjë tjetër që nuk është shqiptare.

Politikën duhet ta komandojnë interesat kombëtare e jo emocionet e rastit. Atë duhet ta udhëheqë arsyeja dhe jo instikti. Politika e vërtetë është si një kalkulim matematikor i pikave tangente të rrymave të ujit me akullin mbi të. Dhe akulli politik sot në Kosovë është i pranishëm, goftë edhe në gojën e zonjës Pack.

Këtë thënie duhet ta besojë edhe Kryeministri i Kosovës, i cili ka bërë disa ecejake në vende të ndryshme të Evropës. Mirë bën që lëviz. Së fundi ka deklaruar se “...Kurrë nuk mendoj se Kosova mund të mos jetë e pavarur apo mund të mos ketë ulëse në selinë e Kombeve të Bashkuara, kështu që qëllimi ynë është që Kosova të jetë vend normal si të gjitha vendet tjera, që t’i ketë të gjitha ato elemente, të gjitha të drejtat, të gjitha kompetencat që i ka çdo vend

demokratik në botë, kështu që ne presim që Kosova të jetë vend i pavarur dhe po presim që Kosova të ketë mes tjerash ulësen në Kombet e Bashkuara”.

Kjo është bindja e tij, por popullit nuk i intereson vetëm kjo, pasi e ka të qartë se sa fuqi ka zoti Çeku në Kosovë. “Jemi duke ndërtuar shtetin, - thotë Çeku. Shteti në ndërtim ka mangësi, ne kemi mangësi përfaqësimit jashtë. Dua të them nuk kemi përfaqësi, ambasada, nëpër botë, por e kemi të vërtetën në anën tonë, kemi argumentet në anën tonë. Të gjithë i kuptojnë. Një kryeministër që nuk është i lirë të shkelë tërë hapësirën gjeopolitike të vendit që “drejton”, kjo nuk do komente. Ku qëndron bindja e tij dhe e klasës politike shqiptare për pavarësinë e Kosovës?!

Politika dhe diplomacia nuk janë “pronë”

T’i përkushtohesh dhe të mbrosh sot çështjen kombëtare shqiptare, nuk ka të bëjë vetëm me faktin që të deklaroresh se je shqiptar patriot dhe e do kombin dhe vendin tënd. Për njerëzit e thjeshtë dhe ata me përgjegjësi në drejtimin e politikës shqiptare kjo nuk mjafton. Ajo që është më e rëndësishme, është fakti se sa aktiv je në jetën e përditshme dhe në politikë për t’i shërbyer vendit tënd, sa je në gjendje të konceptosh se përmbledhja e masave dhe veprimtarive të karakterit kombëtar, sot janë një proces i gjerë e i vështirë, që kërkojnë përkushtim, kthjelltësi, urtësi por dhe kurajo e guxim.

Ky qëndrim lidhet me mbrojtjen e interesave të shqiptarëve, të cilët historia e tyre i ka parë të shpërblyer me “syrin e njerks”. Kjo nuk mund të realizohet pa pjesëmarrjen dhe kontributin e klasës politike në vend. Interesat tona kombëtare janë një hapësirë e gjerë veprimi dhe ato shtrihen kudo ku jetojnë shqiptarë në trojet e tyre etnike, por dhe më gjerë. Nuk besojmë se ky konstatim do të merret lehtë nga ata njerëz aktivë në politikë, që sot mendojnë se qëndrimet politike dhe diplomacia në veprim janë pronë e një kategorie njerëzish, të cilët shpesh me qëndrimet e tyre nuk kuptohet se çfarë bëjnë dhe për kë e bëjnë.

Qëndrimet politike ndaj trajtimit të interesave kombëtare janë koncentrat i analizës së thellë të situatave dhe të realitetit shqiptar në raport me zhvillimet gjeopolitike në rajon e më gjerë, për të ardhur në një pikë takimi, se çfarë është më e rëndësishme e çfarë duhet bërë, me motivin “një komb, një qëndrim”. E bëjmë këtë lidhje, në raport me rrjedhën e zgjidhjeve që kërkohen, në këtë vit të ngjeshur me ngjarje politike, të cilat synojnë raftësimin e kombit shqiptar në rrugën e tij.

Sot prioritet i prioriteteve në çështjen kombëtare mbetet zgjidhja e problemit të Kosovës. Janë thënë e stërrthënë fjali e deklarata, janë bërë udhëtime e ecejake të shumta, dhe përsëri është kuptuar se përballë turravrapit të politikës dhe diplomacisë serbe, faktori politik shqiptar ndihet inferior. Duke mos u shkëputur nga problemi i Kosovës, nuk mund të mos marrim në analizë qëndrimin zyrtar të ministrit të Jashtëm të Qeverisë Shqiptare, zotit Mustafaj, për çështjen e statusit të Kosovës.

Deklarimi i tij kohë më parë për “një pavarësi të kushtëzuar”, atëherë habiti opinionin shqiptar në të gjithë hapësirën kompakte etnike, dhe pse jo, këto deklarata shkaktuan një situatë të pakëndshme, jo vetëm për një ministër të ri, por për vetë reputacionin e Qeverisë dhe të shtetit shqiptar tek popullsia shqiptare në Kosovë. E njëjta situatë u përsërit më vonë, kur zoti Mustafaj deklaroi në rastin konkret, se shteti shqiptar nuk do të mbante përgjegjësi se çdo të ndodhte në rajon, në rast të një reagimi të mundshëm të shqiptarëve në Kosovë.

Nuk marrim përsipër të mësojmë zotin Mustafaj se si duhet të drejtojë dhe udhëheqë diplomacinë shqiptare, por nuk na duket me vend të gjykojmë se “nxitimi” i tij në një problem kaq serioz, që lidhet me vlerësimin racional e të kujdesshëm të interesave të popullit shqiptar, paska pasur të vërtetën brenda. Ku e dinte që atëherë këtë zoti Mustafaj?! Lëvizjet e tij të mëvonshme, vizita në Moskë dhe informimi reciprok i zv.kryeministrit të Kosovës për bisedimet, bëjnë që diplomacia shqiptare “të ndihet aktive”, por deri këtu kjo nuk mjafton. Por çështja duhet parë më tej se sa kaq.

Qëndrimi “plastelinë” për të ardhmen e Kosovës

Sot nuk mund të shmanget një nga detyrimet kryesore të politikës dhe diplomacisë shqiptare, e cila duhet të pranojë se përgjegjësia e saj në vlerësimin e situatës politike në Kosovë është pjesë e përgjegjësive institucionale me karakter kombëtar, dhe këtu nuk ka vend për të marrë leje ose për të pyetur se çfarë duhet bërë. Askush nuk duhet të bëhet merak se “i ha racionin” klasës politike në Kosovë.

Thirrja me urgjencë në Bruksel e zotit Mustafaj nga shefi i diplomacisë së BE-së, Javier Solana, për “lajthitjen” e tij, nuk kishte të bënte me atë, se ishte apo nuk ishte dakord zoti Mustafaj me deklaratimet e tij. JO. Edhe shpjegimet e sikletshme të ministrit për opinionin shqiptar nuk ishin bindëse se “atë e kishin keqkuptuar” brenda dhe jashtë Shqipërisë. Përsëri, JO. Ministri ynë i Jashtëm tha një të vërtetë, e cila sot mbetet evidente përballë deklaratimeve “plastelinë” të politikës ndërkombëtare mbi të ardhmen e Kosovës.

Përballë kësaj situatë, diplomacia shqiptare duhet të përmbushë detyrimet e veta politike, duke justifikuar angazhimin aktiv, pse jo, duke sakrifikuar diçka me kurajo nga mbështetja dhe kontributi që jep komuniteti ndërkombëtar dhe Evropa në mbështetje të saj. Çështja e Kosovës mbetet ende një konflikt politik i hapur, i cili duhet të zërthehet mbi përmbajtjen e tij në disa aspekte të rëndësishme. Cila mund të jetë kontradikta e brendshme që dominon sot në hapësirat shqiptare.

Politika shqiptare është e përçarë dhe e mbërthyer në interesat e saj utilitare, duke përfaqësuar një masë amorge, pa kockë e pa bosht. Është kuptuar se patriotizmit të popullit shqiptar në Kosovë dhe kudo tjetër, klasa politike shqiptare nuk po i përgjigjet me të njëjtin sens. Në kushtet e rezultateve të bisedimeve me palën serbe dhe mungesën e transparencës ndaj opinionit shqiptar, veçanërisht në Kosovë, është parë se klasa politike ka rënë përtokë përballë situatës në sulm të politikës dhe diplomacisë serbe.

Strategjia politike nuk ka të bëjë me “patriotin”

Politikanët shqiptarë vazhdojnë të bëjnë “patriotin” duke mashtruar veten dhe të tjerët. Çfarë nuk kanë arritur të kuptojnë ata?

Patriotizmin secili e shpreh me përgjegjësitë politike që ka përballë kombit të tij. Ai kërkon unitet mendimi dhe veprimi, qëndrim të unifikuar. Nuk shkon që opozita në kohën që nuk është përcaktuar e ardhmja e Kosovës kërkon sherre midis shqiptarësh, dhe dikush tjetër kërkon ndarjen apo ruajtjen e statukuosë në Maqedoni. Nuk shkon fare që në prag të një evenimenti historik në R.SH. politika shqiptare nuk ka zgjidhur akoma meritë e vjetra. Klasa politike nuk ecën me vrullin patriotik të popullit shqiptar të Kosovës dhe Luginës së Vardarit, e pse jo edhe të popullit në shtetin administrativ. Ky vrull patriotik nuk është shoqëruar me qartësimin që duhet të bëjë politika për detyrat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata që e presin popullin në këto hapësira, në rrugën e historisë së tij.

Në këtë aspekt, mungon një strategji politike e përbashkët që duhet t’i ofrohet komunitetit ndërkombëtar, si alternativa më e mirë, ku t’i bëhet e qartë se në raste të tjera, vërtet siç thotë zoti Mustafaj, shteti shqiptar “mund të mos mbajë përgjegjësi”, pra e nënkuptuar, situata mund të servirë pasoja të pakëndshme, mund të ketë dalje të situatës nga kontrolli, pra një reaksion zinxhir të ngjarjeve, të cilat mund të pasojnë njera – tjetrën jashtë vullnetit të politikës në hapësirat shqiptare. Ngjarjet e marsit 2004 nuk janë larg në kohë dhe në rrjedhojat e tyre.

Apeli i fuqishëm që dha vullneti popullor, nuk mund të anashkalohet e, më keq akoma, të kalojë në harresë. Në një shtet ku të drejtat nuk respektohen, konflikti mbetet i hapur. Këtu nuk ka rëndësi se çfarë emri mund të ketë një marrëveshje për llojin e pavarësisë që do të gëzojë Kosova. E rëndësishme është se sa ajo afron zgjidhje për kapërcimin e kontradiktave themelore që

dominojnë popujt në rajon, ku vlerësimi maksimalisht i çështjeve të pazgjidhura etnike mbetet problemi më delikat dhe më thelbësor.

“Diplomaci” për diplomaci

Për t’u paraprirë ngjarjeve dhe pasojave të tyre, është e nevojshme që të afrohet një alternativë funksionale, e cila të dalë nga kuadri politik i Kosovës, por që në fakt, rekomandon zgjidhjen më të mirë të problemit të Kosovës dhe heq përfundimisht dilemën tragjike të politikës serbe në rajon. Kjo nuk përkon me prononcimet e Surroit, Sejdiut, Besnikut, të Ahmetit e Xhaferrit, e as me ato të disa politikanëve të tjerë në R.SH, të cilët nxitohen e flasin pa përgjegjësi. Nuk mund të përtypet koncepti i ministrit të Jashtëm sot se “Kosova është multietnike”, kur dihet fare mirë se sa për qind zënë serbët sot dhe pakicat e tjera. Pse nuk ka një koncept bazë që do t’u mbyllë shtigjet edhe abuzimeve të tjera politike?

Pra, një qëndrim i unifikuar në politikën shqiptare, bën që komuniteti ndërkombëtar të ulet seriozisht në Kosovë, në Serbi, në Mal të Zi dhe në Maqedoni dhe të paracaktojë zgjidhje afatgjata e të përhershme, në mënyrë që të vendoset paqja në rajon. Pra sot jemi vënë të gjithë përpara faktit: “Pavarësi e kushtëzuar, apo autonomi e zgjeruar”, pavarësisht se kush e kërkon, janë e njëjta gjë, dhe kjo bën që popullsia shqiptare në Kosovë të ndihet e lënë në mes të rrugës dhe e tradhtuar. Pse duhet lozur me ndjenjat e një populli, i cili ka dhënë maksimumin në qëndrimin paqësor të tij, në pritje të një vendimi që do ta angazhojë të shikojë jetën e tij? Mos vallë duhet bërë diplomaci për diplomaci, duke i dhënë rëndësi vetes, kur ende nuk kanë folur ata që e kanë në dorë të marrin vendim për të ardhmen e Kosovës?!

“Diplomacisë së madhe” i ka ikur koha

Mjaft politikanë shqiptarë ende vuajnë nga sindromi i së kaluarës dhe kanë dëshirë të bëjnë “diplomaci të madhe”. Politika shqiptare ende nuk e ka kuptuar (ose nuk do ta kuptojë) se qartësia në qëndrimet politike, jashtë interesave të mbrapshta e të kamufluara, duhet të funksionojë maksimalisht, pa favorizuar askënd, por me zgjidhjet përkatëse. Nuk na takon neve, shqiptarëve, të merremi me historinë e origjinës së Kosovës, të harxhojmë kohën për t’i mbushur mendjen vetes dhe Serbisë se Kosova është shqiptare dhe PIKË. Nuk na takon neve, shqiptarëve, të merremi me meritë e vjetra, të ndershmërisë apo të pandershmërisë në zgjedhjen e “kreat të qoshesë”. Këto sot nuk vlejné hiç.

Sot vlejné zgjidhjet e mençura që kapërcejné barriera të tilla historike, të mbetura në vlerat e tyre arkaike. Dhe të tilla ne shqiptarët kemi boll. Prandaj është i paarsyeshëm dhe shumë i dëmshëm qëndrimi i dyzuar në politikën shqiptare. Tirana zyrtare duhet të jetë vetë e bindur se, kur kërkohet pavarësia e Kosovës, të gjithë aksesoret e saj duhet të jenë funksionale për mbështetjen e kësaj veprimtarie në përmasat kombëtare. Nga deklaratimet e fundit të politikës zyrtare serbe mësohet se ajo e pranon pavarësinë e ekzekutivit kosovar, të gjyqësorit dhe elementëve të tjerë, por kërkon të ruajë sovranitetin dhe integritetin territorial mbi të, pra të drejtën juridike të “eksterritorialitetit”.

Duhej vlerësuar maksimalisht se referendumi së fundi në Serbi e tregoi edhe një herë hapur lëkurën e vjetër të politikës serbe. „Ku ishim, - thotë populli, - hiç gjëkund“, edhe kjo punë nuk na qenka gjë!! Çfarë tjetër mund të pritet nga politika dhe diplomacia serbe, vallë nuk e dinë këtë politikanët shqiptarë? Politika zyrtare në shtetin administrativ, duke e mbrojtur çështjen e pavarësisë së Kosovës, duhet të sakrifikojë nga qëndrimi i vet, në raport me faktorin ndërkombëtar, ashtu siç ka sakrifikuar inteligjencia dhe patriotët shqiptarë, të cilët kanë pranuar në heshtje, duke mos kërkuar bashkimin e Kosovës më Shqipërinë, por pavarësinë dhe sovranitetin e saj.

Tendenca për të bërë diplomaci “të madhe” për Grupin Negociator të Kosovës dhe personalitetet e politikës shqiptare, i bën ata që të nxitohen në deklaratimet e tyre për çështjen e

Kosovës. A e dinë këta njerëz se popullsia shqiptare në Kosovë, nëse i jepen ato të drejta që i takojnë, do të respektojnë pa mëdyshje kushtet që do t'i afrojnë faktori ndërkombëtar? Çfarë e detyron politikën shqiptare në qëndrimin zyrtar të pranojë një alternativë të nivelit të ulët, kur faktori ndërkombëtar vendimmarrës nuk ka folur për këtë problem? Ky qëndrim absurd ka të bëjë me preferenca personale, apo me shitje të interesave kombëtare për përfitime të pamërituara në karrierën politike.

Çfarë mund të ketë këtu për të mos kuptuar dhe për të bërë të paditurin? Vallë nuk dëgjohen zërat që kërkojnë bashkimin kombëtar? Pse duhet të ndihet bosh politika shqiptare në një rast të tillë? Pra në këtë çështje nuk është e mjaftueshme të pranosh pavarësinë e Kosovës, por duhet të ketë një qëndrim të qartë dhe këmbëngulës në tërë hapësirën e veprimit që kërkohet për një politikë të përgjegjshme që u del për zot fateve të kombit të vet.

Në këtë këndvështrim, pavarësia e padiskutueshme e Kosovës duhet të ishte pranuar më herët si opSION, duke krijuar të gjitha shanset politike për ta bërë atë hap pas hapi realitet. Opsioni i sotëm mbi të ardhmen e Kosovës duket ende i dyshimtë. Dhe kemi të drejtë ta themi këtë. Nëse mbahen këto qëndrime, atëherë përsëri duhet të pyesim: Si mund të bëhet Kosova e pavarur, duke mos ndryshuar vlerat e rezolutës 1244 të OKB-së, dhe duke e kaluar atë edhe për një periudhë tjetër nën protektoratin dhe kujdestarinë e BE-së?

“Një hyn e një del, një Kiço e një Vangjel”

Populli ynë ka një shprehje të tijën, të cilën kundër etikës sime do ta përdor edhe për lexuesin e gjerë. Kësaj i thonë, “një hyn e një del, një Kiço e një Vangjel”. Çfarë tjetër duhet të bëjë politika evropiane dhe ajo serbe në këto tre vite të ardhshme? Çfarë tjetër duhet të bëjë populli shqiptar në Kosovë në këto tre vite të ardhshme? Ku qëndron vështirësia e njohjes së një shteti të ri në Ballkan, kur rasti i Malit të Zi, sipas Solanës, “na qenka nja rast i veçantë”?! Ku qëndron e veçanta këtu midis malazezëve dhe shqiptarëve?! Kjo nuk është thjeshtë dëshirë shqiptarësh apo politikanësh, të cilëve mund t’u pëlqejë mendimi i tyre, vetëm e vetëm se e thonë ata. JO. Këtu kemi të bëjmë me një të drejtë si për të gjithë kombet dhe popujt e tjerë që kërkojnë të ndërtojnë jetën e tyre, pa diktat e racizëm, pa kolonizim, dhunë e grabitje.

Duhet kuptuar se veprimtaria e OKB-së në Kosovë, është përkohësisht funksionale si protektorat, pra ajo vetëm ka pezulluar përkohësisht autoritetin e Serbisë mbi Kosovën, dhe me këtë akt juridik, nominalisht “Kosova i takon Serbisë”. Lojra të tilla politike të paprincipita dhe deklarata me ekuivoke, përjashtojnë dashur pa dashur, tërësinë e masave që duhen për të argumentuar pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Në këtë nivel inekzistent ka rënë politika shqiptare sot. Për shqiptarët dhe serbët duhet të jetë e qartë se fitorja e pavarësisë për Kosovën, nuk ndihmon vetëm këtë të fundit, por ndikon në tërë hapësirat e tjera shqiptare dhe, njëkohësisht, i jep mundësi Serbisë dhe tërë rajonit të integrohet në proceset evropiane.

21. Kosova e meriton pavarësinë dhe sovranitetin e saj

Ngjarjet mitologjike të ardhura nga lashtësia, ndoshta nuk janë të vërteta, por filozofia që ato përfaqësojnë, në thelb, kanë të vërtetën e pamohueshme. Sot flitet për “thembrën e Akilit” dhe të gjithë besojnë se ishte Hektori ai që e vrau luftëtarin grek. Akili kishte pikën e tij të dobët, por këtë pikë nuk mund ta godiste dot Hektori me një shigjetë duke i dalë lehtësisht në shpinë. Çfarë ngjau me Akilin? Atë e vrau Apolloni, perëndia e sharë prej tij. Ishte pikërisht Apolloni që e drejtoi shigjetën e Hektorit në thembrën e Akilit. Përsëri duhet të pyesim: Kush e vrau në fakt Akilin?

Kush e gjunjëzoi Serbinë pas tri luftërave në Ballkan? Kush duhet ta gjunjëzojë Serbinë pas shtatë vitesh në pritje të ndryshimit të saj? Kush duhet ta mbajë drejt tash e politikës dhe kush duhet t'i japë asaj forcë që të shkojë në vendin e duhur? Ku është vendi dhe roli i politikës shqiptare në këtë situatë të ndërlikuar, por jo të palexueshme? Ndikimet e politikës së Tiranës zyrtare në qëndrimin e institucioneve shqiptare në Kosovë nuk mund të thuhet se mbeten jashtë realitetit që mbretëron atje. Jo rrallë në qëndrimet vetjake ka dhe rrëshqitje handikapi, që ngjallin habi dhe kureshtje në opinion.

Një problem më vete shkaktoi edhe deklarimi i Kryeministrit Shqiptar mbi mundësinë e destabilizimit në Ballkan. Njeriu i ekzekutivit shqiptar duhet ta vazhdonte më tej analizën e situatës. Ku është interesi që në rastin e shpalljes së statusit mund të ketë rrëmuja? Mos vallë kjo do t'i interesonte Serbisë dhe Greqisë në kohën e miratimit të statusit të Kosovës? Do të jemi akoma në janar të 2007-s dhe Kosova ende nuk e ka marrë statusin e saj. A mund të ketë një shpallje të njëanshme të pavarësisë një ditë pas përfundimit të zgjedhjeve në Serbi? Çfarë duhet të bëjë atëherë Serbia që do t'i ketë bërë këto zgjedhje?

Është një situatë që ka në brendinë e vet një skenar të rrezikshëm që po përgatitet të funksionojë, për të destabilizuar situatën e brendshme dhe për të provuar që shqiptarët nuk kanë aftësi shtetformuese. Deklarata e Kryeministrit mbetet e rrezikshme, jo bindëse dhe e mbarsur me një patriotizëm formal. Nga do t'i vijë destabilizimi Ballkanit, a mund të shpjegohet kjo në këtë situatë? Si dhe në çfarë mënyre mund t'i vijë rajonit destabilizimi?

Nëse mendohet se do t'i vijë nga Shqipëria, atëherë duhet pranuar se i bëhet një dëm shumë i madh çështjes kombëtare. Nëse do t'i vijë nga Serbia, atëherë duhet shpjeguar se si do të ndodhë kjo. Opinioni ka nevojë të dijë të vërtetën pa e bërë politikën çështje ekranesh dhe rrugësh. Nëse nënkuptohet për këtë situatë në Mitrovicën Veriore, atëherë duhet thënë hapur se këtu mund të veprojë patriotizmi shqiptar që nuk e dëshiron ndarjen e saj.

Por nëse nuk është kjo arsye, atëherë duhet thënë se destabilizimi mund të vijë nga veprimi i agresivitetit serb që synon të prishë ekuilibrin e brishtë që ekziston në rajon. Kjo mund të ngjasë në një situatë kur pakicat serbe mund të kërkojnë ndihmën dhe ndërhyrjen e Beogradit. Një kërkesë e tillë nuk është akuzë, përkundrazi duke e përshëndetur këtë qëndrim kërkohet edhe shpjegim. Në situatë të ngarkuara nuk është e udhës të krijohen tensione që mund të shkojnë shumë larg.

Ta shkulim “gozhdën e Nastadinit” serb

Çështja e statusit të Kosovës, që po shtyhet në mënyrë të pashpjegueshme, llastimi dhe krehja e bishtit që u bëhet vazhduesve të politikës së Millosheviçit nga strukturat evropiane, ka shkaktuar një situatë terrorizuese për shqiptarët në Kosovë dhe në veçanti për banorët në Mitrovicën Veriore, e cila sot mbetet “thembra e Akilit” në marrëdhëniet delikate që janë krijuar në rajon. Kjo situatë kërkon qëndrim të kthjellët dhe të vendosur nga faktori politik shqiptar në Kosovë.

Nuk ka më hapësirë për të menduar se qëndrimi i politikës dhe diplomacisë serbe do të ketë reagime ndryshe nga sa deri tani. Kokëfortësia e ushqyer nga ndjenjat nacionale e shovene, pavarësisht se sa dëm i bën vetë Serbisë, i bën dëm të madh çështjes shqiptare, duke e kthyer Mitrovicën në një “gozhdë” të ndryshkur të Nastadinit serb, duke e mbajtur peng çështjen e statusit të ardhshëm të Kosovës.

Nëse politika serbe deri tani është në prag të dhënies së një “shah-mati”, nga ana tjetër veprimi i mençur dhe gjakftohtë i politikës shqiptare duhet të dijë rrugëdaljet për të dalë në planin ofensiv, duke u mbështetur në vullnetin e faktorit politik ndërkombëtar dhe në vullnetin e shumicës së qytetarëve të Kosovës për vetëvendosje, për të garantuar stabilitetin e brishtë në rajon.

Dëshira serbe për ricopëtimin e Kosovës nuk do të funksionojë

Është mëse e qartë se qëllimi i Serbisë është që ta shkëpusë Mitrovicën Veriore deri në përmasat e një krahine të vogël autonome, duke i hapur rrugën certifikimit të komunave të tjera dhe duke bërë një ricopëtim të ri të Kosovës. Kjo mënyrë e veprimit deri tani e ka mbajtur dhe po e mban situatën të tensionuar, duke i dhënë ngarkesa të tepërta politike dhe në opinionin e thjeshtë. Në këto kushte politika shqiptare në Kosovë dhe veçanërisht qëndrimi në Parlament është orientuar ndaj kritikave të ashpra ndaj Grupit Negociator, duke e akuzuar atë për paaftësi dhe mungesë të transparencës në ciklin e bisedimeve me palën serbe. Vetë Grupi Negociator, me atë çka parë e dëgjuar në këto bisedime, ndoshta mendon me naivitet se “ishallah jemi në ëndërr dhe ujku nuk na ka hipur në kurriz e të fillojë të na kafshojë mishin”.

Në shpjegimin e situatës nuk ka vend për iluzione, veç për aksion politik, duke përgatitur opinionin e gjerë qytetar se politizimi i skajshëm i problemit të Mitrovicës Veriore nga Serbia, kërkon vëmendje e organizim, kërkon përgatitje të vetëdijes qytetare, për të parashikuar gjithçka dhe për të mos rënë pre e skenarëve serbë për destabilizimin e situatës.

Takimet deklarative apo të radhës për të gjykuar situatën nuk kanë vlerë, qofshin ato në Tiranë apo në Prishtinë e gjetkë, pa vënë në qendër të vëmendjes se cili është problemi më i mprehtë që kërkon analizë konkrete në kushtet konkrete të situatës politike në Kosovë. Shqiptarët mund të kenë dëshirë që të organizohen në nivelet më të larta institucionale të përfaqësimit të çështjes sonë kombëtare dhe kjo është një nismë e mirë, por kjo nuk mund të merret e shkëputur nga situata konkrete që përjetojnë njerëzit në terren, atje ku ata duan të jetojnë të qetë e të lirë.

Takimi i organizuar së fundi me nismën e BBC-së në Mitrovicë ishte një përpjekje serioze për të testuar se deri ku shkojnë urat e ndarjes midis dy kombësive në këtë qytete problematik, deri ku shkon armiqësia dhe sa ajo mund të veprojë në të ardhmen në mënyrë të njëanshme. Pretendimet ishin nga secila palë, por ajo që binte në sy ishte fakti se çështja e Mitrovicës Veriore mbetet tejet e politizuar dhe marrëveshja midis dy kombësive shkon deri në pafundësi.

Nuk mund të sheshohen pasojat e ngjarjeve të rënda që kanë ndodhur në një hark kohor kaq të shkurtër, pa sheshuar më parë shkaqet thelbësore që e mbajnë akoma gjallë nacionalizmin ekstrem në kufijtë midis dy kombeve. Këtë e kuptojnë shqiptarët, serbët, këtë e kuptojnë edhe ndërkombehtarët, por vetëm rrugëzgjdhje nuk ka.

Të gjithë të bashkuar për një Mitrovicë të pandarë

Veprimtaritë që bëhen në shërbim të zgjedhjeve dhe zgjidhjeve përherë do të vlerësohen nga sa ato janë në gjendje të japin rezultate konkrete. Fakti që situata në Mitrovicë nuk pret, është një tërheqje e fortë vëmendjeje për faktorin politik shqiptar dhe gjithë potencialet e tjera kombëtare që e kanë për detyrë në këtë situatë të dalin në ballë të qytetarëve që kërkojnë drejtësi. Nuk mund t’u lihet përgjegjësia vetëm strukturave politike përfaqësuese, të cilat përveç mandatimit për t’u marrë me këtë çështje, të tjerat nuk jemi në gjendje t’i vlerësojmë. Duke qëndruar në pritje, për të parë se çfarë do të bëjnë politikanët, atëherë do t’i lejojmë vetes edhe t’i paragjykojmë ata me atë çka do të arrihet. Kjo është e pamoralshme dhe e pafalshme.

Sot vërejmë në Kosovë aktivizimin e grupit të lëvizjes “Vetëvendosja”, të cilët në një mënyrë krejt origjinale kanë shtruar kërkesat e tyre hapur dhe pa vështirësi për t’u kuptuar. Ata nuk janë dakord për negociata me agresorët dhe persekutorët e shqiptarëve dhe kërkojnë të zbatohet vullneti i shumicës në Kosovë.

Në shumë aspekte vërehet se mjaft struktura e subjekte në Kosovë kanë distancim nga kjo lëvizje dhe u binden programeve të tyre politike. Kjo është puna e tyre, por nëse lëvizja “Vetëvendosja” ka marrë përsipër të dalë në sheshe dhe të kërkojë me këmbëngulje të drejtën dhe lirinë e njerëzve që duhet të jetojnë në Mitrovicë dhe në tërë Kosovën, atëherë nuk ka arsye që të rrimë e të bëjmë sehir Albinin se si udhëheq njerëzit, si e fusin në burg dhe e lirojnë dhe se si prononcohet para opinionit të gjerë për programin që zbaton.

Nëse do të bisedosh me intelektualë të shkëputur në Kosovë e kudo, ata rrallë herë mund të dalin kundër kur trajtohen probleme të çështjes kombëtare. Në terrenin konkret, atje ku duhen përkrahur dhe mbështetur veprimtarët e aksioneve mbarëkombëtare në shërbim të Kosovës, ka stepje e deri tërheqje. Kjo nuk është e ndershme.

Pranimi është njëra anë e problemit dhe ata mirë bëjnë që deklarohen të tillë, por, në fakt, Albinut dhe të tjerëve u duhet pjesëmarrja e popullit në sheshe, u duhet përkrahja hapur e qëndrimeve se në Mitrovicë shqiptarët duhet të bashkohen, të rrisin qëndresën e tyre dhe kurrsesi të mos pranojnë një Mitrovicë të ndarë sipas përrallave serbe.

Nëse këta intelektualë premtojnë se mund të angazhohen në veprimtari të tilla, atëherë ata duhet të vihen në krye të popullit, në të kundërt duhet të mendojmë pa mëdyshje se edhe ata janë si të tjerët dhe mund të afrohen thjesht për interesat e karrigeve, siç kanë bërë paraardhësit e tyre që sot heshtin. Trimat pas beteje nuk i duhen më askujt.

Për një Kosovë unike, të pavarur dhe sovranë

Deduksionet politike janë të mjaftueshme për ta parë të vërtetën në sy. Kështu, dinjiteti i kohës nuk është i cenuar dhe i rrezikuar, por është i goditur seriozisht në zemër të tij. Kalimi nga individi kriminel, në filozofi dhe në shtet kriminel, shënon cenimin historik të dinjitetit të kohës njerëzore që jetojmë. Në këtë kontekst, nuk kishte arsye që këtë ta pësonin popujt e Ballkanit, e veçanërisht shqiptarët në prag të mijëvjeçarit të ri.

Ngjarjet e vendosura në kuadratin e natyrshëm të kohës në të cilën ndodhin, brenda arsyes njerëzore, asnjëherë nuk i ngarkojnë të pafajshmit me faj, por në të njëjtën kohë nuk i falin as fajtorët që shkaktojnë tragjedi të tilla. Në këto kushte duhet të gjykojmë me gjakftohtësi se bashkimi bën fuqinë, por bashkimi bën dhe mençurinë. Atëherë, ku qëndron mençuria e inteligjencies dhe politikës shqiptare?

Nëse do të vendosim të përkrahim “Vetëvendosjen” apo subjekte të tjera që po luftojnë me këmbëngulje për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, duhet që këto subjekte të mos mbeten vetëm me përkrahësit e tyre, por të kenë masën e njerëzve prapa, dhe po të ndodhë kështu, duke dalë në shesh në mënyrë paqësore me Flamurin tonë Kombëtar me parullat për një “Kosovë unike”, për një “Kosovë të pavarur”, për një “Kosovë sovranë”, jashtë prirjeve të anarkisë, atëherë do të bindemi se këto veprimtari të karakterit kombëtar do të rrisin qëndrueshmërinë e popullit shqiptar dhe nuk do të kenë kthim prapa.

Një nga kërkesat e palëkundshme përballë qëndrimit të faktorit ndërkombëtar duhet të jetë fakti që Serbia duhet t’i kërkojë falje popullit shqiptar dhe vetë komunitetit ndërkombëtar, për atë tragjedi që i shkaktoi Ballkanit në dhjetë vjet. Kjo kërkesë, megjithëse është thënë edhe më parë, në mënyrë të padrejtë është anashkaluar në heshtje nga faktori ndërkombëtar, duke e mbarsur më keq problemin e marrëdhënieve midis dy kombeve. Kjo është pika e referencës për të cilën nuk duhet të ketë lëkundje.

Jo vetëm faktori shqiptar, por as ai ndërkombëtar nuk duhet të presë ndonjë qëndrim ndryshe nga politika serbe në të ardhmen, përderisa nuk njihet faji dhe ndërgjegjia kombëtare serbe është akoma e dyzuar dhe e trazuar. Nuk ka se si Serbia të pranojë pavarësinë e Kosovës kur nuk reflekton në historinë e saj dhe të rajonit përreth, nuk ka se si të reformohet qëndrimi i politikës serbe kur ajo jo vetëm që nuk njihet gabimet dhe fajet e veta, por pretendon akoma se i është bërë një padrejtësi e madhe dhe një “agresion ushtarak” me përgjegjëse NATO-n dhe bashkësinë ndërkombëtare.

Pra paradoksit serb nuk mund t’i kundërvihesh me konceptimet standarde e dogmatike mbi të vërtetën historike, e cila nuk mund të vihet më në dyshim. Gjurmët i dimë dhe ato i di edhe bota e qytetëruar, por ne sot na duhet të jemi të vëmendshëm se kemi ujkun përballë. Shqiptarët e dinë fort mirë se ai egërsohet më shumë dhe tenton të të kafshojë atëherë kur i vjen ngordhja. Vallë do ta lëmë përsëri ujkun serb të na kafshojë dhe të na marrë jetën?! Pra, kjo kërkesë duhet

të trokasë fort, veçanërisht në dyert e Evropës. Sa e ka bërë deri më sot këtë politika shqiptare në Kosovë e më gjerë?!

* * *

Populli filozofon natyrshëm: Kush ka zemër të mirë, nuk ia do të keqen tjetrit dhe kush kërkon zemër edhe duhet të japë zemër. Kush nuk i ka këto virtyte është i lig dhe kërkon të sundojë mbi të tjerët. E thënë shkurt, përderisa analiza me logjikë të plotë mungon dhe në çfarëdolloj ndryshimi të situatës, të gjithë vrapojnë për të mos mbetur prapa, për një copë bajrak e një pozitë, pa kurrfarë boshti filozofik dhe ideologjik, të gjitha shtigjet për të penetruar, keqinterpretuar dhe abuzuar do të jenë të hapura.

Këtë lloj qëndrimi ndaj çështjes shqiptare, ekzistente, pa përfaqësues tipikë të një teorie apo të paktën të një rryme të vijëzuar “me kockë” në politikën shqiptare, nuk do ta quanim një rastësi. Ky është një tipar i nacionalizmit agresiv ballkanik që shpesh gjen terren edhe në mesin tonë. Deri tani është parë se veprimtaria politike e subjekteve shqiptare ka qenë e tillë, për t’u treguar të tjerëve që “jemi edhe ne këtu”.

Kjo nuk mjafton për të bërë detyrën ndaj kombit dhe interesave të tij. Për shumë arsye duhet pranuar se klasa politike në Shqipëri dhe në Kosovë është e përgatitur dhe për hir të së vërtetës, të mos e krahasojmë këtë politikë me disa horra e bastardë shqipfolës në parlamentet tona që krijojnë situata konfliktuale për interesat e tyre, duke dhënë në sy të botës imazhin e mungesës së aftësisë shtetformuese të shqiptarëve.

Sot duhet pranuar se elementët e zgjuar që kontribuojnë në politikë janë lënë pas dore dhe jo rrallë zhvillimet politike funksionojnë në tradicionalizmin e vjetër e pa efikasitet. Veçoritë psikologjike që funksionojnë nuk kanë më efikasitet dhe për kohën që jetojmë ato janë të dëmshme. Mungesa e mendimit dhe shterpësia intelektuale në politikë drejt tendencave për të mos u përfshirë në këtë filozofi, po krijojnë një boshllëk të thellë shpirtëror. Çfarë na mungon vallë?

Vendi sot ka nevojë për liderë atdhetarë, të cilët duhet të kuptojnë historinë e tij të djeshme dhe realitetet e sotme. Ai nuk ka nevojë për mendje johistorike që sabotojnë arsyen historike, që kuptojnë politikën si hakmarrje dhe e shndërrojnë pushtetin në mjet të thellimit të përçarjes kombëtare.

Megjithatë, shqiptarët sot, duke reflektuar me gjakftohtësi në historinë e tyre, po kuptojnë se, në këtë çështje madhore, para se t’u kërkojnë të tjerëve, do të duhet të kërkojnë nga vetja e tyre. Këto e kanë çuar disa herë Shqipërinë në buzë të greminave dhe tragjedi të mëdha.

Drejtësia e ka braktisur botën, që kur klerikët e të gjitha rrymave dhe mbretërit, në emër të saj, kryen hakmarrje dhe bën të derdhet gjak e të digjen njerëz në turrat e druve, për të ndëshkuar në emër “të së drejtës”. Por nocionet mbret dhe liri, janë dy gjëra të ndryshme e të papajtueshme me njëra-tjetrën. Është e drejta e çdo kombi, që të përpiqet me fjalën e tij të urtë, me punë shumë, me gojë, me dorë, me pendë, me armë, që të fitojë njëherë e përgjithmonë të drejtën e tij nga thonjtë e zaptuesve dhe kolonizatorëve.

A duhet të besojmë se kombet janë si peshqit që hanë njëri-tjetrin dhe mjerë kush është i dobët se e pëson? Shqiptarët nuk kanë qenë asnjëherë agresivë, atyre u ka mjaftuar të mos ndiejnë mbi vete asnjë pushtet të huaj, të mos u paguajnë atyre taksa, të luftonin e të merreshin me hallet e problemet e tyre. Në trajtimin e çështjes kombëtare kemi pasur përherë një pikënisje e, natyrisht, që do të kemi edhe një pikëmbërritje.

Njohuritë themelore dhe platforma e shtruar, kur janë të plota, hapin horizonte të afërta e të largëta për të ardhmen, por kjo materializohet dhe merr jetë, atëhere kur intelijenca dhe djemtë dinë të duan vendin e tyre dhe të luftojnë për vendin e tyre. Këtë realizuan kombet në luftërat botërore, këtë duan të bëjnë dhe sot. E ardhmja është e popujve.

(Fund)

UÇK-ja e re që po rilind në Kosovë

Dr. Sulejman Abazi (NESHAJ)

Në politikën shqiptare në Kosovë, ka individë që kanë marrë në dorë “flamurin e pavarësisë”, duke mos bërë atë që duhet në interes të saj. Konstatimi nuk ka doza mosbesimi dhe denigrimi, por përgatitja për t’u përballur me ngjarjet, nuk imponon respekt ndaj vullnetit të shumicës prej strukturave të përfaqësimit, përballë krizës së besimit ndaj politikës. Fenomene të çuditshme në politikën shqiptare, që shumkush mund t’i quajë “reformatore”. Shkrirje e ideologjisë partiake me pragmatizmin, duke mos e ngritur çështjen në nivelet që kërkon vendimmarrja për mbrojtjen e interesave kombëtare. E thënë më shkurt, veprimtaria në planin konkrete dhe të pranisë së alternativave rezervë të zgjidhjes ka mbetur shumë hapa prapa. Politikanët shqiptarë kudo nuk e kanë kuptuar se duhet të bëjnë të paktën sa bëjnë disa personalitete botërore për çështjen e Kosovës dhe çështjen shqiptare në përgjithësi. Paradoksi shqiptar, që ka çuar në diskreditimin e politikanëve aktivë në çështjen e Kosovës. Që tani, para shpalljes së statusit të Kosovës, mund të thuhet se ata kanë kohë që e kanë mbyllur misionin e tyre.

Të ndalemi në një pikë thelbësore: mbi mënyrën se si shtrohet sot çështja e statusit të Kosovës, hallka që duhet zgjidhur më parë, që të kapet zinxhiri i zgjidhjeve të mëvonshme. Është e vërtetë, që nuk mund të ketë dy zgjidhje, dhe të pretendohet se janë të drejta. Ka shkallë veprimesh për të shkuar në këtë hallkë, por e vërteta nuk mund të tjetërsohet, akoma më keq, të shpërftyrohet. Përballë saj qëndrojnë interesat utilitare të kujtdo qoftë që pretendon se është i pranishëm në politikë.

Analiza e problemit mund të çohet edhe më tej. Nëse pyeten shqiptarët në masë, nuk është çudi që ata të kërkojnë bashkimin kombëtar, të gatshëm të kontribuojnë që çështja shqiptare të zgjidhet një herë e mirë. Shumkush sot është bindur se më herët Evropa e ka shikuar hapësirën shqiptare si një “mish të huaj” në Evropën kristiane. Përballë të vërtetës historike, duhet të pranohet e vërteta e kohës, e cila nuk mohon dot që vendimet e para një shekulli shkaktuan tragjedinë shqiptare, dhe prej atëherë kanë kaluar shumë kohë, kanë rrjedhur shumë ujëra. Sot po përballemi me paradoksin e kohës. Pavarësisht “premtimeve” që mund të ketë marrë politika ndërkombëtare nga segmentet “moderatore” të politikës serbe, në Serbi shihet qartë dominimi i psikologjisë së mbarsur me frymë nacionaliste. Ndaj këtij realiteti është punuar shumë pak për ta ndryshuar. Sot i verbëri na paska dalë në dritë për të kërkuar gjilpërën në kashtën e haurit të Avgjisë.(!!) E vërteta historike, duhet të jetë pikënisje për të mos përsëritur gabimet e gjyshërve dhe baballarëve, të cilët nuk patën kurajo dje t’i kërkonin falje kombit shqiptar. Këtë nuk ka se si ta bëjnë sot djemtë dhe nipërit e tyre përballë ruajtjes së “statuquosë gjyshërore” në Ballkan. Zhvillimet në hapësirat shqiptare ndihen të lena jashtë vëmendjes. Çdo pjesë tjetër shqiptare jashtë Kosovës, në zhvillimet e pritshme, mbetet një hapësirë ndihmëse, që nuk përbën konfliktin kryesor për shqiptarët. Atëherë çfarë pritet tjetër për të sqaruar në politikën shqiptare? Çfarë duhet të bëjë ajo pa lëkundje në mbrojtjen e interesave kombëtare, veçanërisht në Kosovë? Të gjitha ndoshta dihen, veç kjo e fundit jo. Problemet që dominojnë në jetën e shqiptarëve në Kosovë janë ato që po mundojnë shpirtin e popullit për liri e pavarësi, janë kolla jonë që nuk na lë rehat të marrim frymë. Mund të mbështetësh pavarësinë e Kosovës (siç është deklaruar), por në të njëjtën kohë, nuk mund të deklaroresh kundër ndryshimit të kufijve në rajon. Veprimi i parë sjell të dytin, si pjesë e pashkëputur e tij. Si mund ta fitojë pavarësinë Kosova, nëse ajo nuk shkëputet juridikisht nga Serbia?! Konformimi i politikës zyrtare është një gabim i pafalshëm i saj. Nuk mund të rrih në dy karrige, sepse i bën keq vetes, nuk mund të hipësh njëkohësisht në dy kuaj, sepse rrezikon të shqydhesh më dysh.

Fillesat e drejtimit të kryengritjes së armatosur të shqiptarëve në Kosovë, u zëvendësuan mekanikisht nga disa njerëz që dolën nga laboratorit si sejmënë të bindur ndaj politikës së jashtme dhe një pjesë të bindur ndaj politikës së Beogradit. Të infiltruarit nga politika serbe janë

përfaqësues të strukturës së vjetër politike, e përpunuar prej saj dhe në simbiozë me të për përfitime klanore e vetjake. Këta elementë veprues në politikë nuk janë sinqerisht për pavarësinë e Kosovës, sepse janë të frikshëm nga hapja e defterëve të vjetër, dhe kjo shprehet në alibitë e tyre në teoritë e dështuara që u ka dalë kallaji në opinionin shqiptar. Ata perifrazojnë “për dyzimin e kombit shqiptar”, për “himne e flamuj të rinj”, për “kombin kosovar” etj. Opinioni i shëndoshë sot në Kosovë ka filluar rezistencën ndaj depërtimit grek, janë ato djem e vajza të Shqipërisë, të cilët slloganin e tyre patriotik e ndiejnë në shprehjen “o sa mirë me kenë shqiptar”. Politikanët e Kosovës sot nuk mund t’i zëvendësojnë rinisë dhe popullit njerëzit e ndershëm, nuk mund t’ua marrin dot trurin, forcën, nuk mund ta bëjnë dot rolin e “dashit që prin kopenë”. Faktet dhe ngjarjet që kanë pasuar nuk janë alibira, por ato denoncojnë dhe akuzojnë. Pse për të njëjtin pretendim “Rremi”, Haradinaj e shumë të tjerë shkuan burgjeve dhe Thaçërit, Selimajt, Çekërit, e të tjerë janë të lirë dhe “bëjnë” politikë? Mbi cilat kritere sot në politikën e Kosovës aplikohen këto “standarde” dhe kërkesa të dyfishta, pse ca duhet të venë në burg e ca të jenë të lirë, kur mund të akuzoheshin për të njëjtën gjë? Në të gjitha sistemet, njeriu mund të dënohet për “tejkalim kompetencash” dhe jo pse zbaton “ligjet e një sistemi”. Atëherë kush e ka provuar se çfarë ka tejkaluar njeri apo tjetri brenda ligjeve të luftës? Kjo nuk ka ndodhur dhe nuk ka për të ndodhur. Atëherë është parë se këta ish- komandantë nuk bëjnë gjë tjetër, veçse glorifikojnë njeri-tjetrin, duke u kthyer në marioneta të bindura të politikave të vjetra.

Kush e drejton sot Kosovën? Agim Çeku ka qenë oficer i ushtrisë sllave, me akademi sllave, me një grua kroate, me shtetësi kroate, me fëmijë që nuk dinë gjuhën shqipe, kur në familjen e tij nuk flitet shqip. Kush është ky njeri dhe kush e sollti atë në krye të ushtrisë dhe të qeverisë së Kosovës, a bën ta dimë?! Si mund të besojnë shqiptarët e thjeshtë, se ky Çeku na e dashka më shumë Shqipërinë nga Mentor Kaci, Adem Demaçi, baca Avdul e shumë të tjerë, që kanë vuajtur tmerrësisht nën regjimin e Beogradit, si mund të krahasohet ky njeri me sakrificën njerëzore të familjes Jasharaj, Haradinaj, të Pajazitëve, të “Sandokanit”, e të qindra të tjerëve, që kanë dhënë gjak për Kosovën dhe Shqipërinë. Çeku nuk është i vetëm në Kosovë, si ai ka shumë të tjerë pas. Sot për Kosovën shtrohet një problem i hapur. Nga njëra anë duket sikur çështja e pavarësisë është e zgjidhur, nga ana tjetër askush nuk e kupton dhe nuk merr përgjegjësitë për t’ia bërë të qartë politikës dhe vetë popullit shqiptar në Kosovë, se ende ka shumë punë për t’u bërë. Askush nuk është në gjendje të pranojë me kurajo se politika e ndjekur deri tani i ka shkaktuar një dëm të madh çështjes së Kosovës, duke shpenzuar kohën dhe energjitë në drejtimin e gabuar. Pikënisja ka qenë e gabuar. Testi i shkollës teknike të Harri Fulcit në Kavajë, afro një shekull më parë, paska qenë i drejtë. Ulja në tavolinën e bisedimeve me kriminelët e popullit shqiptar, kur ata ende dhe sot e kësaj dite nuk kanë kërkuar falje popujve dhe politikës për gjenocidin e përsëritur në Ballkan, pranimi i kushteve të servitura kur pala shqiptare ishte e rreshtuar bindshëm në anën e fitimtarëve, ishte ai test “fulcian”, që u mbushi mendjen politikanëve konservatorë që mund të sillleshin në çfarëdo mënyre me udhëheqësit “fitimtarë” të pasluftës. Një e vërtetë e hidhur që nuk do komente. Janë të pambështetura deklaratat emocionale të Çekut, Thaçit, Surroit, Sejdiut e të tjerëve që pretendojnë se vitin tjetër ne shqiptarët do ta festojmë “së bashku” festën e pavarësisë. Ky është mashtrimi politik i radhës në shërbim të politikave antikombëtare.

Le të marrim një shembull të thjeshtë për të cilin opinioni shqiptar është tashmë i informuar. Ditën e festës së Flamurit dhe të Pavarësisë, nëse politikanët dhe titullarët e “shtetit” fantazmë në Kosovë festuan “së bashku”, pasdite mijëra djem dhe vajza të Kosovës dolën në rrugë për të kërkuar drejtësi, liri dhe pavarësi. Ata sulmuan të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Çfarë ngjau në Prishtinë? Nëse Albin Kurti del në sheshe me 5 - 6 mijë veta sot, atëherë kush thotë se “ata nuk janë popull”, kush thotë se “ata kanë marrë përsipër të destabilizojnë Kosovën”, kush thotë se “ata nuk i shtrojnë drejt kërkesat”, kush pranon se “kërkesat e tyre janë antijuridike” ndërkombëtarisht, kush ka guximin të thotë se “ata nuk janë shqiptarë të ndershëm”, por “të paguar nga Beogradi”?!! Kush dhe kush tjetër..., Kush arrin ta bindë popullin se vërtet është “kështu” dhe Albin Kurti “të mbetet vetëm”?! Shpjegimi i problemit dhe realiteti nuk kanë shanse të vërtetojnë të kundërtën. Për të kërkuar të drejtën e Kosovës, këtë po e bëjnë shqiptarët, ajo

pjesë e popullit që në kohën e luftës së lavdishmes të UÇK-së ishin fëmijë 12-13 vjeçarë, që përjetuan tmerrin dhe u rritën dhe edukuan në këto shtatë vite nga nënat dhe baballarët e tyre me ndjenjën e lavdisë së ushtrisë më të re në Ballkan, që lëkundti nga vendi një perandori dhe i vuri “kufirin tek thana” shtetit terrorist serb. Këta janë ajo pjesë vitale e popullit që e duan me shpirt Kosovën dhe Shqipërinë dhe janë të gatshëm të rreshtohen përsëri në një UÇK të rilindur për të kërkuar drejtësi dhe liri. Kush do të jetë në gjendje t’i ndalë ata? Vallë nuk bën përshtypje fakti që nga shpirti luftarak i të rinjve dhe të rejave të “Vetëvendosjes” kanë hedhur vështrimin dhe urat e bashkëpunimit edhe rinia e lëvizjes “Mjaft” këtu në Tiranë? Po këta kush janë? Ata janë fëmijët tanë, ata janë rinia që e sheh të zymtë të ardhmen e saj, kudo në hapësirat shqiptare, që nuk kanë garanci për të ardhmen e tyre, sepse këtë ia privon klasa politike, e cila është e lidhur me njëmijë fije të errëta me të kaluarën e saj. Atëherë, cili është opinionin i vërtetë për njerëzit që e duan Kosovën dhe Shqipërinë, opinionin i Surroit&CO që del dhe shan djemtë dhe vajzat shqiptarë se i prishën “qetësinë” në perandorinë e politikës së shitur, apo opinionin i ndriçuar i popullit, i cili nesër mund të dalë në sheshe me disa qindra mijë dhe të kërkojë liri dhe drejtësi? A e ka pyetur ndonjëherë veten politika se çfarë është duke bërë? Djemtë dhe vajzat e Kosovës sulmuan korpusin e UNMIK-ut, sulmuan SHPK-në, Kryeministrinë, dhe përballë tyre këtë radhë nuk guxoi të ngrinte dorën asnjë nga elementët e sigurisë në Kosovë. Vallë është pak për të kuptuar se askush nuk e ka më në dorë situatën në Kosovë? Çfarë është ky mekanizëm vetëveprues që funksionon atje dhe që shpesh nuk ka forcë t’i dalë përpara. Vallë mos janë larg në kohë mesazhet e ngjarjeve të 2004, të cilat bënë kurban në themelet e lirisë gjakun e 18 djemve dhe vajzave të Kosovës? Kush ishin këta që u vranë dhe pse u vranë? Kush e pyeti veten seriozisht, pse u vra përsëri rinia shqiptare në Kosovë? Askush dhe jo atëherë, por as sot e as nesër, sepse ata nuk kanë kurajon ta shikojnë në sy popullin e mashtruar. Pra, “shteti” në Kosovë nuk guxoi të dilte në rrugë dhe të dhunonte rininë, sepse nëse do të ndodhte e kundërta, atëherë mund të dilnin në rrugë edhe ata që nuk dolën në protestë ditën e Flamurit. Historia edhe mund të përsëritet.

Filozofia ortodokse serbe në ofensivë antishqiptare.

Fundamentalizmi fetaro politik i autoriteteve kishtarë ortodokse serbe nuk njeh kufi. Ai ka për qëllim të rikthejë kohën e sundimit të drejtëpërdrejtë të Beogradit mbi Kosovën e ngushtë, të rikthejë kohën e genocidit antinjerëzor, të llahtarisë pa kufij të terrorizmit ushtarako shtetëror serb, të mekanizmave politike ultranacionaliste shtetërore të Serbisë, kundër popullit shqiptar në Kosovë.

Qytetërimi evropian në kushtet e kalimit nga epoka e Mesjetës në modernizëm e pa të domosdoshme ndarjen e institucioneve fetare nga veprimtaria politike e shtetit dhe e shoqërisë, duke bërë një hap të sukseshëm në ndërtimin e jetës së lirë. Kjo frymë moderniste pati ndikimet e veta në hapësira më të gjera, duke i dhënë liri veprimi shtetit institucional dhe emancipimit të shoqërisë njerëzore. Do të dëshironim, që pas mëse një shekulli të gjysëm, kjo të ndodhte edhe në Serbi dhe Greqi, ku nuk mund të diskutohet më se Kisha Ortodokse është e përzjerë në punët e shtetit dhe inspiruese e tërë qëndrimeve politike, duke gjetur gjuhën e përbashkët “të mendjeve të shenjta” me klasën politike në vendet e tyre. Nuk është e rastit që hierarkia e lartë fetare në këto vende mban rolin e mbikëqyrësit në zbatimin e planeve shtetërore, për të ruajtur dhe zgjeruar hapësirat e besimit ortodoks në dëm të popujve të tjerë. Kjo ka ndodhur me shtete fqinje të Shqipërisë, ish Jugosllavisë (sot Serbia e mbetur) dhe Greqisë, të cilat tradicionalisht kanë realizuar genocidin dhe ekspansionin e tyre ndaj kombit shqiptar, duke anëksuar pjesë të tëra të trojeve shqiptare. Pushtimi është shoqëruar me dhunimin e objekteve të kultit dhe ndërtimin e objekteve të reja mbi to, duke injektuar besimin ortodoks në dëm të besimeve të tjera.

Autokracia qeveritare serbe në veprim

Një fenomen i tillë nuk është objekt i këtij opinioni, pasi ka një mori faktesh shkencore që vërtetojnë agresionin fetar ortodoks ndaj popullsinë shqiptare të dominuar nga besimi musliman. Një reprezalje e tillë ka ndodhur me popullsinë shqiptare në Kosovë dhe me popullsinë çame në jug të Shqipërisë. Një bizantizëm mesjetar që tashmë po u kushton shumë shtrenjtë popujve në këto vende, duke vështirësuar jetën e tyre drejt qytetarisë dhe demokratizmit. Ndryshimi i këtij mentaliteti tashmë është bërë një fenomen jetësor, nëse duhet respektuar kopertura juridike e Europës së Bashkuar, drejt shtetit qytetar e demokratik. Pëplasja e mendimit të lirë si atribut i një shoqërie demokratike, i cili ka filluar të hedhë rrënjë edhe në këto vende, është vënë përballë qëndresës së "autokracisë qeveritare", e cila nën ndikimin religjioz nuk ka shanse të reformojë vetveten dhe t'i hapë rrugë zhvillimit progresist. Qëndrimet politike të shteteve fqinje të Shqipërisë janë të mbarsura me një frymë të ndieshme nacionalo – fetare. Dhe kjo nuk është pak për të mos rënë në sy.

Po le të kthehemi në çështjen e Kosovës, e cila sot mbetet një nga problemet më të mprehta dhe më të diskutueshme për politikën ndërkombëtare dhe atë rajonale. Deklarata e Marti Ahtisarit muaj më parë se, "serbët janë komb fajtor", duhet të ishte një "shi i ftohtë" me efekte shëruese ndaj "dehjes" së strukturave radikale ultranacionaliste në Serbi, të përfaqësuara në pushtet, përkundër asaj që kërkon sot bota demokratike ndaj tyre. Fatkeqësisht kjo nuk ka ndodhur. Dehja me simbolet dhe mitet serbe, pararendëse të ekspansionizmit serbe në Ballkan, të inspiruara nga strukturat hierarkike të Kishës Ortodokse Serbe (KOS), mund të konsiderohet një fatkeqësi në përmasa popullore, po të kemi parasysh se pasojat e këtij ekspansioni do t'i vuajë edhe për shumë kohë vetë populli serb. Një popull që pranon me aq lehtësi përrallën serbe se, "Kosova është djepi i Serbisë", duke u mbështetur në iracionalitetin e jetës dhe simbolizimin e saj me frymën fetare ortodokse, nuk ka bërë gjë tjetër, veçse ka dhunuar hapur e me brutalitet të vërtetën historike, duke i mohuar popullit shqiptar autoktoninë në trojet e veta. Vetë populli serb duhet ta dijë, se është një ardhacak, dhe këtë ai e ka të shkruar në historinë e tij.

Politika serbe në thelb mbetet ajo që ka qenë

Në ish – Jugosllavi (të mbetur Serbi) ende ekziston një sistem politik, thellësisht fetaronacionalist, i cili me dhunë e terror shkaktoi tragjedinë ballkanike dhe ai, nuk mund të mos gjykohet si i tillë. Në sistem, politika serbe e ka hak të demaskohet rëndë, sepse historia dhe pasojat e saj të rënda nuk mund të tjetërsohen. Ndryshimi i qëndrimit brenda faktorit politik serb për çështjen e Kosovës mbetet minimal. Ky është një fillim i mirë, por kjo nuk mjafton. Një popull, që për hir të nacionalizmit intolerant, pranon krimet dhe genocidin shumëvjeçar mbi popuj të tjerë dhe që nuk reagon, për t'u ngritur në nivelet e qytetarisë kundër strukturave shtetërore terroriste, luftënxitëse, ai detyrimisht dhe fatkeqësisht bëhet "palë" me to, e ndan fajin me to, dhe më së paku, moralisht duhet të ndidhet i diskretituar për udhëheqësinë e mbrapshtë, e cila ja ka ulur kokën në sy të mbarë botës. Një popull që pranon të justifikojë tragjedinë e shkaktuar në Ballkan në një dekadë, të finalizuar me genocidin terrorist ndaj popullit musliman në Bosnje Hercegovinë, e së fundi mbi poliin shqiptar në Kosovë. Me siguri që njerëzit në Serbi u irrituan ndaj bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, me siguri që e kanë kuptuar, se për prapësinë e tyre shkuan 50 vjet më prapa, edhe pse kishin dhe kanë "bekimin" e KOS-it shtet. Bekimi i kishës së tyre nuk arriti ta mbante Kosovën një plaçkë tregu dhe një "djep përkundës" të një shteti kriminal e terrorist.

Referendumi së fundi në Serbi e vërtetoi edhe një herë vlerat që përmbante deklarata e Antisarit. Qëndrimi nacionalofetar i politikës serbe, ende nuk i është nënshtruar reagimit pozitiv të masës së qytetarisë, të cilët e kanë kuptuar se Kosova duhet të shikojë punën e vet. Trashëgimia e periudhës së errët të Milloshit është e pranishme, e përforcuar së fundi me korin e radikalëve dhe klerikëve të lartë serbë, të cilët mendojnë se qendra e botës është në Beograd. Ky kor u angazhua në një propogandë të çmendur kundër misionarit ndërkombëtar. "Ofensiva diplomatike" në të gjitha nivelet kundër Ahtisarit (i cili edhe pse është një "ambasador shtetit"),

ka pasur dhe ka vetëdijen politike, se tashmë historia nuk mund të tjetërsohet, dhe nuk mund të favorizohet më një komb që ka nevojë të reformojë jetën e tij. Fryma shoviniste serbe ka marrë një goditje vdekjeprurëse duke realizuar hap pas hapi shkëputjen përfundimisht të Kosovës nga Serbia. Nuk është e vështirë të kuptohet, se kjo zhurmë propagandistike është e nxitur nga Kisha Ortodokse Serbe.

Kisha Ortodokse serbe kundër Antisarit

Dëshmi e freskët mbetet deklarata e Sinodit të politizuar të KOS-it, nëpërmjet komunikatës së botuar në agjencinë serbe "Tanjug", më 30 gusht 2006. «Kisha Ortodokse Serbe shprehu shqetësimin dhe hidhërimin për deklaratën e kohëve të fundit nga i dërguari special i OKB-së, Martti Ahtisaari se, "serbët janë komb fajtor". Deklarata e Sinodit të Shenjtë, e firmosur prej Patriarkit Pavle shpall se çdo njeri është i përgjigjshëm për veprat e tij dhe se nuk ekziston një faj kolektiv. Nëse dikush akuzon një komb të tërë se është fajtor, ai/ajo dëmton konceptin e krishterë të njeriut dhe të komunitetit. Sinodi tragon se një shqetësim më të madh është shkaktuar nga fakti, se këto vlerësime vijnë prej njeriut që do të duhej të ndërmytësonte në mënyrë konstruktive dhe objektive negociatat serbo-shqiptare, për të arritur në një zgjidhje kompromisi lidhur me statusin e Kosovës. Në mënyrë të dukshme, duke mos llogaritur një gjë të tillë dhe duke harruar se në Evropën moderne nuk ka më as koloni, as guvernatorë kolonialë, Ahtisaari dha këtë deklaratë si një shpjegim të vetvetës, pse Serbia do të duhej të grabitej prej zemrës së saj historike dhe shpirtërore – Kosova [...] duke shtuar se ata që prekin këtë lloj të teorive në shekullin XXI, dëshmojnë se forca dhe drejtësia janë të kundërta të papajtueshme... ». Bukur edhe kjo!!

Ison mbi komunikatën e "Tanjung-ut" e kanë bërë edhe përfaqësuesit udbashë "Rashka-Prizren" për të njëjtin problem: «Eparkia ka kritikuar deklaratën e Ahtisaarit, se trashëgimia e Millosheviçit do të duhej të merrej në konsideratë, kur është fjala për zgjidhjen e statusit krahinor dhe se, "serbët janë fajtorë si komb", duke e ftuar të rikujtohet sfondin historik të Luftës së Dytë Botërore, kur shqiptarët ishin aleatë të shtypësit gjerman. (!) Pikërisht që nga ardhja e forcave ndërkombëtare, terroristët shqiptarë nga Kosova vazhdojnë me shpartallimin e popullit serb dhe të gjurmave të ekzistencës së saj krishterë nëpërmjet dëbimit të mbi 220.000 serbë e jo-shqiptarë, duke vrarë mbi 1.000 dhe duke shkatërruar rreth 150 kisha krishterë, pohon eparkinë. Në të njëjtën kohë, është theksuar, një derdhje të myslimanëve nga Shqipëria fqinje është lejuar, u ndërtuan 400 xhami të reja, të gjithë këto duke qenë shoqëruar me përforcimin e ideologjisë në të cilët e kanë bazën tek Al Kaida» (!).

Shumë "mrekullisht" funksionon logjika e standardeve të dyfishta të "filozofisë fetare" të KOS-it, duke marrë përsipër të dezinformojë mbi "fajin" e popullit shqiptar në Kosovë. Duhet bërë me dije hierarkia e lartë serbe se shqiptarët me luftën e tyre të lavdishme Nacionalçlirimtare janë të rreshtuar në anën e fitimtarëve të L2B, dhe kjo nuk ka nevojë të merret në diskutim nga koka të nxehta nacionalofetare. Gjurmët e masakrës serbe ndaj rekrutëve shshiptar në Tivar, të mobilizuar kundër forcave fashiste gjermane, janë ende të freskëta, dhe ato edhe sot kërkojnë shpagim.

Nën efektet e këtyre deklaratave ekstremiste me përmbajtje fetare, opinioni serb mbetet i dyzuar në qëndrimin e tij. Kjo situatë e ka të nevojshme që vetë faktori ndërkombëtar të veprojë në Serbi sa nuk është vonë, duke analizuar pasojat politike të fenomenit «*ish-Jugosllavi*». Sot kërkohen zgjidhje afatgjata e të qëndrueshme në interes të paqes dhe stabilitetit në rajon. Luftrat në Ballkan i hoqën lëkurën absurdit fetaronacional serb në kohët moderne, dhe analiza nuk duhet të favorizojë askënd. Përse politika serbe, nëpërmjet sektorit të saj të propagandës të drejtuar nga Pavle, nuk e pranon pavarësinë e Kosovës? Sot nuk mund të jepen dhe të pranohen zgjidhje, duke marrë për bazë përrallën historike, se "*Kosova është djepi i Serbisë*". Atëherë, ne shqiptarët pyesim, po Beogradi çfarë është, kush është «*guzhina, krevati, jastëku*» apo çfarëdo tjetër, për Serbinë e përrallave serbe?!

Nëse do të flasim për nocionin e përgjegjësisë në drejtësi dhe për konceptet bazë të krishtërimin, të dy këto koncepte përjashtojnë si akte të jashtëligjshme dhe jo normale shtypjen e një kombi prej një kombi tjetër. Nga ana tjetër, vrasja dënohet në të gjitha kodet penale të shteteve të botës. Vrasja kolektive (krimet kundër njerëzimit dhe genocidi) dënohen edhe në të drejtën penale ndërkombëtare. Në fushën e krishtërizmit, ndër mëkatet më të mëdha që mendohet se Zoti nuk i fal, është vrasja e njeriut prej një njeriu tjetër. Atëherë, çfarë duhet të na tregojë për të na mbushur mendjen Sinodi i Shenjtë të Kishës Ortodokse Serbe mbi konceptimin e krishtërimin për vrasjet masive, masakrat, spastrimin etnik, varret massive që ende po zbulohen edhe pas dhjetë vitesh, për të gjitha tmerret e kryera prej Beogradit ndaj boshnjakëve në Bosnje dhe shqiptarëve të Kosovës historike?! Vetëm serbët paskan të drejtë të jetojnë dhe të vrasin njerëz të pafajshëm vetëm pse ata janë muslimanë?! Përse nuk janë gjykuar dhe dënuar këto krime më së pari në Serbi e mandej më tutje?! Ku fshihen sot 16 kriminelë të luftrave në Ballkan, të shpallur në kërkim nga Gjykata Supreme e Hagës?!

Partriarku Pavle dhunon historinë

Atëherë, nën emrin e interpretimit të vet të krishtërimin, më së pari, në emër të së drejtës për të jetuar, të paqes dhe humanizmit njerëzor, KOS-i duhet të distancohet dhe të denoncojë strukturat shtetërore që fshehin dhe mbrojnë kriminelët terroristë të luftës në Kroaci, Bosnje e Kosovë, që ata të venë përpara drejtësisë. Me sa duket misioni është i gabuar. Kisha Ortodokse Serbe nuk mund të luajë rolin e instrumenteve të fushatave propagandistike antishqiptare, të dëshirës së saj premanente të sllavizimit të shqiptarëve, sepse ajo ka dhunuar në Kosovë shumë kisha e manastire tradicionalisht shqiptare (shembulli i manastirit të Deçanit është më i dukshëm), duke ngritur mbi rënojat e tyre objektet e reja të kultit fetar serb. Dhunimi i padrejtë i tokës në Deçan është treguesi më i mirë i angazhimit fetar në përpjekjet që bën kasha serbe për kolonizimin e Kosovës nëpërmjet "ekstraterritorialitetit".

Më shumë se sa "objektiv", partriarku Pavle me mendje të prishur, por me vetëdije të plotë, kërkon sot t'i mbushë mendjen Europës, nëpërmjet deklaratave në thelb politike, duke gënjyer se në Evropë ende ka "koloni dhe guvernatorë kolonialë"! Ai nuk është në gjendje të kuptojë (dhe nuk do të kuptojë) duke i mbushur mendjen vetes dhe të tjerëve se që nga vitet 1912-1913, Kosova historike shqiptare u invadua dhe terrorizua nga ushtritë pushtuese serbe, dhe për një periudhë 80 vjeçare, Beogradi ka zbatuar politikën e **kolonizimit me dhunë** të trevave shqiptare, mbështetur në motivin: "vrit, dëbo, sllavizo shqiptarët autoktonë të Kosovës, duke sjellë sa më shumë serb në vend". Qëndresa shqiptare në një shekull ka bërë që të dështojnë planet serbe të bekuara nga kasha, dhe sot Kosova e ngushtë është liruar prej sundimit të tyre.

Qeveritarët serbë dhe megafoni i tyre kishtar, duke shfrytëzuar segmente të caktuara në strukturat ndërkombëtare në Kosovë dhe gardën e shqipfolësve të paguar, kanë krijuar strukturat paralele, duke synuar një Kosovë me "autonomi të zgjeruar", juridikisht të varur nga Serbia. Po çfarë duhet t'i themi hierarkut Pavle për terrorizmin që u bëhet sot shqiptarëve në Kosovën Lindore, çfarë duhet të themi për mbajtjen padrejtësisht të 2400 km katrore nga IRMJ, pjesë të territorit të Kosovës, çfarë duhet të themi për popullsinë shqiptare në Luginën e Vardarit, çfarë tjetër duhet t'i themi këtij kleriku në emër të së vërtetës dhe kërkesës për paqe e drejtësi?!

Ende hierarku i lartë serb nuk është bindur (dhe nuk ka se si) se pavarësia e Kosovës, i shërben demokratizimit të rajonit dhe ndikon pozitivisht mbi fqinjët agresivë ultranacionalistë. Shqiptarët nuk u kanë asnjë detyrim nacionaliteteve intolerante fqinje, historikisht ekspansionistë. Nëse serbët, maqedonasit, malazezët, grekët, nuk do të mund shërohen prej pasojave të helmimit ultranacionalist të mbarsur me ideologji fetare, ky nuk është faji i shqiptarëve. Me këtë ata po tregojnë se kanë mbetur rob të formulave të vjetra mesjetare. Diktati serb dhe pretendimet aneksioniste të qarqeve shoviniste greke e maqedonase, kanë qënë dhe mbeten shkaktarët kryesorë të antagonizmit ndërnacional në Ballkan. E bëjmë me dije hierarkun e lartë serb, se në

kohët moderne shqiptarët ka kohë që kanë hedhur vështrimin në riaftësimin e tyre përballë pasojave që u ka servirur historia.

* * *

Duke analizuar deklarata të tilla me përmbajtje nacionalofetare, është më se e qartë se fundamentalizmi politik i KOS-it nuk njihet kufi dhe vazhdon të nxisë urrejtjen fetare midis popujve. Sa tolerantë janë shqiptarët në besimet e tyre fetare, këtë nuk ka nevojë ta vërtetojë hierarku Pavle, e as Janullatos, i cili vazhdon të lundrojë në ujrat e ndenjura obskurantiste. Konflikti me shqiptarët nuk do t'i nxjerrë në dritë, as duke predikuar në emër të Zotit. Ndoshta do t'u duhet t'i kthehen studimit të Biblës, për të mësuar të vërtetën mbi Zotin në qiell dhe në tokë. Shqiptarët sot karakterizohen nga toleranca e shkëlqyer fetare dhe me vetëdije të lartë kombëtare po luftojnë për të drejtat e tyre, drejt integritetit mbarëkombëtarë, duke u kthyer në një faktor për demokratizimin e jetës në Ballkan. Kjo është e drejta jonë për vetevendosje, pavarësi kombëtare, sovranitet, bashkim dhe integritet.

Dy kokat e shqiponjës

Kemi mbetur me shpresën se dy protagonistët e duelit të gjatë mediatic, shkrimtari Ismail Kadare dhe akademiku Rexhep Qosje do të ulnin “armët”, duke dhënë mesazhet e mirëkuptimit për të gjithë shqiptarët, të cilët ndjenë lodhje deri në bezdi përballë sensacioneve të shumta mediatike. Mesazhin e mirëkuptimit e vlerësojmë të përkrahur dhe të pranueshem në prononcimet e intelektualëve dhe analistëve në shtyp dhe për këtë sot kemi nevojë të gjithë. Duke mos denigruar vlerat e “përplasjeve” në mendimin filozofik për çështje që kanë të bëjnë me problemet në fushën kombëtare, nuk do të dëshironim kurrë që këto ecejake gazetash dhe ekranesh të degjenerojnë në probleme të rëndomta, që nuk do të gëzonin askënd. Jo rrallë, duke ditur vlerat që ata përfaqësojnë në jetën e shqiptarëve, përplasia midis tyre shkakton trishtim.

Duke qenë racional dhe duke mbetur në mendimet që kam shprehur më parë në opinioin, do t'u referohem prononcimeve të Kadaresë në esenë e tij filozofike, “Shqiptarët në mijëvjeçarit e tretë” në të cilën, krahasuar me ngjarjet sot, bëjnë përshtypje dhe shpesh lënë shije të hidhur, kur mendon sesa poshtë mund të biesh kur merresh me individin, shmang analizën e ngjarjeve dhe nuk kontribuon me ide racionale në çështjen kombëtare.

“Ne prag të mijëvjeçarit të tyre të tretë, shkruan Kadare, që është dhe mijëvjeçari i tretë i botës së sotme, shqiptarët i priste një befasi tragjike. Ishte e pangjashme me dramën e mëparshme, ndaj ishte, ndoshta, dhe më e hidhura.... Një vizatim në një gazetë franceze të atyre ditëve e jepte të tronditshme thelbin e ngjarjes: Njera kokë e shqiponjës dykrenare, zogut simbolik të shqiptarëve, përpiquej të mbyste kokën tjetër. A ishte e denjë kjo për një popull, që ka mijëra vjet që jeton në këtë botë të vështirë? A ishte shenjë papjekurie, lodhjeje apo fatalizmi? Së fundi, a ishte e turpshme?”

Nuk kemi dëgjuar e lexuar kund që kjo ngjarje e turpshme të analizohet pse ndodh në një vend të madh si Franca, ku shkrimtari ynë ka 15 vjet që ka zgjedhur strehën e vet të krijimtarisë në moshë pleqërie.

Duke ndjekur me shumë vëmendje debatin mediatic, pas kaq kohësh, me keqardhje mund t'i kujtohet Kadaresë se francezët atëherë “paskan pasur të drejtë” që kanë skematizuar në mënyrë banale simbolin tonë kombëtar!! “Prapësia” franceze nuk na qenka plotësisht e tillë. Simbolet tona kombëtare nuk janë vetëm flamuri, identiteti, gjuha, himni, por në këtë sistem vlerash, përfshihen të gjithë njerëzit e mëdhenj të kombit që i shërbejnë atij. Pse kaq mllef për të sulmuar njeri-tjetrin?

Dy kokat e shqiponjës që zihen të mbysin njera – tjetrën! Në rastin më të pranueshëm, pse habitet shkrimtari i madh me atë që kanë bërë francezët, çfarë po bën konkretisht ai në debatin e përfshirë kundër akademik Qosjes, duke përdorur një zhargon fjalësh të pabesueshëm?! Vallë do të pranohej një rast i tillë si një shembull i keq tek shqiptarët edhe në sy të botës, atë shembull që e shohim përditë të ndikojë kudo në jetën sociale të shqiptarëve, në politikë, në

fushën e gjuhësisë, në biznes, midis hapësirave shqiptare, e kudo tjetër. Vallë të tillë jemi ne, kombi më i vjetër në Evropë, që kemi mbijetuar në historinë tonë të dhimbshme? Si ka mundësi që njerëzit shqiptarë kanë shkëlqyer në shtetet dhe perandoritë e tjera dhe kanë bërë kaq pak kur ka ardhur puna për Shqipërinë? Mos vallë përherë njerëzit e mëdhenj të këtij kombi do të përjetojnë fatin e të parëve? E bukur edhe kjo ëëëë... (!!)

Shkrimtari i madh nuk duhet të harrojë për asnjë çast vlerat e atyre që ka shkruar. Ja si shprehet ai kohë më parë: “Le të pranojmë me trishtim se në krejt Gadishullin Ballkanik, në kohën kur shumica e vendeve u përfshinë nga valët e egra nacionaliste, te shqiptarët ndodhi e kundërta. Kjo ishte e thënë që, pasi u përpoqën t’i japin botës shembullin grotesk të popullit të parë pa fe në botë, majmunët e vendit tonë u joshën nga mbrapshtësia tjetër: të japin shembullin e popullit pa atdhe”.

Nuk besojmë se ky zhargon për pjellat e popullit të përjashtojë edhe të tjerë që nuk dinë të ndalen duke baltosur ndërgjegjen e kombit. Shkrimtari Kadare, duke vuajtur nga deliri i madhështisë dhe i persekutimit, ka mbi 15 vjet që jeton jashtë dhe vjen në Shqipëri vetëm për t’u prezantuar shqiptarëve librat e tij me autografe. Do të tregohem paksa i ashpër për një arsye të thjeshtë: duke mos dashur të sulmoj asnjë nga dy njerëzit e mëdhenj shqiptarë. Kurrë jo. Do t’i dua gjithë jetën dhe në punën time, dhe falë kontributeve, më kanë mbetur pika referimi, veçanërisht akademik Qosja si filozof i mendimit shqiptar për çështjen kombëtare.

Çdo shqiptar do të ndihet i madhëruar, nëse nesër nga kombi ynë do të ketë një NOBELIST në fushën e letrave. Dhe këtë e dëshiron populli shqiptar, që është një popull me atdhe, me historinë e tij të lashtë. Këtë e di mirë dhe shkrimtari i nderuar i Tiranës. Nëse do të pranojmë se imazhin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve e japin këta “majmunë” (gjithmonë sipas Kadaresë) në botë, atëherë ka ardhur koha që këta “majmunë” të vendosen në kopshtin zoologjik të Tiranës, Prishtinës dhe të Tetovës për të kënaqur fëmijët tanë. Sherriada Kadare - Qose, nuk mund të lozë rolin e saj në politikë, si dhe në fushën e letrave dhe të historisë sonë kombëtare. Shërbimi më i mirë që mund t’i bëhet çështjes sonë kombëtare në një rast të tillë, është heshtja. Askush nuk ka të drejtë t’i mbyllë gojën kujt, por ka një moral që e dikton individin të heshtë përballë ngjarjeve të vrullshme, për të cilat pritet prej çdo shqiptari kontribut i madh.

Nuk e paskemi ditur, por “morti” na e thotë se shkrimtari i madh ka qenë në qendër të bisedimeve dhe kontakteve me aktorët e Rambujesë. Ngjarjet e marsit e nxehën keq, sa ai akuzoi shqiptarët se dogjën padrejtësisht kishat ortodokse në Kosovë (!!). Jo, ju atëherë nuk kishit të drejtë. Kosova ka mbi 6 shekuj që i mban dhe i ruan këto objekte kulturi, sepse ato i ka pjesë të kulturës dhe historisë së saj. Kosova ka 6 shekuj që i ka ruajtur dhe pranuar, edhe kur ato kanë pritur në derën e tyre serbë dhe shqiptarë.

Edhe në kohën e shtatë viteve të mbretërimit të OKB-së në Kosovë, shqiptarët nuk preferuan të merren me kishat ortodokse, por i ishin përkushtuar çështjes së pavarësisë së tyre. Përse luftuan dhe u vranë shqiptarët, i nderuar shkrimtar i madh, që të fitojnë lirinë dhe pavarësinë e tyre, apo të djegin kishat që nuk u prishin punë? Koha vërtetoi tjetër gjë.

Edhe Dritëro i madh flet ndonjëherë me modesti, duke pranuar se “...ne shkrimtarët këto punë nuk i dimë, këto janë punë që i dinë shkencëtarët”. Frashërllinjte i kanë shërbyer Shqipërisë, secili në fushën e tij. Naim Frashëri me poemën e tij “Bagëti e Bujqësi”, shprehu filozofinë e tij poetike, por nuk është e njëta gjë me mënyrën se si e shprehu këtë Sami Frashëri, në veprën e tij, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”.

Madhështia juaj do të mbështetet në dorën e pajtimit dhe bashkimit e përpjekjeve për të cilat sot ka shumë nevojë Kosova dhe Shqipëria. Kokat e shqiptonjës nuk kanë arsye të kafshojnë njera-tjetrën. Ato duhet të qëndrojnë ashtu krenare siç janë, me rrënjën e tyre në Tiranë dhe vështrimin nga Kosova dhe Çamëria.

